KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

Organ teoriko-shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes

Nr. 2/2014

Tiranë, gusht 2014

Këshilli Botues i Revistës Ushtarake
Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1304, datë 20.06.2013

Kryetar
Kolonel Ruzhdi Kuçi, Zëvendëskomandant i KDS

Anëtarë
Kolonel Dr. Ahmet Leka
Kolonel Prof. Asc. Dr. Agim Q. Sula
Kolonel Prof. Asc. Dr. Gëzim Mustafaj
Kolonel Prof. Dr. Kristaq Xharo
Kolonel (R) Prof. Dr. Pëllumb Danaj
Kolonel (R) Prof. Dr. Pajtim Ribaj

Shef i Degës së Botimeve
Nënkolonele Majlinda Sallaku

Redaktore
MSc. Silvana Markgjonaj

Faqosja
Teuta Mullisi

Përkthyes
Dr. Jaup Zenuni
MSc. Granit Zela

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2012 nga Qendra e Doktrinës (QD) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes).

Copyright © 2012 by the Center for Doctrine (CD) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pareferuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në *website* http://www.tradoc.mil.al/

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkoni në internet lutemi të kërkoni një kopje të tij në adresën: e-mail: *revistaushtarake@aaf.mil.al* ose *qd@aaf.mil.al*

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

Qendra e Doktrinës

Dega e Botimeve

Shtypur: gusht 2014

PËRMBAJTJA

300 ditë qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes 5
Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes

Lufta kundër korrupsionit në FA 8
Dritan Hila, Zv. Ministër i Mbrojtjes

Reforma ligjore dhe ristrukturimi i FA-ve 11
Yllka Lamçe, Drejtor i Drejtorisë Juridike në MM

Dinamika operacionale në Forcat e Armatosura 15
Kolonel Idriz Haxhiaj
Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në SHPFA

Angazhimi i strukturave të FA-ve në operacionet në ndihmë të komunitetit 18
Kolonel Manushaqe Shehu
Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA

RUBRIKA E PARË: FARSH, në përgjigje të sfidave të reja, në prag të Samitit të Uellsit

Sfida dhe vlerësime të reja në prag të Samitit të Uellsit 21
Karl-Heinz Kamp
Drejtor i Departamentit të Punës Kërkimore në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s

Samiti i Uellsit dhe Shqipëria 32
Kolonel Manushaqe Shehu, Drejtor i J9, SHPFARSH

Një vështrim rreth Samitit të Uellsit 41
Kolonel (R) Thimi Hudhra, Zv.drejtor i QKSM

RUBRIKA E DYTË: Nevoja për një Strategji të Re të Arsimimit Profesional Ushtarak (SAPU)

Një konceptim i ri i arsimimit dhe trajnimit ushtarak në FA 49
Kolonel Ruzhdi Kuçi, Zv.komandant i KDS
Kolonel Ahmet Leka, Shef i QD

Koncepte dhe ide për arsimimin, trajnimin dhe përgatitjen e nëpunësit të inteligjencës shtetërore 60
MSc. Nënkolonel Sokrat Paskali
Shef i Qendrës së Trajnimit të Inteligjencës "Shawn Pine" në AIM

Edukimi mjedisor i personelit të FARSH nëpërmjet legjislacionit 69
MSc. Valbona Zeka, Pedagoge e Edukimit Fizik në AFA

RUBRIKA E TRETË: Analiza, Sinteza dhe Vlerësime të Sigurisë

Koncepti Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës si pjesë thelbësore e fuqizimit të shtetit 77
Agim Çeku, Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës

"Task Force" - Një koncept pragmatist, po aq edhe modern 85
Qendra e Doktrinës

NRF, pjesëmarrja dhe perspektiva e FA-ve shqiptare në këtë strukturë 95
Kolonel Ilir Pujo
Zv.përfaqësues Ushtarak për Operacionet, SHAPE, Mons, Belgjikë

Krimea: Parajsa e rifituar e Rusisë?! 102
Enkelejda Malaj

Lidershipi në luftim 109
Kolonel Dritan Demiraj, Shef i Qendrës së Simulimit, KDS

Shqipëria dhe sfidat e sigurisë 118
Nënkolonel Ali Mali, Shef i Degës së Mësimeve të Nxjerra, QD

Forcat e Armatosura dhe familja si "greedy institutions" 130
Nënkolonel MSc. Latif Shurdhi, Pedagog në AFA

Të panjohurat e "Botës" së Paqeruajtjes dhe Paqebërjes 139
Kolonel Dr. Zaho Golemi
MSc. Granit Zela

RUBRIKA E KATËRT: Punime historike

Strategjia e "Përgjigjes Fleksibël", strategjia e reagimit proporcional ndaj kërcënimeve 150
MSc Agron Malaj, Nënkolonel Aleksandër Pando, AFA

Fillesat e komunikimit diplomatik në komunitetet ilire 169
Dr. Jaup Zenuni, Pedagog në AFA

Karakteristikat e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Luftarake Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore (LANÇ) 181
Dr. Asllan Zemani, historian ushtarak, MSc. Afërdita Hajro, specialiste në AQSH

Përmbledhje në anglisht 198

Kujtesë për bashkëpunëtorët 210

*300 ditë qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes**

Mimi Kodheli
Ministër i Mbrojtjes

Kemi mbushur 300 ditë së bashku në këtë përpjekje për të transformuar rrënjësisht një realitet, i cili po bëhej gjithnjë e më shumë problematik me kalimin e ditëve. Po e nis fjalën pikërisht me transformimin e realitetit problematik, sepse kjo ka qenë sfida e parë e përpjekjes tonë të përbashkët që nga dita kur nisëm punën, në atë mes shtatori të vitit 2013. Kam hyrë në Ministrinë e Mbrojtjes në një ditë gri, çuditërisht me një shi të beftë shtatori dhe mes një atmosfere të nderë. Simbolikat ishin të shumta dhe të spikatura. Por, ajo që pashë në sytë e disa prej ushtarakëve që më pritën atë 16 shtator, më la të kuptoja një gjë të qartë dhe të vetme.

Në këtë strukturë nuk vlente më karriera, profesionalizmi, aftësitë, por vetëm vështrimi i ministrit dhe lidhja me partinë në pushtet. Një menaxhim personeli jashtë çdo imagjinate dhe parashikimi, një situatë financiare e goditur rëndë nga borxhet e akumuluara ndër vite, një bazë ligjore e cila i përkiste periudhës 2003-2005, përbënin thelbin e realitetit në të cilin ju, të nderuar ushtarakë, përpiqeshit t'i mbijetonit sistemit.

Por përgjigjet e dilemave të mia i gjeta mes jush. Që në orët e para, u takova me burra dhe gra në uniformë, të cilët vazhdonin të luftonin për dinjitetin e tyre. Mes jush, të nderuar miq në uniformë, gjeta zgjidhjet për përmirësimin e situatës. Forcat e Armatosura në thelb janë të bazuara në rregull, traditë dhe nder. Këta elementë, të kombinuar me ruajtjen e vlerave demokratike dhe kontrollin civil mbi Forcat e Armatosura, i gjeta të cenuar rëndë.

Dhe përsëri e theksoj, zgjidhjet i gjeta mes ushtarakëve dhe për ushtarakët. Ka gjithmonë dritë në fund të tunelit. Drita ishit ju. Programi i Qeverisë për 300 ditët e para në fushën e Mbrojtjes, përmban objektiva ambiciozë të cilat kërkojnë vijimin e reformave dhe transformimin e mëtejshëm të Forcave tona të Armatosura, krijimin e kapaciteteve të nevojshme ushtarake për përballimin e sfidave të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe vendosjen e tyre në lartësinë që meritojnë në shoqërinë shqiptare.

Në qendër të reformave është lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, legjislacionit, promovimit në karrierë, rritjen e transparencës, llogaridhënies, si dhe në eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

---

* Fjalë e mbajtur në analizën "300 ditët qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes" më 15 korrik 2014

Struktura e re e Forcave të Armatosura

Një nga dokumentet e para strategjike që u hartua në fillimet e 300-ditëshit tonë të parë, ishte dhe struktura e re e Forcave të Armatosura, në përgjigje të realiteteve në të cilat gjendemi dhe në funksion të burimeve që janë në dispozicion. Nuk e kishim menduar që edhe për strukturën do të hasnim një rezistencë të pakuptimtë, të paargumentuar dhe shumëmujore, por i rëndësishëm është fakti që prej pak ditësh e kemi në dorë strukturën dhe kemi nisur programin për implementimin e saj. Struktura vazhdon të vërë fokusin në një forcë të vogël numerikisht, por sa më mirë të pajisur dhe trajnuar, sipas standardeve të NATO-s.

Kuadri ligjor

Paralelisht me hartimin e strukturës së re, nisëm punën për përmirësimin e kuadrit ekzistues ligjor që rregullon mbarëvajtjen e Forcave tona të Armatosura, si në raport me detyrimet ndaj Aleancës, por dhe në funksion të realiteteve të reja që po kalojmë. Ligji i ri për Autoritetet dhe Pushtetet në Forcat e Armatosura, ka përcaktuar qartë zinxhirin drejtues dhe përgjegjësitë kushtetuese të çdo autoriteti të komandimit. Anëtarësimi në NATO, qenia pjesë e strukturave operacionale të Aleancës, sillte si domosdoshmëri sjelljen e praktikave me të mira të vendeve tona partnere. Jam e bindur se, bazuar në propozimet e vetë strukturave të Forcave të Armatosura, kemi bërë të mundur një përkufizim më të qartë të punës sonë të përditshme. Thelbësisht në këtë frymë është dhe ligji për Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura. Nuk do të ndalem në detajet e teknikës legjislative, por thjesht dua të them se jemi të vendosur të çojmë deri në fund atë që kemi nisur. Asnjë interes personal mbi të mirën e përgjithshme, asnjë kompromis me zbatimin dhe respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve në funksion të saj.

E padyshim, nuk mund të le pa përmendur ligjin e ri për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. A e kishte menduar njeri se në shekullin e 21-të, në një vend anëtar të NATO, në një vend kandidat për në Bashkimin Evropian, shërbimi inteligjent ushtarak të përdorej kundër opozitës si në skenarë juntash të republikave të bananeve. Dhe hileja qëndronte që në objektin e veprimtarisë së shërbimit. Në zbatimin e ligjit të ri nuk do të ketë më vegla në shërbim të partive në pushtet. Ligji dhe vetëm ligji do të mbizotërojë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Reforma në personel

Në këto 300 ditë të para, nga kolegët ushtarakë kam kërkuar një gjë thelbësisht parimore: ngritjen e sistemeve. Sistem transparent, të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë të interesuarit, për përparimin në gradë, trajnimet, kurset, pjesëmarrjen në operacione. Kudo. Dhe po ia arrijmë. Në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm kemi krijuar një frymë të re e cila po i jep efektet e saj. Standardet e NATO-s dhe përvojat më të mira janë në thelb të asaj që po bëjmë. Nuk ka kthim mbrapa. Kemi nisur një projekt pilot tepër interesant me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që do të shërbejë si guri i themelit për konsolidimin e këtij sistemi në të ardhmen.

Batalioni i Këmbësorisë së Motorizuar

Modernizimi i Forcave të Armatosura me armatim, teknikë, pajisje dhe sisteme të zhvillohet në përputhje me objektivat e planit afatgjatë, duke synuar plotësimin e kapaciteteve operacionale për pjesëmarrjen në misionet brenda dhe jashtë vendit. Për vite me radhë i ishte premtuar Aleancës që kjo njësi do të ishte e gatshme, si detyrimi ynë kryesor në kuadër të kapaciteteve të kërkuara nga NATO. Nuk dua ta zgjas me *si*-të dhe *pse*-të. Ju

ushtarakë e dini më mirë se unë arsyet e vërteta të vonesës. Në këto 300 ditë të para, i caktuam përparësitë, i vumë piketat dhe jam krenare të them se ky batalion do të ketë armatim dhe pajisje të standardeve të NATO-s, brenda këtij viti. Për herë të parë, një njësi ushtarake shqiptare nuk do të përdorë më kallashnikovin si pjesë e armatimit personal, por karabinën M4, e cila përdor municion të kalibrit 5.56mm të NATO-s.

Pjesëmarrja në operacione

Shpreh mirënjohjen e thellë ndaj të gjithë atyre që shërbejnë, së bashku me aleatët tanë, në misionet tona jashtë vendit, në ruajtje të paqes dhe sigurisë. Ata do të mbeten pjesa më jetësore e shoqërisë dhe e Forcave tona të Armatosura. Ne mbetemi tërësisht të angazhuar të kontribuojmë edhe pas përfundimit të misionit ISAF. Do të jemi të pranishëm në të gjitha frontet e Aleancës. Po shikojmë mundësinë e angazhimit edhe në operacionet e Bashkimit Evropian. Një vend kandidat merr përsipër edhe përgjegjësi. Dhe ne jemi gati.

Angazhimet në ndihmë të komunitetit

Shqipëria, nga një vend i cili do të përpunonte mbetjet e veta dhe të disa vendeve evropiane, ishte shndërruar në një përqendrim hedhurinash, në çdo pikë kalimi kufitar. Ishit ju, të nderuar ushtarakë, që pastruat të gjitha pikat hyrëse në Shqipëri nga përqendrimi i më shumë se plehrave, i paaftësisë dhe indiferencës. Ishit ju, kolegë në uniformë, që pastruat nga mbeturinat dhjetëra kilometra plazhe dhe i bëtë gati për sezonin e ri turistik. Jeni ju, ushtarakë të Forcave të Armatosura, që po përmirësoni kushtet e sigurisë në plazhe dhe zonat shlodhëse në bregdet me praninë tuaj gjatë gjithë sezonit turistik.

Gjatë këtij 300-ditëshi, ne përmirësuam rrënjësisht menaxhimin financiar dhe kontrollin, që çdo qindarkë e destinuar për FA të shkojë detyrimisht aty ku është projektuar. Në funksion të mirëmenaxhimit të parave u ngrit një audit funksional, i cili po mbështet arritjet e objektivave tona për përdorimin efektiv dhe efikas të të gjitha burimeve ekonomike.

Infrastruktura

Që në fillim të herës, ne ndërpremë gjithë veprimtarinë abuzive me pronat e Forcave të Armatosura. Kemi nisur një proces rigoroz të verifikimit dhe plotësimit të dokumentacionit për çdo pronë.

Korrupsioni

Numri i dosjeve që kemi çuar në prokurori do të vazhdojë të shtohet, për këtë ju garantoj. Çdo qindarkë e shpenzuar nga buxheti i Mbrojtjes do të kalojë në lupën e drejtësisë. Dhe këtu dua të bëj të qartë një gjë. Korrupsionin do ta luftoj fort, shumë fort. Dhe nuk e kam kokën vetëm mbrapa. Po shoh, ndjek me vëmendje dhe ruaj çdo veprimtari financiare që mund të ketë pasoja korruptive. Askush nuk është më i paprekshëm.

Në këto 300 ditë kanë ndodhur shumë ngjarje të cilat kanë formatuar karrierat tona. Kemi pasur dhe momente shqetësuese, por edhe, njëkohësisht absurde, akuzash të pabaza si ato për trafik droge. Por ne nuk do ta lejojmë askënd të na tregojë më me gisht: as hajdutët, as abuzuesit.

Për një gjë jam e bindur: që ndihem e privilegjuar e krenare që punoj mes jush, duke ditur kufizimet e vështirësitë që hasni çdo ditë. Të gjithë duhet të ndihemi të tillë dhe t'i shërbejmë atdheut. Misioni ynë është një dhe i vetëm, mbrojtja e të ardhmes. Më shumë punë na pret. Dhe mos harroni, me profesionalizmin dhe përkushtimin tuaj, ditë më të mira na presin.

*Lufta kundër korrupsionit në FA**

Dritan Hila
Zv. Ministër i Mbrojtjes

Jemi sot këtu për të bërë një bilanc të gati një viti që shkoi, që kur koalicioni i majtë dhe qeveria shqiptare mori besimin plebishitar të shqiptarëve, për të parë se ku jemi me objektivat që i kishim vënë vetes. Ndërmjet shumë të tillave, unë sot do të flas për korrupsionin, luftën ndaj tij, papajtushmërinë me të, përpjekjet që po bëjmë për ta reduktuar.

Një ushtri thyhet më kollaj nga korrupsioni, se nga kundërshtari. Kur oficerët përvetësojnë pronën, promovojnë në bazë të miqësive, rriten në gradë jo në bazë të aftësive por njohjeve, atëherë shpirti i kësaj ushtrie është brejtur nga brenda dhe një hap e ndan nga kapitullimi.

Në fillimet e saj, Roma ishte perandoria e pathyeshme, pasi thonë se kur legjionet e saj fushonin rreth një molle me fruta të pjekura, po ashtu ishte ajo pemë edhe në mëngjes kur njerëzit largoheshin. Roma qëndroi e tillë, deri kur komandanti i legjionit këputi një kokërr. Atëherë e mbrapa, krimbi i përvetësimit, brejti nderin e ushtrisë dhe bënë që perandoria të shkërmoqej. Romën, Bizantin, Otomanët, Traktatin e Varshavës nuk i mundën kundërshtarët, por ajo që sot quhet korrupsion, trafik influence, shkelje e rregullave të lojës, mumifikim i strukturave. Amerikanët dhe NATO qëndrojnë në këmbë, sepse lufta e tyre për një moral të lartë të shoqërisë dhe ushtrisë e për mundësi të barabarta, është e njëmendtë.

Lufta jonë kundër korrupsionit është mbështetur në katër drejtime kryesore:

Së pari, verifikimi dhe krijimi i strukturës së luftës antikorrupsion

Në këtë kuadër, kemi bërë transparencë në buxhetin e mbrojtjes; kemi bërë kujdes në menaxhimin e aseteve të mbrojtjes veçanërisht në pronat; kemi kontrolluar veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes; dhe nëpërmjet AKSHE, kontrollin e eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake, apo atyre më përdorim të dyfishtë.

Për personelin e Forcave të Armatosura është verifikuar me transparencë procedura e emërimeve dhe gradimeve të personelit ushtarak si dhe rekrutimi dhe arsimimi profesional në FA.

Për financat e mbrojtjes janë kontrolluar procedurat e prokurimeve, veçanërisht atyre në AIM dhe prokurimet e drejtpërdrejta si dhe është kontrolluar përdorimi i fondeve për projektet ushtarake apo fondeve specifike.

---

*Fjalë e mbajtur në analizën "300 ditët qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes" më 15 korrik 2014

Për të monitoruar realizimin e këtij planveprimi, është krijuar njësia antikorrupsion, e cila funksionon si Drejtori e Inspektimit të Përgjithshëm dhe Antikorrupsionit në Ministrinë e Mbrojtjes që nxjerr në pah denoncimet e qytetarëve apo punonjësve të MM dhe Forcave të Armatosura, për rastet e korrupsionit. Në këtë drejtori funksionon gjithashtu edhe pika e kontaktit e Ministrisë së Mbrojtjes për Komitetin Ndërinstitucional që drejtohet nga Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundërkorrupsionit.

Ne jemi të bindur se korrupsioni, përpara se me goditjen ndaj individëve të caktuar, ka të bëjë me ngritjen e institucioneve të shëndosha, të bazuara në kuadër ligjor që zvogëlon mundësitë e abuzimit. Për këtë, në periudhën shtator 2013-korrik 2014, janë rishikuar dhe përmirësuar kuadri ligjor e ai rregullativ.

Ndaj drejtimi i dytë ka qenë përmirësimi i të gjithë kuadrit ligjor mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Forcave të Armatosura.

Tashmë, kemi ose janë në prag të votimit tre ligje të rëndësishme për:

- Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes.
- Pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Gradat dhe Karrierën Ushtarake në FA të RSH.

Ndërkohë janë përgatitur dhe po shqyrtohen në ministri projektligjet si më poshtë:

- Projektligji për disiplinën ushtarake
- Projektligji për Policinë Ushtarake.

Ndryshimet e propozuara në kuadrin ligjor të sipërcituar, do të lehtësojnë punën për menaxhimin e burimeve njerëzore në rekrutimin e shtetasve që dëshirojnë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, për përmirësimin e procedurave për arsimimin, kualifikimin dhe karrierën ushtarake të personelit ushtarak, si dhe për menaxhimin e burimeve të mbrojtjes.

Drejtimi i tretë ka të bëjë me ndryshimet në procedurat e emërimeve, arsimimit dhe gradimit të personelit në nivele të ndryshme të drejtimit të Forcave të Armatosura.

Për këtë qëllim po punohet për hartimin e politikave të menaxhimit të personelit, hartimit të rregulloreve të komisioneve të karrierës ushtarake, si dhe të kritereve në përzgjedhjen e kontingjenteve të ndryshme që marrin pjesë në misione të ndryshme në kuadër të NATO-s apo organizatave të tjera ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, janë realizuar me efektivitet lëvizjet në personelin e niveleve të ndryshme të komandimit dhe drejtimit të strukturave të Forcave të Armatosura, për të cilët ka patur sinjalizime për veprimtari korruptive. Emërimi në vend të tyre i personelit më të kualifikuar profesionalisht dhe me integritet të lartë moral, ka filluar të përmirësojë imazhin e dëmtuar të FARSH. Por kjo është një përpjekje në vazhdim.

Dhe së katërti, rritja e transparencës për administrimin në të shkuarën e fondeve publike dhe Forcave të Armatosura, është tjetër përpjekje e jona si menaxhim i ri politik i kësaj shtylle të rëndësishme të shtetit.

Në opinionin tonë, në të shkuarën e afërt, Forcat e Armatosura janë përdorur jashtë misionit të tyre kushtetues dhe kemi dyshime të forta të shpërdorimit të fondeve publike,

pronave të FA, shkeljet në procesin e rekrutimit, të emërimeve e gradimeve të personelit ushtarak dhe arsimimin profesional në FA.

Në përfundim të kontrolleve dhe inspektimeve të realizuara, janë kallëzuar për ndjekje penale ish-ministri i mbrojtjes, ish-shef i shtabit të përgjithshëm, gjeneralë, komandantë njësish ushtarake, shefa degësh apo specialistë në strukturat e ndryshme në MM dhe Forcat e Armatosura.

15 raste me akuzat "Shpërdorim detyre dhe i kontributeve të dhëna nga shteti", "Vjedhje" "Falsifikim dokumentesh zyrtare", "Përdorim i Forcave të Armatosura jashtë misionit të tyre kushtetues", "Tejkalim kompetencash" në fushën e menaxhimit të personelit, "Shkelje e procedurave të emërimeve, arsimimit dhe gradimit të personelit" në nivele të ndryshme të drejtimit të Forcave të Armatosura**,** kanë qenë çka është konstatuar nga kontrollet e bëra deri më sot.

Nga pikëpamja administrative (aq sa është mundësia e drejtuesve politikë për shëndoshjen e situatës dhe vendosjen e drejtësisë), është larguar nga detyra shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, për shkak të keqmenaxhimit të burimeve të mbrojtjes dhe janë kryer lëvizje të personelit të niveleve të ndryshme të komandimit dhe drejtimit të strukturave të Forcave të Armatosura, për të cilët ka patur sinjalizime për veprimtari korruptive.

Nuk mund të thuhet se prokuroria dhe drejtësia ka pasur të njëjtin përkushtim në ndjekjen e këtyre rasteve, edhe atëherë kur abuzimi është i dukshëm. Por kjo nuk do të thotë se ritmi ynë, sa i takon rritjes së performancës së FA e MM dhe goditjes së fenomenit negativ, do të dekurajohet.

Kjo ishte në vija të përgjithshme sa kemi bërë në këto ditë. Ende kemi shumë për të bërë.

*Reforma ligjore dhe ristrukturimi i FA-ve**

Yllka Lamçe
Drejtor i Drejtorisë Juridike në MM

Më lejoni të paraqes disa nga sfidat më të rëndësishme me të cilat është përballur Ministria e Mbrojtjes në 300 ditëshin e parë të veprimtarisë së saj. I referohem reformës legjislative, ristrukturimit të FA-ve, si dhe procesit të modernizimit dhe rivendosjes së standardeve.

Reforma ligjore

Reforma ligjore ka konsistuar në punën intensive për të hartuar një paketë ligjesh që rregullojnë veprimtarinë e FA-ve. I referohem ligjit për "Pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit strategjik të FARSH", ligjit për "Karrierën ushtarake në FARSH" dhe ligjit për "Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes". Ligjet e mëparshme që rregullonin fushat përkatëse të mësipërme ishin miratuar prej rreth 11 vjetësh tashmë dhe nevoja për rishikimin e tyre paraqitej e domosdoshme edhe në kuadrin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, më 2009. Nga analiza që është kryer në Ministrinë e Mbrojtjes doli e qartë se puna për rishikimin e platformës ligjore mbi të cilën veprojnë FA-të, nuk mund të kufizohej vetëm në ndryshimin e ligjeve ekzistuese, qoftë për shkak të përmbajtjes së ligjeve, qoftë dhe për shkak të teknikës legjislative të përdorur në hartimin e tyre.

Ligji për "Pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit strategjik të FARSH"

Ligji për "Pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit strategjik" ka ridimensionuar pushtetet dhe autoritetet e komandimit si dhe kompetencat e tyre, në përputhje me zbatimin e parimit demokratik të kontrollit dhe drejtimit civil mbi Forcat e Armatosura. Gjithashtu janë ripërcaktuar nivelet strategjike dhe operacionale të përgjegjësisë për drejtimin dhe komandimin e Forcave të Armatosura, si dhe është bërë një përkufizim më i qartë i zinxhirit të drejtimit dhe të komandimit të tyre. Ndryshimet e sjella janë hartuar në përputhje me modelet më të mira të vendeve partnere të NATO-s, si dhe në harmoni me legjislacionin e brendshëm.

Ligji për "Karrierën ushtarake në FARSH"

Përsa i përket ligjit për "Karrierën ushtarake", edhe në këtë rast nevoja për rishikimin e plotë të tij, erdhi pas zbatimit prej gati 11 vjetësh. Ligj i ri synon të korrigjojë një sërë mangësish si p.sh. ashpërsinë e sistemit të nxjerrjes në rezervë të ushtarakëve, për më tepër në kulmin e prodhimtarisë së tyre intelektuale dhe fizike, gjë që nënkupton edhe një impakt financiar të rëndësishëm për buxhetin e shtetit. Ligji i ri bën të mundur rritjen e moshës për dalje në rezervë/lirim të ushtarakëve të karrierës, duke synuar të promovojë

*Fjalë e mbajtur në analizën "300 ditët qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes" më 15 korrik 2014

një sistem karriere për ushtarakët dhe një ndarje të sistemit të karrierës nga ai i shërbimit të përkohshëm në FA. Ligji i ri sjell gjithashtu përmirësime të sistemit të karrierës, bazuar në meritën, profesionalizmin dhe performancën, ku secilit i jepen shanse të barabarta për t'u arsimuar, trajnuar, kualifikuar dhe përparuar në karrierë. Ky ligj është në linjë dhe me përparësitë e Ministrisë së Mbrojtjes për lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut.

Ligji për "AISM"

Nisma për hartimin e ligjit të ri për "Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes" lidhet me direktivën e Këshillit të Ministrave dhe është zbërthyer në programin e punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Kjo për një sërë arsyesh që lidhen me:

a) ndryshimin e ambientit të sigurisë dhe natyrën e kërcënimeve e rreziqeve, me të cilat përballen FA-të në kryerjen e misionit të tyre;
b) mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të ligjit ekzistues për AIM;
c) përfshirjen e veprimtarisë së komponentëve të inteligjencës dhe sigurisë në FA-të dhe ushtrimit të ligjshëm të veprimtarisë së tyre;
d) partneritetin dhe pjesëmarrjen në operacionet e përbashkëta me shërbimet partnere të vendeve të NATO-s.

Dispozitat e ligjit për "AISM" janë mbështetur në filozofinë e organizimit dhe funksionimit të një institucioni inteligjence të një vendi anëtar të NATO-s që funksionon bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, asnjanësisë politike, etj. Siguria kombëtare nuk ka të bëjë vetëm me një institucion, por me komponentë të ndryshëm thelbësorë për ekzistencën e një shteti, që japin kontributin e tyre në funksion të sigurisë kombëtare, ku AISM kontribuon nëpërmjet realizimit të detyrave të saj funksionale.

Projektligji për SSK

Gjithnjë në kuadrin e reformës ligjore, vlen të theksohet nisma ndërinstitucionale për hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK). Procesi i hartimit të strategjisë është fokusuar në analizën e të gjithë elementëve përbërës të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, ndër të cilët edhe ata që lidhen me fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë këtij procesi janë konsultuar një sërë materialesh ku përfshihen strategjitë e vendeve të tjera të rajonit dhe NATO-s, dokumente zyrtare të prodhuara nga institucionet vendase, dokumente strategjike të organizatave ndërkombëtare, etj. Ky projekt është një detyrim që Shqipëria po realizon si anëtare e NATO-s. Aktualisht projektligji është në fazën e shqyrtimit në komisionet parlamentare dhe pritet të kalojë së shpejti për miratim në kuvend. Miratimi i këtij dokumenti ka ecur paralelisht me përgatitjen e draftit të strategjisë ushtarake të mbrojtjes.

Rishikim i strukturës së FA-ve

Në kuadrin e ndryshimit të mjedisit të sigurisë, është konceptuar edhe rishikimi i strukturës së Forcave të Armatosura. Kështu është synuar kalimi nga forca aktuale me personel prej 10.190 vetësh, në forcën me personel prej 8500 vetësh, objektiv që mendohet të realizohet deri në vitin 2015. Struktura e re është hartuar duke vlerësuar me kujdes përcaktimin e rajoneve më të mundshme të dislokimit të njësive dhe reparteve, e cila i është nënshtruar një analize të thellë, diskutimeve të gjata në Ministrinë e Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura si dhe në komandat e Forcave. Gjatë përgatitjes

së saj është bashkëpunuar ngushtë me ekipin amerikan të ekspertëve CUBIC. Struktura e re dhe Plani i Vendosjes dhe Përhapjes së FA u miratua nga Presidenti i Republikës në muajin qershor 2014. Aktualisht në SHPFA po përgatiten Tabelat e Organizmit dhe Pajisjeve të FA, urdhrat e kalimit në strukturën e re, të cilat priten të miratohen së shpejti. Ndryshimi kryesor i strukturës së re konsiston në reduktimin e komandave kryesore nga 7 në 5, në unifikimin e strukturave mbështetëse në një komandë të vetme, si dhe në adresimin më të plotë të kërkesave të paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s. Objektivi kryesor i ndryshimeve në strukturën e Forcave të Armatosura është zhvillimi i një force me aftësi të plota operacionale, të ndërveprueshme, fleksibël dhe efiçente, që të jetë në gjendje të realizojë detyrat e saj, si dhe të kontribuojë në misionet e NATO-s, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga ky anëtarësim.

Rivendosja e standardeve/Modernizimi

Rivendosja e standardeve/Modernizimi është pjesë e rëndësishme e angazhimeve të ndërmarra nga MM. Kështu vlen të përmendet projekti "Për pajisjen e FD me katër anije patrulluese të mëdha". Pas ndryshimeve në mision si dhe në mjedisin e sigurisë, u bë i domosdoshëm zëvendësimi i anijeve të vjetra luftarake me anije të reja shumëfunksionale. Anija më e fundit që u bë pjesë e inventarit të FD është anija "Butrinti". Kjo anije u ndërtua në kantierin detar të Pashalimanit. Anija "Butrinti", e katërta e klasit "Iliria", shënon dhe përfundimin me sukses të projektit më të rëndësishëm të Forcës Detare në rrugën e saj të modernizimit.

Anijet, pjesë e këtij projekti, kanë rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale për kontrollin dhe monitorimin e trafikut detar, mbrojtjen e mjedisit detar, kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, zbatimin të ligjshmërisë dhe rritjes së sigurisë detare.

Kontrata me Eurocopter

Ministria e Mbrojtjes, në vitin 2009, ka lidhur me shoqërinë "EUROCOPTER" kontratën për blerjen e 5 helikopterëve shumërolësh *Cougar*. Me blerjen e realizuar deri më sot nëpërmjet kësaj kontrate është rritur ndjeshëm operacionaliteti i Forcës Ajrore për realizimin e misionit të tyre. Aktualisht, prej 5 helikopterëve të kontraktuar, janë marrë në dorëzim tre helikopterë *Cougar*. Në kushtet kur helikopteri VIP u rrëzua gjatë kryerjes së testimit përfundimtar, u bë i domosdoshëm rinegociimi i termave të kontratës. Pas analizës së kryer nga strukturat përkatëse për modernizimin e Forcave të Armatosura si dhe vlerësimin e leverdishmërisë funksionale dhe operacionale, lidershipi i këtij institucioni vendosi për zëvendësimin e helikopterit *Cougar* VIP me dy helikopterë të tjerë të modelit *SAR*. Padyshim që ky amendim i kontratës favorizoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, pasi të dy këta helikopterë nuk do përdoren më për qëllime transporti të personaliteteve, por janë konceptuar në shërbim të qytetarëve. Projektligji për amendimin e kontratës në fjalë ka kaluar fazën e shqyrtimit në komisionet parlamentare dhe aktualisht pritet të miratohet në kuvend.

Rivendosja në funksionim e sistemit të radarëve

Së fundi, sjellim në vëmendje punën intensive që është bërë për rritjen dhe përmirësimin e standardeve që orientojnë veprimtarinë e FA-ve, përsa i përket rivendosjes në funksionim të sistemit të radarëve, për vëzhgimin e hapësirës detare, i cili nuk funksiononte prej 3 vjetësh. Ministria e Mbrojtjes u angazhua për rivënien në funksionim të këtij sistemi në pak muaj, dhe me kosto mjaft të reduktuara, krahasuar me pritshmëritë e përvojës së

mëparshme. Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIHVD) është një element mjaft i rëndësishëm për mbështetjen e veprimtarisë së Forcës Detare dhe për Sigurinë Kombëtare. Me mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes, në dhjetor 2013, u bë e mundur që shtatë radarët, së bashku me pjesë të tjera përbërëse të sistemit, të vendosen në gjendje pune dhe aktualisht ky sistem është në gatishmëri të plotë operacionale.

*Dinamika operacionale në Forcat e Armatosura**

Kolonel Idriz Haxhiaj
Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në SHPFA

Forcat e Armatosura vazhdojnë të jenë të angazhuara intensivisht në operacione të një spektri të gjerë, kombëtar e ndërkombëtar, në ndihmë të popullsisë, emergjencave civile, si dhe në mbështetje të autoriteteve lokale.

Gjatë këtij viti, ato kanë marrë dhe janë pjesë në operacionin ISAF në Afganistan, KFOR në Kosovë, ALTHEA në Bosnjë Hercegovinë, në misionin vëzhgues të zhvilluar në fillimet e krizës në Ukrainë si dhe janë pjesë aktive e programit të masave të sigurisë që NATO ka ndërmarrë në interes dhe për përballimin e kësaj krize. Kontributet tona në operacionet e NATO-s, gjatë këtij viti, jo vetëm janë zgjeruar, duke bërë që FA të jenë pjesë e 4 operacioneve të saj dhe të përfaqësohen në 10 shtabe të NATO-s, por ato shënojnë angazhimin më cilësor dhe nivelin më të lartë që FA kanë ndërmarrë që nga anëtarësimi në NATO, duke shërbyer me ekipe trajnimi, këshilltarë, përfaqësues të lartë ushtarakë në shtabe e komanda të niveleve të ndryshme.

Në fushën e gatishmërisë operacionale, objektivi i MM-së dhe FA për këtë periudhë ishte sigurimi i kapaciteteve të plota për t'iu përgjigjur nevojave, si në kuadër kombëtar ashtu edhe ndaj operacioneve të NATO-s. Programet e ndërmarra, kohët e fundit, për zhvillimin e forcës ushtarake, siç janë: rishikimi i kontratës me kompaninë EUROCOPTER, me synim shtimin e numrit të helikopterëve të Forcave Ajrore; ndërtimi i katër anijeve të klasit "Iliria"; modernizimi i b2k dhe fillimi i procesit te zëvendësimit, brenda vitit, të armatimit individual të ushtarit me armë të kalibrit 5.56 për k1b2k, sigurimi i pajimeve/ setit të ri individual të ushtarit, jo vetëm që do të sigurojnë kapacitete të mirëfillta ushtarake, por do të garantojnë ndërveprueshmëri të plotë me aleatët tanë në operacionet e ardhshme.

Certifikimi i b2k, gjatë muajit të kaluar, nga ekipet e NATO-s në stërvitjen më të madhe fushore "*Biza 14*", e rreshtuan këtë repart si pjesë të kapaciteteve të aleancës. Po kështu, deklarimi i Togës së PU si pjesë e Forcave të Reagimit të Shpejtë të NATO-s për vitin 2014, janë treguesit më domethënës që tregojnë se FA janë bërë tashmë pjesë organike dhe përbërëse e NATO-s dhe kapaciteteve të saj.

Gjate këtij viti, Forcat e Armatosura kanë synuar që arsimimin dhe stërvitjen ta kthejnë në përparësinë kryesorë të tyre. Një gjë e tillë është bërë e mundur, jo vetëm nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në këtë proces, por edhe nga përmirësimi cilësor i tij.

---

*Fjalë e mbajtur në analizën "300 ditët qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes" më 15 korrik 2014

Puna që po bëhet nën kujdesin e ministrit të Mbrojtjes, për hartimin e Konceptit të Ri të Arsimimit Profesional Ushtarak (SAPU), rishikimi dhe përshtatja e organizimit të institucioneve arsimore, në përputhje me madhësinë e forcës dhe nevojat reale të saj, konsolidimi dhe rritja e cilësisë mësimdhënëse, përfaqësojnë masat konkrete të ndërmarra me ndikim pozitiv në këtë fushë. Projekti i filluar në muajin prill të këtij viti, në bashkëpunim me SHBA, ku 26 studentët e parë ushtarakë shqiptarë do të përgatiten për oficerë të rinj në Shkollën e Kandidatëve për Oficerë të Gardës Kombëtare të *New Jersey*-t, do të shënojë ndryshimin e duhur në profilin e oficerit të ri të FA-ve. Jo vetëm kaq, por kohëzgjatja e pritshme e këtij projekti për një periudhë 5 vjeçare dhe zbatimi i të njëjtit sistem në akademitë tona do të bëjnë që korpusi i oficerëve të ardhshëm të kultivohet e përgatitet në bazë të sistemit më të përparuar dhe bashkëkohor.

Pas një periudhe të gjatë tranzicioni, por edhe të një angazhimi të gjerë në operacione, repartet i janë kthyer stërvitjeve intensive. Në periudhën tetor 2014-qershor 2015, numri i ushtarakëve që kanë marrë pjesë në kurset institucionale është afërsisht 2900 vetë ose 30% e numrit të përgjithshëm të FA-ve. Të gjitha repartet operacionale kanë zhvilluar të paktën nga një stërvitje fushore dhe të gjitha shtabet e tyre kanë kaluar në stërvitje shtabi e planëzimi. Vetëm në Qendrën e Simulimit, gjate këtij viti, janë zhvilluar 12 stërvitje planëzimi, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt në aftësimin e shtabeve e rritjen e aftësive kolektive të njësive.

Institucionet arsimore të FA-ve janë shndërruar në një platformë të fuqishme për trajnimin e institucioneve të tjera qeveritare që shërbejnë në fushën e rendit e të sigurisë. Gjatë kësaj periudhe, në akademitë ushtarake dhe qendrat e arsimimit janë trajnuar Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Qendra Ndërinstitucionale e Operacioneve Detare, efektiva të Policisë së Shtetit, Rojës Bregdetare, Autoritetit të Aviacionit Civil, etj. Këto trajnime të përbashkëta kanë sinkronizuar në maksimum aftësinë e strukturave shtetërore për t'u përgjigjur si një organizëm i vetëm gjithëpërfshirës ndaj situatave të ndryshme të sigurisë, qofshin këto të luftës kundër trafikut, cenimit të sigurisë detare, ajrore e tokësore, katastrofave natyrore, emergjencave civile apo rasteve të kërkim-shpëtimit.

Vendi ynë ka deklaruar se do të jetë pjesë e operacioneve të NATO-s në Afganistan deri në largimin përfundimtar të aleancës. Në këtë kuadër, FA po planëzojnë kontributin e tyre për periudhën post-ISAF në këtë vend, si pjesë e Operacionit *Resolute Support*. Ky kontribut do të vazhdojë të jetë i gjithanshëm dhe cilësor, i harmonizuar me aleatët dhe me NATO-n.

Përfundimi i operacionit ISAF pritet të shoqërohet me uljen e tempit operacional të NATO-s. Në këtë situatë, fokusi dhe e gjithë vëmendja jonë është kthyer tek stërvitja e trupës ushtarake dhe përgatitja e saj për çdo mision të radhës, duke e shndërruar atë nga një *forcë në operacion në një forcë të gatshme për operacion*.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të stërvitjes dhe ekonomizimin e saj, si dhe duke vlerësuar realitetin financiar, po punohet që të sinkronizojmë zhvillimin e stërvitjeve tona dhe me ato të aleancës dhe aleatëve; t'i bëjmë stërvitjet tona kombëtare pjesë të stërvitjeve të NATO-s si dhe të shfrytëzojmë e të marrim pjesë në stërvitjet që aleanca dhe vendet anëtare zhvillojnë. Këtij qëllimi i shërbejnë pikërisht veprimtari të tilla stërvitore siç janë: stërvitja e përbashkët, tashmë e planëzuar, me Britaninë e Madhe "*Albanian Lion-2014*" e cila përfaqëson edhe stërvitjen më të madhe të trupave të marinës britanike për këtë vit;

stërvitja "*Dolphin-15*" ku do të marrin pjesë disa vende të rajonit dhe të NATO-s; stërvitja e NATO-s "*Joint Reaction-2015"* që do të zhvillohet në Shqipëri, etj. Masat e mësipërme janë pjesë përbërëse dhe mbështesin plotësisht nismat e aleancës si atë të *Forcave të Ndërlidhura* apo edhe axhendën e samitit të ardhshëm të Uellsit ku gatishmëria dhe stërvitja do te jenë një ndër temat kryesore të tij. Në mbështetje të drejtpërdrejtë të këtyre synimeve, Shqipëria ka deklaruar dhe po punon për pjesëmarrjen në stërvitjen e NATO-s me vizibilitet të lartë "*Trident Juncture-2015*" që do të zhvillohet në Spanjë-Portugali dhe Itali dhe do të jetë pjesë e Forcave të Reagimit të Shpejtë të NATO-s 2016 me repartet e saj.

Spektri i gjerë i veprimtarive në të cilat FA-të janë të angazhuara, nga pastrimi i plazheve e akseve rrugore tek hapja e rrugëve e ndërtimi i urave, nga këshillimi dhe mentorimi në kuadër të NATO-s tek luftimet ndaj talebanëve e rrjeteve terroriste si dhe gjeografia e zgjeruar e këtyre operacioneve nga Bosnja në Afganistan e Kosovë, tregojnë vitalitetin e FA-ve, aftësinë për t'u përshtatur në çdo rrethanë e situatë.

*Angazhimi i strukturave të FA-ve në operacionet në ndihmë të komunitetit**

Kolonel Manushaqe Shehu
Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA

Forcat e Armatosura, në zbatim të misionit të tyre kushtetues, janë gjendur gjithmonë pranë komunitetit, duke ofruar kontributin e tyre kurdo ku ka pasur nevojë. Përballë ndryshimeve të mëdha që po ndodhin sot në botë, FA kanë vendosur të jenë pjesë e pandarë e angazhimeve të tyre në ndihmë të komunitetit.

Gjatë këtyre muajve, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, janë ndërtuar dhe vazhdon puna për ndërtimin e urave të ndryshme, për shuarje zjarri, heqje blloqesh betoni, transport inertesh në 28 bashki dhe komuna, me angazhimin e qindra forcash pune dhe dhjetëra mjetesh.

Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër!-kjo ka qenë motoja e cila ka udhëhequr Forcat e Armatosura në emergjencën mjedisore me të cilën u desh të përballeshin këtë vit.

Sezoni turistik 2014 i gjen pikat hyrëse në Shqipëri, si dhe plazhet më të pastra për shqiptarët, vëllezërit kosovarë, fqinjët maqedonas dhe të gjithë ata turistë të huaj që dëshirojnë të pushojnë në vendin tonë. Në zbatim të detyrave të vendosura nga Këshilli i Ministrave dhe ministri i Mbrojtjes, strukturat ushtarake u angazhuan për rehabilitimin e mjedisit në projektin e pastrimit të rrugëve kombëtare dhe zonave turistike nga ndotja". Strukturat e Forcave të Armatosura u angazhuan në pastrimin e territorit, kryesisht në rrugët kombëtare dhe pikat kufitare hyrëse në të gjithë Shqipërinë.

Në total, në fund të fazës së parë të operacionit, Forcat e Armatosura pastruan:

- 653 kilometra rrugë;
- 9 hektarë zonë të ndotur;
- 2306 metra kub mbetje;
- 80 metra kub dhe 1494 metra katrorë nivelim terreni.

Gjatë pastrimit në afërsi të Urës së Dajlanit u gjetën 6 predha artilerie të kalibrave të ndryshëm. Gjatë pastrimit në rrethin e Gjirokastrës u gjet 1 minë mortaje, 82mm.

Në fazën e dytë, krahas akseve kombëtare, FA u angazhuan në pastrimin e plazheve kryesore në vend, duke filluar nga plazhi Velipojë, Shkodër deri në Ksamil, Sarandë.

---

*Fjalë e mbajtur në analizën "300 ditët qeverisje në Ministrinë e Mbrojtjes" më 15 korrik 2014

U pastruan 103 km vijë bregdetare. Forcat e Armatosura janë pjesë e *Task-Force*-s për përmirësimin e kushteve të sigurisë në plazhe dhe zonat çlodhëse në bregdet. Nga veriu në jug janë marrë masa për ngritjen e 10 (dhjetë) kampingjeve me çadra, plotësimin e tyre me materiale për një personel prej 20 vetësh për çdo kamping. Prania jonë është në plazhet e Velipojës; Shëngjinit; Tale të Lezhës; Gjirit të Lalzit, Durrës; Golem; Vlorë; Dhërmi; Borsh dhe Sarandë.

Kontributi i FA në rehabilitimin e *hot-spote*-ve nga municionet dhe eksplozivët është shtrirë në poligonin Qafalaç (Laç Qyrsaçi), Shkodër. Poligoni i asgjësimit të municioneve Qafalaç ka filluar veprimtarinë në shtator 2002 për asgjësimin e municioneve të ish Repartit Ushtarak nr.1100, Shkodër.

Forcat e Armatosura kanë dhënë gjithashtu kontributin e tyre në ndihmë të komunitetit për pastrimin e inerteve nga prishja e objekteve pa leje në dispozicion të INUK.

RUBRIKA E PARË

FARSH, në përgjigje të sfidave të reja, në prag të Samitit të Uellsit

Me mesazhin se NATO do të vijojë të jetë në vijë të parë, me qëllim ndërtimin e stabilitetit në një botë të paparashikueshme, në fillim të shtatorit do të zhvillohet samiti i radhës i Aleancës Euroatlantike, në Uells. Ndryshe nga samitet e kaluara, ky do të jetë samit me shqetësime më të mëdha: Ku po shkon Rusia? Cilat janë synimet e saj? Ku po shkojnë vendet e Azisë, si India dhe Kina? Çfarë duhet të bëjë NATO? Çfarë duhet të ndryshojë në pikëpamje politike, ekonomike dhe financiare nga vendet anëtare të Aleancës për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve të mjedisit të sigurisë?

Rubrika "FARSH, në përgjigje të sfidave të reja, në prag të Samitit të Uellsit" nis me analizën e Drejtorit të Departamentit të Punës Kërkimore në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s, *Karl-Heinz Kamp*, me paraqitjen e sfidave dhe vlerësimeve të reja, në prag të këtij samiti. Pikëpamjet e shprehura në artikullin e tij janë personale dhe nuk pasqyrojnë opinionet e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s apo të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Kol. Manushaqe Shehu, Drejtor i Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (J9) në Shtabin e Përgjithshëm të FARSH, vjen, në këtë rubrikë, me detyrimet e Shqipërisë ndaj kërkesave të NATO-s. Shqipëria, si një vend anëtar i NATO-s, luan një rol aktiv dhe kontribuon në drejtim të forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë,-thuhet në shkrim. Vendi ynë ka marrë përsipër një sërë reformash që synojnë avancimin e mëtejshëm të vendit, sidomos në kuadër të plotësimit të detyrimeve ndaj BE-së, pas marrjes së statusit të vendit kandidat muajin e kaluar. Megjithatë mbeten një sërë sfidash me të cilat përballet rajoni dhe që kërkojnë veprimin tonë të përbashkët. Siguria është një proces kompleks dhe shumëdimensional dhe kërkon të kuptohet dhe trajtohet si i tillë. Shqipëria është e përkushtuar për të përmbushur të gjitha standardet që rrjedhin nga anëtarësimi në Traktatin e Atlantikut të Veriut. Siguria dhe mbrojtja e vendit tonë duhet të konceptohen dhe zhvillohen si mbi bazën e përfitimeve, ashtu edhe të kontributeve të konceptit të mbrojtjes kolektive të Aleancës. Në këtë kuadër, një nga interesat madhorë do të mbetet menaxhimi i drejtë dhe në kohë i sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që mund të prodhojnë kriza dhe mungesë stabiliteti në vend. Ndërsa në shkrimin "Një vështrim rreth Samitit të Uellsit", të autorit Kolonel (R) Thimi Hudhra, pjesë e kësaj rubrike, jepen disa vlerësime dhe rekomandime që mund t'iu shërbejnë stafeve të punës apo autoriteteve vendimmarrëse pjesëmarrëse në këtë samit.

Sfida dhe vlerësime të reja në prag të Samitit të Uellsit

Karl-Heinz Kamp
Drejtor i Departamentit të Punës Kërkimore
në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s

Trajtesë e shkurtuar. *Në 4-5 shtator, udhëheqësit e qeverive nga 28 vendet anëtare të NATO-s dhe personalitete të larta nga 30 vende partnere do të mblidhen në Uells për të diskutuar çështje të rëndësive të mëdha për të gjithë ne si: terrorizmi, pirateria, shtetet e paqëndrueshme, sulmet kibernetike dhe sfidat për të ndërtuar stabilitet në një botë të paparashikueshme. Gjithashtu do të sigurohemi që të gjitha kombet e NATO-s të kenë pajisjet, aftësitë dhe inteligjencën e nevojshme për të mbrojtur veten e tyre.*

Por, ndër të gjitha mundësitë që padyshim do të sjellë samiti i këtij viti i NATO-s në Uells, ndoshta më e rëndësishmja është ajo që e rithekson mesazhin se interesat e botës së lirë dhe të popujve të saj janë që, duke punuar ngushtë së bashku, të vazhdojnë të jenë të mbrojtur gjithmonë e më mirë.

Në shkrimin në vijim, Dr. Karl-Heinz Kamp, drejtor i Departamentit të Punës Kërkimore në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s, trajton çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet NATO-Rusi, mbrojtjen raketore kërcënimet kibernetike, zgjerimin e NATO-s, SHBA-të si aktor qendror në Azi, evolucionin e partneriteteve, si dhe vizionin e NATO-s për epokën pas vitit 2014.

Pikëpamjet e shprehura në këtë artikull janë pikëpamjet e tij personale dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s apo të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Zhvillimet e reja në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare kërkojnë që Aleanca të bëjë përshtatje të vazhdueshme dhe samitet e NATO-s me krerët e shteteve dhe qeverive kanë tre funksione shumë të rëndësishme: ato shënojnë zhvillime të rëndësishme dhe arsyetojnë mbi ngjarje të rëndësishme historike që ndodhin herëpashere. Ato gjithashtu lejojnë udhëheqësinë politike të NATO-s që t'i japë orientime largpamëse aparatit burokratik dhe ushtarak të Aleancës dhe bien dakord mbi çështjet me rëndësi të veçantë. Së fundi, samitet e këtij niveli synojnë të përshpejtojnë proceset e vendimmarrjes në NATO, sepse një takim nga afër i "shefave të mëdhenj" përcakton një afat kohor për kompromis dhe konsensus, si në shtabe ashtu edhe në kryeqytete.

Samiti i ardhshëm i NATO-s është planifikuar për mesin e vitit 2014. Që prej takimit të fundit në vitin 2012 në Çikago, asnjë aleat nuk ka dalë vullnetar të mirëpresë takimin vijues; vendi i mbajtjes së tij është ende i pavendosur. Ka një numër ngjarjesh të rëndësishme që duhen shqyrtuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të NATO-s si: largimi nga detyra i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, *Rasmusen* (dhe rënia dakord

mbi pasardhësin e tij), 20-vjetori i programit të NATO-s për Partneritet për Paqe (PfP) dhe tërheqja, me të vërtetë historike, e të gjitha forcave luftarake nga Afganistani. Këto nuk janë vetëm raste për shprehje falënderimesh, por çështje mjaft të rëndësishme politike për të cilat duhet të gjendet konsensus: cila do të jetë e ardhmja e PfP-një program që duket se e ka kaluar kulmin e vet-dhe ç'formë do të marrë misioni i trajnimit në Afganistan, i quajtur "Mbështetja e Vendosur" pas vitit 2014.

Implikimet që dalin nga përfundimi i misionit ISAF të NATO-s (i Forcës Ndërkombëtare për Siguri dhe Ndihmë) vështirë se mund të mbivlerësohen. Situata në Afganistan ka përcaktuar mendimin strategjik, planifikimin ushtarak, organizimin e strukturave të forcës dhe vendimeve të prokurimit të 50 aleatëve dhe partnerëve për më shumë se një dhjetëvjeçar. Madje, edhe një numër i buxheteve të mbrojtjes u ruajtën nga kritikat publike dhe nga shkurtime të mëtejshme, duke nënvizuar rëndësinë e misionit në Afganistan për sigurinë e komunitetit euroatlantik. Përveç kësaj, ishte lufta e gjatë dhe e frikshme kundër talebanëve e cila ndihmoi shumë vende evropiane të zgjerojnë horizontin e tyre eurocentrik të politikave të sigurisë të së kaluarës, duke përfshirë në të një perspektivë globale, të shekullit të 21-të.

Megjithatë, edhe në qoftë se Afganistani është ai që i jep emrin samitit të 2014, ai më shumë duket si një çështje e së kaluarës dhe nuk duhet të jetë çështja dominuese në diskutimet e udhëheqjes politike të NATO-s. Nëse samitet e NATO-s japin drejtimin politik, ky që vjen duhet të përqendrohet në ato çështje të cilat janë me të vërtetë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të Aleancës në botën post-Afganistan.

Diskutimet kanë filluar tashmë në kryeqytetet përkatëse dhe ka një tendencë pothuajse tradicionale tek aleatët që përpiqen të shprehin të gjitha shqetësimet e tyre rajonale apo individuale përgjatë ditëve të samitit. Kjo sjell rrezikun e futjes në çështje të cilat mund të jenë relevante por zgjidhjet për to nuk janë gati dhe, në këtë mënyrë, zhgënjimi duket se është i pashmangshëm.

Në shikim të parë, dy çështje të veçanta duket sikur janë elementët e dukshëm të samitit: problemi i dukshëm i NATO-s, ai i "hendekut të kapaciteteve" midis forcave ushtarake të SHBA-ve dhe atyre evropiane dhe ai krizës siriane që po vazhdon ende. Po të shikohen më nga afër duket sikur të dyja çështjet mbartin më tepër rrezikun e zhgënjimit transatlantik se sa të forcimit të kohezionit të NATO-s. NATO është marrë me hendekun midis kapaciteteve për dhjetëvjeçarë të tërë dhe ka rënë dakord për një mori nismash. Mjafton të përmendim dy prej tyre: Nisma e Kapaciteteve Mbrojtëse në fundin e viteve 1990 apo Përkushtimi për Kapacitetet i Pragës në vitin 2002. Shumica e këtyre nismave nuk ka dhënë ndonjë rezultat. Duke patur parasysh krizën financiare në Evropë, nuk mund të priten përmirësime të shpejta. Përkundrazi, përmirësimi i aftësive ushtarake të NATO-s është një proces i vështirë dhe i pakufizuar që ecën me hapa shumë të vogla. Po t'i shtohet edhe një deklaratë tjetër ambicioze synimesh ku nuk ka perspektivë realizimi nuk do ta shpinte NATO-n gjëkundi. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për rastin sirian. Pavarësisht situatës tragjike në Siri dhe përkundër vendosmërisë së disa anëtarëve të NATO-s për të reaguar ndaj mizorive të kryera nga regjimi i Asadit, NATO nuk ofron ndonjë zgjidhje ushtarake të afërt. Për më tepër, rasti i Libisë ka treguar se edhe një ndërhyrje e suksesshme ushtarake nuk çon në stabilitet politik. Angazhimi i vetëm i imagjinueshëm i NATO-s do të mund të ndodhë në një situatë post-Asad, ku udhëheqja e

re siriane do të kërkonte, në mënyrë të qartë, mbështetjen e NATO-s për të ndërtuar forca sigurie të efektshme. Po të mbahet parasysh gjakderdhja aktuale, ky moment duket i largët.

Në vend që të përqendrohet në kapacitetet, në Siri apo në çështje të përzgjedhura nga vende të veçanta, samiti duhet të përqendrohet në ato tema që janë me rëndësi shumë të madhe për të ardhmen e NATO-s në epokën post-2014 dhe të cilat, për këtë arsye, kërkojnë adresim nga niveli më i lartë politik. Sipas mjedisit të tanishëm strategjik, një numër i pikave të programit përmbush këto kritere dhe duhet të diskutohet nga kryetarët e shteteve dhe qeverive. Shtatë prej tyre do të paraqiten sipas një renditjeje, nga më e rëndësishmja tek më pak e rëndësishmja, në këtë trajtesë.

Marrëdhëniet NATO-Rusi

Në fundin e listës së çështjeve të rëndësishme ne gjejmë "partneritetin strategjik" me Rusinë, i cili ka qenë një temë e qendrueshme në takimet e nivelit të lartë të NATO-s. Megjithatë, nëse krahasojmë deklaratat e samiteve të fundit në Riga (2006), Bukuresht (2008), Strasburg/Keln (2009), Lisbonë (2010) dhe Çikago (2012), formulimi është bërë gjithnjë e më skeptik përsa i përket qëndrimit të Rusisë në raport me NATO-n. Ndërsa dokumenti i Rigës duket tepër pozitiv dhe Deklarata e Samitit të Çikagos ende mburr "përparimin e rëndësishëm në bashkëpunimin tonë", e njëjta deklaratë e shpreh qartë se NATO dhe Rusia "ndahen për çështje të veçanta" dhe i bën thirrje Rusisë të heqë dorë nga disa politika të caktuara.

Të "ndahesh për çështje të veçanta" duket se është një përshkrim zbukurues për një ndryshim themelor në perceptimin që kanë të dyja palët se marrëdhëniet janë përkeqësuar. Bashkëpunimi për Mbrojtjen Raketore-dikur vitrinë e interesave të sigurisë të perceptuara si të përbashkëta-është duke marrë fund. Moska ankohet për planet amerikane të mbrojtjes nga raketat pothuajse si diçka që përbën kundërvajtje, ndërsa Uashingtoni nuk lë asnjë dyshim se do të vazhdojë me programin pavarësisht bashkëpunimit me palën ruse. Edhe çështja tjetër me afat që po i mbaron, ajo e rishikimit të traktatit për Forcat Konvencionale në Evropë (CFE) nuk po ecën në rrugën e duhur. Sipas zëvendësministrit rus të mbrojtjes *Anatoli Antonov*, Traktati CFE "është i vdekur". Pozicionet e kundërta në rastin e Sirisë nuk ndihmojnë në rigjallërimin e marrëdhënieve.

Përveç këtyre mosmarrëveshjeve të veçanta, zhvillime të tjera kontribuojnë në përkeqësimin e vazhdueshëm të klimës. Rusia përsëri ka hartuar plane për stërvitjen e madhe ushtarake në *Zapad* (perëndim) në vjeshtë të vitit 2013. Sipas njoftimeve të shtypit, ajo do të ketë një konfigurim të ngjashëm me *Zapad* 2009, i cili arriti kulmin me simulimin e një goditjeje bërthamore mbi Varshavë. Nga ana tjetër, stërvitje të caktuara të NATO-s në Evropën Lindore apo Protektori i Unifikuar i Operacioneve të NATO-s (OUP) në Libinë Qendrore janë interpretuar nga Moska si stërvitje sulmuese madje dhe agresive. Duket se zhgënjimi në lidhje me perceptimet e gabuara të ndërsjella dhe pritmëritë e papërmbushura do të transformojnë të gjithë partneritetin. NATO duhet të vijë në pikën e dhimbshme të pranimit se nuk ka asgjë të përbashkët për bashkëpunim efektiv. Madje edhe shumë nga ata anëtarë të NATO-s të cilët më parë i konsideronin marrëdhëniet e frytshme me Rusinë si absolutisht të domosdoshme, në mënyrë të hapur dhe jo diplomatike, kritikojnë sjelljen jodemokratike të regjimit të Putinit. Nga ana tjetër, Moska në mënyrë të dhimbshme,

është e vetëdijshme për faktin se, në shumicën e rasteve, NATO nuk do t'i japë Rusisë ndonjë mundësi për të qenë zë i vërtetë në proceset e saj të vendimmarrjes, por do të ndjekë kursin e vet, pavarësisht skepticizmit rus.

Në dritën e këtyre zhvillimeve, të paktën dy çështje të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën do të kërkojnë orientim nga udhëheqja politike e NATO-s:

- A do të vazhdojnë që të etiketohen një "partneritet strategjik" Marrëdhëniet NATO-Rusi-një përshkrim që tregon marrëdhënie veçanërisht intensive dhe të privilegjuara? Çfarë është "strategjike" në lidhjet NATO-Rusi në qoftë se bashkëpunimi i NATO-s me shumë partnerë të tjerë "të zakonshëm" është shumë më intensiv dhe duket reciprokisht shumë më tepër i dobishëm? A nuk duhet që retorika të përshtatet me gjendjen e vërtetë të marrëdhënieve NATO-Rusi për të shmangur pritmëri të rreme dhe për të mundësuar bashkëpunimin mbi baza reale?
- Pavarësisht nga madhësia gjeografike e Rusisë, pasuritë e saj në gaz dhe naftë apo fuqia e saj me anën e vetos në Kombet e Bashkuara: sa e rëndësishme është Rusia me të vërtetë për zhvillimin e mëtejshëm të NATO-s apo për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar? Në cilat raste ka qenë Moska me të vërtetë mbështetëse e NATO-s në vitet e fundit? A është Rusia vërtet partner i domosdoshëm sikundër u portretizua gjatë periudhës së muajit të mjaltit të marrëdhënieve NATO-Rusi sidomos në vitet 1990?

Mbrojtja Raketore

Mbrojtja Raketore (MD) ka qenë thuajse një pikë e rendit të ditës në dy samitet e fundit në Lisbonë dhe Çikago-pjesërisht për shkak të kritikave ruse për planet e MD të NATO-s dhe pjesërisht për shkak të vështirësive të brendshme të Aleancës në gjetjen e konsensusit mbi aspektet e ndryshme të projektit. Megjithatë, në pranverë 2013, MD pësoi disa ndryshime thelbësore, duke ngritur çështje të cilat duhet të trajtohen nga krerët e shteteve të NATO-s.

Mbrojtja Raketore e NATO-s është kryesisht një program amerikan, me anën e të cilit Shtetet e Bashkuara, në bazë të një skeme me kontribute kombëtare, marrin barrën e platformave raketore, interceptorëve dhe sensorëve për mbrojtjen e territorit të NATO-s. Aleatët e NATO-s, në shumicën e rasteve, shtojnë përbërësit (radarët, sensorët) që sigurojnë mbrojtjen ajrore apo janë për qëllime mbrojtëse në teatrin e luftës raketore. Në mars 2013, administrata e Obamës-kryesisht për arsye financiare-modifikoi programin e saj të mbrojtjes raketore, "Qasja Evropiane e Përshtatur sipas Fazave" (EPAA), duke fshirë hapin e fundit të konceptit me katër faza të MD-së. Kjo anulloi zhvillimin e interceptorëve të rinj të raketave të cilët ishin menduar të mbronin territorin e Shteteve të Bashkuara nga raketat balistike ndërkontinentale nga Lindja e Mesme apo vende të tjera.

Ajo që fillimisht u duk se ishte, para së gjithash, një çështje teknike/financiare, është duke u kthyer, gjithnjë e më shumë, në një çështje politike me ndikim mbi të gjithë Aleancën. Nga pikëpamja koceptuale, në tri fazat e saj të para, EPAA kryesisht mbron territorin e anëtarëve të NATO-s në Evropë (dhe të forcave amerikane të stacionuara atje) nga raketat me rreze të mesme nga Lindja e Mesme-thjesht sepse ky është kërcënimi me të cilin NATO do të përballet në vitet e ardhshme. Vetëm faza e fundit e EPAA-s, nga 2020 e tutje, ishte menduar t'i kundërvihej kërcënimit nga raketat me rreze interkontinentale që kanë si objektiv tokën amerikane, duke menduar se agresorëve të mundshëm, si Iranit apo Koresë së Veriut, ende do t'iu duhet kohë për të zhvilluar raketa me rreze të gjatë

veprimi. Ky arsyetim bazë tashmë është kritikuar ashpër nga republikanët në Uashington, duke argumentuar se taksapaguesit amerikanë do të financonin për sigurinë evropiane për vite të tëra (faza 1-3), ndërsa mbrojtja e atdheut amerikan nuk mund të pritet para vitit 2020. Pas anullimit të fazës së 4-t, ky argumentim u bë edhe më i spikatur dhe mbrojtja raketore u sulmua edhe më ashpër në Kongresin Amerikan, duke arsyetuar se Evropa do të kishte mburojën e mbrojtjes pa shpenzime, kurse toka e SHBA-ve nuk do të ishte e mbrojtur fare. Si rezultat, në qershor 2013, Dhoma e Përfaqësuesve solli një amendament për projektligjin e 2014-s në lidhje me autorizimin e mbrojtjes, duke kërkuar që aleatët e NATO-s të financojnë të paktën 50% të kostos së EPAA-s.

Edhe në qoftë se një amendament i tillë do të ketë pak shanse për t'u miratuar, ai ende do të nxjerrë në pah ujërat e trazuara në të cilat po futet NATO. Në samitin historik të Lisbonës, NATO njoftoi planet e saj ambicioze për një sistem të mbrojtjes nga raketat për Aleancën, duke e ditur fare mirë se barra kryesore teknike dhe financiare do të përballohej nga Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, sot, me konsolidimin buxhetor në kulmin e vet (shkurtime automatike buxhetesh-të quajtura "sekuestrim"), një ribalancim i vëmendjes amerikane nga Evropa në Azi dhe një debat për ndarjen e barrës së Aleancës, ka bërë që gatishmëria e SHBA për financimin, pak a shumë të plotë, të një sistemi të mbrojtjes raketore të NATO-s, të jetë gjithnjë e më shumë në rënie.

Me ose pa presionin e Kongresit, qeveritë e ardhshme të SHBA-ve ka gjasa të shkurtojnë ndjeshëm fondet e tyre për MD-në. Përderisa aleatët evropianë, me buxhetet e tyre të mbrojtjes me reduktim të shpejtë, nuk janë as të gatshëm dhe as në gjendje të ndërhyjnë për garantimin e interceptorëve të tyre *Aegis* dhe të radarëve, e ardhmja e të gjithë projektit MD të NATO-s është në rrezik. Lidershipi politik i NATO-s do të duhet të marrë vendime të guximshme për të shmangur që projekti i mbrojtjes raketore të kthehet në një fshat *Potemkin*.

Kërcënimet kibernetike

Nga të gjitha kërcënimet jo tradicionale-sipas mënyrës së shprehjes nga ana e NATO-s "sfidat e reja"-rreziqet në fushën e hapësirës kibernetike shfaqen më dukshëm në axhendën transatlantike. Rritja me shpejtësi e numrit të sulmeve kundër rrjeteve kompjuterike ushtarake dhe civile mban çështjen në qendër të vëmendjes dhe rrit ndërgjegjësimin publik për shqetësimet që lidhen me kibernetikën. Sidoqoftë, disavantazhi i kësaj vëmendjeje me rritje maksimale, bën që tema të ketë tendencën për t'u mbivlerësuar nga shumë vende anëtare të NATO-s, veçanërisht në lidhje me implikimet e saj të mundshme ushtarake. Krahasimi i sulmeve kibernetike me një tjetër "*Pearl Harbor*", apo me rrëzimin e kullave binjake më 11 shtator, sikundër bëjnë mjaft zëra të rëndësishëm, e fryn çështjen dhe mjegullon faktin se sulmet kibernetike vështirë se mund të shikohen si një "luftë" në kuptimin më ekzakt të termit. Parë më nga afër, ato madje nuk përbëjnë një rrezik krejtësisht të ri. Përkundrazi, sulmet kibernetike janë në thelb versione të sofistikuara të tri aktiviteteve shumë tradicionale: sabotimit, spiunazhit dhe subversionit (të ndryshme nga krimet kibernetike si hakerimi apo aktet mashtruese në sistemin financiar). Kjo nuk e zbeh problemin në vetvete, por të paktën, vë në pah mbrojtjen e rrjeteve kompjuterike dhe kundërmasat e mundshme ushtarake. Përdorimi ose kërcënimi për përdorimin e forcës ushtarake, në një mënyrë apo një tjetër, është ndoshta një nga mundësitë e fundit për t'u marrë me problemin kibernetik.

Vetë NATO ka përmirësuar vazhdimisht kapacitetet e saj të zbulimit, vlerësimit dhe parandalimit për të mbrojtur më mirë objektet e saj të komunikimit dhe rrjetet kompjuterike

nga sulmet kibernetike, si dhe për të rimarrë veten në rast të një sulmi. Në samitin e Pragës në vitin 2002, çështja kibernetike ishte në rendin e ditës, por u deshën sulmet kibernetike kundër Estonisë në vitin 2007 dhe lufta Rusi-Gjeorgji në vitin 2008, për të përshpejtuar veprimin. Megjithatë, deri më tani, masat e NATO-s kanë për qëllim mbrojtjen e rrjetit, duke ofruar ekspertizën e centralizuar dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe jo veprime ushtarake në kuptimin e parandalimit apo përdorimin e forcës.

Duke pasur parasysh tendencën për të militarizuar kërcënimet kompjuterike, të paktën nga pikëpamja retorike, drejtimi politik nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të NATO-s është e nevojshme më së paku për dy çështje:

- Deri në çfarë mase përballimi i kërcënimeve kibernetike ka një dimension ushtarak-përveç mbrojtjes së elementëve të rrjeteve kompjuterike që lidhen me komandën dhe kontrollin? A ka masa specifike, përtej konsultimeve dhe ndërtimit të konsensusit, që mund të marrë një Aleancë politiko-ushtarake për të parandaluar ose kundërvepruar ndaj një agresioni kibernetik? A janë aftësitë e NATO-s në parandalimin dhe mbrojtjen të zbatueshme në fushën kibernetike?
- Duke menduar se NATO ka rol si një aleancë politike dhe ushtarake, çfarë niveli intensiteti është e nevojshme të ketë një sulm kibernetik që të shkaktojë një reagim (ushtarak) të NATO-s? Sa dëm dhe çfarë lloj dëmi duhet të ndodhë para se agresioni kibernetik të përkufizohet si një sulm, sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit?

Këto pyetje të rëndësishme politike mund të mos jenë të lehta për t'iu dhënë përgjigje, të paktën për shkak se shumë anëtarë të NATO-s ende nuk kanë një pozicion kombëtar mbi këtë çështje. Për të shmangur një debat mbi dimensionin ushtarak të luftës kundër kërcënimeve kibernetike, krerët e shteteve të NATO-s mund të ngarkojnë organizmat e NATO-s që ta shqyrtojnë çështjen dhe të raportojnë në një nga takimet e ardhshme ministrore.

Zgjerimit i NATO-s

Pas samitit të Çikagos në maj 2012, çështja se cilat vende duhet të bëhen anëtare të NATO-s dhe kur, ishte (përsëri) një çështje ndarëse mes aleatëve. Sekretarja e Jashtme e SHBA-ve *Hillari Klinton* sugjeroi që Çikago duhet të jetë samiti i fundit i NATO-s që të mos fokusohet në mënyrë të qartë tek zgjerimi. Shumë anëtarë evropianë arritën në përfundimin se, nga këndvështrimi amerikan, të gjitha samitet e ardhshme duhet të merren me anëtarët e rinj që do t'i bashkohen NATO-s. Që nga ajo kohë, shumë aleatë kishin dyshimet e tyre në lidhje me prudencën e zgjerimit të mëtejshëm të NATO-s. Deklarata e *Klinton*-it ishte një nga arsyet pse Aleanca nuk mund të pajtohej me një samit pasues pas Çikagos-dhe një numër vendesh u përpoqën ta shtyjnë çështjen.

Pavarësisht nga fakti se administrata Obama duket se e ka larguar vëmendjen nga çështja e zgjerimit dhe shfaqet sot më pak nxitëse se në maj 2012, zgjerimi do të jetë në qendër të samitit 2014. Katër vende janë përcaktuar nga NATO si "vende aspirante": Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Gjeorgjia. Në lidhje me realizimin e anëtarësimit për tre të parat, çështja e tyre zor se vihet në diskutim. FYROM ishte gati për t'u bashkuar me NATO-n në fillim të vitit 2009. Sapo të zgjidhet mosmarrëveshja me Greqinë rreth emrit të vendit, anëtarësimi mund të realizohet. Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina janë vende relativisht të vogla dhe mund të ftohen për t'u bashkuar në çdo moment që ata përmbushin kushtet e nevojshme.

Sidoqoftë, pika kritike e çështjes së zgjerimit është Gjeorgjia. Në vitin 2008 ajo hyri në luftë me Rusinë mbi rajonet e saj renegate të Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut.

Ndërkohë, rendi në betejën pro apo kundër anëtarësimit të Gjeorgjisë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Numri i anëtarëve të NATO-s që përpiqeshin për ta lënë çështjen e Gjeorgjisë pas krahëve është dukshëm më i vogël-Gjermania dhe një pjesë e vogël vendesh të tjera janë nga të fundit. Argumenti sipas të cilit, Moska do të refuzojë me forcë një hap të tillë dhe se një hap i tillë do të dëmtonte të gjitha marrëdhëniet NATO-Rusi, gjen gjithnjë e më pak mbështetës. Disa anëtarë të NATO-s duket se mbështesin anëtarësimin e Gjeorgjisë në veçanti për shkak se ajo shkon kundër interesave ruse. Edhe argumenti për konflikte të pazgjidhura territoriale të Gjeorgjisë, të cilat do të pengonin hyrjen e Gjeorgjisë në NATO, e ka humbur vlefshmërinë e tij. Ndërkohë, zëra të shquar në qeverinë e Gjeorgjisë po tregojnë më shumë fleksibilitet dhe pragmatizëm në lidhje me marrëdhëniet me Rusinë. Për më tepër, Gjeorgjia u dallua në raport me NATO-n, duke ofruar kapacitetet e veta ushtarake për të gjitha misionet e NATO-s pa ndonjë kusht-Tbilisi madje ishte gati të kontribuonte me forca në Forcën e Reagimit të NATO-s (NRF).

Duke pasur parasysh këto dinamika ka gjasa që Gjeorgjia të pranohet në Planin e Veprimit për Anëtarësim të NATO-s (MAP)-një program për përgatitjen e vendeve kandidate për anëtarësim. Kjo do ta sjellë Gjeorgjinë një hap më pranë anëtarësimit pa caktimin e datës për pranim-Shqipëria mbeti në MAP për një dhjetëvjeçar, para se të bëhej anëtare e NATO-s në vitin 2009.

Megjithatë, krerët e shteteve të NATO-s duhet të merren me çështjen e anëtarësimit përtej çështjes gjeorgjiane. Duke pasur parasysh numrin dhe shumëllojshmërinë e vendeve aplikante, NATO duhet të sjellë në mendje elementët bazë për zgjerimin, në mënyrë që procesi të zhvillohet normalisht dhe të shmangen gabimet e së shkuarës. Kjo kërkon përballje me disa realitete jo të këndshme përtej gjykimit të përgjithshëm të zgjerimit (sipas përkufizimit të dhënë) si një "proces fitoj- fitoj (win-win process)"-sepse realiteti ka provuar se është ndryshe. Dokumentet e NATO-s kanë përcaktuar gjithmonë se zgjerimi duhet të jetë përfitues jo vetëm për vendet e sapopranuara, por edhe për NATO-n. Për disa prej anëtarëve të rinj kjo ishte e vërtetë, ndërsa të tjerët me shpejtësi lanë pas dore detyrimet që sjell anëtarësimi dhe kontribuojnë shumë pak për kapacitetet e përgjithshme të NATO-s-apo shfaqin nivele shqetësuese të korrupsionit dhe nepotizmit. Dy pyetje duhet të marrin përgjigje:

- Si mund të sigurohet NATO se vetëm vendet që ofrojnë vlerë të shtuar për kapacitetet e NATO-s dhe të sigurisë së zonës euroatlantike pranohen si anëtarë, në vend që, në rastin më të mirë, të mbeten neutrale dhe, në rastin më të keq, bëhen pengesë?
- Për çfarë mekanizmash mund bjerë dakord NATO, për t'u siguruar se vendet e pranuara rishtas përmbushin detyrimet e tyre, pasi ata janë bërë anëtarë? Si mund të sigurohemi se vendet që janë aspirantë të mirë bëhen dhe anëtarë të mirë?

SHBA-të, aktori kryesor në Azi

Shpallja nga ana e Shteteve të Bashkuara, në fillim të vitit 2012, se theks më i fortë do të vihet mbi zhvillimet në rajonin e Azi-Paqësorit, përbën një ndryshim të madh strategjik për Aleancën.

Ky "strumbullar"-që më vonë u quajt si "ribalancim"-i burimeve dhe vëmendjes politike në Lindjen e Largët nuk është ndoshta as antievropian, as nuk është vetëm një ristrukturim i forcave të armatosura në fushën e shahut të strategjisë globale. Përkundrazi, ai është, më shumë, një ndryshim politik dhe ekonomik sesa një ndryshim ushtarak. Ai pohon faktin se në Evropë ka gjithnjë e më pak punë të papërfunduara-që është në fakt një dukuri pozitive. Për më tepër, ai nuk përbën një zhvillim të ri. Presidenti i SHBA, Xhorxh W. Bush hapi perspektiva amerikane në drejtim të Azisë dhe vendosi lidhje të reja me Indinë, Indonezinë dhe Vietnamin. Presidenti Obama vetëm shkoi një hap më tej në përcaktimin e rrjedhojave të rritjes së rëndësisë së gjithë rajonit të Azi-Paqësorit në mënyrë më të qartë

Implikimet për NATO-n do të jenë të thella, jo vetëm për shkak se Aleanca nuk mund të mbetet e paprekur në qoftë se fuqia e saj kryesore ripërkufizon përparësitë e saj strategjike, por edhe për shkak se zhvillimet në Azi janë shumë të rëndësishme edhe për anëtarët evropianë të NATO-s. Aleanca tashmë ka miratuar një horizont global, duke e kuptuar se interesat e sigurisë së anëtarëve të saj janë më të kufizuara brenda kufijve të tyre gjeografikë. Për më tepër, ekonomitë e Evropës, me linjat e tyre të prodhimit, me kohë janë të varura nga stabiliteti në Azi dhe në linjat e lira të komunikimit, ashtu si dy vendet e Amerikës së Veriut, SHBA-të dhe Kanadaja.

Pavarësisht nga rëndësia e çështjes, duket sikur NATO, si institucion, ende nuk po merret seriozisht me implikimet e këtij ndryshimi në lojën strategjike. Për këtë arsye, një numër çështjesh duhet të diskutohen nga lidershipi politik më i lartë i NATO-s:

- Në qoftë se fuqia kryesore e NATO-s nxjerr përfundime për pasojat e ndryshimeve ndërkombëtare të fuqisë dhe për këtë arsye ripërkufizon përparësitë e saj strategjike, a duhet që edhe NATO t'i kushtojë më shumë vëmendje rajonit të Azi-Paqësorit,-dhe nëse po, në çfarë shkalle?
- Nga pikëpamja e NATO-s: ç'do të thotë "vënie e një fokusi më të madh"? A do të thotë, në radhë të parë, të marrësh parasysh zhvillimet në rajonin e Azi-Paqësorit dhe në fund të konsultohesh me partnerët në zonë apo do të thotë të veprosh individualisht ose kolektivisht në Azi?
- Në qoftë se NATO ka ndërmend të veprojë, cilët janë anëtarët me kapacitete për ta bërë këtë dhe çfarë do të thotë realisht "të veprojë"? Ka një numër hapash të imagjinueshëm në varësi të kapaciteteve dhe synimeve të shteteve të NATO-s. Politikisht, përfaqësuesit e NATO-s do të mund të merrnin pjesë (në nivelin e duhur) në forume të ndryshme rajonale në Azi-të tilla si Forumi Rajonal i ASEAN-it (ARF). Ata gjithashtu mund të hapin zyrat e ndërlidhjes në vende të caktuara, për të treguar që janë të pranishëm. Ushtarakisht, forcat detare të NATO-s mund të vizitojnë portet aziatike për të treguar interes për rajonin apo edhe mund të marrin pjesë në stërvitjet ushtarake.
- Në qoftë se NATO synon të veprojë ushtarakisht në rajone të largëta, bëhet e qartë se forcat detare do të bëhen gjithnjë e më e rëndësishme-jo vetëm në Azi. Nëse ky është rasti, anëtarët e NATO-s duhet të pyesin veten nëse ata po ndjekin strategji të përshtatshme afatgjatë të sigurisë.

Evolucioni i partneriteteve

Partneritetet e NATO-s, d.m.th marrëdhëniet e ngushta dhe zyrtare me vendet jashtë Aleancës, kanë qenë një histori e vërtetë suksesi. Gjatë më shumë se dy dhjetëvjeçarësh

është zhvilluar një rrjet i dendur i forumeve rajonale të partneritetit: Partneriteti për Paqe (PfP), Dialogu Mesdhetar (MD), Nisma e Stambollit për Bashkëpunimin (ICI) dhe marrëveshje të tjera dypalëshe me të ashtuquajturit "Partnerë Globalë". Të gjitha këto partneritete janë reciprokisht të dobishme, duke i dhënë NATO-s ndikim në ato rajone dhe me kontribute ushtarake ose politike në projekte të përbashkëta nga vendet partnere. Nga ana tjetër, partnerët morën njohuritë nga NATO për operacionet shumëkombëshe, standardizimin apo ndërtimin e kapaciteteve.

Së pari, pavarësisht suksesit të përgjithshëm, veprimtaria e partneritetit e NATO-s është nën presion të madh për të ndryshuar në mënyrë që të përshtatet me kërkesat e epokës post-2014. Dy zhvillimet aktuale dhe ato që do të pasojnë nxjerrin në pah nevojën për një evolucion të përmasave më të gjëra të partneriteteve. Numri në rritje i vendeve partnere dhe institucioneve (si BE, OKB, Lidhja Arabe dhe Bashkimi Afrikan), ngre çështjen se si duhet menaxhuar politikisht numri i madh i partnerëve me origjinë, qëllime, interesa dhe ambicie të ndryshme. Për më tepër, tensionet midis partnerëve apo problemet midis anëtarëve të veçantë të NATO-s dhe vendet partnere kanë tendencë për t'u bërë çështje për të gjithë Aleancën. Për shembull, tensionet në mes Turqisë dhe Izraelit kanë pasur pasoja të rënda për NATO-n në përgjithësi.

Së dyti, ridislokimi pas Afganistanit dhe riorientimi i Uashingtonit ndaj rajonit të Azi-Paqësorit ndryshon rëndësinë dhe pikën e rëndesës së partnerëve të veçantë. Vendet politikisht problematike në Azinë Qendrore të cilat aktualisht mund të konsiderohen si të domosdoshme për tërheqjen nga Afganistani, mund të humbasin rëndësinë sapo të gjitha forcat luftarake të NATO-s të jenë kthyer në atdhe. Nga ana tjetër, vendet në zonën e Azi-Paqësorit ka gjasa të fitojnë rëndësi sapo aleatët kryesorë të NATO-s të fokusojnë interesin e tyre në atë rajon.

Duke pasur parasysh përvojat me partneritetet në të kaluarën dhe sfidat që rrjedhin nga kërkesat e botës post-2014 tre përfundime duken të pashmangshme:

Së pari, partneritetet nuk mund të jenë pa hierarki. Jo të gjithë partnerët janë të barabartë dhe jo të gjithë partnerët janë njësoj të rëndësishëm. Për shembull, Bjellorusia dhe Turkmenistani, të dy vende të PfP, nuk janë në të njëjtin nivel rëndësie me Suedinë dhe Austrinë.

Së dyti, duke qenë se NATO është një komunitet i vlerave ku të gjithë anëtarët iu përmbahen parimeve të demokracisë, lirisë individuale dhe shtetit ligjor (edhe pse disa anëtarë ende kanë mangësi në këtë drejtim), partnerët me qasje të njëjta politike duhet të marrin vëmendje të veçantë.

Së treti, partnerët që janë demokraci të plota (dhe janë të gatshëm për të kontribuar në misionet e NATO-s) duhet të kenë një status të privilegjuar në Aleancë dhe duhen përfshirë në proceset e konsultimeve dhe formësimit të vendimeve të NATO-s sa më shumë të jetë e mundur-me kusht që të jenë anëtarë me të drejta të plota. Kjo nuk përjashton bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me vendet e tjera jashtë këtij grupi të privilegjuar të demokracive-ajo është thjesht një nivel i ndryshëm intensiteti dhe afërsie.

Çështjet politike të cilat mund të diskutohen nga lidershipi politik i NATO-s janë:

- Si mund ta transformojë NATO sistemin aktual të partneritetit i cili ende karakterizohet nga grupime rajonale, në një mekanizëm që i kushton vëmendje

kërkesës së veçantë të farkëtimit të lidhjeve më të ngushta me vendet e afta ushtarakisht dhe që kanë të njëjtat qasje politike, pavarësisht nga vendndodhja e tyre gjeografike?

- A duhet NATO të krijojë një forum të veçantë për t'u konsultuar me këto vende të afërta politikisht-diçka që deri tani është karakterizuar me qesëndisje si "Salloni i Qylymit të Kuq"-dhe nëse po, cilët do të jenë të ftuarit? Partnerët globalë si Australia apo Japonia do të jenë anëtarë të natyrshëm, e njëjta vlen për Suedinë dhe Finlandën. Por si duhet vepruar me partnerët që janë vende demokratike por nuk kontribuojnë fare në misionet e NATO-s, ose me ata që kontribuojnë, por për të cilët ka pikëpamje të ndryshme brenda Aleancës mbi kredencialet e tyre demokratike?
- Si mundet NATO të përcjellë mesazhin se krijimi i një forumi të partneritetit të privilegjuar për demokracitë nuk drejtohet "kundër" dikujt, përkundrazi, ai është në përputhje të plotë me vetë imazhin e NATO-s si një aleancë bazuar në vlerat e demokracisë?

Vizioni i NATO-s për epokën pas vitit 2014

Përveç të gjitha këtyre temave të veçanta, një çështje themelore dhe ndoshta çështja më e rëndësishme që do të mbisundojë debatet e samitit dhe do të kërkojë qëndrim politik nga niveli më i lartë është: si mund të justifikohet ekzistenca e NATO-s në epokën e pas 2014? Me tërheqjen nga Afganistani, me SHBA-të që do ta spostojnë vëmendjen në zonën e Azi-Paqësorit, me buxhete mbrojtjeje që po reduktohen ndjeshëm kudo brenda Aleancës, me Rusinë që gradualisht po i bie rëndësia, me punë gjithnjë e më pak të papërfunduara në Evropë, pyetja thelbësore është: A mundet që një Aleancë politike-ushtarake si NATO të justifikojë ekzistencën e saj në epokën e pas Luftës së Ftohtë, pa u angazhuar në një operacion ushtarak që është kyç për sigurinë e anëtarëve të saj? A është e mjaftueshme, po të shprehemi sipas gjuhës standarde të NATO-s, të deklarojmë se Aleanca duhet të zhvillohet nga "NATO e dislokuar në NATO e përgatitur", pa marrë parasysh pyetjen: përgatitur por për çfarë? Po t'i referohemi Konceptit Strategjik të vitit 2012 si baza kryesore konceptuale që u kundërvihet dyshimeve për rolin dhe misionet e ardhshme të NATO-s, sikundër argumentojnë disa vëzhgues, nuk ndihmon sa duhet sepse ndërkohë ky dokument të paktën pjesërisht është tejkaluar nga zhvillimi i ngjarjeve.

Në qoftë se Aleanca nuk arrin të paraqesë një gjykim bindës, perceptimi publik mund të jetë se NATO është e gatshme të pranojë rënien e rëndësisë së saj dhe është e përgatitur për ta vënë veten në pozita pritjeje letargjike derisa të rizgjohet nga një mision i ri. Nëse ndodh vendosja e saj në një gjendje të tillë letargjie, do të jetë edhe më e vështirë të alokohen fondet e mjaftueshme për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, sidomos në vendet evropiane të vëna në darën e shtrëngesave financiare. Pra, pa financim të mjaftueshëm, NATO nuk do të jetë në gjendje të ruajë pikat e saj të forta si: përgatitjen dhe ndërveprueshmërinë përmes planifikimit, standardeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Për këtë arsye, liderët e NATO-s duhet të përkthejnë tri misione abstrakte thelbësore të Konceptit Strategjik 2010 (mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave, siguria e përbashkët) në një konceptim konkret, që pasqyron sfidat e epokës post-Afganistan. Një konceptim i tillë mund të jetë i tillë që Aleanca do të përqendrohet në detyrat për të cilat u themelua: për të mbrojtur sigurinë dhe interesat jetësore të anëtarëve të saj. Kjo mund të përfshijë

pasiguritë larg Evropës-pa marrë parasysh nëse ato janë misione sipas nenit 5 apo jo dhe nëse ato përfshijnë forcat e dërguara apo kapacitetet mbrojtëse territoriale. Një sulm me raketa nga Koreja e Veriut në Alaskë (duke pasur parasysh kokëfortësinë e regjimit të Penianit, ky zor se mund të jetë një skenar i largët) mund të jetë po aq i sigurt sa një sulm sirian kundër territorit turk, për të kërkuar një reagim sipas nenit 5. Edhe përtej pyetjeve të mbrojtjes kolektive, të rregulluara me nenin 5, veprimi i menjëhershëm për të mbrojtur interesat jetësore mund të bëhet i nevojshëm. Për shembull, nëse një luftë në Lindjen e Mesme do të bënte që Irani të bllokonte Ngushticën e Hormuzit, NATO nuk do të qëndronte pasive thjesht për faktin se nuk u sulmua drejtpërdrejt. E njëjta gjë duhet thënë për sulmet shkatërruese terroriste apo shkatërrimin e dhunshëm të rrjeteve të furnizimit me energji. Me prodhimin aktual të armëve bërthamore, me shtrirjen e teknologjive të prodhimit të raketave dhe me potencialin e padyshimtë për sulme shkatërrimtare mbi rrjetet e komunikimit apo për aktet terroriste që përdorin teknologjitë e zotëruara nga shtetet, formulimi i një konceptimi për NATO-n e pas 2014-s nuk mund të jetë një mision i pamundur.

Përktheu nga gjuha angleze: Dr. Jaup Zenuni

Samiti i Uellsit dhe Shqipëria

Kolonel Manushaqe Shehu
Drejtor i J9, SHPFARSH

Trajtesë e shkurtuar. *Fillim shtatorin e këtij viti, Mbretëria e Bashkuar do të mirëpresë takimin më të madh të liderëve botërorë për të diskutuar mbi temat më të nxehta të fushës së sigurisë globale. Presidenti i SHBA-ve Obama, kryeministri britanik Kamerun, kancelarja gjermane Merkel, së bashku me rreth 60 drejtues shtetesh dhe ministra mbrojtjeje nga mbarë bota, do të marrin pjesë në samitin e radhës së Aleancës Euroatlantike në Uells. Ky samit shumë i rëndësishëm vjen në momentet kur NATO do të vendosë për tërheqjen ushtarake nga Afganistani, pas një misioni të gjatë disavjeçar, me qëllim kalimin nga misioni luftarak në mision këshillues e trajnues. Për më tepër, ky samit vjen si një domosdoshmëri për uljen e tensioneve politike të shkaktuara nga ndërhyrja ruse në Krime dhe destabiliteti i thellë në Ukrainë.*

Synimi i Aleancës Euroatlantike do të jetë transmetimi i mesazhit se NATO do të vijojë të jetë në vijë të parë, me qëllim që të ndërtojë stabilitet në një botë të paparashikueshme. Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i axhendës së samitit të Uellsit do të jetë rishikimi dhe forcimi i mbrojtjes kolektive nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve dhe rolit të NRF dhe forcave speciale, duke e vënë theksin në përmirësimin e shpenzimeve buxhetore prej 2% të GDP, kjo në përgjigje të rritjes së shpenzimeve nga ana e Rusisë dhe vendeve të tjera. Marrja e përgjegjësive më të mëdha, në kuadër të mbrojtjes kolektive nga vendet evropiane, është një pikë tjetër e diskutimeve edhe në modernizimin e mëtejshëm të mbrojtjes kolektive.

Një tjetër çështje që do të kërkojë vëmendjen e krerëve të shteteve, do të jetë angazhimi proaktiv për një ambient kompleks global më të sigurt, partneriteti dhe bashkëpunimi me vendet e tjera, e sidomos ato të Evropës Lindore, si dhe "politika e dyerve të hapura" dhe mbështetja për vendet e dobëta. Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në bazë të konceptit "Defence capabilities building", nëpërmjet dërgimit të specialistëve ose ekipeve stërvitore në shtetet partnere dhe përgatitja e një programi ambicioz e gjithëpërfshirës, do të jenë disa nga drejtimet bazë të diskutimeve të samitit dyditor të Uellsit.

Ndër të gjitha mundësitë që do të sjellë samiti i këtij viti i NATO-s, ndoshta më e rëndësishmja, është ajo që e rithekson mesazhin se interesat e botës së lirë dhe të popujve të saj janë që duke punuar ngushtësisht së bashku, të vazhdojnë të jenë të mbrojtur gjithmonë e më mirë.

Samiti i Uellsit

Ky do të jetë samiti i parë i NATO-s që mbahet në Mbretërinë e Bashkuar, qysh prej vitit 1990, kur "Zonja e hekurt" Margaret Theçer mirëpriti takimin e liderëve të NATO-s. Përgjatë sesioneve zyrtare që do të zhvillohen në *Celtic Manor* dhe *Kardif*, drejtuesit botërorë do të diskutojnë çështje të cilat shqetësojnë sigurinë kombëtare të vendeve anëtare të NATO-s, duke filluar nga shtetet e dobëta, pirateria, terrorizmi dhe sulmet kibernetike.

NATO, në këtë 65-vjetor të sajin, krahas "*hot spoteve*" si agresioni rus në Ukrainë, do të vendosë për rishikimin e rregullave dhe përfshirjes globale të saj për një botë më të sigurt, në luftë kundër piraterisë, terrorizmit dhe sulmeve kibernetike, të cilat gjithnjë e më tepër po kërcënojnë paqen dhe stabilitetin në rajone apo zona të caktuara të globit.

Të gjitha këto janë çështje të ndjeshme dhe të rëndësishme, të cilat janë trajtuar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesit më të lartë të shteteve evropiane-perëndimore, të SHBA-ve dhe vendeve partnere e aleate. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. *Anders Fogh Rasmussen*, në fillim të raportit të tij vjetor të janarit të këtij viti, theksoi se investimi në kapacitetet e duhura, ruajtja e forcave të lidhura, si dhe thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me vendet partnere janë thelbësorë për t'i dhënë formë një NATO-je që është në gjendje të përmbushë sfidat e të ardhshmes. "Në shtator, ne do të takohemi në Uells për të formësuar NATO-n e së ardhmes: një Aleancë që është e fortë, e ribalancuar dhe e gatshme të ofrojë siguri për gjeneratën e ardhshme", ka theksuar z. *Rasmussen*. Gjatë raportit vjetor të NATO-s, i cili analizon atë çka është arritur gjatë vitit të kaluar si dhe përcakton sfidat për vitin e ardhshëm, sekretari i përgjithshëm nënvizoi faktin se tashmë NATO është më efektive dhe efikase se në çdo kohë të historisë së saj, por shtoi se aleatët gjithashtu duhet të ruajnë ritmin e transformimit në Samitin e Uellsit.

Për një sy të vëmendshëm është lehtësisht e qartë të dallohet se NATO tashmë ka hedhur themele të forta, sidomos gjatë viteve të fundit, bazuar në udhëzimet e vyera të Konceptit Strategjik të Samitit të Lisbonës, i cili promovon angazhimin aktiv dhe mbrojtjen moderne. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2013, aktivitetet e NATO-s përfshinë një gamë të gjerë dhe të larmishme, duke filluar nga operacionet ushtarake tek ndërtimi i marrëdhënieve me partnerët, nga përpjekjet për të siguruar dhe ruajtur kapacitetet e Mbrojtjes tek vijimi i reformave, etj. NATO vazhdon të garantojë sigurinë e aleatëve të saj, duke përmbushur tri detyrat kryesore: mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Operacionet tona në Afganistan, Kosovë, në brigjet e Somalisë dhe dislokimi i raketave "Patriot" në Turqi janë shembuj të qartë. Forcat tona janë më të afta dhe më të lidhura se kurrë më parë[1].

Në suazën e mësimeve të nxjerra, Aleanca ka kuptuar se është shumë e rëndësishme të investojë në përmirësimin e kapaciteteve për t'u përballur me rreziqe dhe sfida të tilla si terrorizmi, pirateria, paqëndrueshmëria rajonale, si dhe sulmet raketore e kibernetike. Nën drejtimin e SHBA-ve, aleatët evropianë duhet të luajnë plotësisht rolin e tyre në zhvillimin e kapaciteteve kritike të tilla si inteligjenca, vëzhgimi dhe mbikëqyrja e përbashkët, si dhe mbrojtja raketore.

[1] Anders Fogh Rasmussen, raporti vjetor i NATO-s, janar 2014.

Në lidhje me ruajtjen e forcave të ndërlidhura, z. *Anders Fogh Rasmussen* ka vlerësuar se në Samitin e Uellsit, aleatët duhet të angazhohen në një program të gjerë stërvitjesh reale, trajnimi dhe edukimi si pjesë e Nismës së Forcave të Lidhura të NATO-s. Aleatët gjithashtu duhet të shikojnë përtej vetes, duke krijuar lidhje më të ngushta me partnerët, duke përfshirë mbështetjen e atyre partnerëve që kanë nevojë për ndihmë për të ndërtuar dhe zhvilluar sektorët e tyre të sigurisë. Është fakt i pamohueshëm që NATO tashmë arkivon një sërë arritjesh në operacionet sfiduese dhe në partneritetet anembanë botës. Ndaj drejtuesit e saj po përpiqen të përshtaten për ta bërë NATO-n më të zhdërvjellët dhe më efikase, në mënyrë që aleanca të mbetet një faktor thelbësor stabiliteti në një botë të paparashikueshme dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

> *"Në konferencën e ardhshme të nivelit të lartë të NATO-s në Uells të Anglisë shtatorin që vjen, Aleanca e Atlantikut do të demonstrojë forcën dhe guximin e përbashkët duke përballuar me mënyra të reja shumë sfida të shekullit të 21-të, me të cilat përballet sot bota".*
>
> *John Kerry Sekretari Amerikan i Shtetit*

NATO përballë zgjerimit

NATO e ka cilësuar politikën e saj të dyerve të hapura si një nga arritjet më të suksesshme të viteve të fundit. Në më pak se dy dhjetëvjeçarë, NATO afroi brenda Aleancës edhe 12 shtete të reja anëtare, duke përforcuar natyrën transformuese të Aleancës dhe duke kontribuuar në paqen dhe stabilitetin në Evropë. Pyetja që shtrohet sot rëndom është nëse NATO duhet ta mbajë derën hapur për vendet e reja për t'u bashkuar me Aleancën. Megjithatë, dera nuk hapet automatikisht vetëm sepse dikush ndodhet para saj. Pranimi është i bazuar në merita individuale të kandidatëve, sipas aftësisë për të përmbushur detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarësimit. Në të njëjtën kohë, duhet të jetë e qartë se asnjë fuqi e jashtme nuk mund të ketë të drejtën e *veto*-s në NATO në lidhje me procesin e zgjerimit.

Gjykuar nga perspektiva e Moskës, anëtarësimet e reja në NATO janë një tregues i përpjekjeve të kësaj të fundit për të organizuar rendin botëror sipas kufijve të rinj. Qysh prej vitit 2000, Rusia ka treguar një forcë të re dhe rimëkëmbje ekonomike dhe nuk ka hezituar të përdorë burimet e energjisë që ajo zotëron si "asin nën mëngë" në arenën ndërkombëtare. Lufta e vitit 2008 në Gjeorgji tregoi se Rusia është sërish një fuqi e madhe, me dëshira për të ruajtur qoftë edhe ushtarakisht interesat e saj gjeopolitike. Kjo u zyrtarizua së fundmi me aneksimin e Krimesë dhe agresionin rus në rajonet e Ukrainës Lindore, duke hapur një front të ri të betejës politike ndërmjet perëndimit dhe Rusisë që, për hir të së vërtetës, ka pak gjasa të zgjidhet pa hapa të fortë dhe sanksione të të gjitha llojeve.

Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s, gjatë takimit në muajin qershor, shqyrtuan përparimin e bërë nga katër vende që aspirojnë anëtarësimin në NATO e që janë Gjeorgjia, Mali i Zi, Bosnje-Herzegovina dhe Maqedonia. Gjatë këtij takimi drejtuesit e diplomacisë së vendeve të NATO-s ndanë mendimin e përbashkët se secili vend do të gjykohet për anëtarësim, bazuar në meritat. Sa i takon Ukrainës, si një përgjigje ndaj aneksimit të Krimesë nga Rusia, lidershipi i saj duhet të mendojë për përshpejtimin e hapave të afrimit me NATO-n. Kjo vlen edhe për Maqedoninë, e cila së pari duhet të finalizojë një zgjidhje përfundimtare sa i takon çështjes së emrit me Greqinë.

Marie Harf, zëdhënëse e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, në një deklarim zyrtar gjatë muajit mars, u shpreh se Aleanca mbetet e hapur për të gjitha demokracitë evropiane të cilat dëshirojnë t'i bashkëngjiten, i avancojnë parimet e NATO-s dhe kontribuojnë drejt stabilitetit dhe sigurisë së rajonit veriatlantik. Zgjerimi nuk do të jetë një ndër temat kryesore të samitit në vitin 2014, por ajo është çështje në të cilën duhet të fokusohemi, deklaroi *Harf*.

Edhe zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, *Aleksandar Vershbou*, paralajmëroi se në samitin e NATO-s në shtator në Britani, do të duhet të dërgohet mesazh i qartë për zgjerimin e Aleancës, madje edhe nëse asnjë vend nuk pranohet në anëtarësim. "Në fund të fundit, kemi sfidë që të dërgojmë mesazh të fuqishëm dhe bindës për zgjerimin e samitit në Britani, që të jetë e qartë se dera jonë e hapur me të vërtetë është e hapur, se procesi i zgjerimit edhe më tej është i bazuar mbi merita të vendeve aspirante dhe se asnjë fuqi e jashtme nuk do të ketë të drejtë të *veto*-s mbi pranimin e anëtarëve të rinj", deklaroi *Vershbou*.

Kjo është natyrisht e vlefshme për çdo shtet për t'u vendosur në rrugën drejt integrimit të tyre euroatlantik. Përvoja e shumë vendeve, duke përfshirë Kroacinë dhe Shqipërinë janë faktorë të dëshirës dhe rezultateve konkrete dhe tregon se anëtarësimi në NATO dhe BE nuk është i pamundur për katër vendet aspirante. Në sesionin e punës së Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC), të datës 25 qershor, i cili iu kushtua përgatitjeve për Samitin e Uellsit, ministri shqiptar i Punëve të Jashtme shprehu konsideratat e Shqipërisë rreth zhvillimeve aktuale në kontekstin e krizës në Ukrainë, analizoi pasojat që ato mund të kenë për marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë, si dhe për paqen dhe stabilitetin në Evropë e më gjerë. Ministri Bushati shprehu gjithashtu mbështetjen e Shqipërisë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, si dhe mbështeti masat e marra nga Aleanca për bashkëpunimin e mëtejshëm NATO-Ukrainë. Ministri Bushati theksoi rëndësinë e partneriteteve dhe rolin që ato kanë për bashkëpunimin e ardhshëm në Evropë dhe më gjerë. Ai vlerësoi rolin e madh që kanë partnerët, veçanërisht në aspektin operacional, përsa i përket përballimit me sukses të sfidave të sigurisë, sikundër dhe mbështeti vizionin e ardhshëm të Aleancës për t'u ofruar partnerëve më shumë mbështetje politike dhe praktikë në të ardhmen.

NATO dhe sfidat e reja të sigurisë

Zona euroatlantike është në paqe dhe kërcënimi për një sulm konvencional kundër territorit të NATO-s është tejet i ulët[2]. Ky është një sukses historik për politikat e fuqishme të mbrojtjes, integrimit euroatlantik dhe partneritetit aktiv që kanë drejtuar NATO-n, për më shumë se gjysmëshekulli. Ky kërcënim pothuajse nuk ekziston, sepse momentalisht nuk ka asnjë vend në botë me kapacitete që do t'i siguronin epërsinë konvencionale, qoftë edhe për një afat të shkurtër kohor kundrejt Aleancës.

Por paqëndrueshmëria ose konfliktet përtej kufijve të NATO-s, mund të kërcënojnë direkt sigurinë e Aleancës, duke përfshirë nxitjen e ekstremizmit, terrorizmit dhe aktivitete ilegale trans-kombëtare, të tilla si trafikimi i armëve, narkotikëve dhe njerëzve. Nga kërcënimet e tjera, më të mundshme për të ndodhur janë krizat, konfliktet dhe situatat e krijuara pas tyre. Aleanca, me veprimet e veta, ka konfirmuar angazhimin e saj për të parandaluar krizat, menaxhuar konfliktet dhe për të stabilizuar situatat paskonfliktuale, duke përfshirë dhe duke punuar më ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, si Kombet e Bashkuara dhe

[2] Giovanni Grevi and Álvaro de Vasconcelos, Global security in a multipolar world, "Partnerships for effective multilateralism".

Bashkimin Evropian[3]. Kufizimet kryesore të lidhura me mjedisin dhe burimet, duke përfshirë edhe rreziqet e shëndetit, ndryshimet klimaterike, mungesat e ujit dhe nevojat në rritje për energji, do të vijojnë të ndikojnë dhe formëzojnë mjedisin e ardhshëm të sigurisë në fushat me interes për NATO-n, pasi ato kanë potencialin që të ndikojnë dukshëm në planifikimin ushtarak të operacioneve të NATO-s në të ardhmen.

Është detyrë eminente që NATO të rigjejë pozicionin e vet në një rend ndërkombëtar më pak të centralizuar dhe më shumë të komplikuar. Roli i saj duhet që të frymëzohet nga emergjencat e kërcënimeve specifike, që burojnë nga një spektër i gjerë mundësish. NATO do të jetë e detyruar që të veprojë edhe në rastet kur sfidat nuk përbëjnë kërcënim për vetë sigurinë e saj, por që ndikojnë në stabilitetin dhe mirëqenien e qytetarëve të saj, pra që do të kontribuojë ndjeshëm në perceptimin e komunitetit ndërkombëtar ndaj Aleancës. Këto sfida mund të përfshijnë emergjenca humanitare në një shtet të dështuar, shkretimin e zonave të tëra si rezultat i fatkeqësive natyrore, por edhe genocid apo forma të tjera të dhunës kolektive ndaj të drejtave të njeriut.

Demografia dhe rritja e numrit të popullsisë paraqesin një prej këtyre sfidave të reja të sigurisë globale. Rajone të tilla, si Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore kanë përjetuar tranzicione të thella demografike që janë akoma në zhvillim. Edhe pse numri i lindjeve në këto vite është gjithnjë në rënie, shfaqet një numër gjithnjë e më i madh i popullsisë me moshë të re. Për dhjetëvjeçarin në vijim, rreth 65% e popullsisë së këtyre rajoneve do të jetë më pak se 24 vjeç. Këto statistika tregojnë padyshim një impakt të madh në të ardhme e shoqërive të këtyre rajoneve.

Bazuar në disa studime të realizuara nga agjenci prestigjioze, ka një lidhje reale ndërmjet përqindjes së madhe të moshave të reja dhe rritjes së dhunës politike, paqëndrueshmërisë sociale dhe represionit shtetëror në vende të caktuara. Kështu, në ato vende ku numri i popullsisë me moshë të re është shumë i lartë, vërejmë se rekrutimi i tyre nga banda kriminale, organizata të dyshimta apo organizata ushtarake paramilitare është më i dukshëm, por dhe më i lehtë për t'u realizuar. Ky argument përshkallëzohet në rritje, falë faktit se në vendet e Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Veriore shënohet një shkallë e lartë e papunësisë, që varion nga rreth 40% në Algjeri dhe në territoret palestineze, deri në 6% në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rritja e numrit të të papunëve, sidomos ndërmjet moshave të reja, vjen si shkak i kushteve ekonomike globale gjithnjë e në përkeqësim. Në Lindjen e Mesme rritja e popullsisë shoqërohet me rritjen e çmimit të ushqimeve, si dhe me shterimin e rezervave ujore. Por ky problem nuk haset vetëm në Lindjen e Mesme, ai vërehet gjithashtu edhe në Afrikë, Amerikën e Jugut, Azinë Jugore, pra në të gjithë brezin e varfërisë botërore. Këto janë tendencat globale që NATO duhet të marrë në konsideratë, ndërsa analizon sfidat e reja të sigurisë me të cilat ajo do të përballet.

Fushata disavjeçare e NATO-s në Afganistan është padyshim një dritare e hapur për të qartësuar më mirë sfidat e së ardhmes. Kjo, pasi luftërat e së nesërmes mund të kenë shumë karakteristika të ngjashme me atë që po zhvillohet ende në Afganistan. NATO mund të përballet sërish me rivendosjen e rendit dhe të institucioneve kushtetuese në shtete të dështuara, të sigurojë popullsinë dhe territoret e këtyre shteteve. Forcat ushtarake të NATO-s mund ta gjejnë veten të angazhuar njëherazi në shumë detyra, si operacione luftarake, paqeruajtëse, rindërtimi apo asistence humanitare. Në të njëjtën kohë, Aleanca duhet të përballet edhe me pasigurinë e kufijve ndërshtetërorë në shumë zona të

[3] Theo Farrell, NATO War-Making in Afghanistan and Beyond.

pastabilizuara, pasi oponentë kriminalë mund të kërkojnë që të pajisen me armë dhe kapacitete konvencionale.

Dega e Sfidave të Reja të Sigurisë (DSRS), e krijuar së fundmi në NATO, nuk është thjesht një domosdoshmëri në përgjigje të sfidave të reja, por edhe një angazhim dhe qëndrim i fortë politik. Për herë të parë, NATO po bashkërendon në mënyrë sistematike punën në fusha që do të kenë gjithnjë e më shumë ndikim në sigurinë e aleatëve në të dy anët e Atlantikut: terrorizëm, sulme kompjuterike, kërcënime ndaj furnizimit me energji dhe përhapje të armëve të dëmtimit në masë. Në shikim të parë mund të duket sikur këto sfida kanë pak gjëra të përbashkëta. Megjithatë, një vështrim më nga afër nxjerr në dritë përse ato përputhen me njëra-tjetrën nga ana konceptuale. Këto sfida jo vetëm që kanë disa karakteristika të përbashkëta, por trajtimi i tyre kërkon gjithashtu që NATO të ndryshojë mënyrën e të menduarit rreth solidaritetit të Aleancës dhe të ndërveprimit me bashkësinë ndërkombëtare e më gjerë, në veçanti me aktorë civilë dhe me sektorin privat.

Karakteristikë e këtyre sfidave është se ato nuk prekin të gjithë aleatët në të njëjtën mënyrë. Një sulm terrorist ndaj një aleati të vetëm mund të krijojë shqetësim të përbashkët, por megjithatë, ai nuk mund të vështrohet vetvetiu si një sulm kundër Aleancës në tërësi. E njëjta gjë qëndron vërtet për një sulm kompjuterik ndaj sistemit bankar ose një sulm ndaj furnizimit me energji të një aleati të veçantë. Vendimi në lidhje me mundësinë dhe mënyrën e përgjigjes i takon, para së gjithash, vendit që është goditur.

Risi tjetër e sfidave të reja është fakti se ato nuk kërkojnë domosdoshmërisht një përgjigje ushtarake. Një sulm kompjuterik i orkestruar me shkathtësi mund të paralizojë një vend me mënyra të tilla që në të kaluarën mund të arriheshin vetëm nga një pushtim i huaj; por nëse sulmuesit, për shembull, do të ishin një OJQ, NATO vështirë se do të ishte në gjendje të ndërmerrte një kundërveprim ushtarak. Kjo të çon në karakteristikën tjetër të përbashkët të sfidave të reja: meqenëse ato janë njëherësh të jashtme dhe të brendshme, sikurse edhe ushtarake dhe ekonomike, ato kërkojnë një këndvështrim gjithëpërfshirës. Me fjalë të thjeshta, ato shtrojnë para NATO-s kërkesën për të ndërtuar marrëdhënie të reformuara me një varg aktorësh civilë.

Disa aleatë mund të ngurrojnë për t'i dhënë NATO-s një rol më të fuqishëm në fusha të tilla, si sigurimi i energjisë ose shqyrtimi i përhapjes së armëve bërthamore, duke argumentuar mospajtimin e tyre ndaj militarizimit të tepruar të shumë çështjeve, që për arsye të forta duhet të mbeten politike. Të tjerë mund të jenë të shqetësuar ngaqë, duke u marrë me këto sfida të reja të sigurisë, do të shmanget vëmendja e NATO-s nga detyra e saj kryesore e mbrojtjes së përbashkët.

Prandaj, ajo çka nevojitet është një baraspeshë mes së tashmes dhe së ardhmes: NATO duhet të zhvillojë një kulturë të diskutimit politik që të mos jetë e mbyllur në çështje të përfshirjes së drejtpërdrejtë të NATO-s ushtarakisht, por të përmbledhë edhe çështje që mund të kenë "vetëm" zbatueshmëri politike. Për sa kohë që çdo debat në NATO do të vështrohet si përgatitje operacionesh ushtarake, një debat largpamës dhe pa paragjykime rreth sfidave të reja në shekullin e 21-të do të mbetet i papërcaktuar. Dega e Sfidave të Reja të Sigurisë do të luajë rolin e saj në ndihmesën për një kulturë të tillë të re të debatit. Aftësia e saj për analiza strategjike do të depërtojë në horizontin strategjik të sfidave që mund të ndikojnë në sigurinë aleate. Kjo do të ndihmojë në nxitjen e debatit mes aleatëve dhe do të përforcojë vlerën e pashoqe të NATO-s si një forum kryesor për këshillime në fushën e sigurisë ndërmjet Evropës dhe Amerikës së Veriut, bashkësia më e fortë në botë

e vendeve të natyrave të përbashkëta[4].

Shqipëria dhe kontributi i saj në Aleancë

Si shprehje e vullnetit për përmbushje sa më të mirë të detyrimeve ndaj kësaj Aleance, Shqipëria ka vijuar pjesëmarrjen me sukses në operacionet e NATO-s, si në operacionin ISAF në Afganistan me ekipe OMLT/MAT, të forcave speciale, etj, si dhe në operacionin KFOR në Kosovë me personel në shtab. Si vetë Aleanca, që për lejtmotiv ka "transformimin", edhe Forcat tona të Armatosura, si një organizëm jetik, janë gjithmonë në një proces të vazhdueshëm transformimi dhe zhvillimi[5].

Në politikën e saj për vazhdimin e zbatimit të procesit të "Tranzicionit" shpallur në Samitin e Lisbonës dhe mbështetur në politikën e Samitit të Çikagos "Exit Strategy", NATO synon arritjen e suksesit dhe daljen nga lufta në Afganistan. Kjo strategji konsiston në uljen graduale të numrit të trupave të mbështetjes së luftimit dhe në shtimin e ekipeve trajnuese (NTM, OMLT/MAT dhe POMLT). Bazuar në këtë politikë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA, përshtati nivelin e angazhimit të pjesëmarrjes në operacionin ISAF, duke rritur peshën specifike dhe duke ulur buxhetin e shpenzimeve të pjesëmarrjes.

Vlen të theksohet se pjesëmarrja në operacionin ISAF, me Trupa Speciale dhe Ekipe Trajnuese (OMLT, Shëndetësore dhe trajnues të FS), është vlerësuar maksimalisht nga strukturat vendimmarrëse të NATO-s (DSACEUR) dhe Komanda e Operacionit ISAF. Kjo, për vetë faktin se detyrat specifike dhe të vështira që kanë kryer dhe kryejnë, kanë dhënë rezultate të dukshme në mbështetjen e operacioneve luftarake të forcave të Aleancës si edhe në trajnimin dhe monitorimin e Ushtrisë dhe Policisë Afgane.

Detyrimet e Shqipërisë ndaj kërkesave të NATO-s

Shqipëria si një vend anëtar i NATO-s, luan një rol aktiv dhe kontribuon në drejtim të forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Vendi ynë ka marrë përsipër një sërë reformash që synojnë avancimin e mëtejshëm të vendit, sidomos në kuadër të plotësimit të detyrimeve ndaj BE-së, pas marrjes së statusit të vendit kandidat muajin e kaluar. Megjithatë mbeten një sërë sfidash me të cilat përballet rajoni dhe që kërkojnë veprimin tonë të përbashkët. Siguria është një proces kompleks dhe shumëdimensional dhe kërkon të kuptohet dhe trajtohet si i tillë.

Shqipëria është e përkushtuar për të përmbushur të gjitha standardet që rrjedhin nga anëtarësimi në Traktatin e Atlantikut të Veriut. Siguria dhe mbrojtja e vendit tonë duhet të konceptohen dhe zhvillohen si mbi bazën e përfitimeve, ashtu edhe të kontributeve të konceptit të mbrojtjes kolektive të Aleancës. Në këtë kuadër, një nga interesat madhore do të mbetet menaxhimi i drejtë dhe në kohë i sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që mund të prodhojnë kriza dhe mungesë stabiliteti në vend.

Forcat e Armatosura janë në rrugën e gjatë të reformës së mbrojtjes, që konsiston në një transformim të konceptit strategjik, të doktrinës, të strukturës organizative, të menaxhimit të personelit, të infrastrukturës ushtarake, të trajnimit dhe arsimimit, të sistemeve dhe pajisjeve e të shumë elementëve të tjerë. Ky transformim përbën një proces analitik të

[4] Gabor Iklodi, Ndihmësekretar i Përgjithshëm i NATO-s për Sfidat e Reja të Sigurisë. Revista e NATO-s.
[5] Nga fjala e SHSHPFA, gjeneral major Jeronim Bazo, mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

vazhdueshëm, të bazuar mbi vlerësimin e mjedisit të sigurisë dhe "mësimet e nxjerra", të shoqëruara me reflektimet përkatëse në interes të përmbushjes së misionit kushtetues.

Programi i ri i Qeverisë në fushën e mbrojtjes, përmban objektiva ambiciozë, të cilat kërkojnë vijimin e reformave dhe transformimin e mëtejshëm të Forcave tona të Armatosura, krijimin e kapaciteteve të nevojshme ushtarake për përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe vendosjen e tyre në lartësinë që meritojnë në shoqërinë shqiptare. Direktiva e Mbrojtjes përcakton qart drejtimet kryesore të punës për 2014-ën. Ato fokusohen tek përfundimi i dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, strategjisë së sigurisë kombëtare, strategjisë ushtarake dhe planit afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura.

Hartimi i dokumentit të strategjisë së sigurisë kombëtare, pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO, modernizmi i Forcave të Armatosura janë përparësi të rëndësishme dhe janë në rendin e ditës së punës së qeverisë për një Shqipëri evropiane, për një Shqipëri serioze dhe gjithnjë të përgjegjshme në tryezën e madhe të vendimmarrjes së Aleancës së Atlantikut të Veriut[6]. Direktiva e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2014 rithekson misionin e Forcave të Armatosura për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale, mbështetjen e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë që mbetet një mision i shenjtë. Ky mision do të vijojë të realizohet duke harmonizuar të gjitha planet dhe përpjekjet me Aleancën dhe me institucionet e tjera të sigurisë së shtetit[7].

Përfundime

Mësimet e nxjerra nga operacionet e fundshekullit të kaluar dhe fillimshekullit të ri, kanë nxjerrë në pah nevojën që Forcat tona të Armatosura të adoptojnë konceptin e ushtrive të Aleancës, atë të "Operacioneve të bazuara mbi efektet" dhe jo të operacioneve të bazuara vetëm mbi përdorimin e forcës ushtarake, sipas doktrinës së 3D-ve (Defense, Development and Diplomacy), të NATO-s.

Në përputhje me Konceptin Strategjik të Aleancës, koncepti i sotëm dhe i ardhshëm i Sigurisë dhe Mbrojtjes sonë Kombëtare duhet ta konsiderojë mbrojtjen e vendit si një çështje që shkon përtej angazhimeve tradicionale të mbrojtjes së tërësisë territoriale. Pranimi dhe zbatimi i këtij koncepti do të imponojë një pjesëmarrje edhe më sinergjike se deri tani, të të gjitha instrumenteve të sigurisë kombëtare në role të tilla si: parandalimi i konflikteve, menaxhimi i krizave, menaxhimi i pasojave, operacionet në mbështetje të paqes, kundërpërgjigja në operacionet e pas konfliktit, të ndërtimit të institucioneve dhe të asistencës humanitare.

Vizioni i përdorimit të Forcave të Armatosura duhet të jetë në të njëjtën linjë me konceptin strategjik të Aleancës Euroatlantike, i cili kërkon maksimizimin e kontributit të Forcave të Armatosura në periudhën para, gjatë dhe pas konfliktit, për të siguruar stabilitetin dhe rindërtimin e paqes, si pjesë e një orientimi strategjik të integruar. Pjesëmarrja e deritanishme në operacione të tilla ka bërë të qartë domosdoshmërinë e përgatitjes për vazhdimin e kontributit në operacione të këtij lloji. Kjo përvojë duhet të konsiderohet

[6] Nga fjala e Kryeministrit Edi Rama, mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.
[7] Direktiva e Ministrisë së Mbrojtjes, 2014, fq. 1.

thellësisht në zhvillimin e doktrinës dhe procedurave të veprimit, në skenarët operacionale të së ardhmes.

Forcat tona të Armatosura duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë kapacitete dhe aftësi të tilla operacionale, të krahasueshme nga ana cilësore me ato të vendeve të NATO-s. Aftësitë operacionale bazë të tilla si sistemi C4I, organizimi i forcave për detyrë, lëvizshmëria në kuptimin e shpejtësisë së veprimeve, saktësisë dhe efikasitetit, qëndrueshmëria (mbijetesa), mbrojtja e forcave, mbështetja logjistike dhe mbështetja e përgjithshme, përfaqësojnë kapacitetet e vërteta referuese për zhvillimin e FA-ve dhe arritjen e objektivave të procesit të transformimit. Këto aftësi bazë duhet të kuptohen të pandara nga zbatimi i kërkesave të përgjithshme, si gatishmëria për të vënë në dispozicion sasinë e kërkuar të forcave në kohë të shpejtë, integrimi dhe ndërveprimi me strukturat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë.

Bibliografia:

- Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, 2010.
- Giovanni Grevi and Álvaro de Vasconcelos, Global security in a multipolar world, "Partnerships for effective multilateralism".
- Revista ushtarake, prill 2014.
- Direktiva e Mbrojtjes, 2014.
- NATO official site.
- Raporti vjetor i NATO-s, janar 2014.
- Revista e NATO-s, 2014.

Një vështrim rreth Samitit të Uellsit

Kol (R) Thimi Hudhra
Zv.drejtor i QKSM

Trajtesë e shkurtuar: *Ditët e fundit po flitet shumë për samitin e ardhshëm të NATO-s në Uells. Pas Konceptit Strategjik të Lisbonës dhe Samitit të Çikagos, si dhe pas fundit të misionit madhor në Afganistan, dukej sikur NATO po shkonte drejt një periudhe më të qetë. Por nuk ndodhi kështu. Këto pritje i prishi "ariu polar", i cili u zgjua nga gjumi. Nga viti 2008, ai po tregohet më agresiv duke sfiduar NATO-n me rastin e Gjeorgjisë dhe së fundmi me rastin e Ukrainës.*

Çfarë mund të pritet më tej? Çdo gjë mund të jetë e mundshme me Politikën e Jashtme të Rusisë dhe me buxhetet e saj të mbrojtjes në rritje në 10 vitet e fundit. Gjithmonë e më shumë NATO po shikon me shqetësim zhvillimet e paparashikueshme dhe qëndrimet e ftohta dhe fodulle të Rusisë ndaj saj. Strategjia e Sigurisë së Rusisë e vlerëson NATO-n dhe sidomos zgjerimin e saj në lindje si një politikë armiqësore. Shumë analistë thonë se po shkojmë drejt një lufte të ftohtë të një profili tjetër. "...Një botë njëpolare është e papranueshme...[1]*",* është thelbi i doktrinës Medvedev.

Ky studim vlerësues jep pritjet e axhendës së NATO-s në samitin e radhës në Uells. Ndryshe nga samitet e kaluara, ky do të jetë samit me shqetësime më të mëdha. Ku po shkon Rusia? Cilat janë synimet e saj? Ku po shkojnë vendet e Azisë, si India dhe Kina? Çfarë duhet të bëjë NATO? Çfarë duhet të ndryshojë në pikëpamje politike, ekonomike dhe financiare nga vendet anëtare të Aleancës për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve të mjedisit të sigurisë? Një gjë është e sigurt: Samiti i Uellsit do të sjellë qëndrime të reja të NATO-s ndaj Rusisë.

Edhe Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, duhet normalisht të jetojë me këto ndryshime. Megjithë kontributin tonë modest në këtë organizatë, ne jemi pjesë e përfitimeve të paimagjinueshme të mbrojtjes dhe sigurisë kolektive. Në konsultimet me aleatët, Shqipëria duhet të artikulojë qëndrimet e saj për arritjen e konsensusit në vendimmarrjet e Aleancës në këtë samit. Pra, duhet të shkojmë atje të përgatitur.

Ky është edhe qëllimi i këtij vlerësimi strategjik, i cili do të pasohet me artikuj të tjerë në muajt në vijim, para dhe pas samitit të Uellsit. Ky artikull ofron gjithashtu 10 vlerësime dhe rekomandime që mund t'iu shërbejnë stafeve të punës apo autoriteteve vendimmarrëse pjesëmarrëse në këtë samit.

---

[1] "*Bota duhet të jetë shumëpolare. Një botë njëpolare është e papranueshme. Dominimi është diçka që ne nuk mund ta pranojmë,"*-deklaratë e Medvedev më 31 gusht 2013 në një stacionin shtetëror televiziv rus.

Hyrje

Samiti i Uellsit pritet të mbahet më 4-5 shtator 2014 me pjesëmarrjen e rreth 60 liderëve botërorë, aleatë dhe partnerë. Në ditët e para të qershorit 2014 ka filluar të diskutohet axhenda e tij, e cila ka devijuar disi nga ajo që mund të ishte e pritshme nga disa analistë. Liderët e NATO-s dhe të vendeve aleate kanë ndjekur me shqetësim ndryshimet e vrullshme të mjedisit të sigurisë globale, në veçanti përvijimin e një politike konstante të Rusisë për krijimin e një bote shumëpolare dhe ndarjen e re të zonave të ndikimit.

Kjo politikë e Rusisë e ka origjinën në Politikën e Jashtme të saj të iniciuar si "Doktrina Medvedev" në vitin 2008, e cila u testua me agresionin ndaj Gjeorgjisë po në atë vit, si dhe vijon të konsolidohet më tej në Politikën e Jashtme të Rusisë të miratuar nga Duma/Parlamenti i Rusisë në vitin 2013. Testimi i kësaj politike kësaj radhe u realizua me aneksimin e Krimesë, si dhe vazhdon me ndërhyrjet e mëtejshme për destabilizimin e Ukrainës.

Politika aneksioniste e Rusisë nuk është vetëm synim, por edhe realitet. Ajo është tani një politikë "*de jure*" dhe "*de facto*". Në muajt e fundit, më me këmbëngulje se në të shkuarën, Rusia ka treguar se ka ardhur koha për rishikimin e kufijve, me forcë nëse është e nevojshme. Për arritjen e synimeve të saj gjeopolitike, ajo synon rikrijimin e vijave ndarëse në Evropë, duke destabilizuar kombet sovrane, sidomos ato në kufijtë e saj.

Këto qëndrime të Rusisë e kanë bazën e tyre në qëndrimet e perandorëve dhe carëve të vjetër të Rusisë. Vetë Medvedev thotë në një takim me ushtarakët rusë se "*Rusia ose do të vazhdojë të jetë një fuqi e madhe, ose ajo do të pushtojë së ekzistuari*"[2]. Me epokën Putin-Medvedev dhe pasuesit e tyre, parashikohet të fillojë rizgjimi i Rusisë nga ëndrrat e vjetra të carëve të saj. Pas Gjeorgjisë dhe Ukrainës, me të drejtë ndokush mund të bëjë pyetjen: Kush e ka radhën?

Kjo sjellje e Rusisë ka krijuar një situatë jo të zakonshme dhe po shikohet me shqetësim në perëndim, veçanërisht në NATO, si organizmi simbol i sigurisë transatlantike dhe globale. Samiti i shtatorit në Uells do të mbahet mend pikërisht për këtë çështje: çfarë do të ndryshojë në marrëdhëniet me Rusinë? Nëse ndryshimet në këto marrëdhënie do të jenë të mëdha rezulton logjikisht që NATO duhet të fillojë një transformim të ri të strukturës politike dhe ushtarake të saj. Kjo do të sjellë ndryshime në sistemin e planifikimit të mbrojtjes kolektive dhe ato të vendeve aleate, ndër të cilat nuk përjashtohet as Shqipëria.

Për mbi 20 vjet, që nga samiti i Romës, NATO ka pasur marrëdhënie të suksesshme në fusha specifike të bashkëpunimit me Rusinë. Këto arritje mbi 20-vjeçare të Këshillit NATO-Rusi do të pësojnë një tronditje të thellë, ndoshta të pariparueshme për një kohë të gjatë. Në këtë kontekst, pritet që kjo situatë të vendoset në themel të transformimit të NATO-s në 10 vitet e ardhshme, si një NATO e së ardhmes, e përgatitur jo vetëm në formatin njëdimensional, por me një staturë shumëdimensionale. Një gjë është e sigurt deri tani: samiti i Uellsit do t'i kushtojë kohë dhe energji të konsiderueshme çështjeve të qëndrimeve ndaj Rusisë në dhjetëvjeçarin në vijim.

---

[2] "*Russia can either be big and strong or it will cease to exist" -tha Dmitry Medvedev në fjalimin e tij në diplomimin e ushtarakëve të lartë rusë në Kremlin, më 30 shtator 2008.*

Më 14 qershor 2014, në forumin *Chatam House*, *Rasmussen* thotë se "*Tani, ne po përballemi me një pikë tjetër kthese në histori. Bota që ne u përpoqëm për të ndërtuar pas fundit të Luftës së Ftohtë është duke u sfiduar. Në mënyra të ndryshme dhe nga drejtime të ndryshme, agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës është një përpjekje për të rishkruar rregullat ndërkombëtare dhe për të krijuar një sferë të ndikimit*".

Qysh në ditët e para të muajit qershor, vetë sekretari i NATO-s *Rasmussen*, zv.sekretari *Vershbow* dhe disa liderë të tjerë të lartë të vendeve të Aleancës, kanë filluar përgatitjen për formulimin e axhendës së samitit të ardhshëm të Uellsit. Muaji korrik dhe gusht do të jenë muaj diskutimesh dhe arritje e konsensusit për çështjet themelore të Samitit.

Çfarë shikojmë deri tani? Liderët e Aleancës dhe të vendeve aleate kanë përzgjedhur për të artikuluar mendimet e tyre për samitin e Uellsit, disa institucione "*think tank*" dhe forumet më prestigjoze të mendimit dhe kërkimit shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Shikojmë sekretarin *Rasmussen* të ndajë mendimet e tij në Institutin Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare -*Royal Institute for International Affairs* (në forumin *Chattam House*, Londër), zv.sekretarin *Vershbow* në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë, apo liderë të tjerë aleatë në forume të ngjashme. Platforma e diskutimit të liderëve është e përbashkët dhe boshti i diskutimit është i mirëbalancuar. Vlerësoj se boshti i axhendës së samitit të Uellsit do të ketë 3-4 çështje thelbësore, për të cilat edhe liderët tanë të shtetit dhe qeverisë duhet të jenë të përgatitur për të dhënë qëndrimet e tyre në vendimmarrjet me konsensus.

Nga diskutimet del se çështjet themelore të Samitit të Uellsit pritet të jenë:

1. Menaxhimi i periudhës pas misionit luftarak të ISAF-it në Afganistan.
2. Forcimi i mbrojtjes kolektive të Aleancës.
3. Vazhdimi i angazhimit global të NATO-s.

Le t'i trajtojmë këndvështrimet e aleatëve që po kristalizohen për arritjen e konsensusit për këto tre çështje.

Menaxhimi i periudhës pas misionit të ISAF-it

Operacioni ISAF i NATO-s në Afganistan farkëtoi një nga koalicionet më të mëdha në historinë e njerëzimit me 50 vende, aleatë dhe partnerë nga të gjitha kontinentet e globit. Sot Afganistani është një vend më ndryshe. Janë hedhur bazat për një siguri në rritje e cila po çon në përfitime në rritje në ekonomi, arsim, shëndetësi, zhvillimin e mediave dhe të drejtat e grave. Është në proces tranzicioni i parë demokratik i pushtetit pas zgjedhjeve presidenciale, të siguruara plotësisht nga vetë afganët.

Samiti i Uellsit pret hapjen e një faqeje të re të marrëdhënieve me presidentin e ri të Afganistanit. Nga 1 janari 2015 fillon një mision të ri joluftarak me emrin "*Resolute Support*", për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane. Partneriteti me Afganistanin ka një rëndësi domethënëse sidomos nën këndvështrimin e ngjarjeve të fundit në Irak. Konsolidimi i arritjeve të deritanishme për forcimin e kapaciteteve afgane të sigurisë mbetet vendimtar për paqen dhe stabilitetin afatgjatë të Afganistanit.

Forcimi i mbrojtjes kolektive të Aleancës

Kjo parashikohet të jetë çështja qendrore dhe më serioze e Samitit të Uellsit. Një sërë masash parashikohet të merren deri në samit për t'u paraqitur për miratim para kryetarëve të shteteve dhe qeverive aleate. Këto ndryshime janë reagim i mjedisit të sigurisë së kohëve

të fundit, sidomos ndaj veprimeve të Rusisë. Prej tyre, më kryesoret mund të jenë:

Rishikim i konceptit të mbrojtjes së Aleancës. Samiti i Uellsit pritet të sjellë një transformim në konceptin e mbrojtjes së territoreve të Aleancës. Parashikohet që marrja e masave konkrete për një mbrojtje kolektive të sigurt dhe të efektshme do të jenë në qendër të vendimmarrjeve të samitit. Aleanca ka filluar një proces të ri të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj saj, jashtë ciklit normal të këtij procesi. Për këtë qëllim, Aleanca po punon për të paraqitur në samit një Plan Veprimi për Gatishmërinë e Aleancës, i cili do të rikonsiderojë konceptin e mbrojtjes aleate, praninë, si dhe përhapjen/vendosjen e forcave aleate për mbrojtjen nga kundërshtarët e saj. Kjo do të marrë në konsideratë futjen dhe përpunimin e skenarëve të rinj të paparashikuar më parë, si dhe planifikimin e kapaciteteve për këtë qëllim në periudhën afatmesme.

Zhvillimi i një Aleance shumëdimensionale. Qëllimi kryesor i NATO-s mbetet mbrojtja e territoreve dhe qytetarëve të shteteve të Aleancës. Por, siç shprehet zv.sekretari *Vershbow*, "*Në mjedisin e paparashikueshëm të sigurisë së sotme, ne nuk mund dhe nuk duhet të ndërtojmë një Aleancë njëdimensionale. Aleanca e NATO-s duhet të jetë shumëdimensionale, e gatshme për t'u përgjigjur dhe për të vepruar shpejt, për gjithçka, kurdo dhe kudo që kërkohet*". Të gjithë tashmë e dimë se misioni i NATO-s ka tre shtylla kryesore: 1) mbrojtja kolektive e nenit 5; 2) menaxhimi i krizave jashtë nenit 5; dhe 3) partneritetet strategjike të sigurisë. Ky trinom i sigurisë kolektive kërkon domosdoshmërisht një Aleancë shumëdimensionale.

Rishikimi i Infrastrukturave të Aleancës. Në mjedisin e ri të krijuar, NATO ka vlerësuar të rishikojë planin e vendosjes së infrastrukturave të saj bazë për përmbushjen e misionit. Mbi bazën e mjedisit të vlerësuar, do të rikonsiderohen infrastrukturat e nevojshme, përcaktimi i vendbazimeve dhe skalionimi i pajisjeve dhe rezervave strategjike të saj. Ka filluar një rishikim i plotë i planeve të mbrojtjes dhe po përditësohen procedurat e paralajmërimit të hershëm dhe planifikimit, në përgjigje të krizave. Po ashtu, një Plan i ri i Stërvitjeve të Aleancës me emrin "*Connected Forces*" është në zhvillim në përputhje me mjedisin e ri të sigurisë.

Përmirësimi i Kapaciteteve Ushtarake. Në përputhje me konceptin e ri të mbrojtjes që do të adoptohet në samit, NATO parashikohet të marrë masa urgjente për përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese. Fokus kryesor do të vihet mbi 16 kapacitetet më të rëndësishme të përcaktuara nga Aleanca për përmbushjen e sfidave të sigurisë së sotme dhe të ardhme, ndër to ato të inteligjencës, vëzhgimit dhe zbulimit, të mbrojtjes raketore, të mbrojtjes kibernetike, të municioneve të drejtuara me preçizion të lartë, të furnizimit në ajër, të Forcës së Reagimit të Shpejtë, të Forcave Speciale, etj. Zhvillimi i kapaciteteve do të jetë një nga përparësitë kryesore të vendimmarrjeve të samitit. Siç thoshte me të drejtë ish-shefi i NATO-s, Lordi *Robertson*: "*në fund të fundit, thelbi i reformës së Aleancës është: kapacitete, kapacitete, kapacitete...*"

Rritja e buxheteve të Mbrojtjes Aleate. Duke marrë në konsideratë transformimin e konceptit të mbrojtjes si dhe përmirësimin e kapaciteteve të mbrojtjes kolektive, Aleanca parashikon shpenzime më të larta se deri tani. "*Siguria nuk mund të merret si e mirëqenë. Për të duhet të kontribuohet nga të gjithë*" shprehet presidenti *Obama*. Jo vetëm që shpenzimet e mbrojtjes duhet të rriten, por ato duhet edhe të adresohen siç duhet, atje ku janë përparësitë kryesore, si dhe duke adoptuar qasjen '*Smart Defence*'. Sekretari *Rasmussen* bën krahasimin: "*Që prej vitit 2008, Rusia ka* ***rritur*** *shpenzimet e mbrojtjes*

*me rreth 50%, ndërsa, mesatarisht, aleatët e NATO-s i kanë **ulur** me rreth 20% shpenzimet e mbrojtjes në këtë periudhë. Ky hendek duhet të adresohet, sidomos tani me përmirësimin e performancës së ekonomive të vendeve aleate*".

Shqetësimi tjetër është që dy të tretat e barrës së buxhetit të NATO-s mbahet nga SHBA. *Rasmussen* bën thirrje që "*nëse ne evropianët duam që Shtetet e Bashkuara të mbeten të angazhuar për sigurinë evropiane, ne duhet të tregojnë një angazhim për të marrë pjesën tonë të barrës së përbashkët*".

Rasmussen shprehet se "*shtetet evropiane kanë një pikë referimi të rënë dakord midis aleatëve, që është alokimi i 2% të GDP-së për mbrojtjen. Këtë vit vetëm 4 vende aleate e respektojnë këtë nivel angazhimi. Nëse të gjitha vendet evropiane do të plotësojnë angazhimin prej 2% të GDP*-thotë ai-*NATO do të ketë një shtesë totale prej 90 miliard dollarë në vit për të investuar në mbrojtjen e saj*". Samiti i Uellsit pritet të kërkojë angazhimin e krerëve të shteteve dhe qeverive për ta përmbysur gradualisht tendencën negative të shpenzimeve të mbrojtjes, nëpërmjet një paragrafi të veçantë në deklaratën finale të samitit.

Vazhdimi i angazhimit global të NATO-s

Një nga çështjet e veçanta që do të trajtohet në samit është edhe vendosja e formave të larmishme të bashkëpunimit dhe partneritetit të Aleancës me vende dhe organizata të tjera, në interes të përgjigjes efektive ndaj sfidave komplekse të sotme dhe të ardhme.

Në samit pritet të miratohet një platformë e re bashkëpunimi me partnerët, bazuar në përvojën e konsiderueshme 20 vjeçare. Synimi do të jetë i dyanshëm: partnerët të bëjnë më shumë veprime ko

nkrete me Aleancën dhe Aleanca të ofrojë më shumë për ata partnerë të cilët dëshirojnë ndihmën e saj.

Për të arritur objektiva më konkretë me partnerët, Aleanca është duke përgatitur një nismë të re të Ndërtimit të Kapaciteteve të Mbrojtjes. Kjo nismë synon të përqendrojë më mirë mbështetjen e partnerëve në fushën e reformës së mbrojtjes, në planifikimin e mbrojtjes dhe trajnimin ushtarak. Sipas kërkesës së partnerëve, ndihma aleate mund të konsistojë në dërgimin e ekipeve të specializuara këshilluese dhe vendosjes së misioneve të trajnimit, siç është rasti i Libisë.

Përfundime dhe rekomandime

Krahas çështjeve të tjera, Samiti i Uellsit do të përcjellë me përparësi të veçantë çështjen e transformimit të NATO-s së ardhshme, për t'iu përgjigjur mjedisit të ri të sigurisë globale.

Në këtë kontekst, në mendimin tim, disa mesazhe të mundshme që ne mund të përgatitemi të përcjellim në Samitin e Uellsit, të cilat mund të kristalizohen më tej në dy muajt në vijim, mund të jenë:

1.Të shprehet mbështetja e qeverisë shqiptare për reformat e Aleancës për forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, në kushtet e reja të mjedisit të sigurisë globale dhe evropiane. Kjo do të thotë që ne jemi dakord me reformat dhe transformimin e Aleancës që do të gjenerohen nga deklarata e përbashkët e Samitit të Uellsit.

2. Të përshpejtohet formulimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare 2014 dhe i Strategjisë Ushtarake 2014 të RSH si vend anëtar i Aleancës, si dhe të shprehet kjo arritje në mesazhin

e kreut të shtetit/qeverisë në Samitin e Uellsit. Gjykoj që këto dy dokumente të miratohen pas samitit të Uellsit për të qenë sa më të përditësuara me mesazhet kryesore të tij në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Miratimi para samitit i këtyre dokumenteve mund të kërkojë ndryshime të shpejta të tyre.

3. Të shprehet miratimi i një Plani Afatgjatë të Zhvillimit të Reformave në FASH dhe strukturës së re të FASH 2014, e cila të marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në Sistemin e Planifikimit të Mbrojtjes së Aleancës (NDPS), si dhe të vlerësojë si përparësi të parë kapacitetet e kërkuara nga samiti për zhvillimin e forcave të deklaruara për kontribute në misionet e Aleancës.

4. Të shprehet vazhdimi i reformave të mbrojtjes së FASH mbi një bazë të re ligjore si vend aleat brenda vitit 2014 si dhe përputhja e legjislacionit kombëtar me detyrimet aleate aty ku ka nevojë për përmirësime. Kjo të bëhet duke mbajtur në konsideratë ndryshimet e mundshme ligjore që mund të gjenerohen si pasojë e reformave nga Samiti i Uellsit.

5. Të konfirmohet vullneti dhe pjesëmarrja në Planin e Veprimit të Gatishmërisë së Aleancës, duke treguar vullnetin dhe vlerësuar gjendjen për të ofruar infrastruktura kombëtare tokësore, ajrore, apo detare, në interes të këtij plani të Aleancës.

6. Të shprehet pjesëmarrja dhe kontributi i Shqipërisë në operacionin e ri "*Resolute Support*" në Afganistan me ekipe trajnimi dhe ndihme. Ashtu siç ka kontribuar deri tani në mënyrë shembullore në ISAF, gjykoj që ky vullnet politik duhet të shprehet nga kryetari i shtetit/i qeverisë në samit. Realizimi konkret duhet të bëhet në përputhje me evoluimin e planeve të Aleancës për këtë qëllim.

7. Të konfirmohet rritja e buxhetit të mbrojtjes së vendit në rritje progresive nga 1% GDP në 1,5 deri 2% GDP deri në fund të vitit 2020, në përputhje me performancën e ekonomisë kombëtare. Gjykoj që ky angazhim duhet të shprehet edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake të RSH për t'u përmbushur në mënyrë graduale.

8. Të shprehet përparësia për njësitë e deklaruara në NATO, në kuadrin e Paketës së Objektivave të Kapaciteteve, si njësi të përparësisë së parë për mbështetje me burime njerëzore, materiale dhe financiare. Po ashtu, t'iu jepet përparësi zhvillimit të disa Objektivave të Partneriteteve të karakterit civil, për kontribute ndërkombëtare, sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve me NATO-n.

9. Të mbështesim pjesëmarrjen në nismën "*Connected Forces*" sipas planit të stërvitjeve të Nenit 5 apo jashtë Nenit 5 te Aleancës, për rritjen e ndërveprimit të njësive të deklaruara. Në këtë kontekst, krahas deklarimit të Grup Batalionit apo në NRF, t'i jepet përparësi forcave speciale/komando për trajnimin, mbështetjen dhe pajisjen e tyre për përmbushjen e misioneve të specializuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

10. Të vazhdojë procesi i ndërveprimit dhe standardizimit sipas STANAG-eve të Aleancës, sipas planit afatmesëm për këtë qëllim dhe të testohet zbatimi i tyre në stërvitje të ndryshme. Krahas njësive të deklaruara, të cilat duhet të zhvillohen dhe certifikohen si njësi model të FASH, duhet të zhvillohen edhe njësitë e tjera, bazuar në plane më afatgjatë.

Bibliografia:

- Për një NATO të ardhme: Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s *Rasmussen* në forumin "*Chatham House*", Londër, Mbretëria e Bashkuar, 30 maj 2014.

- Forcimi i Lidhjeve Transatlantike: *Anders Fogh Rasmussen*, 10 qershor 2014.
- Drejt samitit të Uellsit: Fjala e Zv.sekretarit *Alexander Vershbow* në Kolegjin e NATO-s në Romë, 13 June 2014.
- Drejt samitit të Uellsit: *Karl Heinz Kamp*, Research Paper, October 2013.
- Koncepti i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse, miratuar nga Presidenti i Federatës Ruse V. Putin në 12 shkurt 2013.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Federatës Ruse 2009, miratuar me Dekret No. 537 të Presidentit të Federatës Ruse, 12 Maj 2009.
- *Fjalim i Dmitry Medvedev në ceremoninë e studimeve të larta të oficerëve madhorë, Kremlin, 30 Shtator, 2008, faqe e vizituar në http://archive.kremlin.ru/eng/speeches/ 2009/02/27/2253_ type84779_213417.shtml*.

RUBRIKA E DYTË

Nevoja për një Strategji të Re të Arsimimit Profesional Ushtarak (SAPU)

Revista Ushtarake, herë pas here, ka bërë pjesë të trajtimit të saj tema që lidhen me çështjet e profesionalizmit ushtarak, zhvillimit dhe konsolidimit të një sistemi të integruar të arsimimit e stërvitjes, të operacioneve, të mësimeve të nxjerra e standardizimit në sistemin e FA. Realiteti i ri në Forcat e Armatosura, pas anëtarësimit në NATO dhe veçanërisht pas integrimit të plotë të FARSH në Aleancë, kërkon ndryshime dhe zhvillime të reja edhe në fushën e arsimimit, trajnimit dhe stërvitjes së personelit të FA. Në shkrimet e kësaj rubrike, specialistë të ndryshëm analizojnë probleme dhe fakte të shumta që lidhen me domosdoshmërinë e reformimit të sistemit të arsimimit dhe trajnimit në FA.

Autorët kolonel Ruzhdi Kuçi dhe kolonel Ahmet Leka, me shkrimin: "Një konceptim i ri i arsimimit dhe trajnimit në FA", pasi vlerësojnë dhe nxjerrin në pah disa mangësi në të gjithë piramidën e arsimimit dhe trajnimit në FA, trajtojnë dhe parashtrojnë një projekt koncept të zhvillimit të sistemit të arsimimit dhe trajnimit për të ardhmen. Në shkrim iu jepet përgjigje disa pyetjeve të shtruara për zgjidhje në momentet që po kalojnë FA, të tilla si: Si do të vazhdojë përgatitja individuale e personelit në FA, si do të bëhet rekrutimi i kandidatëve për oficerë? Cilat janë kriteret e rekrutimit për kandidatët për nënoficerë dhe oficerë? Si do të zhvillohen kurset e karrierës? Si mund të zhvillohet struktura e Shkollës së Trupës? Çfarë raporti dhe ndikimi do të kenë doktrina, sistemi i standardizimit dhe sistemi i mësimeve të nxjerra në programet dhe kurrikulat e arsimimit dhe trajnimit? Shkrimi, në mënyrë modeste, jep përgjigje për pyetjet e shtruara më lart dhe bën disa rekomandime konkrete, të cilat mund të jenë objekt i takimeve, diskutimeve, mendimeve të ndryshme, me qëllim lindjen e ideve të reja dhe përcaktimin e mënyrave që argumentojnë thellë domosdoshmërinë e hartimit të një strategjie konkrete për arsimimin dhe trajnimin.

Shkrimi me autor MSc. Valbona Zeka, "Edukimi mjedisor i personelit të FARSH nëpërmjet legjislacionit", trajton çështje që lidhen me njohjen dhe respektimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për mjedisin, si dhe respektimin e pakteve, marrëveshjeve e konventave të ndryshme në këtë fushë. Autori trajton rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përsosjes së legjislacionit në fushën mjedisore, si një kusht shumë i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE.

Në vijim, rubrika e dytë vazhdon me shkrimin: "Koncepte dhe ide për arsimimin, trajnimin dhe përgatitjen e nëpunësit të inteligjencës shtetërore", të autorit MSc. N.kol. Sokrat Paskali. Autori vë theksin në trajtimin e nëpunësit të inteligjencës, duke pasur parasysh veçoritë e këtij shërbimi dhe ndarjen e fushave të përgjegjësisë në trajnimin e këtij kontingjenti, duke nxjerrë në pah se politikat qeveritare në këtë fushë janë të lidhura kryesisht me standardet, politikat institucionale janë të lidhura me profesionin dhe profesionalizmin, ndërsa politikat si shkollë ose politikat e institucioneve dhe strukturave akademike, arsimore, edukuese dhe kërkimore në organizatat e inteligjencës ose jo, janë të lidhura kryesisht me ekspertizën për ta gjetur atë tek ata që e kanë (zotërojnë) dhe për t'ua përcjellë atyre që nuk e kanë (nuk e zotërojnë).

Një konceptim i ri i arsimimit dhe trajnimit ushtarak në FA

Kolonel Ruzhdi Kuçi
Zv.komandant i KDS

Kolonel Dr. Ahmet Leka
Shef i QD

Trajtesë e shkurtuar. *Transformimet e thella, të bëra në FA të RSH-së dhe domosdoshmëria për të krijuar një forcë efektive e të aftë profesionalisht për t'iu përgjigjur kërkesave të integrimit euroatlantik dhe zhvillimit të forcës, diktojnë përherë nevojën e një transformimi dhe zhvillimi të filozofisë së arsimimit e trajnimit, të koncepteve doktrinarë dhe të mendimit ushtarak në tërësi. Sot, është e qartë për të gjithë shoqërinë se integrimi i plotë i vendit tonë në strukturat euroatlantike është një objektiv përparësor strategjik i Republikës së Shqipërisë. Realiteti i ri, pas anëtarësimit në NATO, kërkon dhe parashtron, në të njëjtën kohë, nevojën e ndryshimeve të thella në fushën e arsimimit dhe trajnimit të FA.*

Programi i Qeverisë, si dhe Direktiva e Mbrojtjes për vitin 2014 shtrojnë një sërë detyrimesh nga pikëpamja arsimore, doktrinarë, konceptuale dhe strukturore, me qëllim rritjen e profesionalizmit për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale.

Shkrimi i mëposhtëm, pasi nxjerr në pah disa mangësi në të gjithë piramidën e arsimimit dhe trajnimit në FA, trajton dhe parashtron një projekt-koncept të zhvillimit të sistemit të arsimimit dhe trajnimit për të ardhmen. Aty iu jepet përgjigje disa pyetjeve të shtruara për zgjidhje në momentet që po kalojnë FA, të tilla si: Si do të vazhdojë përgatitja individuale e personelit në FA, si do të bëhet rekrutimi i kandidatëve për oficerë? Cilat janë kriteret e rekrutimit për kandidatët për nënoficerë dhe oficerë? Si do të zhvillohen kurset e karrierës? Si mund të zhvillohet struktura e Shkollës së Trupës? Çfarë raporti dhe ndikimi do të kenë doktrina, sistemi i standardizimit dhe sistemi i mësimeve të nxjerra me programet dhe kurrikulat e arsimimit dhe trajnimit?

Shkrimi, në mënyrë modeste jep përgjigje për pyetjet e shtruara më lart dhe bën disa rekomandime konkrete, të cilat mund të jenë objekt i takimeve, diskutimeve, mendimeve të ndryshme, me qëllim lindjen e ideve të reja dhe të përcaktimin e mënyrave që argumentojnë thellë domosdoshmërinë e hartimit të një strategjie konkrete për arsimimin dhe trajnimin.

Si paraqitet gjendja e arsimimit dhe trajnimit në FA

Realiteti i ri në Forcat e Armatosura, pas anëtarësimit në NATO dhe veçanërisht pas integrimit të plotë të FARSH në Aleancë, kërkon ndryshime dhe zhvillime të reja edhe në fushën e arsimimit, trajnimit dhe stërvitjes së personelit të FA. Ndryshimet e shpejta në fushën e ristrukturimit, hartimi i dokumenteve strategjike, paketës ligjore dhe modernizimi i mëtejshëm i forcës, kërkojnë një qasje të re në rishikimin, zhvillimin dhe

konsolidimin e sistemit arsimor ushtarak, për ta bërë atë sa më cilësor, fleksibël, në funksion të zhvillimit të FARSH dhe të shoqërisë.

Në Forcat e Armatosura është krijuar një sistem arsimor ushtarak i integruar dhe i mbështetur si në përvojën tonë, ashtu edhe në atë të aleatëve tanë euroatlantikë, duke e gërshetuar atë me sistemin arsimor civil, në konsolidim e sipër. Sistemi i arsimimit dhe stërvitjes në FA është bashkimi i përpjekjeve mes institucioneve arsimore e stërvitore, njësive dhe individëve, për të arritur nivelin e kërkuar të aftësive operacionale të trupës dhe drejtuesve të saj. Ai është një proces shumëshkallësh, në unitet dhe në marrëdhënie të brendshme e të ndërsjellë, i bazuar në zhvillimin e taktikave dhe teknologjive bashkëkohore. Sistemi i arsimimit dhe stërvitjes synon të formojë ushtarakë të motivuar, të disiplinuar, të aftë të veprojnë si individë, në përbërje të grupit, të njësisë dhe njëherësh të përgatitur mendërisht e fizikisht për të plotësuar kërkesat dhe cilësitë që karakterizojnë pjesëtarin e Forcave të Armatosura të RSH-së.

Forcat e Armatosura të RSH-së janë vijimisht në proces transformimesh të thella, me objektivin kryesor krijimin e një force efektive e të aftë profesionalisht për t'iu përgjigjur misionit kushtetues të tyre dhe kërkesave të integrimit euroatlantik. E gjithë puna e mirë e strukturave të FA, në tërësi, dhe e institucioneve arsimore, në veçanti, është bazuar në nevojën e përhershme të transformimit dhe zhvillimit të filozofisë së arsimimit e stërvitjes, koncepteve doktrinare dhe të mendimit ushtarak në tërësi. **"**Sistemi i arsimimit dhe stërvitjes shërben për të mbështetur FA me personel të mirëtrajnuar, për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale. Ai kryen trajnim të përditësuar të FASH, si dhe zhvillon bazën konceptuale dhe doktrinore të nevojshme"[1]. Në këtë kuadër, ai **ka përbërë dhe përbën, padyshim, sfidën më të madhe të së ardhmes drejt integrimit të plotë euroatlantik.** Transformimi drejt këtij objektivi madhor, para së gjithash, lidhet me një reformë konceptuale tek të gjithë ushtarakët, si një domosdoshmëri e kuptimit, pasqyrimit, ndryshimit dhe zhvillimit drejt "Vizionit 2020 të Forcës".

Objektivi kryesor i sistemit të arsimim-trajnimit është aftësimi profesional i personelit të FA dhe rritja e kapaciteteve operacionale, sipas standardeve të NATO-s. Në këtë pikëpamje, për t'iu përgjigjur këtij objektivi të rëndësishëm, rëndësi e veçantë i është kushtuar vënies së sistemit të arsimimit dhe stërvitjes mbi baza ligjore moderne dhe zhvillimit të tij me plan perspektiv. Pavarësisht nga arritjet e deritanishme, gjendja e sistemit të arsimit ushtarak dhe realiteti i ri pas anëtarësimit në NATO dhe integrimit të plotë të FARSH, paraqet nevojën për zhvillime të reja në aspektet e transformimit, reformimit dhe zhvillimit të sistemit të Arsimit Profesional Ushtarak (APU) për FARSH. Tendencat e zhvillimit në rrafshin kombëtar, rajonal dhe global, si dhe një sërë problemesh të tjera, kërkojnë ndryshime, ridimensionime, zgjidhje dhe risi në sistemin e arsimit dhe trajnimit në FARSH.

Më poshtë po paraqesim disa problematika të hasura në procesin e arsimimit dhe përgatitjes së ushtarit, nënoficerit dhe oficerit ku përshkruhet gjendja konkrete e sistemit arsimor për të ardhur më pas tek nevoja për politika të reja në zhvillimin e sistemit të arsimimit ushtarak:

Shkolla e Trupës, aktualisht, është përgjegjëse për zhvillimin, krijimin e programeve dhe kryerjen e stërvitjes së nivelit bazë (SB) dhe stërvitjes individuale të avancuar

[1] Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes 2013, f..23, miratuar me VKM nr. 269, datë 3.4.2013.

(SIA) për të gjithë personelin e FA. Ajo gjithashtu kryen certifikimin e aftësive të trajnimit, sipas standardeve të fituara në programet formale (kurse) dhe ato informate (në punë) të gjithë kësaj kategorie personeli të FA. Përsa i përket përgatitjes individuale të ushtarit (Stërvitja Individuale), mendojmë se ka probleme në lidhje me shpërndarjen e përgjegjësive dhe se koordinimi i zhvillimit të saj në njësi e reparte ka rezultuar me mangësi. Lidhur me specialitetet për të cilat kanë nevojë FA, të tilla si: teknik kompjuteri dhe rrjetesh, specialistë të teknologjisë së informacionit, administrator rrjetesh kompjuterike, elektricist, tornitor, motorist, kuzhinier, etj., nuk ka kapacitete të nevojshme njerëzore e materiale për të mbuluar trajnimin e kësaj kategorie.

Kemi konstatuar se vijueshmëria e stërvitjes në fazat e tjera të përgatitjes profesionale, pas asaj individuale, veçanërisht stërvitja kolektive ka rezultuar me mangësi, konkretisht, në zhvillimin e vazhdueshëm të Listës së Detyrave Themelore të Misionit (LDTHM) dhe rishikimin e kësaj të fundit, në përputhje të plotë me Dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM).

Padyshim, në piramidën e sistemit të arsimimit dhe trajnimit, nënoficeri zë një vend të rëndësishëm. Akademia e Nënoficerëve (**ANO) përgatit drejtues të njësive të vogla, drejtues ekuipazhesh dhe asistentë stafi. Fokusi i kësaj akademie ka qenë zhvillimi i standardeve më të larta të mundshme të ekspertizës së drejtimit, profesionalizmit dhe praktikës së drejtimit të trupave në të gjithë FARSH.** Pavarësisht konsolidimit të programeve dhe kurrikulave të përgatitjes së nënoficerit, konstatohet me lehtësi se ende nuk ka një politikë të qartë për rekrutimin e kësaj kategorie. Aktualisht, rekrutimi i nënoficerëve bëhet vetëm nga një burim, nga ushtarët PR II, duke mos marrë në konsideratë burime të tjera jashtë FARSH. Vihet re një mungesë planifikimi përsa i përket drejtpeshimit ndërmjet nevojave faktike të FA dhe operimit konkret, çka ka sjellë devijime nga kërkesat e ligjit nr. 9171 për "Gradat dhe karrierën ushtarake në FARSH", lidhur me titullimin e nënoficerëve dhe dhënien e gradës së parë si nëntetar.

Arsimimi dhe përgatitja e oficerit ka pasur luhatjet e veta, në përputhje me reformat dhe transformimin e arsimit kombëtar, mjedisit të ri pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ristrukturimit të vazhdueshëm të FA, etj. **Mungesa e një strategjie të qartë për nevojat, mënyrën e rekrutimit dhe të përgatitjes së oficerëve të rinj ka bërë të mundur që politikat e pranimit e të përgatitjes së tyre të ndryshojnë disa herë**. Jemi dëshmitarë se në rekrutimin e kandidatëve për oficerë, janë zbatuar disa mënyra, përvoja dhe shkolla të ndryshme. Me gjithë punën e vazhdueshme te mirë të bërë nga drejtuesit e AFA dhe stafet akademike në drejtim te zhvillimit dhe konsolidimit të programeve dhe kurrikulave, përsëri ato kanë shfaqur problematika përsa i përket mënyrës dhe kritereve të pranimit studentëve, nevojave për plotësim organik në strukturat e FA dhe zbatimit të "listë-meritës" nga ana e komisioneve të karrierës. **Arsimimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në FA, shpeshherë, nuk ka qenë plotësisht në funksion të kryerjes së detyrës së pritshme, për t'iu përgjigjur kushteve dhe pozicioneve që do t'u ofrohen brenda dhe jashtë vendit në kuadër të detyrimeve kombëtare ndaj NATO-s, si dhe nuk ka mundësuar sigurimin e aftësive bazë për të zhvilluar punë kërkimore e shkencore në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes.**

Arsimimi dhe përgatitja e civilëve, nëpërmjet kurseve funksionale, mbështetur në nevojat e FA, nuk ia ka arritur qëllimit për sigurimin e një administrate civile të përgatitur e me nivel të lartë profesional në të gjithë sistemin e mbrojtjes, çka do të thotë se arsimimi i

civilëve mbetet akoma një hallkë e dobët. Në këtë këndvështrim, lipsen strategji dhe politika arsimore të qarta për përgatitjen e Administratës Civile të Mbrojtjes, detyrimet institucionale e individuale, për nivelet e përgatitjes së personelit civil dhe programet gjithëpërfshirëse për këtë kategori të personelit.

Një aspekt tjetër i misionit të KDS dhe institucioneve të saj, në mbështetje të FA, është puna studimore dhe kërkimi shkencor. Është lehtësisht e konstatueshme se në këtë fushë mungojnë legjislacioni dhe politikat mbështetëse për funksionimin e qendrave studimore, kërkimore-shkencore, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të të drejtave të autorit në FA. Mendojmë se aktualisht ka kapacitete të kufizuara për punë studimore e shkencore si në strukturë, ashtu dhe në mbështetjen financiare, të shoqëruara këto edhe me mungesën e politikave, programeve dhe planeve konkrete për FA. Kjo duhet të na rrisë më shumë ndërgjegjësimin profesional dhe intelektual, në lidhje me nevojën e studimeve, sidomos në fushën e kërkimit dhe zbatimit në FA. Gjithashtu lipset një punë më e madhe e një qasje tjetër shumëdisiplinëshe për përmirësimin e bashkëpunimit, në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, në punën kërkimore shkencore.

Sistemi arsimor duhet t'i nënshtrohet një transformimi të thellë, ku përparësi të mbetet përgatitja e ushtarit profesionist, nënoficerit, oficerit të trupës, si dhe shtabeve për të gjitha nivelet. Sistemi i arsimit ushtarak duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë, që t'u shërbejë Forcave të Armatosura, t'u përgjigjet nevojave kombëtare, t'u përgjigjet realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe të jetë i përputhshëm me sistemin e arsimimit kombëtar dhe shkollave të vendeve të NATO-s.

Në përputhje me misionin, përgjegjësitë dhe detyrat e FA, të sanksionuara në Kushtetutë, Strategjinë e Sigurimit Kombëtar (projekt), Dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM), si dhe Direktivën e Mbrojtjes 2014, synimi kryesor i sistemit të arsimimit dhe trajnimit, për të ardhmen, duhet të jetë zhvillimi i një force të vogël profesionale, zhvillimi i koncepteve "të bashkuar" dhe "të përbashkët", si dhe krijimi i kapaciteteve ushtarake operacionale, të duhura dhe të nevojshme, në kuadër të ndërveprueshmërisë me vendet e NATO-s. Direktiva e Mbrojtjes përcakton qartë nevojën e përgatitjes individuale, nga ushtari deri tek gjenerali. Trajnimi individual duhet të planëzohet në të gjithë strukturën e Forcave të Armatosura, duke përfshirë nivelin taktik deri në nivelet më të larta politike e strategjike. Në thelb të këtij trajnimi duhet të jenë kërkesat për kryerjen e detyrës specifike individuale të përcaktuar. ***Në kuadrin e zhvillimit afatgjatë, synimi do të jetë "Rishikimi i tërë sistemit të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura, me qëllim përgatitjen e ushtarit profesionist, nënoficerit, oficerit të trupës dhe shtabit të Forcave të Armatosura, në përputhje me nevojat e strukturës së re të kësaj force".***[2]

Në këtë kuadër, planet dhe programet do të orientohen drejt zhvillimit të kapaciteteve për një forcë të aftë që t'i përgjigjet, në mënyrë dinjitoze, detyrimeve si vend anëtar i NATO-s. Përmbushja e detyrimeve të përgatitjes së dokumenteve kryesore për integrimin në NATO është sot detyra kryesore për të gjitha strukturat e FA. "Trajnimi kolektiv dhe stërvitjet mbeten elemente të rëndësishme për kompaktësimin e trupës, reparteve dhe njësive ushtarake, për realizimin e misionit kushtetues të Forcave tona të Armatosura. Stërvitjet duhet të marrin parasysh nivelin kombëtar, rajonal dhe atë të NATO-s, duke e shtrirë spektrin e vet që nga përballimi i emergjencave civile e deri te bashkëpunimi me

[2] "Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale"-Programi i Qeverisë së RSH 2013-2017.

NATO-n, në kuadër të mbrojtjes kolektive"[3]. Spektri i konflikteve, në të cilat mund të angazhohen FA apo pjesë të tyre në të ardhmen, përfshin gjithë fushën e operacioneve ushtarake, veçanërisht ato në shkallë të vogël, përfshijnë partnerë ndërkombëtarë apo edhe anëtarë të NATO-s. Të gjitha këto operacione do të zhvillohen brenda ose jashtë vendit, më vete ose në bashkëpunim me forca të shteteve të tjera. Me qëllim kryerjen sa më mirë të këtyre operacioneve, FA duhet të stërviten për t'u përballur me një gamë të gjerë kërcënimesh që mund të shfaqen kudo në botë, kërcënime të cilat do t'i vendosin FA para angazhimeve të niveleve të ndryshme. Në këtë pikëpamje, strukturat e FA duhet të stërviten për të qenë sa më të forta dhe të manovrueshme, të jenë të organizuara dhe të pajisura më së miri.

"***Qëllimi i stërvitjes është arritja e standardeve, nëpërmjet të cilave ruhen dhe zhvillohen aftësitë luftarake… Për të arritur këtë, njësitë duhet të stërviten në kushte sa më afër realitetit të luftës".***[4]

Pjesë e pandarë e arsimimit dhe trajnimit duhet te konsiderohet edhe procesi i vlerësimit. "Vlerësimi i individëve, grupeve, njësive dhe reparteve ushtarake duhet të jetë pjesë e pandarë e veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe ky vlerësim të bëhet me grup vlerësuesish për kapacitetet operacionale, në përputhje me kërkesat e NATO-s". Procesi i vlerësimit është njëherësh fillimi dhe fundi i ciklit të menaxhimit të arsimimit dhe trajnimit. Nëpërmjet vlerësimit ne krijojmë vizionin për të ardhmen, përcaktojmë lidhjen ndërmjet performancës dhe standardit doktrinar të miratuar të Forcave të Armatosura, duke plotësuar kështu një sistem të integruar dhe efikas.

Mbështetur në fokusin e ndryshimeve dhe të zhvillimeve të pandalshme në të gjitha aspektet konceptuale, doktrinare, operacionale e strukturore, rëndësi jashtëzakonisht të madhe mendojmë se ka ristrukturimi i sistemit arsimor dhe stërvitor dhe i institucioneve që e mbartin atë. Programi i Qeverisë shtron si nevojë të domosdoshme " ...***kryerjen e një reforme të thellë në Forcat e Armatosura, nga pikëpamja doktrinare, konceptuale dhe strukturore, me qëllim që të rrisë profesionalizmin, të sigurojë depolitizimin e strukturave dhe të forcojë luftën kundër korrupsionit"[5].***

Në këtë kuadër, kërkohet që procesi i arsimimit, trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit të konsolidohen më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO-s dhe objektivi kryesor i këtij sistemi të jetë mbështetja e Forcave të Armatosura me personel profesional për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale.

Grupi i Punës, i ngritur pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në kuadrin e ristrukturimit të saj dhe institucioneve të vartësisë, ka përgatitur dhe dërguar për mendime, konceptin "Për rishikimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimimit dhe trajnimit në FA". Ky koncept parasheh, që në fillim, nevojën e riformulimit të misionit. Duke qenë se Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes nuk është njësi e dislokueshme, konceptimi i strukturave te saj është parë në funksion te arsimimit e trajnimit, zhvillimit doktrinës dhe punës kerkimore e shkencore.

Për plotësimin me sukses të misioneve të tyre, Forcat e Armatosura kërkojnë, në radhë të parë, personel të arsimuar e të mirëstërvitur, me qëllim rritjen e

[3] Direktiva e Mbrojtjes 2014, f.4.
[4] Doktrina e Arsimimit dhe Stërvitjes f.15, viti 2009.
[5]Programi i Qeverisë së RSH (2013-2017) - "Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale".

aftësive profesionale të personelit të FA, sipas koncepteve bashkëkohore, për të realizuar misionin kushtetues dhe për t'iu përgjigjur kërkesave e standardeve si vend anëtar i NATO-s. "Forca e Ardhshme do të jetë një forcë më e motivuar, e pajisur dhe e trajnuar për të vepruar në të gjithë spektrin e detyrave të misionit, nga skenarët luftarakë të nenit 5 deri tek ato në mbështetje të paqes, brenda dhe jashtë vendit, më vete ose me aleatët, kryesisht një forcë e këmbësorisë me elemente të këmbësorisë së motorizuar."[6]

Një drejtim shumë i rëndësishëm, në planin afatgjatë të zhvillimit, do të jetë hartimi i politikave dhe dokumenteve themelore në të cilat do të paraqitet tërësia e parimeve dhe drejtimeve kryesore, mbi bazën e të cilave planëzohet, organizohet, standardizohet, zhvillohet dhe menaxhohet arsimimi e stërvitja, për të gjitha nivelet e komandimit, në institucionet arsimore e stërvitore dhe njësitë e repartet e FA. Në këtë kuadër, **synimet kryesore në fushën e arsimimit dhe stërvitjes do të jenë mbështetja** në përvojën kombëtare, në standardet më të larta të NATO-s, duke e bërë atë të krahasueshëm dhe të konkurueshëm me sistemin e përgatitjes ushtarake dhe rrjetin e shkollave të NATO-s.

Stafet akademike dhe strukturat e arsimimit e stërvitjes në KDS, në kuadër të projekt-konceptit të paraqitur për arsimimin dhe trajnimin e personelit të FA, kanë hartuar programimin e punës dhe janë në proces për rishikimin e strukturave, kurseve, kurrikulave, ripunimin e programeve, leksioneve dhe metodikave arsimore, duke iu përgjigjur, në të njëjtën kohë, edhe kalimit të FA në strukturën e re.

Cilat janë disa nga sfidat kryesore që parashtron koncepti i ri për arsimimin dhe trajnimin në FA?

Sistemi i stërvitjes në FA do të vazhdojë të mbështetet në dy kolona kryesore: në stërvitjen individuale (institucionale) dhe në stërvitjen kolektive (operacionale) apo stërvitjen në njësi. Stërvitja individuale, e cila përfshin Stërvitjen Bazë (SB) dhe Stërvitjen Individuale (SI) do të synojë të përgatitë, të formojë dhe arsimojë individë të aftë për të vepruar në operacione me spektër të plotë. Këtij procesi do t'i nënshtrohen të gjitha kategoritë e personelit si: oficerët, nënoficerët dhe ushtarët për të plotësuar rolin individual në operacion, si pjesë e një grupi apo skuadre. "*Trajnimi individual* duhet të planëzohet në të gjithë strukturën e Forcave të Armatosura, duke përfshirë nivelin taktik deri në nivelet më të larta politike e strategjike. Në thelb të këtij trajnimi do të jenë kërkesat për kryerjen e detyrës specifike individuale të përcaktuar"[7].

Bazuar në Konceptin e Ri të Arsimimit dhe Trajnimit, SB për të gjitha kategoritë e personelit ushtarak do të zhvillohet në Qendrën e Stërvitjes Individuale, pranë Shkollës së Trupës në Bunavi, ndërsa Stërvitja Individuale e Avancuar do të realizohet pranë njësive dhe reparteve, sipas specialiteteve. Por largësia e konsiderueshme e vendvendosjes së departamenteve nga seksionet përkatëse të vartësisë, si dhe shpërndarja e seksioneve në disa njësi e reparte, ka zbehur ndjeshëm kohezionin e strukturave departament-seksion. Departamentet ndjejnë vështirësinë e kontaktit të përditshëm me strukturat vartëse (seksionet) dhe nuk luajnë si duhet rolin e tyre në pikëpamje të menaxhimit të procesit të trajnimit, bashkëpunimit, koordinimit, ndihmës dhe kontrollit të seksioneve. Në këto kushte, pengohet puna e përbashkët, zhvillimi i diskutimeve dhe debateve për programet dhe materialet mësimore, diskutimi i STANAG-eve dhe mësimeve të nxjerra, pasqyrimi i tyre me efektshmëri në

[6] Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes 2013, f.25, miratuar me VKM nr. 269, datë 3.4.2013. Po aty.
[7] Direktiva e Mbrojtjes 2014, f.4.

programe; pra, në tërësi kryhet një punë e mbyllur dhe, për pasojë, produktiviteti i punës vihet në diskutim.

Në këtë kontekst, në projekt-idenë e re, ky model do të përshtatet në mënyrë të tillë që në strukturat e njësive dhe reparteve, sipas specialiteteve, të vendosen edhe seksionet përkatëse të SHT, por tashmë në formë organike. Pra realisht, menaxhimi i këtyre "minishkollave" do t'u mbetet komandave të forcave, duke i kthyer këto njësi operacionale/mbështetëse edhe në institucione arsimore e stërvitore, duke bërë të mundur zvogëlimin, në mënyrë të moderuar, të personelit organik të SHT, si dhe duke i afruar ato më afër përvojës operacionale të reparteve. Ndërsa, duke krijuar një strukturë, pranë SHT ose KDS, për zhvillimin e programeve dhe kurrikulave do të bëhet e mundur drejtimi i menaxhimit të procesit nga Shkolla e Trupës, në aspektin e programeve dhe certifikimit.

Lidhur me specialitetet e ngushta, mendojmë se personeli që rekrutohet në FA për të kryer funksione në këto specialitete të ngushta, të përzgjidhet nga kontingjentet që kanë diplomë, certifikatë, dëshmi aftësie automjeti, etj., që përputhet me kërkesat e funksioneve përkatëse organike. Nëse lind nevoja e rifreskimit të njohurive ose për kualifikim shtesë, kualifikimi i tyre të bëhet në institucione publike të formimit profesional e teknik (*outsourcing*), pasi kostoja e trajnimit të tyre në këto institucione është shumë herë më e vogël. Ndërsa për arsimimin e pilotëve, kontrollorëve të trafikut ajror, etj., *që nuk mund të mbulohent nga SHT/KDS* për shkak të mungesës së kapaciteteve (burimeve njerëzore dhe financiare, por edhe të raportit jo efektiv të arsimimit të tyre me koston e zhvillimit të kurseve), mendojmë se nga Komanda e Forcës Ajrore të hartohen plane bashkëpunimi dhe procedura përkatëse për trajnimin e personelit të tyre me vendet e NATO-s dhe ato partnere, duke bërë propozime përkatëse në MM/SHP për lidhjen e marrëveshjeve me këto vende.

Arsimimi i ushtarakut, në tërësinë e vet, përbëhet nga dy komponentë bazë dhe plotësues akademikë dhe ushtarakë, të cilët të dy së bashku zgjerojnë dhe përpunojnë njohuritë bazë të individit, duke i ngritur atij nivelin e njohurive. Në Forcat e Armatosura Shqiptare, Arsimimi Profesional Ushtarak (APU), i cili përgatit oficerët, fillon pas arsimit universitar, ndërsa për nënoficerët, pas arsimit të mesëm. Ky trajnim është i vazhdueshëm. Gjatë gjithë karrierës, ai përfshin programe të strukturuara e të integruara në kurset institucionale pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Trupës, Akademinë e Nënoficerëve dhe në akademitë apo shkollat jashtë vendit. ***AFA do të bëjë arsimimin (përgatitjen intelektuale) hierarkik, të cilësisë së lartë dhe sipas standardeve të NATO-s, si dhe stërvitje operacionale (zbatimin e aftësive praktike) për oficerët dhe civilët e përzgjedhur të FA.*** *"Arsimimi është procesi i dhënies së njohurive dhe aftësive intelektuale, me të cilat informacioni mund të përkthehet në një mënyrë të arsyeshme duke përdorur gjykimin e shëndoshë….. gjithashtu ai është procesi i dhënies së një grupi njohurish për t'i përgatitur nga ana intelektuale individët që këta të përballen me mjediset dinamike të sigurisë dhe të zgjidhin probleme të dyshimta, duke përdorur mendimin kritik dhe gjykimin e arsyetuar".*[8]

Sistemi i Arsimit të Forcave të Armatosura do të mbështetet në programe të bashkuara dhe të integruara të kurseve të niveleve të ndryshme, që zhvillohen në institucionet stërvitore dhe arsimore të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, duke filluar nga edukimi universitar, niveli i parë "*bachelor*", deri në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

[8] Doktrina e Arsimimit dhe Stërvitjes, f. 29, viti 2009. Po aty.

Koncepti i Ri i Arsimimit & Trajnimit parashikon se rekrutimi i kandidatëve për oficerë të rinj do të bëhet nga radhët e kandidatëve që zotërojnë një diplomë minimalisht të ciklit të parë (*bachelor*) në fushat përkatëse, sipas nevojave të FA. Ndryshe nga më parë tashmë porta hyrëse parashikon edhe rekrutimin e kandidatëve nga brenda vete FA (nënoficerë dhe UP), duke plotësuar paraprakisht kriteret ligjore.

Kandidati për oficer fillimisht do të kryejë Stërvitjen Bazë në SHT. Pas kësaj, do të realizojë arsimimin dhe formimin e përgjithshëm profesional të kandidatëve për oficerë në AFA, e cila do t'i pajisë ata me njohuri e kulturë të përgjithshme ushtarake, me aftësi komanduese e drejtuese për nivelin e nënrepartit dhe, pas një periudhe afërsisht 44 javë, do të bëhet diplomimi dhe, në të njëjtën kohë, edhe titullimi oficer. **Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e oficerëve të rinj në vend dhe jashtë tij.**

Arsimimi Profesional Ushtarak i personelit të FA vazhdon, më tej, në përputhje me politikat arsimore dhe piramidën e kurseve të karrierës së plotë të arsimimit të oficerëve në nivel operativ dhe strategjik duke e vënë theksin në përshtatjen dhe përgatitjen e kurrikulave arsimore për realizimin e operacioneve në kuadër të NATO-s (Artikulli 5 dhe Operacionet në Mbështetje të Paqes). **Akademia e Forcave të Armatosura do të përqendrohet në përmirësimin e kapaciteteve drejtuese, planifikuese, koordinatave dhe menaxhuese, si dhe do të certifikojë kualifikimet arsimore e operacionale të ushtarakëve dhe civilëve të përzgjedhur në studimet e mbrojtjes dhe sigurisë. Akademia, mendojmë se, duhet të japë gradat akademike në *partnership* me institucionet e tjera të arsimit të lartë, sipas marrëveshjeve të posaçme të MM me këto institucione.**

AFA, nëpërmjet kurseve të karrierës, do të zhvillojë njohuritë, aftësitë dhe shprehitë e domosdoshme për punën në grup dhe në shtab, në nivel batalioni, për të gjithë komponentët e FA, aftësitë dhe shprehitë e domosdoshme për komandim dhe drejtim në nivel operacional, aftësitë dhe shprehitë e domosdoshme për komandim e drejtim në nivel operacional e strategjik për të gjithë komponentët tokësorë, detarë dhe ajrorë, si dhe punën kërkimore e shkencore në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Në lëmin e arsimimit ushtarak do t'i kushtohet rëndësi rritjes së mëtejshme të cilësisë së trupës mësimdhënëse, përmirësimit të infrastrukturës mësimore për të siguruar konsolidimin e mëtejshëm të kurseve institucionale dhe funksionale, si dhe programimin dhe realizimin e arsimimit të personelit të FA, nëpërmjet përdorimit edhe të ekipeve trajnuese të lëvizshme (ETL). Në të ardhmen, si një kusht dhe nevojë e patjetërsueshme do të jetë konsolidimi i arsimimit të nënoficerëve, në të gjitha fazat e arsimimit institucional, si dhe përgatitja e tyre për të marrë në dorë përgatitjen e të gjithë kontingjenteve të ushtarëve e nënoficerëve, me një shkallë të lartë profesionizmi.

Në kushtet kur Shqipëria është anëtare e plotë e NATO-s, rëndësi në institucionet tona arsimore do të ketë planifikimi dhe zhvillimi i arsimimit dhe trajnimit individual dhe shtabeve sipas konceptit "të bashkuar" dhe "të përbashkët". Në këtë aspekt, nëpërmjet Qendrës së Simulimeve, rëndësi do të marrë konsolidimi i punës për trajnimin e komandave dhe shtabeve sipas këtyre koncepteve. **Qendra e Simulimit do të organizohet, pajiset e funksionojë për kryerjen e stërvitjeve operacionale dhe taktike, të bazuar në simulim për komandantët, drejtuesit dhe shtabet e të gjitha niveleve në FA.** Në këtë mënyrë do të mund të arrihen shkallët e planifikuara e të kërkuara të operacionalitetit në FA, duke u bazuar në standarde kërkuese sipas doktrinës tonë kombëtare dhe STANAG-ve të NATO-

s, me qëllim mbështetjen e plotë, në funksion të objektivave të kapaciteteve (CT), sipas Listës së Detyrave Themelore të Misionit, duke bërë një vlerësim real të këtij procesi.

"Procesi i arsimimit, trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit të konsolidohen më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO-s. Objektivi kryesor i këtij sistemi të jetë mbështetja e Forcave të Armatosura me personel profesional për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale."[9]

Planëzimi i stërvitjeve të përbashkëta dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e NATO-s dhe vendeve të tjera partnere do të bëjnë të mundur arritjen e objektivave të caktuara për ndërveprueshmërinë, përdorimin e procedurave standarde për planëzimin, organizimin dhe drejtimin e këtyre stërvitjeve, si dhe të sigurojnë rritjen e aftësive operacionale të reparteve e nënreparteve që marrin pjesë.

Si pjesë e pandarë e procesit të arsimimit dhe trajnimit, do të jetë zhvillimi i doktrinës, ndërveprimi, standardizimi dhe procesi i mësimeve të nxjerra. Ndërtimi dhe zhvillimi i strukturës doktrinare ka qenë dhe mbetet një përparësi tjetër në të ardhmen. Doktrinat, manualet apo rregulloret duhet të përmbledhin veprimtaritë kryesore, objektivat, indikatorët monitorues, nevojat e Forcës në kuadrin e zhvillimit, si dhe afatet e përgjithshme kohore. Nëpërmjet Qendrës së Doktrinës do të synohet zhvillimi, shpërndarja dhe rivlerësimi në mënyrë periodike i teknikave, taktikave dhe procedurave për luftim dhe mbështetjen e shërbimeve të luftimit në të gjithë FARSH. Për periudhën 2015-2019, **përpunimi, zhvillimi dhe shtjellimi i mendimit doktrinar** do të konsiderohet si pjesë e pandarë e parimeve dhe zhvillimit konceptual e doktrinar të Aleancës, nëpërmjet procesit të rishikimit dhe hartimit të një sërë doktrinash, konceptesh e dokumentesh bazë për veprimtarinë e FA. "Një ndër drejtimet më të rëndësishme të zhvillimit të FA është hartimi i një koncepti të ri të përdorimit operacional, i cili duhet të harmonizohet me parimet doktrinare të NATO-s"[10].

Sistemi i Standardizimit në FA është mjeti kryesor, nëpërmjet të cilit Forcat e Armatosura integrohen plotësisht në Aleancë. Në këtë kontekst, **objektivi kryesor do të jetë vazhdimi i punës për konsolidimin e këtij sistemi,** zgjerimi i mëtejshëm i hartës së ratifikimit dhe përdorimit të standardeve në FA. Gjithashtu, përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të Mësimeve të Nxjerra, duke e shtrirë funksionalitetin e këtij sistemi përtej fushës së operacioneve, trajtimin e këtij sistemi në procesin arsimor, si dhe përgatitja e *database* për Mësimet e Nxjerra, do të jetë një tjetër përparësi e Qendrës së Doktrinës. Kjo detyrë kërkon mendësi, lidership, strukturë dhe një proces të plotë sipas standardeve të NATO-s.

Vendosja e një departamenti të studimeve strategjike në vartësinë e Qendrës së Doktrinës do të bëjë të mundur kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare dhe rajonale me qëllim asistimin në formulimin e dokumenteve të nivelit strategjik.

Reformimi i "Revistës Ushtarake", si i vetmi organ teoriko-shkencor i FA, do të jetë një tjetër përparësi e jona. Ajo do të jetë një hapësirë gjithëpërfshirëse për të gjithë ata që duan të kontribuojnë, nëpërmjet mendimit të tyre, rreth çështjeve të tilla si: problemet e reformës dhe transformimit, integrimit, standardizimit dhe ndërveprimit, sigurisë,

[9] Direktiva e Mbrojtjes 2014, f.3.
[10] Doktrina Ushtarake e FARSH 2013, f.51, miratuar me urdhër të SHSHPFA nr.240, datë 03.06.2013.

profesionalizmit, zhvillimit të një sistemi të integruar të arsimimit e stërvitjes, të operacioneve të sotme dhe të ardhme të FARSH. Një vend të veçantë në këtë revistë do të zërë trajtimi i punimeve të bëra nga stafet akademike dhe studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Reformimi i sistemit arsimor ushtarak ka rëndësi të madhe në rritjen, zhvillimin dhe mbështetjen e një force ushtarake të aftë, e cila do t'i shërbejë nevojave të kombit për siguri, qëndrueshmëri në rajon, si dhe do të sigurojë kapacitetet e duhura për të kontribuuar me forca të dislokueshme në operacionet e përbashkëta me aleatët. Në kuadrin e rishikimit dhe vështrimit më të kujdesshëm të legjislacionit, dokumenteve strategjike, dokumenteve të tjera themelore të rëndësishme për mbështetjen e objektivave të kapaciteteve, të gjitha burimet njerëzore do të jenë të përfshira në hartimin e një plani të hollësishëm afatgjatë, i cili përmban të gjitha aspektet e modernizimit DOTLMPII (doktrinë, organizim, trajnim, lidership, material, personel, infrastrukturë mbështetëse & informacion). Në këtë kontekst, ne mendojmë dhe gjykojmë të nevojshëm hartimin, përgatitjen dhe miratimin e "Strategjisë për Arsimimin Ushtarak Profesional në FA".

Gjithsesi, duke u mbështetur dhe në përvojën e disa vendeve të Evropës Juglindore për sistemin e arsimimit dhe trajnimit, mendojmë se duhet të organizohen takime, të thithen mendimet e specialistëve në tavolina të rrumbullakëta, seminare e diskutime të ndryshme, me qëllim që të gjenerohen ide dhe përcaktohen mënyra, të cilat të argumentojnë thellë domosdoshmërinë e hartimit të kësaj strategjie.

Duke përfunduar, mendojmë se në fokusin e integrimit, arsimimi dhe stërvitja, padyshim përbëjnë sfidën më të madhe të së ardhmes. Sistemi i arsimimit dhe stërvitjes realizon përgatitjen profesionale ushtarake të burimeve njerëzore që do të shërbejnë në FA. Në këtë pikëpamje, më poshtë po japim disa rekomandime:

- Hartimi i një kuadri ligjor të plotë, në funksion të arsimimit e trajnimit ushtarak, duke realizuar përfshirjen dhe integrimin e të gjithë sistemit në sistemin e arsimimit të RSH-së.
- Rishikimi i të gjithë strukturës së kurseve dhe programeve të arsimimit e përgatitjes profesionale, me qëllim që të përcaktohet më qartë, brenda kornizës ligjore (të rishikuar), përmirësimi tërësor i tij, si dhe të mbështetet me të gjitha kapacitetet njerëzore e financiare, sipas mundësive që disponojnë FARSH, për ta bërë atë një sistem arsimor dinjitoz e bashkëkohor, në përmbushje të misionit të tij.
- Konsolidimi i plotë i strukturës akademike dhe mësimdhënëse, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një politike agresive për rekrutimin e trupës pedagogjike që bën të mundur rritjen e cilësisë dhe produktivitetit të sistemit të arsimimit dhe kërkimit shkencor në FARSH.
- Ngritja e një sistemi funksional për menaxhimin e Arsimit të Lartë Ushtarak dhe integrimin e tij me atë kombëtar, sidomos për arsimimin e nivelit të dytë e të tretë.
- Ngritja e kapaciteteve funksionale për punën kërkimore shkencore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Hartimi i politikave dhe mekanizmave për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e arsimit dhe trajnimit ushtarak.

- Ngritja dhe zhvillimi i një infrastrukture të plotë arsimore e stërvitore, përfshirë dhe trajnimin/përgatitjen profesionale *online.*

Bibliografia:

- Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së RSH, mars 2013.
- Programi i Qeverisë së RSH (2013-2017).
- Direktiva e Mbrojtjes 2014
- Doktrina Ushtarake e FARSH 2013, mars 2013.
- Doktrina e Arsimimit dhe Stërvitjes (MP-3-4), 2009.
- Koncepti i Arsimit & Trajnimit të FA (draft), maj 2014.

Koncepte dhe ide për arsimimin, trajnimin dhe përgatitjen e nëpunësit të inteligjencës shtetërore

MSc. Nënkolonel Sokrat Paskali
Shef i Qendrës së Trajnimit të Inteligjencës "Shawn Pine" në AIM

"Shumë gjëra që për ne kanë kuptim, për ju nuk kanë fare dhe anasjelltas shumë gjëra që për ju kanë kuptim, për ne s'kanë fare"

Shawn Pine

Trajtesë e shkurtuar. *Nëpunësi i inteligjencës është një nëpunës i shtetit që punon në organizatën (agjencinë) e inteligjencës, në stafin e inteligjencës. Kjo është sqaruar në Doktrinën e NATO-s, AJP 2.0 për të dalluar qartë nëpunësin e inteligjencës si staf inteligjence. Për profesionalizëm të mirëfilltë në agjencitë e inteligjencës bëhet fjalë për stafin e inteligjencës ose për një koncept më gjithëpërfshirës për "Nëpunësin e Inteligjencës".*

Në trajtimin e nëpunësit të inteligjencës, duke pasur parasysh arkitekturën e saj, mendoj se ai na shfaqet si kategori, kur trajtojmë specifikat e tij të fshehtësisë dhe të besueshmërisë, ashtu sikundër na shfaqet edhe si individualitet kur bëhet fjalë për nëpunësin e Inteligjencës Kombëtare. Trajtimi si kategori është më shumë i lidhur me grupe të caktuara njerëzish, struktura, nevojshmëri komunitare, sasi ekstensive, aplikim, etj.

Politikat e sugjeruara si ato qeverisëse, ashtu edhe ato institucionale apo shkolla të inteligjencës duhet të kenë parasysh dy tipe nëpunësish të inteligjencës: Nëpunësit dhe Senjorët, që duhen zgjedhur dhe bërë si të tillë (gjendje për të cilën vetënjihen), pasi edhe vetë e dinë nga metacognitioni se nuk janë të parëndësishëm dhe kanë për të bërë gjëra me vlerë për veten e tyre, por edhe për vendin dhe popullit të cilit i përkasin.

Gjenealogjia e Inteligjencës Shtetërore si abstrakt

Jean François Loytard, në vitet '70 të shekullit të kaluar, i ftuar në Universitetin e Kebekut në Kanada, shprehet se tashmë "shtetet kombe luftojnë më shumë për dijen sesa për territore", ndërsa "... raporti për situatën e dijes është ai për *legjitimitetin* e saj; raporti *dije për dije* dhe *dije për tregun*…". Legjitimiteti është një problem shumë i madh për dijen, pasi janë në lojë liria e domosdoshme dhe mungesa e të vërtetave përfundimtare që pretendojnë regjimet jodemokratike. Siç e shpjegoj më poshtë, dy janë

mundësitë për këtë: *instancat* dhe *individualitetet*. *Dije për dije* është filozofia e disiplinës ndërsa *dije për tregun* është bashkë me gjenealogjinë e kontekstit të saj.

Në veprën e tij "Pushteti dhe Dija", *Michel Foucault* shprehet se "gjenealogjia e dijes është gërshetimi i dijeve erudite dhe kujtesave lokale. Synimi i gjenealogjisë është të përdorë dijet lokale, të pjesshme, dijet e përçmuara dhe jolegjitime…Thelbi është kryengritja e dijeve, jo aq kundër përmbajtjeve, metodave apo koncepteve të një shkence, sesa, para së gjithash, kundër efekteve pushtetore centralizuese, efekte që lidhen me institucionin dhe funksionimin e ligjërimit të organizuar shkencor në një shoqëri si kjo e jona".

Kur flet për dijen, *Konfuci* thotë se njeriu mëson në një nga këto tri forma, duke u nisur nga më e ulta te më e larta: *-Imitimi -Përvoja -Reflektimi*. Duke i parë këto të lidhura me ndarjen e mësipërme, imitimi është i ngjashëm me analogjinë, ku ne e shohim një gjë dhe themi se duhet bërë ashtu; përvoja është konteksti gjenealogjik i dijeve që vjen nga praktikat e mira të zgjidhjes së problemit dhe mësimet e nxjerra dhe reflektimi është filozofia e inteligjencës si e tillë. Konteksti ynë për problematikën e inteligjencës shtetërore ka të metë themelore *rendimin*, ai niset nga analogjitë dhe imitimi me anë të implementimeve, duke shkuar më pas te gjenealogjia kontekstuale e realitetit tonë dhe në fund, në mënyrë sipërfaqësore e suplementare, ka pak kuptim filozofia e inteligjencës si e tillë apo reflektimet për të (kërkimet e munguara ose të dobëta).

Kuptohet se ne nuk jemi Franca dhe kemi të tjerë kufij e skrupuj. Unë do të mendoja se nevoja jonë do të ishte që, mbështetur në filozofinë e inteligjencës, studimi i saj (i dijes) si "*dije për dijen*", konceptimi dhe rendi doktrinar më shumë nga ata që e kanë vizionin e nevojshëm dhe nivelin *"know how"*, të mbeteshin gjatë te gjenealogjia e kontekstit në anën e mirë të saj, siç sugjeron *Foucault*, për ta njohur thellë dhe në fund të shikonim mundësinë e përdorimit të analogjive dhe simetrive, të cilat patjeter kanë rëndësinë e tyre standardizuese e të pazëvendësueshme.

Nëpunësi i Inteligjencës si profesion i mirëfilltë

Kur flet për historinë e shtetit amerikan, *Henry Kissinger* shprehet se SHBA-të janë ndërtuar mbi bazën e doktrinave, në ndryshim nga shtete të tjera si Anglia dhe Franca, të cilat kanë tradita në administrimin publik, në kuptimin më të përgjithshëm. E filloj me këtë referencë me qëllim që të sugjeroj analogjinë në këtë rast me shtetin shqiptar, i cili mendoj se ka të njëjtin zhvillim, sigurisht brenda limiteve dhe kapaciteteve të veta modeste. Duke arsyetuar kështu, është fjala për filozofinë e gjërave në shqyrtimin e sensit të tyre për idenë shtetërore, sepse asnjë bazë tjetër krahasimi nuk ka kuptim.

Arsyeja e mësipërme na detyron, mendoj, që të kemi për synim ndërtimin e praktikave tona mbi bazën e doktrinave, vizionit dhe konceptimit, duke u mbështetur në ecurinë pozitive të të tjerëve, por me synimin për të krijuar "sensin tonë të gjërave", ose siç e kam shkruar dhe më pëlqen ta përsëris "*bashkëndjesinë komunitare*", e cila të garantohet si praktikë e mirë dhe më tej të vijohet për ta konsoliduar dhe bërë traditë në brezat e ardhshëm.

Shteti shqiptar, i organizuar në 22 vitet e fundit si demokracitë perëndimore, herë i ngjashëm me një model e herë me një tjetër, ka synuar të jetë modern dhe i integruar me botën e zhvilluar, duke zgjedhur kahun e progresit. Duhet thënë se edhe në Perëndim për administratën shtetërore nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar, por si e konsideron

Fukuyama, kjo e fundit ka të bëjë me dy elementë kryesorë të individëve që e përbëjnë, të cilët janë personat që *trajnohen dhe* personat që *vlerësohen*.

Këta dy elementë kryesorë karakterizojnë të gjitha administratat shtetërore në Perëndim. Edhe për vetë profesionin dhe profesionalizmin ka këndvështrime të ndryshme, por unë po i referohem atij të *Huntingtonit* që e zbërthen në 3 elementë:

a) *Elementin e ekspertizës* (për mendimin tim, është elementi themelor dhe që i jep bazën profesionit sepse lidhet me të tre aspektet e njohjeve dhe aftësive individuale, *konjicionin, afeksionin* dhe *aftësitë psikomotore)*.
b) *Elementin e bashkëpunimit* dhe bashkëveprimit me të tjerët.
c) *Elementin e përgjegjësisë*, të qenurit përgjegjës për profesionalizmin.

Nëpunësi i inteligjencës është një nëpunës i shtetit që punon në organizatën (agjencinë) e inteligjencës, në *stafin e inteligjencës.*(Sepse në agjencitë e tipit të tillë ka edhe nëpunës që punojnë në funksione mbështetëse dhe nuk janë nëpunës inteligjence). Kjo është sqaruar në Doktrinën e NATO-s, AJP 2.0 për të dalluar qartë nëpunësin e inteligjencës si staf inteligjence. Pra, për profesionalizëm të mirëfilltë në agjencitë e inteligjencës bëhet fjalë për stafin e inteligjencës ose për të pasur një koncept më gjithëpërfshirës për "*Nëpunësin e Inteligjencës*".

Siç dihet rëndom në ata që kanë dijeni profesionale për agjencitë e inteligjencës, aspektet e saj kryesore mund të grupohen në katër:

I. *Grumbullimi klandestin* i informacionit dhe informimi.
II. *Prodhimi i inteligjencës* së përfunduar me anë të ***analizës*** së informacionit dhe inteligjencës.
III. *Operacionet klandestine* kryesisht në juridiksionin e ekstraterritorialitetit dhe
IV. *Kundërinteligjenca* ofensive dhe difensive.

Nga ana tjetër, e gjithë veprimtaria mund të grupohet në dy bashkësi të mëdha: *shërbimet e Grumbullimit* dhe *shërbimet e Inteligjencës*. Duhet pasur parasysh edhe një dije empirike, ajo që pavarësisht të përbashkëtave, analogjive, simetrive, agjencitë e tilla kanë një vulë të traditave të tyre që lidhen me historinë, etnokulturën, zhvillimet aktuale, misionet e ndryshme, mënyrën e ndarjes juridiksionale të shtetit, etj. Sigurisht ato kanë edhe standarde të përbashkëta, ngjashmëri e simetri të paneglizhueshme, por kjo është një gjë e ditur përgjithësisht. Do të doja të bëja edhe një analizë tjetër. Agjencitë e inteligjencës, pavarësisht mjegullës dhe tymnajës së legjendave urbane që i mbështjellin, nuk janë as më shumë e as më pak të ndryshme nga institucionet e tjera të vendit, sepse ato janë si enët komunikuese, që shtrihen e ngrihen mbi bazën e një etnokulture dhe kanë vulën e kohës së vet. Një rëndësi të madhe në njohjen, studimin dhe reformimin e tyre kanë cilësia dhe ekuilibri i nëpunësit të tyre të inteligjencës.

Gjithashtu vlerësoj se *nëpunësi i inteligjencës* ka dy tipare kryesore: 1) atë të të qenit kategori ose model si i tillë, që lidhet posaçërisht me dy kushtet "*sine qua non*" të konfidencës (*sekretit)* dhe pastërtisë (*besnikërisë*) përveç domosdoshmërisë së 3 elementëve të profesionit sipas *Huntington*-it që u shënuan më lart dhe 2) veçoritë individuale të etnokulturës, personale dhe sociale apo të çfarëdo nuance tjetër qofshin. Këto dy tipare lidhen me natyrën e veçantë të nëpunësit të inteligjencës, duke krijuar në këtë mënyrë "*psikologjinë e posaçme informative*" dhe punimi im, që është i titulluar ***"Psikologjia Informative e Nëpunësit të Inteligjencës"***, shtjellon këto dy tipare, që

trajtohen në një modul të posaçëm.

Institutet dhe institucionet arsimdhënëse dhe edukative për Inteligjencën

Është një shprehje e bukur amerikane që thotë "*smarter than harder*" Kësaj i shërben ajo për të cilën është i interesuar publiku dhe komuniteti. Pikërisht për këtë funksionojnë institucionet shtetërore ose më mirë presupozohet se veprojnë në këtë mënyrë në një kontekst të caktuar.

Duhet të njihet gjerësisht fakti se funksionet e inteligjencës si e tillë janë tre:

- *Knowledge (Dijet e thelluara)*
- *Foreknowledge (Predikim/Parashikim)*
- *Prelud for decisionmakers (Prelud për Vendimmarrësit)*

Duke vënë në paralel/Duke krahasuar "*smarter than harder*" me funksionet e inteligjencës më sipër, kuptohet cilësia e veçantë e intelektit, por edhe cilësi të tjera që i duhen nëpunësit të inteligjencës. Kam parasysh shprehjen e *Weber*-it që, kur merret në shqyrtim shteti dhe veprimtaria shtetërore, këto duhet të trajtohen në mënyrë "*ideale*", pra pavarësisht nga konteksti dhe rrethanat. Unë mendoj se në vendin tonë është e nevojshme që nëpunësit e inteligjencës (por jo vetëm ata, ky këndvështrim shkon edhe më gjerë) mund të ndahen në tre nivele, gjatë trajtimit që iu duhet bërë atyre. (Duke hapur një parantezë që të shmangen dy karakteristikat negative të administratës si *asistenciale* nga pagesa dhe *elektorale* nga përbërja).

Niveli i parë: *Ata që s'dinë asgjë për veten e tyre dhe ndodhen në gjendjen profane, estetike.*

Në këtë nivel bëjnë pjesë ata që vijnë të punojnë "për një copë bukë" (po përdor një shprehje shumë të përhapur tek ne) ose për arsye ekstrapublike, jo shtetërore dhe të tillë në administratën e vendit tonë për një kohë të caktuar do të ketë me shumicë, por kjo sasi duhet të vijë duke u kufizuar me zhvillimin kulturor të shoqërisë shqiptare. Këtu unë nuk e kam fjalën për ata që kanë nevojë të punojnë për të siguruar bukën e gojës. E kam fjalën për atë kategori, e cila nuk ka fare asnjë lloj pretendimi dhe të tillë janë *shumica e njerëzve*. Në administratat tona moderne duhet të shkojë drejt zeros prania e këtyre njerëzve, sa më parë. Një pjesë e tyre mund të bëhen të përshtatshëm edhe për nivelin e dytë pasardhës nga ata që tashmë gjenden në administratën shtetërore. *Mënjanimi i kësaj kategorie duhet të ketë si qëllim "reformat" për zhvillimin e kapaciteteve administrative ose më saktë integrimin e tyre në jetën jo publike.* Problemi më i madh tek ne është krijimi i *instancave* për të bërë përzgjedhjen e njerëzve, gjë që është cilësi e popujve të qytetëruar dhe me tradita shtetërore të tilla.

Në pyetjet rutinë që zhvillohen nga institucionet prestigjioze të instancave që administrojnë burimet njerëzore, tre pyetje janë themelore: *Kush je? Çfarë je në gjendje të bësh? Çfarë do të doje të bëje ti nëse do të mundje?* Këto pyetje kaq të thjeshta në dukje bëjnë edhe diferencën e madhe të raportit midis vetënjohjes dhe njohjes apo certifikimit të vlerave nga instancat e mësipërme.

Instancat janë në gjendje të përzgjedhin për administratorë dhe senjorë dy nivelet e mëposhtme:

Niveli i dytë*: Ata që e njohin veten e tyre, por e dinë se nuk janë të rëndësishëm dhe ndodhen në* ***gjendjen racionale, etike****.*

Kjo kategori është më e lartë se e para dhe në këtë nivel njeriu arrin nëpërmjet vetëdijësimit dhe kënaqet me arritjet dhe vlerat e të tjerëve, sepse nuk sheh tek vetja në mënyrë objektive as vlera dhe as cilësi superiore që mund t'i bëjnë *pika referimi të komunitetit*, por ai admiron ***superioren*** vendase apo të huaj. Tek ne kjo kategori është ende e vogël dhe sigurisht më e vogël se e nivelit të parë. Por është bazë për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. *Përfaqësuesit e shtresës së mesme* janë tipikë, të rregullt dhe të disiplinuar për të bërë burokracinë e rëndomtë shtetërore. Baza e administratës shtetërore moderne edhe tek ne duhet të jetë kjo kategori. Ajo garanton dhe vijon "*sensin komun*" (të përgjithshmen) në shtratin e procedurave dhe praktikave të mira. Unë po e quaj *burokracia klasike*.

Është e domosdoshme që në arsimimin, trajnimin dhe përgatitjen e tyre të kihet parasysh që të kenë kaluar në nivelet e ulta të dimensioneve *Cognitive, Affective dhe Psychomotore*, që janë respektivisht:

Cognitive (*remembering/understanding/applying)—(kujtesa/kuptueshmeria/aplikimi*), Affective (*pranimi i fenomeneve/përgjigja tek fenomenet/aftësia e vlerësimit për të çmuar*) dhe Psychomotor (sipas *Dave)*-(*imitimi/manipulimi/precizioni*).

Niveli i tretë: *Ata që e dinë se janë të rëndësishëm, të paneglizhueshëm dhe ndodhen në gjendjen ontologjike, të nevojshëm për zgjidhjet dhe zgjedhjet strategjike të komunitetit.*

Kjo kategori është kategoria më e lartë e "*smarter than harder*" dhe bëhet fjalë për një set të kufizuar *të sasisë së përgjithshme*. Nga këta persona duhen zgjedhur dhe mësuar menaxherët dhe ekspertët më të mirë të agjencive të inteligjencës. Kjo kategori synon zhvillimin, hopin cilësor, ngritjen e standardeve të performancës në një nivel më të lartë. Unë po e quaj *burokracia moderne elitare*.

Është e domosdoshme që në arsimimin, trajnimin dhe përgatitjen e tyre të kihet parasysh që të kenë kaluar në nivelet e larta të dimensioneve *Cognitive, Affective* dhe *Psychomotor*, që janë respektivisht: Cognitive (*analizë/vlerësim/kreativitet*), Affective *(Organizim dhe karakterizim të vlerave të brendshme/i aftë të adoptojë një sistem vlerash dhe filozofi besimi që kontrollon sjelljen e tij*) dhe Psychomotor (sipas *Dave*)-(*Artikulim i ekspertizës për të realizuar objektiva jo standarde dhe natyralizim & Mjeshtëri të automatizuara intuitive e aftësi të nivelit strategjik*).

Gjithë sa thashë më sipër ka kuptim në një marrëdhënie të ndërsjellë midis vetënjohjes ("uni" individual "ideal") dhe njohja nga institucionet shtetërore si instancë e nëpunësve apo kandidatëve për të tillë si "uni" social "real". *Një përafrim sa më i madh i këtyre dy "unëve" do t'i japë jetë efiçencës dhe efektivitetit.*

Sherman Kent, një nga dy autoritetet më të mëdhenj të Analizës së Inteligjencës Amerikane (bashkë me *Robert Gates*), në pasazhin e mëposhtëm të shumëcituar shprehet: "Burri i shtetit që hedh poshtë atë informacion që paraqitet në mënyrë *të arsyeshme* duhet të marrë vesh që ai i kthen kurrizin dy instrumenteve: instrumentit të ARSYES dhe të METODËS SHKENCORE, me anën e të cilave që nga koha e Aristotelit, njeriu perëndimor ka zgjeruar horizontin dhe njohuritë e veta".

Një *institut* shumë konsistent për konceptimin e Procesit të Inteligjencës është ARKITEKTURA e saj, që do të thotë *framework*-u midis POROSITËSVE-KONSUMATORËVE-PËRDORUESVE me grumbulluesit, që mund të jenë burime,

shërbime ose agjenci. Në mënyrë telegrafike po i referohem disa pikave kyçe që kanë agjencitë e inteligjencës përveç ndarjeve burokratike si menaxherë inteligjence, eprorë dhe vartës, zbulues dhe kundërzbulues, të cilët janë specialitete të nëpunësit të inteligjencës si profesion duke i rreshtuar nga lart-poshtë sipas nivelit të ekspertizës profesionale, siç janë shpjeguar tek Doktrina e Inteligjencës, Kundërinteligjencës dhe Sigurisë (DOIKS): *National Intelligence Officer (Nëpunësi i Inteligjencës Shtetërore); Senior Intelligence Officer(Nëpunësi Senjor i Inteligjencës); Senior Analyst (Senjor Analist); Desk Officer (Nëpunës Tavoline); Liaision Officer (Ndërlidhës ose Koordinator); Agent Clandestine Intelligence Officer (Nëpunës Klandestin i Inteligjencës); Analyst; Baby Analyst (Analist Fillestar); Case Officer (Nëpunës Çështjesh)*, etj. Arsyet dhe metodat shkencore të përdorura në agjencitë e inteligjencës, të cilat ka parasysh *Sherman Kent*, kanë lidhje edhe me shumëllojshmërinë e ekspertizave të nëpunësit të inteligjencës për të patur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur personat, të cilët dinë se si ("*know how*") të plotësojnë misionin inteligjent të inteligjencës.

Nëse do të përpiqeshim të periodizonim arsimdhënien dhe edukimin e inteligjencës unë do të mendoja se ajo duhet të ishte në tre nivele:

Niveli I - duhet t'i japë një personi arsimin e nevojshëm për profesionin e nëpunësit të inteligjencës, që *duhet të jetë 1 vit akademik* sepse personat që rekrutohen si nëpunës inteligjence kanë kryer studime universitare.

Niveli II - ka të bëjë *me kurse profesionale bazike të zhvillimit të doktrinës së inteligjencës*, në varësi të kërkesës dhe ofertës institucionale.

Niveli III - ka të bëjë me studime të thelluara për inteligjencën, që *mund të jenë 9-mujore* dhe duhet të përfshijnë kryesisht menaxherët dhe senjorët e inteligjencës, por edhe të tjerë që kanë lidhje me arkitekturën e saj.

Gjithashtu, mund të marrin pjesë (dhe duhet për mendimin tim) në arsimimin dhe edukimin e inteligjencës edhe persona të tjerë jashtë këtyre agjencive, që kanë lidhje me procesin e saj ose konsumojnë produktin e inteligjencës. Për realizimin e ideve të mësipërme institucionet aktuale akademike, apo ato të atashuara pranë agjencive si institut apo qendër trajnimi inteligjence mund të ndërtojnë një sistem të mirëmentuar dhe të shtrirë deri në planifikim afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër në strategjitë e tyre të Arsimimit, Trajnimit dhe Përgatitjes së Nëpunësit të Inteligjencës.

Planifikimi afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër në arsimimin dhe edukimin e Inteligjencës

Jim Knight në "Strategic Planning for School Managers" për planifikimin si një proces i rëndësishëm sugjeron për "Competencies and Standards (Kompetencat dhe Standardet)": a) *a key purpose* (një qëllim kyç); b) *key roles* (rolet kyç); c) *units of competence* (njësitë e kompetencës); d) *elements of competence* (elementët e kompetencës); e) *performance criteria* (kriteret e performancës); f) *range statements* (formulimet e renditjes) si dhe 4 rolet ose funksionet kyç: 1. *Manage policy* (Menaxhimi i politikes); 2. *Manage learning* (Menaxhimi i mësimit); 3. *Manage people* (Menaxhimi i njerëzve); 4. *Manage resources* (Menaxhimi i burimeve). Po në këtë publikim autori sugjeron planifikimin në tre nivele: planifikim afatgjatë deri në 10 vjet; planifikim afatmesëm deri në 5 vjet dhe planifikim afatshkurtër vjetor. Ashtu siç autori porosit, për të mos qenë skllav shifrash, ato mund të jenë edhe më të ndryshme se ato që sugjerohen, por referenca shërben si sens. Ai shkruan:

"Mendimi ynë rreth strategjisë do të jetë i dominuar nga marrëdhëniet tona me të tashmen dhe të ardhmen immediate, të parashikueshme… Dhjetë vjet është larg mjaftueshëm përpara, më tej bëhet një lëvizje konstante, qëllim i largët i cili vetëm mund të jetë i përftuar në mënyrë jo precize, por është thelbësore në qoftë se ne kërkojmë një dimension strategjik të vërtetë për zhvillimin e vazhdueshëm të shkollës ose kolegjit. Dhe kujtoni, mos u bëni skllav i kësaj"!

Planifikimi strategjik afatgjatë zhvillohet me anë të vizionit për të patur një kuptueshmëri të qartë të qëllimit kryesor që duhet synuar për të arritur; të vlerave të cilat duhet të forcohen, shtohen dhe pretendohen, të stilit dhe pasionit për të plotësuar vizionin. Planifikimi afatmesëm është më konkret se "imagjinata". Ai ka për qëllim që të realizojë objektiva më të arritshme. Për planifikimin afatmesëm është e nevojshme që të zbatohen dy tipe analizash që janë shumë të njohura në perëndim dhe që quhen *SWOT Analysis dhe Decision Analysis.*

Analiza SWOT (**SWOT Analysis**) është analizë që u bëhet katër faktorëve: Fortësive (**S**trengths), Dobësive (**W**eaknesses), Mundësive (**O**pportunities) dhe Kërcënimeve (**T**hreats). Kjo analizë bën të mundur shqyrtimin e pritshmërive, mbështetur në limitet dhe kapacitetet. Analiza e vendimit (**Decision Analysis**) në modelin racional të saj parashikon dhjetë hapa: (0) Agenda (Axhenda), (1) Problem (Problemi), (2) Objectives (Objektivat), (3) Alternatives (Alternativat), (4) Forecast (Parashikimi), (5) Compare (Krahasimi), (6) Select (Përzgjedhja), (7) Implement (Zbatimi), (8) Monitor (Monitorimi), (9) Evaluate (Vlerësimi).[1]

Disa nga problemet që mund të parashikohen në planifikimin afatmesëm janë: 1. Përzgjedhja dhe përgatitja e stafit mësimor të ri të ekspertëve dhe pedagogëve; 2. Parashikimi për realizimin e disa klasave 1-vjeçare të të punësuarve rishtas për të marrë nëpunësinë e inteligjencës, si dhe të disa klasave për studime të thelluara për senjorët (ashtu siç unë sugjeroj më lart); 3. Planifikimi i përmirësimit të kurrikulave që nuk disponohen ose që duhet të përmirësohen në bashkëpunim me partneritetin strategjik; 4. Sigurimi i buxhetimit për objekte të reja për ambiente mësimore (nëse është e nevojshme), etj.

Në këtë fazë gjykoj të bëj këtë citim nga libri i mësipërm:"… Në fakt, natyra e shkollës dhe e kolegjit, roli bazë, tradicional - transmetimi i dijeve dhe i aftësive *nga ata të cilët i dinë (ekspertët ose mësuesit)- e bën më të mundur që ata të jenë veçanërisht të prirur tek ky rrezik: siguria dhe bindja janë të pritur nga ata kujt i supozohet roli i ekspertit.*

Ide për politikat arsimore dhe edukative të Inteligjencës në kontekstin bashkëkohor

Më duket kuptimplotë referenca tek "*Moderning Intelligence…*", produkt i një grupi ekspertësh amerikanë: "Problemi i parë me të cilin përballet progresi në diskutimet rreth reformës së Komunitetit të Inteligjencës (KI) është dobësia e të mirëkuptuarit të koncepteve dhe parimeve të miratuara, që do të thotë "doktrinë" e zbatueshme në mënyrë të përgjithshme në të gjithë *Komunitetin e Inteligjencës*. Sot, secila agjenci në përbërje të KI ka doktrinën e saj vetjake ose nuk ka fare. Deri sa të jetë miratuar dhe pranuar një doktrinë me parime, koncepte dhe terma për KI si një e tërë, qartësia për çështjet e

[1] Andrew Lang Galub "Decision Analysis" "The Rational Approach to Decision Making, the Ten Steps of the Rational Model p. 10-12.

reformës do të mbetet iluzive… Nuk është vetëm shpallja e një doktrine të KI thelbësore. Një sistem shkollimi i KI për nëpunësit e inteligjencës të nivelit "senjor" dhe "të mesëm" është gjithashtu thelbësor për të përcjellë dhe përditësuar parimet dhe konceptet, si dhe për të siguruar, në të njëjtën kohë, kuptueshmërinë në vazhdimësi për të gjithë KI." Unë rekomandoj se duhet krijuar në KI sistemi i menaxhimit të arsimimit të senjorëve.

Kam mendimin se politikat shtetërore arsimore dhe edukative të inteligjencës duhet të kenë parasysh në thelb ndërtimin e këtij "sistemi" dhe ato mund të ndahen në tri kategori, pavarësisht se konceptohen dhe zbatohen në sinergji:

1. Politikat qeveritare.
2. Politikat institucionale të organizatave të inteligjencës.
3. Politikat e institucioneve dhe strukturave akademike, arsimore, edukuese dhe kërkimore në organizatat e inteligjencës ose jo.

Politikat, në të dy format "politics" dhe "policy"[2], kur diskutohet për ato arsimore dhe edukative të inteligjencës, mendoj se duhet llogaritur për një komunitet personash shumë më të madh se sa ai që perceptohet në pamje të parë. Konsideroj se komuniteti, për të cilin duhet të ketë politika arsimore dhe edukative për inteligjencën si të tillë, duhet të përfshijë, përveç pjesëtarëve të entiteteve të inteligjencës si agjenci ose struktura, edhe një spektër personash në administratën shtetërore që kanë marrëdhënie me inteligjencën, si dhe studentë të niveleve të caktuara sidomos ata të shkollave ushtarake, të diplomacisë, etj.

Politikat qeveritare janë të lidhura kryesisht me standardet në radhë të parë, por edhe me efiçencën dhe efektivitetin. Këtu dua të bëj një sqarim: Standardet dhe analogjitë janë gjëra të ndryshme. Kur flasim për standarde kemi parasysh standardet e NATO-s, të BE, të shtetit demokratik, ndërsa analogjitë janë ato të një shteti të caktuar, të kësaj agjencie inteligjence, etj. Standardet janë më të rëndësishme dhe, në të shumtën e rasteve, plotësimi i tyre është i detyrueshëm. Analogjia ka vlerë krahasimi, por nëse ajo nuk shkon për shumë arsye të mundshme, atëherë biem në falcitetin logjik "*false analogy*" duke menduar se ka vlerë edhe tek ne.

Politikat institucionale janë të lidhura kryesisht me profesionin dhe profesionalizmin, por edhe me efiçencën dhe efektivitetin. "Klienti" i mirëfilltë i arsimimit dhe trajnimit të inteligjencës është agjencia dhe komponentët e saj përbërës, si në nivelin fillestar ("new entry"), bazë ("basic") dhe i avancuar ("advanced"), ashtu dhe në ndarjen tradicionale ose të zhvillimit të doktrinës së inteligjencës, në kuptimin e ngushtë profesional.

Politikat si shkollë ose politikat e institucioneve dhe strukturave akademike, arsimore, edukuese dhe kërkimore në organizatat e inteligjencës ose jo; janë të lidhura kryesisht me ekspertizën për ta gjetur atë tek ata që e zotërojnë dhe për t'ua përcjellë atyre që nuk e zotërojnë. Këto politika gjenden gjithashtu edhe tek marrëdhëniet e tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë elementologjike dhe metodologjike, didaktike, stafin mësimor dhe atë jo mësimor të përhershëm, marrëdhëniet interagency në fushën e arsimimit dhe edukimit, etj. Ato duhet të zgjidhin edhe katër funksionet kryesore të arsimimit, që sipas *Gerard*

[2] Merriam Dictionary: *Politics* është arti ose shkenca e lidhur me drejtimin ose influencimin e veprimit qeverisës. *Policy* është një kurs ose metodë përfundimtare e veprimit e përzgjedhur midis alternativash dhe nën dritën e kushteve të dhëna për të drejtuar ose përcaktuar vendimet e tanishme dhe të së ardhmes".

Delainty (Profesor në Universitetin Suseks Angli) janë: *Mësimdhënia, Kërkimi, Arsimimi Profesional dhe Transmetimi Kulturor e Intelektual.*

Në trajtimin e *nëpunësit të inteligjencës,* duke pasur parasysh arkitekturën e saj, unë kam idenë se ai na shfaqet edhe si *kategori*, kur trajtojmë specifikat e tij të fshehtësisë dhe të besueshmërisë, ashtu sikundër na shfaqet edhe si *individualitet* kur bëhet fjalë për nëpunësin e Inteligjencës Kombëtare, Senjor Analistët, etj. Trajtimi si kategori në politikat e mësipërme të sugjeruara trekëndore është më shumë i lidhur me grupe të caktuara njerëzish, *struktura*, nevojshmëri komunitare, sasi ekstensive, aplikim, etj.

Si përfundim, çka kam parashtruar më sipër i shërben sqarimit se politikat e sugjeruara si ato qeverisëse, ashtu edhe ato institucionale apo shkolla të inteligjencës duhet të kenë parasysh dy tipe nëpunësish të inteligjencës: *Nëpunësit* dhe *Senjorët*, që duhen zgjedhur dhe bërë si të tillë (gjendje për të cilën vetënjihen), pasi edhe vetë e dinë nga *metacognitioni* se nuk janë të parëndësishëm dhe kanë për të bërë gjëra me vlerë për veten e tyre, por edhe për vendin dhe popullit të cilit i përkasin.

Bibliografia

- AJP 2.0 Allied Intelligence, Counter Intelligence and Security Doctrine.
- DOIKS Doktrina e Inteligjencës, Kundërinteligjencës dhe Sigurisë .
- AFI Analysis Foundation Intelligence.
- A Consumer's Guide to Intelligence
- National Institut for Public Policy (USA) "Moderning Intelligence: Structure and Change for the 21-st century".
- Henry Kissinger, "Diplomacia".
- Francis Fukuyama "Ndërtimi i Shtetit" "Qeverisja dhe Rendi Botëror për shekullin XXI" AIIS Tiranë-2008, "Përkufizimi i administratës publike".
- Foucault Michel "Pushteti dhe Dija" ISP&Dita2000 Tiranë 2009.
- Carl G.Jung "Psikologjia Analitike" Fan Noli, Tiranë-2006; "Ndërgjegjja nga pikëpamja psikologjike".
- Rise B.Axelrod/Charles R.Cooper "The St.Martin's Guide to Writing"; St.Martin Press New Jork; Library of Congress Catalog; Card Number: 87-060570, "Logical Fallacies" (Falcitetet Logjike).
- Philip Carter/ Ken Russell "Inteligjenca", UEGEN, Tiranë-2008, "Krijimtaria".
- Richard E.Neustadt/ Ernest R.May "Thinking in Time", Macmillan, The Free Press, New York: "Methods/Courses/Cases" (Metodat/Kurset/Rastet).
- John R.Schermerhorn/James G.Hant/Richard N.Osborn "Managing Organizational Behaviour" John Wiley &Sons,Inc. "Sinergy in Organizations", "Four Functions of Management", "The nature of organizational change", etc. ("Sinergjia në Organizata", "Katër Funksionet e Menaxhimit", "Natyra e Ndryshimit Organizativ", etj.)
- Charles W.L.Hill/Gareth R.Jones "Strategic Management Theory" An integrated approach. Library of Congress, Catalogue Card Number 91-71987; "Distinctive Competencies" (Kompetencat Dalluese).
- Jim Knight "Strategic Planning for School Managers" A handbook of Approaches to Strategic Planning and Development for Schools and Colleges. Kogan Page, London-Stirling USA. British Books for Managers, "Competencies and Standards" (Kompetencat dhe Standardet).
- Andrew Lang Golub "Decision Analysis" On integrated Approach, John Wiley & Sons Inc.New York, "The rational approach to decision making- The ten steps of the rational model" (Qasja racionale tek vendimmarrja-Dhjetë hapat e modelit racional).

Edukimi mjedisor i personelit të FARSH nëpërmjet legjislacionit

MSc. Valbona Zeka
Pedagoge e Edukimit Fizik në AFA

"Vetëm atëherë kur druri i fundit të jetë prerë;
atëherë kur lumi i fundit të jetë helmuar
atëherë kur peshku i fundit të jetë zënë;
vetëm atëherë do të kuptojmë që
PARAJA S'MUND TË HAHET."[1]

Trajtesë e shkurtuar. *Zhvillimi i industrisë në ditët tona ka njohur hapa të shpejtë. Paralelisht me anët pozitive, ky zhvillim shoqërohet gjithnjë e më shumë me shqetësimet mjedisore. Vendet e industrializuara, së bashku me organizata të fuqishme mjedisore, po rritin ndjeshmërinë dhe marrjen e masave për uljen e ndikimeve negative të industrisë mbi natyrën dhe mjedisin tonë të përbashkët. Për këto probleme të rëndësishme janë organizuar një sërë takimesh ndërkombëtare ndërmjet qeverive, organizatave joqeveritare dhe atyre mjedisore.*

Në shkrimin e mëposhtëm trajtohen çështje që lidhen me njohjen dhe respektimin e legjislacionit ndërkombëtar për mjedisin, si dhe respektimin e pakteve, marrëveshjeve e konventave të ndryshme në këtë fushë. Synimi i Shqipërisë për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE dikton domosdoshmërinë dhe përsosjen e legjislacionit në fushën mjedisore. Në këtë kuadër, një ndikim jo të vogël mbi mjedisin dhe jetën e përditshme, si dhe në ekologjinë e botës sonë kanë edhe Forcat e Armatosura, nëpërmjet prodhimeve ushtarake, pajisjeve, armatimit dhe mbetjeve të ndryshme të prodhuara prej tyre. Shkrimi trajton detyrimin dhe përgjegjësitë e FA-ve për mjedisin në kushtet e zakonshme pranë vendngulimeve në stërvitje dhe qitje, si dhe gjatë operacioneve të ndryshme. Një aspekt tjetër i trajtesës së këtij shkrimi është edukimi i personelit të FA-ve me anën e legjislacionit dhe STANAG-ve të NATO-s, të ratifikuar edhe nga ana jonë.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet Konferencës së Brazilit të 1992-it (Rio de Janeiro) për zhvillimin industrial dhe mjedisin, ka përcaktuar një program me detyrat që duhet të mbahen parasysh për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Është i njohur sot ndikimi i madh i industrisë dhe i mbetjeve të saj mbi mjedisin, si dhe dëmtimi i jetës së njerëzve dhe i gjallesave të gjalla në tokë prej këtyre mbetjeve. Që prej Konferencës së Brazilit e deri më sot, një sërë aktesh

[1] Proverbë e fisit indian *Cree.*

ndërkombëtare janë hartuar për mjedisin, si p.sh: Konventa e Bonit për "Mbrojtjen e kafshëve të egra", Konventa e Barcelonës për "Mbrojtjen e mjedisit detar, shumëllojshmërinë biologjike (biodiversitetin)", Konventa e Bernës për "Ruajtjen e florës dhe faunës", Konventa e Kombeve të Bashkuara për "Luftën ndaj shkretëtirëzimit (Paris)", Konventa e Gjenevës për "Ndotjet atmosferike në distancë të madhe", Konventa e Bazelit mbi "Kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre" etj.

Futja e vendit tonë në një sërë rrjedhash zhvilluese kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhur me zhvillimin e veprimtarive dhe ndërmarrjen e nismave zhvilluese, kanë diktuar domosdoshmërinë dhe përsosjen e legjislacionit mjedisor. Marrja e statusit si vend kandidat për në BE dhe hapja e negociatave, kushtëzon futjen e një legjislacioni të tillë në vendin tonë.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 59, thuhet:"Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që zotëron si në plotësim të nismës, dhe të përgjegjësive private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm". Mbrojtja e mjedisit në vendin tonë rregullohet nëpërmjet ligjit nr. 10431, datë 09.6.2011 për "Mbrojtjen e mjedisit në RSH". Ky ligj ka për qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit në një nivel të lartë, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve për jetën dhe shëndetin e njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Pra, përcaktimi i parimeve, kërkesave, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave të përgjithshme, për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në Republikën e Shqipërisë në një nivel sa më të lartë, përbën objektin e tij. Në këtë kuadër, nga Parlamenti Shqiptar janë miratuar një sërë ligjesh, të cilat kanë të bëjnë me masat për zhvillimin e turizmit, të faunës së egër dhe gjuetisë, të peshkimit dhe agrikulturës, të kullotave dhe livadheve, të rezervave ujore, të largimit publik të mbeturinave etj.

Në ligjin për "Mbrojtjen e mjedisit", neni 1 thuhet: "Mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe një prioritet kombëtar". Një ndikim jo të vogël mbi mjedisin dhe jetën e përditshme, si dhe në ekologjinë e botës sonë kanë edhe Forcat e Armatosura, prodhimet ushtarake, pajisjet, armatimi dhe mbetjet e ndryshme të prodhuara prej tyre.

Konferenca e Brazilit, krahas të tjerave, vë theksin në angazhimin e gjithë shteteve për një pakësim të ndikimit negativ të ushtrisë në mjedisin dhe ekologjinë tonë. Krahas kësaj, ajo miratoi programin "Agjenda 21", i cili përcakton me saktësi masat për veprim. Vendet e industrializuara kanë një përgjegjësi të veçantë në mbrojtjen globale të mjedisit. Ky dokument përcakton parimet bazë të mbrojtjes së natyrës, duke kontribuuar në cilësinë e jetës të gjeneratave të ardhshme. Ai i detyron shtetet pjesëmarrëse, që në sferën e veprimtarisë ushtarake, të rritin përgjegjësinë dhe veprimet bashkëvepruese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit tonë të përbashkët.

Forcat e Armatosura dhe mjedisi ynë ekologjik

Forcat e Armatosura të RSH-së, në kuadrin e objektivave vjetore të planëzuara dhe atyre të anëtarësimit në NATO, janë të përfshira në një sërë veprimtarish të rëndësishme ushtarake, stërvitore, operacionale dhe të emergjencave civile, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për sa i përket menaxhimit mjedisor dhe kujdesit për të, në Forcat e Armatosura ekzistojnë disa procedura që zbatohen për uljen e ndikimit negativ në mjedis të veprimtarive ushtarake. Këto procedura janë të pasqyruara në rregullore, manuale, instruksione, si dhe në një sërë normash e kriteresh. Gjithashtu, ato kanë në përdorim Doktrinën e Përbashkët të NATO-s për "Mbrojtjen e mjedisit gjatë aktiviteteve ushtarake të drejtuara nga NATO", ku objekti kryesor i saj është se si ndikojnë në mjedis aktivitetet e udhëhequra nga NATO. Udhëzimet e kësaj doktrine përqendrohen në përcaktimin e përgjegjësive të komandantëve gjatë operacioneve ushtarake në menaxhimin e mjedisit, në trajnimet në fushën mjedisore, si dhe në përditësimin e Pikave të Kontaktit Ushtarak Kombëtar për çështjet e mjedisit.

Stërvitjet janë shumë komplekse në pikëpamje të nivelit të tyre, të forcave pjesëmarrëse dhe objektivave që arrijnë. Ato përfshijnë veprime që zhvillohen në tokë, në ajër, në det. Teatri i veprimeve i përfshin të tre variantet së bashku. Në stërvitje e veprimtari të ndryshme ushtarake apo në veprimtari të përbashkëta me ushtri partnere, zhvillohen qitje të ndryshme, si p.sh: me armë të lehta të këmbësorisë, me armë kundërtanke, me artileri e raketa dhe deri te qitje me aviacion. Gjithashtu, përdoren substanca të ndryshme kimike të dëmshme për shëndetin e njeriut, emetohen dhe rrezatohen valë elektromagnetike, të cilat ndikojnë për keq te njerëzit, kafshët, bimët, natyra, të mbjellat, ajri, uji, toka apo te të mirat materiale të krijuara nga njeriu.

Në këtë periudhë të tranzicionit që kalon Shqipëria, ku ndotjet janë në nivelin më të lartë, sistemi ligjor për mjedisin është i pakonsoliduar, kultura qytetare nuk është në nivelin e duhur, ndotja ekologjike përbën, padyshim, një rrezik për sigurinë kombëtare.

Për këtë, ruajtja e mjedisit është detyrë e të gjithë shoqërisë. Forcat e Armatosura mund të luajnë një rol shumë të madh në mbrojtjen e natyrës nga dëmtimet dhe në zvogëlimin e ndikimit të tyre negativ ndaj njerëzve, kafshëve, bimëve, pyjeve, ujërave, ajrit dhe tokës. Në këtë kuadër, nga drejtuesit e MM/SHP të FA-ve, vlerësimi ka qenë maksimal, ku përveç veprimeve të përditshme në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit rrethues, janë hartuar e publikuar disa dokumente, si: "Deklarata e ministrit të Mbrojtjes për Politikat Mjedisore"; "Ratifikimi i disa STANAG-ve për mjedisin dhe zbatimi i tyre në FA"; "Përmirësimi i programeve të arsimimit, stërvitjes e kualifikimit të personelit të FA-ve"; "Zhvillimi dhe zbatimi me një plan të hollësishëm i matricave me detyra të veçanta për mjedisin", si dhe "Nxjerrja e mësimeve të nxjerra gjatë procesit të arsimimit dhe stërvitjes në FA", duke u dhënë zbatim konkret.

Kuadri ligjor ndërkombëtar përmban shumë parashikime, të cilat, në mënyrë direkt apo indirekte, mbrojnë mjedisin dhe rregullojnë përdorimin e burimeve natyrore si gjatë aktivitetit të forcave të armatosura, ashtu edhe gjatë konflikteve të armatosura. Në praktikë, gjithsesi, këto rregullime jo gjithmonë kanë qenë të mirëzbatuara.

Ne mund ta përmbledhim legjislacionin ndërkombëtar që siguron mbrojtjen e mjedisit si gjatë konflikteve të armatosura, ashtu edhe gjatë aktivitetit të përditshëm të Forcave të Armatosura, në katër grupe kryesore:

- Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut (HRL), i cili është shumë i rëndësishëm për t'u njohur. Nëpërmjet neneve 35 dhe 55 të protokollit të parë shtesë të konventës së Gjenevës, përcaktohen disa kushte për mbrojtjen e mjedisit në konfliktet e armatosura.
- Ligji ndërkombëtar mjedisor (IEL), i cili zbatohet edhe gjatë konflikteve të armatosura dhe mund të përdoret shumë mirë si bazë për mbrojtjen e mjedisit. Në

këtë rast, ky ligj zbatohet duke u bazuar në marrëveshjet dy-e-shumëpalëshe për mbrojtjen e mjedisit gjatë konflikteve të armatosura, të brendshme apo ndërkombëtare.

- Nëse dëmi mjedisor kontribuon në krimet e luftës, në krimet kundër njerëzimit dhe në gjenocid, atëherë ky konsiderohet si një vepër penale, e parashikuar si e tillë në Ligjin Ndërkombëtar Kriminal (ICL). Shkatërrimi i mjedisit dhe harxhimi i panatyrshëm apo jo i rregullt i burimeve natyrore mund të përbëjë elemente të mjaftueshme për një vepër penale të parashikuar nga statuti i Gjykatës së Romës, e për rrjedhojë, mund të gjykohet nga kjo gjykatë ndërkombëtare si vepër penale.
- Një ligj tjetër i rëndësishëm është Ligji Ndërkombëtar Humanitar (IHL), i cili në të vërtetë nuk ka shumë nene që kujdesen për mjedisin. Pra, ideja se Ligji Humanitar Ndërkombëtar zëvendëson Ligjin Ndërkombëtar Mjedisor gjatë këtyre lloj konflikteve si "ligj special", nuk është më i padiskutueshëm. Ai, krahas Ligjit të Konfliktit të Armatosur, që bën rregullime të përgjithshme, përcakton me nene te veçanta mbrojtjen e pasurive civile dhe instalimet industriale të vendeve arkeologjike dhe kulturore, gjithashtu siguron mbrojtje indirekte për mjedisin.

Gjithsesi, të gjitha këto ligje, rrallë janë bërë efektive gjatë konflikteve të armatosura. Por, mendojmë se në kushtet e zhvillimeve të reja, të një ndjeshmërie më të madhe të shoqërisë, këto ligje dhe STANAG të NATO-s, të përcaktuara vetëm për mjedisin dhe të ratifikuara nga ana jonë, duhet të ndikojnë te komandantët dhe drejtuesit, për trajnimin dhe edukimin e personelit ushtarak me logjikën e mosdëmtimit të mjedisit, më tepër se sa është nevoja për arritjen e qëllimit ushtarak. Ruajtja e mjedisit përfshin tërësinë e parimeve, normave dhe masave për ruajtjen e jetës në natyrë dhe për zvogëlimin e ndikimeve të dëmshme mbi të.

Mbrojtja e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, tokës dhe ujit, ajrit, klimës dhe pyjeve, si edhe e objekteve të trashëgimisë kulturore nga ndikimet dhe veprimet e dëmshme mjedisore, është një nga marrëveshjet e veçanta që duhet pasur parasysh mes palëve të armatosura në konflikt. Forcat ushtarake udhëhiqen për këtë nga parimet e përkujdesjes, mosdëmtimit dhe kooperimit. Mbrojtjes së mjedisit i shërben siguria e përkujdesjes së qëndrueshme për parimet bazë të jetës e natyrës, veçanërisht të aftësisë funksionale të përfitimeve nga natyra, përfshirë larminë biologjike dhe dobinë e burimeve natyrore.

Shteti, me përgjegjësinë e tij për gjeneratat e ardhshme, mbron bazat e jetës së gjallë natyrore të kafshëve e të bimësisë, me anë të nxjerrjes së ligjeve, duke ruajtur raportin midis ligjit dhe të drejtës dhe duke zbatuar me forcë vendimet e marra. Këtu mund të përmendim udhëzime e ligje të ndryshme, të cilat përbëjnë bazën ligjore në trajtimin e mjedisit.

Forcat e Armatosura, si organizëm shtetëror, kanë për detyrë mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e detyrimeve dhe objektivave të vendosura nga qeveria. Ato do të plotësojnë e realizojnë detyrën e mbrojtjes së mjedisit, edhe në rastet kur nuk ka detyrime politike e ligjore.

Mbrojtja e mjedisit përfshin tërësinë e masave të marra për ruajtjen e kushteve normale të jetës dhe të natyrës. Këto masa synojnë kufizimin e veprimeve dëmtuese mbi natyrën dhe jetën e gjallesave në tokë. Për këtë, trupat ushtarake, në veprimtarinë e tyre të përditshme, duhet të përmbushin detyrimet e vazhdueshme për zvogëlimin e dëmeve të

deritanishme, për kujdesin gjatë kryerjes së stërvitjeve e veprimtarive ushtarake, për hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara, për grumbullimin dhe transportimin e tyre në vendet përkatëse, duke mos ndotur mjedisin e përbashkët.

Zhvillimi i mjedisit ekologjik, nëpërmjet zgjerimit dhe zhvillimit të kushteve për territore të gjera të lira e të gjelbra për gjeneratat e ardhshme, duhet të krijojë kushte për zgjerimin e territoreve për bimësinë dhe jetesën e gjallesave të saj në tokë. Shembujt në këtë fushë nuk kanë munguar, duke përmendur këtu krijimin e mjediseve shumëfunksionale dhe çlodhëse në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes; në Shkollën e Trupës, Bunavi; në Batalionin e Shtabit të Përgjithshëm; në Brigadën e Mbështetjes Rajonale; në Batalionin e Forcave Speciale, Zall-Herr etj.

Rregulloret e veprimtarisë së përditshme dhe të veprimtarisë së FA-ve përcaktojnë qartë detyrimet, se mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të ushtarakëve, si dhe mbrojtja e mjedisit të përbashkët dhe e atij të stërvitjes do të kenë përparësi në veprimtarinë ushtarake në kohë paqeje. Mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të qytetarëve, si dhe mbrojtja e natyrës do të kenë përparësi në kohë paqeje për të gjitha nivelet e komandimit në ushtri.

Çdo ushtarak duhet, që gjatë kohës së tij të punës apo shërbimit, të ndjejë e të mbajë përgjegjësi për ruajtjen e mjedisit dhe të sigurisë së tij. Në këtë kuptim, programet mësimore duhet të synojnë realizimin e idesë për një mjedis të gjelbër, i cili të karakterizohet nga një zhvillim i qëndrueshëm. Ato duhet të synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për të përmbushur nevojat e brezit të tanishëm, duke mos rrezikuar mundësitë e brezave të ardhshëm që do të angazhohen në shërbim të FA-ve.

Mjedisi sot është pjesë përbërëse e përgjegjësisë së drejtimit të çdo niveli komandimi në FA. Trupat ushtarake duhet të udhëzohen vazhdimisht për shfrytëzimin e natyrës, tokës, ujit dhe ajrit gjatë përmbushjes së detyrave të tyre mbrojtëse dhe të kërkojnë mbrojtjen e të gjithë sektorëve të mjedisit.

Detyra kryesore për mbrojtjen e mjedisit bie mbi komandantët dhe shtabet e kazermave dhe të poligoneve. Në poligonet shtetërore e me pjesëmarrje të mëdha trupash duhet shtuar bashkëpunimi i ngushtë i të gjithë komandantëve, shtabeve dhe trupave midis tyre, por edhe me autoritetet lokale. Kryerja e detyrës së mbrojtjes së mjedisit nga strukturat ushtarake mbështetet në masat dhe veprimet praktike të ndërmarra prej tyre, brenda hapësirave të kazermave apo në rrethinat e saj, si dhe në poligonet e rajonet e tyre të stërvitjes.

Ajo lidhet me bashkëveprimin e bashkërendimin e veprimtarisë së tyre ekologjike me organet e pushtetit lokal e rajonal, si dhe me ndërgjegjësimin e organizatave e shoqatave të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në rajonin e kryerjes së detyrës

Legjislacioni mjedisor, si dhe konceptet specifike të mbrojtjes së mjedisit në ushtri duhet të gjejnë zbatim në konceptet e pjesshme të sferës së organizimit e të zbatimit, në rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që udhëheqin veprimtarinë stërvitore dhe qitjet e ndryshme ushtarake.

Duke pasur një traditë në këtë drejtim nga FA, si dhe duke u mbështetur në përvojën e partnerëve tanë, mendojmë se duhen rishikuar dhe pasuruar të gjitha dokumentet që trajtojnë çështjet e mjedisit, në mënyrë të tillë që të përcaktohen qartë përgjegjësitë konkrete dhe ligjore gjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe qitjeve me trupa, në të gjithë hierarkinë e

komandimit. Mendoj se duhet të trajtohen konkretisht çështje që lidhen me veprimtarinë e FA-ve, si: rregullat e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në ushtri; rregullat e qarkullimit në kazerma e poligone; përdorimi i mjeteve lëvizëse e motorike të kontrolluara nga ana teknike; kujdesi dhe respektimi i tabelave që lajmërojnë rajone me kufizime zhurmash; kryerja e përpunimit dhe pastrimit kimik, vetëm në sheshe të caktuara të njohura më parë e që respektojnë kushtet e caktuara teknike; kujdesi nga derdhjet në tokë të karburanteve, vajrave dhe substancave të tjera të rrezikshme (acide,bateri etj.); kujdesi për veten dhe për shokun gjatë përdorimit të substancave me rrezikshmëri; përdorimi për grumbullimin dhe transportimin e plehrave dhe hedhurinave, vetëm i mjeteve të posaçme të caktuara për këtë qëllim; moshedhja e mbeturinave dhe substancave (lëngje e pluhura) të përdorura për pastrim në terrene të hapura apo në ujë; zvogëlimi i dëmtimeve në terrene të çfarëdoshme e sidomos në pyje; lajmërimi i strukturave më të specializuara për çdo terren të ndotur e të papastër, si dhe për dëmtime të tjera të bëra në mjediset e stërvitjes e deri te masat që merren me pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit gjatë stërvitjes(maskimi, transhetë, masat e mbrojtjes nga zjarri dhe trajtimin e mbeturinave të krijuara në fushën e stërvitjes apo gjatë zhvillimit të qitjeve).

Ministria e Mbrojtjes, në kuadër të masave për "Emergjencën Mjedisore", ka krijuar një përvojë dhe po bashkëpunon mjaft mirë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Pushtetit Lokal, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit civil në lidhje me problematikën e mjedisit. Në këtë aspekt, mendoj se bashkëpunimi duhet të shtrihet edhe në fushën e legjislacionit, manualeve mjedisore, STANAG-ve dhe shkëmbimit të informacionit, me qëllim përcaktimin sa më të qartë të masave të duhura në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit të përbashkët.

Mjedisi sot është një faktor shumë i rëndësishëm në kuadrin e sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale. Shkatërrimi i mjedisit është një nga elementët kryesorë të shpërbërjes globale, ndërsa ndërgjegjësimi i opinionit publik për këtë qëllim do të forconte sigurinë dhe integrimin e gjerë global. Kontributi në këtë formë apo në një tjetër është një mbështetje e drejtpërdrejtë dhe konkrete, për t'u siguruar brezave të sotëm dhe të ardhshëm një jetë në një mjedis të pastër, të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe gjithmonë e më të sigurt.

"Sa më shumë largoheshim, aq më e vogël bëhej, në fund u mblodh në madhësinë e një zari, sfera më e bukur që mund të imagjinohet "[2].

Si përfundim, në lidhje me raportin Mjedis-FA, dua të nënvizoj disa rekomandime konkrete. Një hap i parë dhe mjaft i rëndësishëm është njohja dhe menaxhimi i çdo situate dhe konkretisht, i asaj që lidhet me mjedisin tonë rrethues, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të situatës mjedisore, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës sonë dhe të brezave që pasojnë. Së dyti, në zbatim të ligjit për mjedisin, zhvillimi i konferencave (konventave), nxjerrja e akteve nënligjore, ratifikimi dhe zbatimi i STANAG-ve, përgatitja e rregulloreve dhe manualeve, si dhe trajtimi i çështjeve mjedisore në kurrikulat e arsimimit dhe të stërvitjes, duhet të përbëjnë një nga drejtimet e punës së Forcave të Armatosura për të qenë edhe më tutje në krye të kësaj fushate shumë të ndjeshme. Së treti, i gjithë legjislacioni në lidhje me politikat mjedisore, duhet të zhvillohet në përqasje me standardet e NATO-s dhe të BE-së, sepse ai duhet të mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian e më gjerë, si dhe të pasqyrojë përgjithësisht

[2] James Irwin, Astronauti i Misionit Apollo- kështu e përshkruan vështrimin mbi planetin tonë në vitin 1971.

kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është pale. E fundit, Forcat e Armatosura duhet të jenë bashkëpunuese dhe mbështetëse të komunitetit civil kurdoherë, në situata të shpallura si emergjencë mjedisore.

Bibliografia:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Leksione dhe Referenca për Mbrojtjen e Mjedisit në Shkollën e Oficerëve të FT-së të Drezdenit, Gjermani.
- Përmbledhje Aktesh Ndërkombëtare.
- Përmbledhje Aktesh Ligjore për Mjedisin në Shqipëri.
- Publikime për Njohjen e Kuadrit Ligjor për Mjedisin në Shqipëri.
- STANAG 7141 Edicioni 5**.** Doktrina e përbashkët për mbrojtjen e mjedisit gjatë aktiviteteve ushtarake të udhëhequra nga NATO.
- STANAG 2581 Edicioni 1**.** Standardet dhe normat e mbrojtjes së mjedisit për dislokimet ushtarake gjatë operacioneve të NATO-s.
- STANAG 2582 Edicioni 1**.** Praktikat më të mira në mbrojtjen e mjedisit për dislokimet ushtarake në operacionet e NATO-s.

RUBRIKA E TRETË

Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë

"Koncepti Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, si pjesë thelbësore e fuqizimit të shtetit", material i përgatitur nga ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës Agim Çeku, ka për objekt të tij trajtimin e çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përparësitë dhe masat për garantimin e sigurisë kombëtare. Çështjet e sigurisë, të trajtuara në kornizën e Projekt-Konceptit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, kanë të bëjnë, kryesisht, me planifikimin e politikave për periudhën 2011-2024, përparësitë, por edhe mundësitë financiare të shtetit të ri të Kosovës në përballimin e sfidave të reja, edhe në fushën e Mbrojtjes.

Një shkrim i sjellë nga Qendra e Doktrinës është ai mbi dukuritë bashkëkohore të konceptit "Task Force", të përdorimit të tij në veprimtarinë ushtarake të FA, në përgjithësi dhe të atyre shqiptare, në veçanti. Materiali parashtron disa ide e mendime mbi mënyrën e trajtimit të këtij koncepti në veprimtarinë e FA. Zhvillimi dhe ndërlikimi i kushteve të mjedisit të sigurisë përbën një ndër arsyet kryesore të nevojës së implementimit të këtij koncepti edhe në rastin e Forcave tona të Armatosura, tashmë në përpjekje të vazhdueshme për të rritur nivelin e tyre profesional në standardet e vendeve aleate.

Kolonel A.Pujo, zëvendëspërfaqësues ushtarak për operacionet në SHAPE, Mons, Belgjikë, sjell një përmbledhje për Forcën e Reagimit të NATO-s dhe rrugën që kanë ndjekur FA shqiptare për pjesëmarrje në të. Për herë të parë, FA shqiptare marrin pjesë aktive në Forcat e Reagimit të NATO-s (NRF), të vitit 2014, me një togë të Policisë Ushtarake. Tashmë, thotë autori, NRF po rikthehet në qendër të vëmendjes së Aleancës, si një "mekanizëm që transformon forcën". Nga përvoja e deritanishme e angazhimit të FA-ve shqiptare në këtë strukturë, kontributi i FA-ve shqiptare në NRF, si një përvojë e re, sipas autorit, ka nevojë të jetë më i studiuar, më i planëzuar, për një periudhë më afatgjatë dhe i materializuar në një dokument më vete.

Historia e vjetër, por edhe ajo e re e Rusisë dhe Ukrainës, marrëdhëniet mes tyre ndër vite, veçanërisht ajo e kohëve të fundit, është në themel të shkrimit të Enkelejda Malaj. Përpos një vështrimi të shkurtër historik mbi rolin e Rusisë në marrëdhëniet rajonale, por edhe më gjerë, në sferën ndërkombëtare, në material vlerësohen gjithë përpjekjet e saj për rigjetjen e vetes në krye të një "perandorie" të re e në përballje me pjesën demokratike të botës së sotme. Edhe përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar janë pjesë e qenësishme e shkrimit në fjalë, por ndërkaq analizohen me kujdes ndikimet që këto mund të kenë në zhvillimet e ardhshme botërore.

Nënkolonel Ali Mali, në trajtimin e temës merr shkas nga nevoja për të rikonceptuar, në kushtet e sotme, të një mjedisi strategjik të ndryshuar, termin "Siguri Kombëtare". Në këtë kontekst, trajtimi i çështjeve të tilla si ai i natyrës së rreziqeve në kohën e sotme, në mjaft raste edhe jo ushtarake, sjellja e mjedisit ushtarak, veçanërisht e atij intelektual ndaj dukurive të reja në këtë fushë, përballja me sfidat e kësaj natyre, etj., përbëjnë, sipas autorit, disa çështje të rëndësishme që duhen mbajtur në konsideratë e trajtuar hollësisht.

Koncepti Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës si pjesë thelbësore e fuqizimit të shtetit

Agim Çeku
Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës

Trajtesë e shkurtuar. *Projekt-Koncepti i Mbrojtjes së Republikës se Kosovës është dokument planifikimi i politikave për periudhën 2014-2024, që përshkruan parimet themelore strategjike të mbrojtjes kombëtare, prioritetet dhe masat për sigurimin e mbrojtjes kombëtare. Projekt-Koncepti i Mbrojtjes së Kosovës ofron udhëzime për kohë paqeje dhe në raste kur kërcënohet siguria kombëtare.*

Projekt-Koncepti i Mbrojtjes së Kosovës është i bazuar në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë i cili ka filluar që në mars 2012 dhe është finalizuar në mars 2014. Është përgatitur në bazë të situatës gjeopolitike të Kosovës, të sigurisë, interesave dhe objektivave nacionale, të politikës së jashtme, objektivave dhe prezencës ndërkombëtare në vend.

Projekt-Koncepti i Mbrojtjes siguron bazën për planifikimin e aktiviteteve të mbrojtjes kombëtare. I specifikon burimet e veçanta, të nevojshme për zbatimin e saj, zhvillimin e Forcave të Armatosura të Kosovës (FAK), nivelin e kërkuar te gatishmërisë dhe veprimin e shtetit dhe autoriteteve lokale, subjekteve individuale dhe ligjore gjatë kohës së paqes dhe në raste kur kërcënohet siguria kombëtare.

Duke marrë parasysh situatën ekonomike, zbatimin e veprimtarive të mbrojtjes kombëtare dhe përmbushjen e funksioneve e detyrave të përcaktuara ligjërisht për FAK, duhet siguruar që zbatimi të bëhet në përputhje me burimet e disponueshme.

Ky koncept-dokument është ende i paautorizuar dhe i padiskutuar deri më tani në institucionet e Kosovës, i cili paraqet përmbledhje të mendimeve, përvojave, praktikave dhe mësimeve të nxjerra. Po ashtu paraqet përmbledhje të analizave, të gjeturave dhe rekomandimeve të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes.

Mjedisi Strategjik i Sigurisë

Mjedisi global i sigurisë

Kërcënimet konvencionale të luftës shteti kundër shtetit janë zvogëluar në masë të konsiderueshme në shekullin XXI. Në ditët e sotme, mjedisi i sigurisë globale është bërë më i paparashikueshëm dhe më sfidues. Në një botë të ndërvarur, Kosova përballet me rreziqe të ngjashme si shumë vende të tjera: rreziqet dhe kërcënimet

që dalin nga pabarazia ekonomike; aktivitetet terroriste; krimet ndërshtetërore; armët bërthamore dhe të shkatërrimit në masë; përhapja e armëve të vogla; krimit të organizuar, përfshirë trafikimin dhe krimit kibernetik.

Mjedisi rajonal i sigurisë

Kosova dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor kanë një mjedis të sigurisë shumë më të favorshëm se sa pesë vjet më parë. Rajoni ynë tani përbëhet nga vendet aleate dhe shtetet, të cilat janë ose aspirojnë të jenë anëtarë të BE-së dhe NATO-s. Bashkëpunimi rajonal pritet që gjithnjë e më shumë të zgjerohet dhe në vend të rreziqeve konvencionale, sfidat dhe kërcënimet me të cilat po përballet rajoni në ditët e sotme janë si në vijim: përhapja e armëve të vogla; ekstremizmi etnik dhe fetar; krimi i organizuar, përfshirë trafikimin; krimet ekonomike; armët e përhapjes së shkatërrimit në masë; paqëndrueshmërinë politike rajonale; epidemitë dhe fatkeqësitë natyrore.

Mjedisi i brendshëm i sigurisë

Për arsye të marrëveshjes së arritur mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, mjedisi i sigurisë në Kosovë ka përparuar më shumë pas vitit 2013. Nga ana tjetër, në një botë që është vazhdimisht globalizuese, Kosova nuk është imune nga rreziqet dhe kërcënimet që lidhen me këtë dukuri. Bazuar në kontekstin aktual strategjik, rreziqet e brendshme të identifikuara janë: ekstremizmi etnik dhe fetar; terrorizmi; fatkeqësitë natyrore; UXO / IED; përhapja e armëve të vogla; krimi i organizuar; mungesa e zhvillimi ekonomik; papunësia; institucionet e dobëta të sigurisë / drejtësisë; korrupsioni; kontestet rreth përcaktimit te kufirit; dhe keqpërdorimi i burimeve natyrore.

Interesat dhe objektivat e sigurisë kombëtare

Interesat dhe objektivat e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës janë pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial; rendi kushtetues; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës; stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Interesat dhe objektivat e sigurisë kombëtare formojnë bazat për misionin dhe detyrat aktuale dhe të ardhshme të institucioneve në përgjithësi, si dhe institucioneve të sigurisë në veçanti. Interesat dhe objektivat e sigurisë kombëtare kategorizohen në këtë mënyrë:

1. Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial
   - 1.1. Ruajtja dhe mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial
   - 1.2. Përdorimi i mjeteve diplomatike në interes të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës
   - 1.3. Zhvillimi i kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes
   - 1.4. Menaxhimi i integruar dhe kontrolli i kufijve shtetëror

2. Rendi kushtetues
   - 2.1. Ruajtja dhe fuqizimi i sundimit të rendit dhe ligjit në tërë vendin
   - 2.2. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtim më standardet dhe normat ndërkombëtare
   - 2.3. Sigurimi i një sistemi gjyqësor të unifikuar dhe të pavarur

3. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik
   - 3.1. Zhvillimi i politikave për një treg të lire dhe ekonomi të qëndrueshme

3.2. Një mjedis të qëndrueshëm për investimet e huaja dhe investimet vendore

4. Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe ndërkombëtar

5. Jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës
   5.1. Mbrojtja e jetës dhe pronës
   5.2. Ngritja e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët
   5.3. Garantimi i sigurisë së gjithëmbarshme të qytetarëve

6. Stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare
   6.1. Integrimi dhe bashkëpunimi me strukturat e Bashkimit Evropian dhe Aleancën Euroatlantike
   6.2. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare
   6.3. Pjesëmarrje aktive në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtar
   6.4. Promovimi i Kosovës jashtë vendit

Parimi strategjik dhe detyrat kryesore të mbrojtjes kombëtare

Parimi themelor strategjik i mbrojtjes kombëtare është që të minimizohet mundësia e rreziqeve për sigurinë kombëtare. Duke vazhduar së përmirësuari dhe modernizuari kapacitetet e mbrojtjes kombëtare dhe duke kontribuar në sigurinë ndërkombëtare, si në planin dypalësh dhe shumëpalësh, Kosova zvogëlon rrezikun e agresionit të jashtëm ushtarak apo një shpërthim të kërcënimeve të tjera kombëtare dhe, nëse është e nevojshme, është e gatshme të sigurojë masa sprapsjeje efektive.

Kapaciteti i mbrojtjes kombëtare qëndron mbi planifikimin koherent, udhëheqjen e koordinuar politike, bashkëpunimin midis autoriteteve shtetërore, lokale, Forcave të Armatosura të Kosovës dhe shoqërisë në përgjithësi. Kjo është një parakusht i rëndësishëm për parandalimin dhe mposhtjen e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasojave.

Për të qenë në gjendje për t'iu përgjigjur sfidave tradicionale dhe të tjera të sigurisë, një përgjigje e shpejtë në fazat e hershme duhet të jetë e garantuar: FAK së bashku me institucionet e tjera shtetërore, qeveritë lokale dhe shoqëria duhet t'i kryejnë aktivitetet e mbrojtjes, për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Kjo kërkon një ndërgjegjësim të menjëhershëm të situatës, vendimmarrje të shpejtë dhe një qasje gjithëpërfshirëse; pra, përdorimi i burimeve ushtarake dhe civile. Në rast të një kërcënimi ndaj sigurisë kombëtare, detyrat e mbrojtjes kombëtare janë që të zbatohen udhëzimet e udhëheqjes politike kombëtare dhe aftësitë e mëposhtme, të garantuara nga Forcat e Armatosura të Kosovës:

- një sistem paralajmërues;
- një kombinim i ushtarakëve dhe jo ushtarakëve, d.m.th. masa parandaluese (masat politike, ekonomike, diplomatike dhe të sigurisë) jo luftarake;
- aftësitë e vetëmbrojtjes; dhe
- një sistem mbështetës i vendit pritës për ardhjen e shpejtë dhe vendosjen e forcave aleate.

Po ashtu, siguria dhe mbrojtja kombëtare janë të lidhura ngushtë me ndjenjën e përgjegjësisë dhe besnikërinë e shoqërisë civile në Republikën e Kosovës. Detyra shoqërore dhe patriotizmi janë faktorë të rëndësishëm që forcojnë sigurinë dhe shtetësinë e Kosovës. Prandaj, gjatë zbatimit të politikës së mbrojtjes kombëtare, dialogu në mes Forcave të

Armatosura të Kosovës dhe shoqërisë është vazhdimisht duke u inkurajuar, duke siguruar publikun dhe të rinjtë me arsimim patriotik dhe rritjen e njohurive në çështjet e mbrojtjes kombëtare, si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit civil dhe ndjenjën e krenarisë dhe besnikërisë.

Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes kombëtare

Forcat e Armatosura të Kosovës të përgatitura në mënyrë profesionale dhe të trajnuara në mënyrë shumë funksionale. Baza për mbrojtjen kombëtare është Forca e Armatosur e Kosovës, e cila është duke u zhvilluar si një aset aktiv i mbrojtjes kombëtare e trajnuar dhe e pajisur tërësisht në mënyrë profesionale.

Misioni i Forcave të Armatosura të Kosovës është që të jenë të gatshme dhe të afta për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial dhe për të mbrojtur qytetarët, pronat e tyre, dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe global.

Detyrat thelbësore të Forcave të Armatosura të Kosovës janë:

- të mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës;
- t'iu sigurojnë mbështetje autoriteteve civile;
- t'iu sigurojnë mbështetje komuniteteve; dhe
- të marrin pjesë në operacione ndërkombëtare në mbështetje të paqes.

Forcat e Armatosura të Kosovës përbëhen nga: Forca Tokësore, Komanda e Gardës Kombëtare, Komanda e Logjistikës dhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës. FAK përbëhet nga 5 000 pjesëtarë aktiv dhe 3 000 pjesëtarë rezervë.

Forcat e Armatosura të Kosovës janë të gatshme të ofrojnë në mënyrë efektive aftësitë e mëposhtme operative:

- për t'u angazhuar në detyrat e parandalimit të kërcënimit si brenda Kosovës dhe jashtë saj;
- për të vepruar në formacione ushtarake shumëkombëshe dhe për të siguruar ndërveprueshmëri me repartet ushtarake të NATO-s, BE-së dhe OKB-së;
- për t'u përshtatur ndaj kërcënimeve të ndryshme në situata të konfliktit; dhe
- për të kryer operacione në mjedise armiqësore operative dhe kushte ekstreme; për shembull, që vepron nën kushtet e kërcënimeve toksike dhe përdorimit të mjeteve të improvizuara shpërthyese.

*Prioritet është zhvillimi i aftësive të mbrojtjes p*ër *Forcat Tokësore.* Duke marrë parasysh nevojat kombëtare dhe të mbrojtjes kolektive, si dhe burimet në dispozicion (personeli, financat etj.) për zbatimin e mbrojtjes kombëtare, zhvillimi i komponentit të Forcave Tokësore është thelbi i aftësive të FAK dhe prioritet kyç për FAK. Zhvillimi i aftësive të tjera është i lidhur ngushtë me mbështetje për operacionet tokësore dhe ndërtimin e aftësive mbështetëse të vendit pritës.

Komanda efikase dhe e sigurt e kontrollit dhe komunikimit. Në mbështetje të detyrave të mbrojtjes kombëtare, një aftësi strategjike dhe operacionale duhet të jetë në vend për njohuri të situatës në mënyrë të shpejtë, së bashku me komandën dhe kontrollin e sistemit efektiv dhe të sigurt duke i lejuar të përshtaten me sfidat e sigurisë se sotme, duke përfshirë edhe sulmet kibernetike.

Një qasje gjithëpërfshirëse për të ofruar aftësitë mbështetëse të vendit pritës. FAK sigu-

ron mbështetjen e vendit pritës në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera shtetërore, qeveritë lokale dhe shoqërinë, si dhe në bashkëpunim të koordinuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, aleatët e tjerë dhe autoritetet e KFOR-it. Sa për përmbushjen e kësaj detyre dhe ekzekutimin e operacioneve përkatëse, është e rëndësishme të vihet në dispozicion infrastruktura e nevojshme, duke përfshirë aviacionin civil dhe infrastrukturën e transportit tokësor, si dhe angazhimin e duhur të qeverive lokale. Zhvillimi i aftësive mbështetëse të vendit pritës përforcohet në thelb me trajnime të përbashkëta ushtarake të forcave aleate dhe FAK, si dhe nga përdorimi i infrastrukturës ushtarake të Kosovës nga aleatët për nevojat e tyre në kohë paqeje.

Kalimi nga bashkëpunimi në integrim me forcat ushtarake të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Integrimi ushtarak i vendeve të Ballkanit Perëndimor bën të mundur zhvillimin e aftësive të përbashkëta ushtarake që Kosova nuk do të jetë në gjendje për t'i zhvilluar e vetme. Për të nxitur integrimin ushtarake të vendeve të Ballkanit Perëndimor, është e rëndësishme të forcohet bashkëpunimi në fusha të tilla si: planifikimin e mbrojtjes, trajnimeve, blerjeve ushtarake dhe zhvillimin e njësive të përbashkëta mbështetëse.

Aftësitë e përgjithshme të FAK. FAK zhvillon të njëjtën aftësi për detyra të mbrojtjes kombëtare dhe për nevojat e operacioneve ndërkombëtare paqeruajtëse. Zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes së FAK është në harmoni me udhëzimet te NATO-s për zhvillimin e aftësive ushtarake.

Qëndrueshmëria dhe bilanci i strukturës së FAK. FAK siguron ruajtjen e një strukture që kryesisht siguron përmbushjen e detyrave të mbrojtjes. Është e nevojshme të mbahet një sistem fleksibël dhe modern i rekrutimit. Prandaj është e rëndësishme të zhvillohet Garda e Rinisë duke përdorur ndihmën e FAK, forcat e rregullta dhe njësitet e Gardës Kombëtare. Duke promovuar qëndrueshmërinë dhe kapacitetet e strukturës së FAK, kjo e fundit siguron karrierë efektive të personelit dhe sistemit të zhvillimit profesional, i cili do të shkojë në drejtim të:

- sigurimit të konkurrencës së shërbimit ushtarak me tregun e punës;
- ngritjes profesionale dhe përmirësimit të aftësive mbrojtëse të ushtarëve dhe Gardës Kombëtare duke rritur aftësisë e shërbimit ushtarak dhe pjesëmarrjen në ushtrime taktike.

Projektet e prokurimit dhe të logjistikës janë të sinkronizuara me prioritetet e zhvillimit të aftësive të mbrojtjes. Duke marrë parasysh burimet në dispozicion, blerjen e pajisjeve moderne, mjetet e transportit, sistemet e armëve, si dhe teknologjinë moderne duhet të kemi synimin e zhvillimit të aftësive mbrojtëse të FAK. Në mbështetje të njësive të FAK për dislokim, mirëmbajtje dhe procesin e trajnimit, është e nevojshme të zhvillohet një infrastrukturë shumë funksionale që do të jetë e përshtatshme si për nevoja të Forcave të Armatosura të Kosovës, po ashtu edhe të vendeve aleate. Projektet e prokurimit dhe të logjistikës japin mbështetjen maksimale për zhvillimin e komponentit të Forcave Tokësore.

Zhvillimi i Gardës Kombëtare për qëllim forcimin e aftësive operacionale të FAK. Garda Kombëtare është pjesë e FAK dhe qëllimi i saj kryesor është që të përfshijë qytetarët e Kosovës në mbrojtjen kombëtare, duke siguruar kështu një lidhje në mes të Forcave të Armatosura dhe shoqërisë. Garda Kombëtare shërben si bazë kryesore rezervë e FAK që është duke u zhvilluar nga ushtarë rezervë dhe rezervistë dhe përfshirjen e tyre në vetëmbrojtje publike.

Brenda sistemit kombëtar të mbrojtjes së Gardës Kombëtare kryhen këto detyra:

- EOD, HAZMAT, kërkim-shpëtim, dhe operacionet e inxhinierisë civile;
- ndihmon autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera të emergjencave;
- të sigurojë trajnim të Gardës Rinore;
- të mobilizojë rezervën aktive;
- të sigurojë mbështetje për njësitë e tjera të FAK duke ruajtur aftësitë e nevojshme të specializuara dhe sigurimin e mbështetjes së vendit mikpritës; dhe
- të sigurojë integrimin e plotë dhe ndërveprimin me njësi të tjera të FAK, duke ndërtuar një bashkëpunim shumë të ngushtë në trajnim dhe ushtrim me Forcat Tokësore.

Mbështetja e FAK ndaj institucioneve tjera brenda aftësive ushtarake në dispozicion. FAK ofron mbështetje institucioneve të tjera shtetërore, qeverive lokale dhe shoqërisë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret, duke përdorur aftësitë ushtarake në dispozicion. FAK siguron mbështetje për Policinë e Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, si dhe për institucionet tjera, përfshirë KFOR-in, në rastet e mëposhtme:

- Burimet në dispozicion të këtyre institucioneve nuk janë të mjaftueshme për zbatimin e masave emergjente të nevojshme për menaxhimin e krizës.
- Përfshirja e Forcave të Armatosura të Kosovës, konsiderueshëm përshpejton zbatimin e masave emergjente.
- Specializimet e veçanta (të tilla si pastrimin e minave dhe mjeteve shpërthyese) në dispozicion të Forcave të Armatosura të Kosovës konsiderohen të nevojshme.

Sistemi efektiv dhe fleksibël i mobilizimit të rezervës. Sistemi i mobilizimi të rezervës i plotëson kushtet e mëposhtme:

- të aftë të mbështesin në mënyrë efektive detyrat e mbrojtjes kombëtare;
- të përshtatshëm sipas nivelit të kërcënimit, në mënyrë që kontributi i bërë të jetë i përshtatshëm për zbatimin e detyrave të Forcave të Armatosura të Kosovës;
- në një situatë krize, burimet e mobilizimit (sidomos të burimeve materiale dhe teknike) janë përdorura në mënyrë të koordinuar dhe efektive, duke përfshirë disponueshmërinë e burimeve të nevojshme civile.

Përsa i përket burimeve njerëzore, sistemi i mobilizimit të rezervës është formuar nga Garda Kombëtare dhe Rezerva Aktive. Detyrat më të rëndësishme për zhvillimin e sistemit rezervë janë sigurimi i aftësive të ushtarëve rezervë dhe ruajtja e aftësive të tyre ushtarake.

Kontributi për sigurinë ndërkombëtare

Kontributi i madh i Kosovës për sigurinë ndërkombëtare është reduktimi ose shmangja e mundësive të konflikteve të armatosura. Në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare, Kosova po forcon marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe me aleatët e saj dhe me vendet tjera partnere. Kosova kontribuon në promovimin e sigurisë ndërkombëtare dhe në stabilitetin, besimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacionit. Pjesëmarrja e Kosovës në operacionet ndërkombëtare lejon përfshirjen më të madhe në proceset politike globale, siguron kontributin e Kosovës për sigurinë ndërkombëtare, dhe krijon kushte të favorshme për arritjen e synimeve strategjike kombëtare të Kosovës, që janë integrimet në strukturat euroatlantike.

Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare

Ndërtimi i përvojës dhe gatishmërisë se të gjitha njësive të FAK . Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare siguron Kosovën me rritje të vazhdueshme të profesionalizmit të FAK që është thelbësore për forcat e armatosura që janë të ndërtuara në mënyrë profesionale. Me qëllim të promovimit të balancuar të përvojës operacionale dhe rritjen e aftësive profesionale, është e rëndësishme që shumica e njësive të rregullta të trajnohen për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare.

FAK është në gjendje të marrë pjesë në të njëjtën kohë në disa operacione. Duke marrë parasysh burimet e disponueshme financiare dhe njerëzore, ushtarë dhe ekspertë civilë te Kosovës mund të përfshihen ne operacione të tjera ndërkombëtare të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, dhe OKB-ja.

FAK është në gjendje të vetëqëndrojë në operacione në zonat gjeografikisht të largëta. FAK në bashkëpunim me aleatët e saj duhet të jenë të përgatitur për të marrë pjesë në operacionet ndërkombëtare në vende gjeografikisht të largëta që dallojnë nga Kosova për nga klima, aspektet socio- politike, ekonomike dhe kulturore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) janë dhe do të mbeten partneri kryesor strategjik i Kosovës në fushën e çështjeve ushtarake dhe të mbrojtjes. Është e rëndësishme që Kosova të vazhdojë dhe të thellojë bashkëpunimin praktik me SHBA-në. Ky bashkëpunim përforcohet me pjesëmarrjen e përbashkët në trajnime ushtarake dhe operacionet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ushtarak me vendet e Ballkanit Perëndimor luan një rol të rëndësishëm unifikues duke marrë parasysh lidhjet tradicionale, kulturore dhe rajonale. Kjo është në kuadër të interesave të Kosovës për të nxitur bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke promovuar unitetin e tyre në aspektin e sigurisë dhe politikën e mbrojtjes, si dhe thellimin e bashkëpunimit të forcave të tyre të armatosura. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara dhe kufizimet buxhetore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Kosova promovon bashkimin dhe ndarjen e aftësive ushtarake të vendeve të rajonit që është zgjidhja më efektive për ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive ushtarake.

Bashkëpunim aktiv me vendet e BE-së dhe NATO-së që janë të interesuara në forcimin e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kosova promovon bashkëpunimin aktiv me vendet e BE-së dhe NATO-s në mënyrë që të sigurohet stabilitet afatgjatë i sigurisë dhe paqes në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Promovimi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë është një aspekt i sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo është në kuadër të interesave të Kosovës për të promovuar parimin e hapjes dhe besimit të ndërsjellë në dialogun me Serbinë.

Planifikimi i mbrojtjes kombëtare

Zhvillimi dhe sistemi i planifikimit operativ të FAK

Zhvillimi i FAK është paraparë të kalojë nëpër tri faza (2014-2024):

Faza I: 2014-2016

Faza I parasheh zhvillimin dhe përfundimin e nevojshëm kushtetues, legjislative, doktrinar

dhe konceptual për Forcat e Armatosura të Kosovës. Kjo fazë përqendrohet në trajnimin, zhvillimin e doktrinës operacionale dhe taktike, profesionalizmin, ndërtimin e institucioneve dhe personelin, blerje materiale; të gjitha me një fokus primar në mbrojtje të vendit. Rolet dhe misionet për t'iu përgjigjur emergjencave në nivel kombëtar do të vazhdojë të zhvillohet dhe të mirëmbahet nga FAK derisa ato të transferohen në institucione tjera relevante. Kjo fazë, gjithashtu, parasheh që Forcat e Armatosura të Kosovës të vazhdojnë rritjen e bashkëpunimit ushtarak me vendet aleate me qëllim të trajnimit për të fituar aftësi për të marrë pjesë në mënyrë efikase në operacione të përbashkëta me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë por jo kufizuar me organizatat e BE-s, NATO-s, OSBE-s dhe OKB-s.

Faza II: 2017-2019

Faza II vendos theks të veçantë në zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; blerjen e pajisjeve esenciale të nevojshme individuale dhe kolektive; dhe fillimin e krijimit të shkathtësive shtesë dhe kapaciteteve operacionale të nevojshme për forcë të re për ta mbështetur misionin kushtetues. Disa shkathtësi të arritura po ashtu mund t'i nënshtrohen ngritjes dhe përsosjes së mëtutjeshme dhe kjo i referohet në veçanti kapaciteteve nën mandatin momental, dhe nevojën për të vazhduar zhvillimin e tyre.

Faza III: 2020-2024

Faza III do të shënojë fundin e përpjekjeve për zhvillimin e forcës sonë. Gjatë Fazës së III-të secila nga komandat kryesore do të arrijnë plotësimin e tërësishëm të personelit dhe pajisjeve të saja. Për më shumë, komandat kryesore do të arrijnë kompetenca në misionet e tyre të caktuara dhe kështu do ta përmbushin planin afatgjatë të zhvillimit.

Për planifikimin dhe zhvillimin e FAK, udhëzimet e konceptit janë:

- Zhvillimi i FAK është planifikuar në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, duke u bazuar në analizën ushtarake të kërcënimit, studimin operacional dhe në përputhje me Ligjin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Për të siguruar një operacionalitet afatgjatë dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, në bazë të vlerësimit të aftësive operacionale, do të përgatitet një plan zhvillimi për FAK, i cili ka për qëllim balancimin e nevojave dhe burimeve të FAK. Plani i zhvillimit të FAK dhe ky koncept dokument janë bazë për dokumentet planifikuese;
- Procesi i planifikimit të zhvillimit të FAK duhet të sigurojë vazhdimësinë e zbatimit të konceptit. Në kuadër të këtij procesi është e rëndësishme të identifikohen aftësitë thelbësore të FAK për përmbushjen e detyrave kryesore të mbrojtjes kombëtare.

Udhëhequr nga Koncepti i Mbrojtjes së Kosovës dhe Analiza e Kërcënimeve, Plani Shtetëror i Mbrojtjes specifikon aktivitetet e mbrojtjes kombëtare, dhe specifikon prioritetet dhe burimet e nevojshme dhe identifikon nivelin e nevojshëm të gatishmërisë dhe përgjegjësitë e institucioneve, subjekteve individuale ose juridike të përfshirë në sigurimin e mbrojtjes kombëtare. Ky koncept, Analiza Kërcënimeve, dhe Plani Shtetëror i Mbrojtjes janë bazë për udhëzimet e ministrit të Mbrojtjes në përmbushjen e detyrave të FAK dhe supozimet e planifikimit operacional për hartimin e Planit Operativ Shtetëror të Mbrojtjes.

*"Task Force" - Një koncept pragmatist, po aq edhe modern**

Trajtesë e shkurtuar. *E njohim të gjithë fjalën e urtë "bashkimi bën fuqinë". E vërtetuar prej shekujsh e shekujsh në përvojën botërore, edhe sot ndjehet po aq komode, ndërsa përdoret me vend në mjedisin intelektual, përfshi edhe atë ushtarak. E vërtetuar kjo, tashmë, edhe në mjaft koncepte e praktika ushtarake të zbatuara, si përqendrimi i forcave e i mjeteve, i përpjekjeve, i grushtit kryesor e të tjera si këto. Në këtë hulli duket se vjen edhe koncepti më i ri në përdorimin e forcave e të mjeteve për qëllime ushtarake, në interes të realizimit të një misioni konkret.*

Lindur si nevojë për të realizuar me sukses misione e objektiva ushtarake, shprehja e këtij koncepti mishëron në vetvete, ndër të tjera, racionalitetin në përdorimin e forcave, të trupave e mjeteve në veprimtari të mirëfillta ushtarake, pjesëmarrjen e trupave vërtet cilësore e profesioniste në raste të tilla. Në ditët e sotme, ndërsa diapazoni i veprimtarive ushtarake vlerësohet mjaft i gjerë dhe kompleks, përdorimi me nikoqirllëk dhe efektshmëri i trupave në to përbën njëherësh nevojë dhe domosdoshmëri. Në kuptimin më të thjeshtë, koncepti "Task Force" është një grupim i caktuar ushtarakësh apo trupash, të nxjerrë prej një apo më shumë lloje forcash, i krijuar rishtas, me një komandë të re, për të kryer një mision të caktuar ushtarak, në vend e kohë të përimtuar e në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës, vendas apo ndërkombëtar. Duhet theksuar që një strukturë e tillë është e përkohshme.

Në thelb, "Task Force" vlerësohet si një strukturë ushtarake, që krijohet rishtas nga lloje të ndryshme të trupave apo edhe të dy e më shumë forcave, në sasinë dhe cilësinë e kërkuar, për të realizuar një mision në kohën më të shkurtër të mundshme dhe me humbje sa më të vogla. Kur një strukturë e tillë e përkohshme ushtarake krijohet nga trupa të një lloji force, në këtë rast, ajo është strukturë e nivelit taktik, ndërkaq edhe kryen, përgjithësisht, detyra ushtarake të këtij niveli (TF). E krijuar nga trupa të dy a më shumë llojeve të forcave dhe në varësi të misionit që i ngarkohet të realizojë, ajo mund të vlerësohet e nivelit operativ. Ndërkaq, mund të realizojë detyra të këtij niveli, por edhe të atij strategjik (JTF). Në rastin e strukturave analoge, të krijuara rishtas, në kuadrin e NATO-s, OKB-së etj., misioni përmbledh në vetvete kryerjen e detyrave të tilla, që, për nga përmasat e efektit që krijojnë në përfundim të operacionit ushtarak, sjellin ndryshime cilësore në raportin e forcave, në krijimin e kushteve të favorshme njësive të mëdha të realizojnë shpejt e me humbje minimale misionin e tyre, por edhe që u bëjnë të pamundur trupave të kundërshtarit vijimin e plotësimit të misionit të tyre (JCTF).

Me ç'duket, ky koncept i ri lindi si nevojë dhe domosdoshmëri në kushtet e ndërlikimit të mjedisit të betejave e të Luftës, të asimetrisë së krijuar në kushtet e veprimeve

* Ky material u përgatit për Revistën Ushtarake në Qendrën e Doktrinës.

bashkëkohore në veprimtaritë ushtarake etj. Nevoja për një koncept të tillë u diktua edhe nga situata, përherë në ndryshim, e sigurisë në Evropë e në botë, por dhe nga lindja e situatave të paparashikueshme, të shumëllojshme e të rrezikshme për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar.

Krijimi i strukturave të tilla ushtarake, së pari, nënkupton transferimin e autoritetit të komandimit në një komandë tjetër, tashmë të re. E gjithë veprimtaria e elementeve, që e përbëjnë një strukturë Task Force, tash e prapa drejtohet e komandohet nga një celulë e re komandimi. Në rastin më të mirë boshtin e një celule të tillë komandimi e përbëjnë elemente të drejtimit të FT (TF). Në nivelin operativ të drejtimit, një celulë e tillë krijohet mbi bazën e elementeve të drejtimit të llojit të Forcës, në juridiksionin e së cilës do të kryhet operacioni i ardhshëm (JTF).

Veprimtaritë kryesore ushtarake të FA

Forcat e Armatosura veprojnë në bazë të vendimeve të parlamentit në përdorimin e forcave ushtarake, duke përfshirë edhe kufizimet e menduara në veprimtaritë e tyre. Sipas kornizës kushtetuese, forcat ushtarake, në kushte të përcaktuara brenda objektivave dhe kufijve ligjorë, përdoren në kohë paqeje, krize dhe konflikti, brenda ose jashtë vendit. Por le të trajtojmë ndërkaq disa ndër operacionet më të spikatura ku mund të përfshihen FA në spektrin mjaft të zgjeruar e të ndryshuar të konflikteve në ditët e sotme.

Përgjithësisht, këta lloj operacionesh konsistojnë në *operacione të përbashkët*, shumëkombësh apo edhe operacione që kryhen nga një komponent i vetëm i FA. Ata mund të jenë edhe një ndërthurje e mundshme e këtyre kategorive, por që, në asnjë rast, nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Në kontekstin ushtarak, *operacione të përbashkët* (*JTF*) janë ata operacione, në të cilët marrin pjesë elemente të dy a më shumë komponentëve të dy a më shumë llojeve të forcave.

Operacione shumëkombëshe (*CJTF*) janë operacionet që përfshijnë lloje forcash të dy a më shumë shteteve, që veprojnë së bashku për të përmbushur një mision të caktuar. Operacionet e Aleancës së Atlantikut Verior, ata të një koalicioni dhe operacionet e mandatuara nga Kombet e Bashkuara, zakonisht, janë operacione shumëkombësh. Shtetet që marrin pjesë në operacione të tillë kontribuojnë me forca e mjete, në përbërje të komponentëve operacionalë dhe të shtabeve shumëkombësh, sipas marrëveshjeve të Aleancës apo marrëveshjeve ndërmjet shteteve kontribuuese me trupa.

Operacione të një komponenti janë ata operacione që planëzohen, ndërmerren e kryhen nga trupa të vetëm një lloj force. Në materialin e paraqitur nga Qendra e Doktrinës vlerësohet se, për kryerjen e operacioneve të sotëm, zakonisht, krijohet një strukturë operative ose forcë për detyrë (*task force*), që është një grupim i përkohshëm i njësive, reparteve, nënreparteve, nën komandën e një komandanti, për të realizuar një mision të caktuar. Termi forcë operative (*task force)* është i përgjithshëm dhe përdoret për të treguar një forcë me madhësi e përbërje të ndryshme, që nga nënreparti deri të njësitë e mëdha e që mund të përdoret në të gjithë spektrin e operacioneve dhe në çdo nivel të luftës. Çdo formacion që krijohet rishtas për të kryer një operacion ushtarak, pavarësisht nga madhësia, vlerësohet forcë operative ose forcë për detyrë (*task force*). Një forcë operative është

përherë një rendim i posaçëm, për një mision të veçantë. Ajo mund të përmbajë elemente të një a më shumë komponentëve. Kur në përbërje të forcës operative ka elemente të dy a më shumë komponentëve a llojeve të forcave, ajo konsiderohet forcë operative e përbashkët (JTF). Ndërsa një forcë e tillë, e krijuar me trupa nga dy a më shumë shtete, quhet forcë operative e përbashkët shumëkombëshe (JCTF).

Operacionet e përbashkëta

Operacionet e përbashkët janë operacione të integruara, ku marrin pjesë trupa, të paktën të dy llojeve të forcave. Në parim, në kushtet tona, të gjithë operacionet ushtarake do të kryhen me pjesëmarrjen e përbashkët të llojeve të trupave të FT dhe FAj. Në të tjera raste, në ta mund të përfshihen edhe trupa të FD. Bashkëveprimi mes llojeve të forcave në një operacion të përbashkët merr përparësi, veçanërisht në nivelin operativ. Pikërisht, në këta raste, komandanti i operacionit planëzon e bashkërendon veprimet e të gjithë elementeve pjesëmarrës të llojeve të forcave. Suksesi ushtarak në operacionet e sotme mbështetet në përpjekjen e përbashkët, zakonisht nën një strukturë komandimi të unifikuar. Një operacion i përbashkët i suksesshëm kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, për të rritur në maksimum efektin e përgjithshëm operacional të forcës së përbashkët, duke implementuar përdorimin më të mirë të spektrit të plotë të kapaciteteve zotëruese.

Komandanti i operacionit të përbashkët është "i dënuar" të sinkronizojë të gjithë veprimet e komponentëve përbërës, për të arritur një objektiv operativ a strategjik, kryesisht përmes përdorimit me frytshmëri të të gjithë elementeve të fuqisë luftarake që ka në dispozicion por edhe të integrimit më të mirë të mundshëm të betejave. Në këtë mënyrë, sigurohet rritja e efektshmërisë së përgjithshme të forcës së përbashkët, pa i angazhuar në operacion a betejë të gjitha forcat në mënyrë të barabartë, por në përshtatje me drejtimet, objektivat dhe mundësitë e tyre luftarake. Komandantit të forcës së përbashkët, brenda kufizimeve detyruese të direktivës së marrë apo urdhrit të operacionit, duhet t'i mundësohet akses për të përdorur lirinë më të madhe të mundshme në planëzimin dhe zhvillimin e operacionit në rajonin e urdhëruar. Ai përpunon idenë e operacionit dhe nxjerr planin (urdhrin) për realizimin e tij në të gjitha fazat e mundshme, çka kërkon bashkërendim dhe rishikim të vazhdueshëm.

Disa nga operacionet e *Task Force* (TF) në kontekstin e misionit të FA

Sipas misionit, Forcat e Armatosura të RSH përgatiten për t'u angazhuar në të gjithë skenarët e mundshëm strategjikë të sigurisë. Ato luajnë ***rol kryesor*** në operacionet për mbrojtjen e vendit, ***rol mbështetës*** në operacione të Emergjencave Civile ose mbështetje të rendit kushtetues dhe rol ***kontribuues*** në operacione ndërkombëtare. Përdorimi i kapaciteteve ushtarake realizohet përmes një ***zinxhiri të qartë komandimi***, të misionit në kohë paqeje, krize dhe lufte, bazuar në legjislacionin kombëtar, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pas anëtarësimit të plotë në NATO, konceptohen, ndërtohen dhe përdoren, natyrisht si forcë modeste, në përbërje të Aleancës. Të konceptuara si element i një aleance ushtarake, Forcat e Armatosura të RSH, në kohë paqe, nuk mendohet të planifikojnë krijimin e të gjithë spektrit të kapaciteteve operacionale. Duke llogaritur faktin se, si në planin kombëtar, ashtu edhe në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare, Forcat e Armatosura do të veprojnë si pjesë e forcave aleate, planifikimi i kapaciteteve operacionale është i orientuar nga profilizimi i këtyre forcave.

- *Task Force* krijohet për qëllime ushtarake, civile, ligjore dhe humanitare në opera-

cionet që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit.
- Krijohet për një veprim apo veprimtari të ngushtë, për një kohë të caktuar, sipas një situate konkrete.
- Mund të ketë misione që zgjidhin detyra lokale, kombëtare, rajonale apo globale në kuadër të NATO-s, OKB-së, etj.
- Madhësia e saj mund të jetë e ndryshme (nga grup, skuadër deri në reparte a njësi (JTF).

Brenda vendit, mund të jetë *Task Force* Tokësore, *Task Force* Detare, *Task Force* Ajrore apo *Joint Task Force* (JTF). Në kuadrin global apo rajonal, krijohet në kuadrin e NATO-s, BE, OKB. Jashtë vendit, emërtohet *Combined Joint Task Force* (CJTF). Madhësia e kësaj strukture mund të jetë e ndryshme, në varësi të situatës, përmasave të operacionit, kohës së kërkuar për arritjen e suksesit dhe efekteve të mundshme anësore, por veçanërisht të plotësimit të misionit në nivelin e kërkuar.

Vlerësohet se operacione të kufizuara janë ata operacione që skicohen e realizohen brenda autoritetit të komandimit të komandantit të operacionit dhe mund të realizohen me burimet që janë pjesë përbërëse e rendimit (repartit).

Operacione komplekse janë ata që i kapërcejnë kapacitetet e një formacioni bazë dhe që shpesh bazohen në planet dhe kontingjentet e SHPFA, kontrollohen nga SHSHPFA, në emër të Komandantit të Përgjithshëm të FA. Komandanti i strukturës *Task Force* i raporton këtij të fundit përmes Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Në këto raste, krijohet dhe funksionon shtabi i përbashkët i *Task Forc*.

Kur fillon një operacion i kufizuar, mund të këtë tregues që i kalojnë kapacitetet e komandantit për të kryer këtë mision. Shefi i SHP të FA i mbikëqyr të gjitha këto operacione për të siguruar mbështetjen e nevojshme ose zgjeruar autoritetin e komandimit. Në të gjithë këto raste nxirret dhe lëshohet urdhër operacional, që e përcakton këtë operacion si kompleks dhe me qëllim të parë krijimin e zinxhirit të duhur të komandimit.

Struktura e FA ndërtohet në mënyrë të tillë që t'u përgjigjet sa më mirë nevojave të përballimit të kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Në përputhje me Kushtetutën e RSH, FA përbëhen nga Forca Tokësore, Forca Ajrore e Forca Detare dhe njësi të tjera mbështetëse.

Forca Tokësore siguron kapacitete për ruajtjen e pavarësisë, të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, për mbështetjen e popullsisë në përballimin e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit, në kohë paqe, krize e lufte, si dhe për të marrë pjesë në operacione të përbashkëta shumëkombëshe, në kuadrin e Mbrojtjes Kolektive dhe në operacione stabilizimi e të mbështetjes së paqes.

Forca Detare siguron kapacitete për mbrojtjen e hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë dhe të bregdetit shqiptar, në bashkëveprim me Forcën Tokësore e Ajrore, për të marrë pjesë në operacione të kërkim-shpëtimit, për të ushtruar zbatimin e ligjshmërisë në këtë hapësirë, së bashku me agjencitë e tjera shtetërore të zbatimit të ligjit.

Forca Ajrore siguron kapacitete për të kontrolluar hapësirën ajrore të RSH, në bashkëpunim me strukturat e NATO-s dhe partnerët, për mbështetjen e forcave të tjera në operacionet luftarake e joluftarake, si dhe për të marrë pjesë në operacionet humanitare apo edhe ato të kërkim-shpëtimit.

Si rregull, njësitë e FT shërbejnë si bërthama rreth të cilave organizohet forca e përbashkët operacionale (*Joint Task Force*).

Përgjegjësitë e komandave të Forcave

Komandat e Forcave dhe të njësive të tjera kryesore të FA-ve në kohë paqe kanë edhe përgjegjësi të drejtpërdrejta të natyrës operacionale. Mbajtja dhe demonstrimi i nivelit të kërkuar të pranisë ushtarake, si dhe drejtimi i veprimtarisë operacionale që realizon mbrojtjen dhe sigurinë e instalimeve e të infrastrukturës ushtarake, përbëjnë një përgjegjësi operacionale me karakter të përhershëm për të gjitha komandat. Krahas detyrave të mësipërme, Forca Detare dhe Forca Ajrore kryejnë edhe disa detyra operacionale specifike, që lidhen me vetë natyrën e këtyre strukturave.

a. Forca Detare ka përgjegjësi:

- të kontribuojë me përparësi në kryerjen dhe mbështetjen e operacioneve për vëzhgimin e hapësirës detare;
- të kryejë me kompetencë veprimtarinë operacionale që mundëson funksionimin e shërbimit hidrografik kombëtar.

Përdorimi i njësive të FD bëhet nga bazat operacionale detare, të cilat janë të shpërndara përgjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë. Forca Detare siguron prani operacionale, kryesisht për t'u dhënë asistencë e ndihmë përdoruesve të ujërave të brendshme territoriale. Për këtë qëllim, FD është e pranishme dhe ofron shërbime të rojës ujore edhe në liqenet kryesore të vendit.

Zgjerimi dhe demonstrimi i pranisë së kërkuar nga FD në të gjithë vijën bregdetare të vendit dhe përmirësimet e strukturës, ndër të tjera synojnë edhe:

- mbulimin më të mirë të ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë me shërbime të rojës bregdetare,
- shërbime të kërkim-shpëtimit dhe shërbime të ruajtjes së mjedisit dhe të burimeve ujore;
- shkurtimin dhe thjeshtësimin e linjës së komandimit të njësive detare për shkak të konsolidimit të të gjitha mjeteve lundruese detare në një strukturë të vetme;
- zvogëlimin e kohës së reagimit të mjeteve lundruese detare dhe rritjen e nivelit të bashkëpunimit me struktura të tjera që veprojnë në det etj.

Forca Ajrore ka përgjegjësi:

- për të dhënë kontributin kryesor në kryerjen dhe mbështetjen e operacioneve për vëzhgimin e hapësirës ajrore, të policimit ajror, në bashkëveprim me strukturat simotra të NATO-s;
- të kryejë veprimtari operacionale që realizojnë funksionimin e shërbimit meteorologjik.

Anëtarësimi edhe në strukturat ushtarake të NATO-s shënon edhe marrjen e roleve të reja në gjendjen e re, të ndryshuar politike e ushtarake. Përdorimi operacional i FA tashmë do të kryhet në interes të dy përfituesve kryesorë: autoriteteve civile kombëtare, qendrore dhe vendore, në kuadër të operacioneve për përballimin e emergjencave civile, si dhe autoriteteve të NATO-s, në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në strukturat e Aleancës. Në raport me përfituesit e kontributeve operacionale, si në planin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar, FA luajnë rolin e gjeneruesit të forcës (*force provider*).

Sipas këtij koncepti, FA-të krijojnë dhe mbajnë në gatishmëri kapacitete operacionale ushtarake, që i vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm kombëtarë apo ndërkombëtarë, të cilët kryejnë funksionin e përdoruesit të forcës (*force user*). Në këtë rast, si përdorues force mund të jenë autoritetet kombëtare të emergjencave civile, NATO, BE, OKB. Ndaj, mbetet emergjencë krijimi i strukturave ushtarake sipas koncepteve bashkëkohore të ndërtimit e përdorimit të tyre në operacione ushtarake brenda e jashtë vendit, të pajisura e përgatitura sipas standardeve përkatëse. Përbën përgjegjësi të shtuar stërvitja dhe ristërvitja e trupave të llojeve të forcave për misione të veçanta e në përbërje të rendimeve të tillë si *Task Force*, *Joint Task Force* apo edhe *Combined Joint Task Force*. E rëndësishme në të gjitha rastet është veçanërisht përgatitja për njohjen në nivelin e kërkuar të gjuhës angleze, e teknikave e taktikave të kryerjes së veprimeve të mirëfillta ushtarake, e njohjes, në rastin e misioneve ndërkombëtare, së mentalitetit, nivelit ekonomik, kulturor, fetar etj., të popullsisë vendase, aty ku mund të kryhet operacioni i radhës.

Nëse u referohemi procedurave dhe strukturës organizative të NATO-s në operacione të përmasave ndërkombëtare, që në kohë paqe parashikojnë se si mund të organizohen kapacitetet e përbashkëta (*Joint Task Force* ose *Combined Joint Task Force*), se si mund të krijohet shtabi i forcës për komandim-kontrollin e një operacioni të ardhshëm, duke nxjerrë personelin kryesor të shtabit nga struktura aktuale e komandave operacionale, por edhe si do të organizohen forcat për nga kapacitetet e vendeve kontribuuese, struktura operacionale që krijohet (sipas procedurave të NATO-s), nisur nga lloji i operacionit që do të kryhet, në fillim krijon komandën dhe shtabin e operacionit, që bazohet në aktivizimin e pjesës më të madhe të personelit kryesor të shtabit nga komponenti tokësor i Komandës së Forcës së Përbashkët, për operacionet tokësore, nga komponenti ajror për operacionet me bazë ajrin dhe nga komponenti detar për operacionet detare. Në material jepen rekomandime përkatëse.

Në operacione brenda vendit, sipas DP-01, operacionet e të gjitha llojeve realizohen përmes forcës operacionale, të organizuara për detyrë (*task force*). Forca operacionale krijohet mbi bazën e një njësie a strukture kryesore, e cila mban edhe barrën kryesore të operacionit. Kjo njësi përforcohet dhe mbështetet me struktura të llojeve të tjera të trupave, roli i të cilave është kompletimi apo plotësimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për realizimin me sukses të misionit. Çdo forcë operative strukturohet në përshtatje me natyrën e misionit që do të kryhet. Struktura e nivelit *Task Force* komandohet nga komandanti i përcaktuar në urdhrin përkatës të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për operacionin që do të zhvillohet. Kjo strukturë, e krijuar rishtas, vihet në vartësinë e SHPFA dhe komandohet e kontrollohet nga vetë ai, përmes QBO.

Në rastin e veprimtarive ushtarake brenda vendit, vlen të kujtohet se komandat e forcave, të njësive dhe të strukturave të tjera të FA-ve kryejnë funksionin e gjeneruesit të forcës (*force provider*), ndërsa Shtabi i Përgjithshëm i FA-ve kryen funksionin e përdoruesit të forcës (*force user)*, në të gjitha këto raste.

Përdorimi i FA-ve në emergjencat civile përbën një ndër detyrat themelore të FA-ve. Ato përfaqësojnë një nga strukturat më të organizuara, më të stërvitura, më të pajisura dhe më të gatshme për raste të tilla në nivel kombëtar. Angazhimi i tyre në përballimin e emergjencave civile bëhet në kuadër të përpjekjeve kombëtare dhe në mbështetje e përforcim të autoriteteve përgjegjëse civile, veprime këto të parashikuara në ligj. Angazhimi i FA në emergjenca civile bëhet me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, në rastet kur përdorimi i aseteve të tjera civile rezulton i pamjaftueshëm ose i paefektshëm. Strukturat

e FA-ve futen në veprim, në kuadër të operacioneve të ndryshme me natyrë civile, si rregull, kur autoritetet civile kanë shterur kapacitetet e tyre në përballimin e situatave të caktuara. Si rregull, ato hyjnë në operacion të dytat, por kur ndërhyjnë, ato shpalosin një kapacitet të lartë, në forca dhe në mjete.

Struktura kryesore e FA-ve që kontribuon në përmbushjen e misionit të FA për përballimin e emergjencave civile është Komanda e Mbështetjes. Të gjitha strukturat e tjera të FA-ve stërviten dhe mbajnë në gatishmëri forca e mjete për të kontribuuar në përballimin e emergjencave civile. Për përballimin e emergjencave krijohet *Task Force*, ku, si rregull, komandimi i saj realizohet nga struktura kryesore që ka dhe si mision përballimin e këtyre emergjencave.

Në Doktrinën e Përbashkët të FA theksohet se operacionet e FA-ve në rastin e menaxhimit të Emergjencave Civile kryhen, si rregull, në mbështetje të autoriteteve civile kombëtare, qendrore dhe vendore, në kuadër të planit kombëtar të përballimit të fatkeqësive natyrore apo të emergjencave civile[2].

Në këtë kontekst, Forcat e Armatosura vlerësohen si **"***force provider"* dhe autoritetet civile që drejtojnë operacionin konsiderohen "*force user"*. Por, nisur nga fakti që vetë Forcat e Armatosura, në operacionet e Emergjencave Civile, caktojnë një komandant operacioni, atëherë, brendapërbrenda strukturës së FA, komandat e Forcave (Tokësore, Ajrore dhe Detare) vlerësohen "*force provider*", Shtabi i Përgjithshëm i FA konsiderohet si "*force user*", i cili, për komandim-kontrollin e operacionit në terren, ia delegon këtë detyrë komandantit të *Task Force*/*Joint Task Force*.

Në material vlerësohet e trajtohet, sipas kontekstit, edhe mbështetja logjistike. Në rastin e strukturës së krijuar rishtas, ajo organizohet sipas parimeve të përqendrimit të mbështetjes për mallrat dhe shërbimet, krijimit të autonomisë operacionale, ndërtimit të mbështetjes logjistike në trajtën e një sistemi të plotë, sipas parimit nga lart-poshtë. Mbështetja me mallra e shërbime e operacionit realizohet përmes ndërthurjes së shërbimeve që kryhen nga sistemi logjistik i TF me shërbimet që sigurohen nga kontraktorët, ku synohet që, sa më shumë shërbime të jetë e mundur, të realizohen përmes këtyre të fundit.

Përmirësime e dukuri të reja vlerësohet se bëhen edhe në mbështetjen e sistemit të komandimit e kontrollit me shërbime të ndërlidhjes dhe të komunikimit, çka përbën edhe një ndër parakushtet themelore për përmbushjen e misionit të FA-ve. Shërbimi i ndërlidhjes dhe i komunikimit sigurojnë ndërlidhjen e plotë dhe të shumëllojshme mes strukturave të FA-ve, në interes të funksionimit normal të tyre në kohë paqe, krize dhe lufte.

Ashtu si sistemi logjistik, edhe shërbimi i ndërlidhjes dhe i komunikimit organizohet nga lart-poshtë. Zbatimi i këtij parimi kërkon që eprorët të mundësojnë ndërlidhjen e pandërprerë e cilësore për strukturat dhe hallkat e varësisë. Në të gjitha rastet mbahet parasysh që në organizimin, ndërtimin e funksionimin e ndërlidhjes zbatohet parimi "*plug and play*". Ndaj, për një mirëfunksionim të këtij sistemi, duhet që dikush të ofrojë "prizën", me qëllim që abonenti të mund të vendosë "spinën" e tij. Në kushte të tilla, eprori është përgjegjës i drejtpërdrejtë për të garantuar vendosjen e "prizës", çka nënkupton shtrirjen

[2] Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i RSH.

e rrjetit deri te përdoruesit e fundit, ndërsa përdoruesi apo vartësi ka përgjegjësinë e përdorimit të "spinës", që nënkupton aftësinë për t'u lidhur dhe për të operuar pa probleme në rrjetin përkatës.

Po cilat do të jenë marrëdhëniet e komandimit në rastin e Task Force?

Komandimi e kontrolli është art i vendimmarrjes dhe i drejtimit të veprimeve luftarake, si dhe i motivimit të ushtarakëve e organizatave përkatëse të tyre, për të përmbushur misionin. Komandimi e kontrolli i betejës përfshin, ndër të tjera edhe përfytyrimin e gjendjes aktuale dhe asaj të ardhshme, por edhe konceptimin e veprimeve luftarake, për të kaluar nga njëri veprim tek tjetri, në kohë e me kosto sa më të ulët. Gjithashtu, përfshin caktimin e misioneve, të përparësive dhe ndarjen e burimeve, përzgjedhjen e kohës e të vendit kritik të veprimit, si dhe parashikimin se si dhe kur do të bëhen korrigjime gjatë veprimtarisë luftarake.

Komandanti i *Task Force* është komandant i operacionit; atij i specifikohet misioni, marrëdhëniet e komandim-kontrollit, përfshirë delegimin e autoritetit, i caktohen burimet, personeli dhe elementë të tjerë, që i mundësojnë atij t'i kontrollojë këto resurse, në mbështetje të realizimit të misionit.

Në material theksohet e zhvillohet në detaje ideja se komandimi dhe kontrolli në sistemin e FA realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohet në parimin e unitetit të komandimit. Detyra e celulës së drejtimit të operacionit në nivel *Task Force* fillon me formulimin dhe lëshimin e urdhrit për këtë qëllim dhe përfundon me realizimin e misionit dhe rikthimin e trupave pjesëmarrëse pranë kontingjenteve të tyre amë. Po aty shprehet skematikisht edhe organizimi i sistemit të komandimit e kontrollit në raste të njëjta në sistemin e FA të RSH.

Operacionet shumëkombëshe janë operacione ushtarake që planëzohen e kryhen me pjesëmarrjen e forcave dhe të mjeteve nga shtete të ndryshme. Si rregull, këto janë operacione të përbashkëta, që do të thotë se në to marrin pjesë dy a më shumë komponentë të forcave të armatosura dhe kryhen në kuadër të koalicioneve ose grupimeve të forcave aleate. Operacionet që ndërmerren nga NATO janë përherë operacione shumëkombëshe, por të tilla mund të kryhen edhe në kuadër të BE-së, në mbështetje të rezolutave të OKB-së apo të organizatave të tjera ndërkombëtare të sigurisë. Këto operacione kanë si objektiv rritjen e efektshmërisë së ndikimit diplomatik dhe ekonomik të vendeve pjesëmarrëse. Veprimtaria e përgjithshme e Forcave tona të Armatosura në kohë paqe ose në situata krize duhet të çojë në rritjen e aftësive për të marrë pjesë në mënyrë efektive në operacionet shumëkombëshe. Por edhe në këtë rast, efektshmëria e operacioneve të përbashkëta shumëkombëshe mund të kufizohet nga disa faktorë, ndër të tjerë:

- Veçoritë kombëtare në mënyrën e komandimit dhe të përdorimit të forcave.
- Niveli i kërkuar i gjuhës angleze dhe dallimet në përdorimin e terminologjisë së përbashkët.
- Disniveli në sistemet e informacionit, për sa u përket aspekteve teknikë dhe proceduralë.
- Mungesat në standardet e kërkuara të kapaciteteve të përbashkët logjistikë shumëkombësh.
- Kufizimet ligjore në përdorimin e kontingjenteve kombëtare.
- Dallimet kulturore e fetare që ndikojnë në sjelljen e anëtarëve të kontingjenteve të veçanta.

Faktorët dhe konsideratat në operacionet e përbashkëta shumëkombëshe ndryshojnë edhe në varësi të natyrës së operacionit. Ata nevojitet të identifikohen rast pas rasti, në çdo operacion, në mënyrë që të ndihmojnë në planëzimin e tyre, por edhe të atyre pasardhës. Në material theksohen edhe disa nga faktorët më të rëndësishëm, që ndikojnë në planëzimin e operacioneve të përbashkëta shumëkombëshe, si:

- marrëdhëniet politiko-ushtarake,
- marrëdhëniet civilo-ushtarake,
- media,
- konteksti strategjik,
- liria e veprimit,
- përdorimi i burimeve,
- aspektet ligjore,
- rregullat e angazhimit dhe mbrojtja e mjedisit.

Edhe konceptet bazë të delegimit e të transferimit të autoritetit në nivelin JCTF trajtohen me mjaft kujdes në këtë material. Aty analizohen me hollësi raste të mundshme të këtij procesi, sa të rëndësishëm aq edhe delikat e me përgjegjësi. Edhe në rastin shqiptar Forcat e Armatosura luajnë rolin e gjeneruesit të forcës/*force provider.* E rëndësishme, gjatë procesit të planëzimit është përcaktimi se ***kur*** dhe ***ku*** do të kryhet integrimi i forcave, i shtabeve përkatës, si dhe koha e vendi i delegimit të autoritetit nga autoritetet e vendeve kontribuuese me trupa Komandës Strategjike të NATO-s dhe, së fundmi, komandantit të operacionit. Po aq me rëndësi është edhe përpjekja që bëhet për të përshtatur, edhe në rastin tonë, të konceptit e të praktikës ekzistuese në strukturat ushtarake të NATO-s mbi delegimin e Autoritetit tek përdoruesi i Forcës.

Në këtë shkrim trajtohen hollësisht edhe përgjegjësitë e komandantëve në raste të tilla, por edhe se si funksionon shtabi përkatës. Aty përshkruhen, ndër të tjera, detyrat që merr përsipër të realizojë komandanti i *Task Force* e që janë më specifike. Dy ndër detyrat më të spikatura gjykojmë të jenë identifikimi i kufizimeve të mundshme të operacionit që do të kryhet, por edhe specifikimi dhe drejtimi i transferimit të nivelit të caktuar të komandimit të forcave komandantit të *Task Forcës* dhe koha e caktuar për transferimin e këtij autoriteti.

Risi përbën skicimi i shtabit të *Task Force*, por edhe detyrat që realizon ky në interes të realizimit të konceptit operativ të komandantit përkatës. Shtabi në këta raste përmban tri kategori stafesh që janë ai ***personal***, që e ndihmon komandantin në punët e para organizative, përpos krijimit e mbajtjes së lidhjeve me vartësit. ***Stafi special*** e ndihmon komandantin në problemet teknike, administrative, ligjore dhe operacionale; ky, zakonisht, është një grup i vogël, i përbërë nga ekspertë, të cilët, gjithashtu, kanë edhe pozicionet e veta brenda komponentëve dhe grupeve mbështetës ose të grupit të përgjithshëm. Mbase më i rëndësishmi, ***stafi i përgjithshëm*** është organizuar sipas linjës tradicionale, me një shef shtabi dhe degët përkatëse të shtabit. Ky staf, i cili e ndihmon komandantin në ushtrimin e përgjegjësive të tij, përfshihet i tëri në planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të operacionit e të stërvitjes dhe dhënien e zgjidhjeve kërkesave për mbështetje. Ky staf përmban J1-J9, përfshirë informimin publik, juristët etj.

Përfundime

Përgatitja për implementim, diskutimi, përmirësimi i mëtejshëm në veprimtaritë e përditshme stërvitore të FA-ve apo në misionet shumëkombëshe jashtë vendit, përbëjnë ndër detyrat e para të stafit oficer të të gjitha strukturave legjitime të FA-ve. Njëherësh, përbëjnë edhe

një detyrim madhor në rrugën e përafrimit e të njësimit të koncepteve e praktikave më të mira të drejtimit e të realizimit të misioneve të ardhshme përmes strukturave ushtarake të nivelit *Task Force*.

Përvoja disa dhjetëravjeçare e *Task Force* ka treguar se këto organizime bazuar në manovrueshmërinë e lartë, fuqinë e përforcuar të zjarrit, drejtimin me profesionalizëm, por edhe në përdorimin e arritjeve më të fundit në fushën e teknologjisë ushtarake e të IT, janë mjaft të përshtatshme për të vepruar:

- Në të gjitha llojet e operacioneve luftarake.
- Në operacionet paqeruajtëse.
- Në emergjencat civile.
- Në të gjitha llojet e terreneve e të kushteve të motit.

Ndaj, është e domosdoshme përgatitja e procedurave standarde të veprimit, duke orientuar në këtë rrugë trajnimet, stërvitjet kompaktësuese dhe integruese të kapaciteteve të ndryshme të FA-ve, të parashikuara për t'u përdorur në operacione të ndryshme ushtarake, brenda apo jashtë vendit.

Ndërkaq, përbën nevojë dhe domosdoshmëri përshtatja e legjislacionit për komandimin dhe drejtimin e këtyre organizimeve (Task Force) për kryerjen e misioneve brenda vendit dhe në kuadrin e operacioneve të NATO-s, BE, dhe OKB-së. Racionaliteti në organizimin e përdorimin e strukturave të tilla efikase, për të marrë përsipër e realizuar misione të ndryshme ushtarake përbën, ndoshta, pjesën më pragmatiste në kryerjen e operacioneve të sotme, sa të vështirë aq edhe të komplikuar. Të planëzosh e të fitosh luftimin apo betejën me sa më pak forca e kosto më të vogla, duket se është edhe dukuri e kohëve moderne që jetojmë.

NRF, pjesëmarrja dhe perspektiva e FA-ve shqiptare në këtë strukturë

Kolonel Ilir Pujo
Zv.përfaqësues Ushtarak për Operacionet, SHAPE, Mons, Belgjikë

Trajtesa e shkurtuar. *Mbase nuk janë shumë vetë që e dinë se viti 2014 është një ngjarje e shënuar për Forcat e Armatosura, në pikëpamje të angazhimeve në NATO. Për herë të parë FA-të shqiptare marrin pjesë aktive në Forcat e Reagimit të NATO-s(NRF) të vitit 2014, me një togë të Policisë Ushtarake. E shprehur në terma doktrinarë, një nënrepart i FA-ve shqiptare, pra toga e Policisë Ushtarake, si pjesë e NRF IRF-së[1] së vitit 2014, do të qëndrojë e gatshme (stand by) për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2014 në dispozicion të NATO-s, për realizimin e misioneve që mund t'i ngarkohen, sipas Artikullit 5 dhe Jo-Artikullit 5 (Operacionet në Përgjigje të Krizave).*

Me këtë rast, për lexuesin ushtarak dhe civil të FA-ve, kam vlerësuar si të dobishme të bëj një përmbledhje për Forcën e Reagimit të NATO-s: çfarë përfaqëson kjo forcë; si ka evoluar; cila ka qenë rruga që kanë ndjekur FA-të shqiptare për pjesëmarrje në të; disa mësime të nxjerra dhe cilat mund të jenë perspektivat e angazhimit të FA-ve në këtë strukturë.

> *"Ne …duhet të fuqizojmë komunikimin midis Forcave tona të Armatosura nëpërmjet më shumë stërvitjeve, edukimit dhe trajnimit të përbashkët dhe të rifuqizojmë Forcat e Reagimit të NATO-s, me qëllim që të mbrojmë çdo aleat, të dislokohemi kudo dhe të parandalojmë çdo kërcënim.…"*
>
> Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s *Anders Fogh Rasmussen*[2]

NRF, historiku dhe statusi aktual i saj

Forcat e Reagimit të NATO-s (në anglisht NATO Response Force), që në vazhdim do t'u referohem me shkurtimin (NRF), ia detyrojnë ekzistencën e tyre, pjesërisht, atmosferës shqetësuese që u krijua në NATO pas ndërhyrjes Amerikane në Afganistan dhe nevojës në rritje për krijimin e një nisme të zbatueshme mbrojtjeje në Samitin e Pragës të NATO-s, në nëntor 2002, por gjithashtu, edhe një procesi organizativ dhe politik specifik të mbështetjes së modernizimit dhe përmirësimit të kapaciteteve në prag të përgatitjeve të Samitit të Pragës. Në këtë Samit, vendet anëtare të NATO-s[3] vendosën të krijojnë Forcat e Reagimit të NATO-s, NRF. Qëllimi ishte krijimi i një pakete forcash

[1] IRF (Immediate Response Force) është grupimi i Forcave të Reagimit të Menjëhershëm të NRF-ve.

[2] NATO: Ready, Robust, Rebalanced Speech by NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen at the Carnegie Europe Event**.** http://www.nato.int/cps/en/natolive/opinions_103231.htm?selectedLocale=en

[3] Faqja zyrtare e NATO-s: Prague Summit Declaration, 21 Nov. 2002 , http://www.nato.int/cps/en/natolive/ial_texts_19552.htm?utm_source=tiki&utm_medium=social+media&utm_campaign=130927+nrf+sfjazz#nrf

teknologjikisht të përparuara, të dislokueshme, fleksible, të ndërveprueshme dhe të mbështetura mirë nga pikëpamja logjistike, për kryerjen e një spektri të gjerë misionesh luftarake dhe joluftarake. Kjo paketë forcash të bashkuara, e përbërë nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare dhe Forcat Speciale, u konceptua të ishte një forcë e gatshme për t'u dislokuar kudo dhe kurdo që të nevojitej në një operacion të bashkuar në kuadër të Artikullit 5 të Mbrojtjes Kolektive dhe Jo-Artikullit 5 në Operacione në Përgjigje të Krizave.

Pas disa muajsh studimi dhe vlerësimi, NRF u aprovua zyrtarisht si koncept nga ministrat e Mbrojtjes së NATO-s, në pranverë 2003.

Në momentin e shpalljes së NRF-ve, në tetor 2003, gjeneral *Jones* (në atë kohë komandant i Komandës Aleate për Operacionet), theksoi: *Sot shënohet një nga ndryshimet më të rëndësishme të Aleancës qysh nga nënshkrimi i Traktatit të Uashingtonit, mbi 50 vjet më parë… për herë të parë në historinë e saj, Aleanca do të ketë një forcë të përbashkët shumëkombëshe me forca ajrore, tokësore, detare dhe forca speciale, nën një komandant të vetëm, dhe e krijuar si forcë me status rotacioni*[4].

NRF arriti nivelin fillestar operacional (IOC) në vitin 2004 dhe u bë plotësisht operacionale (FOC) në vitin 2006. Vështirësia në menaxhimin e kapaciteteve të plota operacionale pas vitit 2006 bëri që, në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të vitit 2009, mbështetur edhe në përvojën e krijuar dhe mësimet e nxjerra, koncepti i NRF-ve të rishikohej, duke pësuar disa ndryshime thelbësore në strukturë, në mision, në vlerësimin operacional dhe në mbështetjen logjistike. Kështu, iu vu një theks më i madh NRF-ve për kryerjen e detyrave sipas Artikullit 5, u rrit koha e qëndrimit në gatishmëri, nga 6 në 12 muaj, për t'i dhënë NRF-ve më shumë koherencë operacionale, dhe në të njëjtën kohë, iu mundësua mbështetje më e mirë operacionale dhe kursim i shpenzimeve të trajnimit.

Pavarësisht ndryshimeve, misioni kryesor i tyre vijon të mbetet një forcë e dislokimit të menjëhershëm të NATO-s dhe e demonstrimit të pranisë së saj ushtarake në mbështetje të Artikullit 5 dhe Jo-Artikullit 5. Ky koncept bazohet në sistemin e rotacionit 12-mujor, dhe u jep mundësi vendeve të deklarojnë kontribute mbështetur në mundësitë e tyre. Nëpërmjet një direktive të veçantë të SACEUR-it, çdo rotacion i NRF-ve përgatitet për një numër detyrash (2-3 detyra) dhe jo për të gjithë listën e detyrave.

Nga pikëpamja strukturore, NRF përbëhet nga elementë Komandim-Kontrolli, Forcat e Reagimit të Menjëhershëm (IRF) dhe Grupimi i Forcave të Reagimit (RFP)[5]. Vetë grupimi i Forcave në RFP ndahet në dy kategori: "NRF designated",që janë trupa të trajnuara dhe të gatshme për t'u deklaruar në IRF për një mision specifik dhe "NRF earmarked", që janë trupat e trajnuara me standardet e forcës së NATO-s, por nuk janë ende të certifikuara. Vendet i deklarojnë trupat në IRF dhe RFP mbështetur në nivelin e përshkallëzuar të gatishmërisë dhe ashtu siç theksuam më sipër, në trajnimin e realizuar sipas standardeve të trajnimit (ACO Training Standards).

Në grupimin e quajtur Immediate Response Force (IRF), listohen trupat e deklaruara nga vendet në Konferencën e Gjenerimit të Forcave, duke përfshirë në të kohën e gatishmërisë

[4] Fjala e mbajtur më 15 tetor 2003 në AFNORTH HQ, Brunssum, Holandë në momentin e prezantimit të stemës së NRF-s.

[5] Faqja zyrtare e NATO-s http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49755.htm

për lëvizje (Notice to Move), që për këtë kategori shkon nga 5-30 ditë. Numri i trupave të deklaruara në IRF shkon rreth 13.000-14.000 vetë.

Në grupimin e Forcave të Reagimit, të quajtur Response Forces Pool (RFP), vendet janë të lira të kontribuojnë me çfarë të munden, kur të munden dhe bazuar në termat e tyre për këtë grupim. Për sa i përket mekanizmit të pjesëmarrjes në të, ato rregullohen nga një shumëllojshmëri marrëveshjesh teknike, realizuar në marrëveshje me baza dy-e shumëpalëshe, me vende të cilat bien dakord të sigurojnë forca për t'u trajnuar dhe stërvitur së bashku. Koha e gatishmërisë për këtë grupim shkon nga 10-60 ditë. Siç mund të duket, nga natyra, ato janë vullnetare.

Në fakt, vetëm trupat e deklaruara në IRF listohen për operacione, ndërsa trupave të deklaruara në RFP u jepet mundësia të trajnohen me standardet e forcës dhe në rast mangësish, kapacitetet e deklaruara në IRF mund të përdoren në një operacion të mundshëm.

Çdo rotacion në NRF kalon gradualisht në një sistem vlerësimi operacional kombëtar dhe në kuadër të NATO-s, ndërsa vendimmarrja për përdorimin e NRF-ve merret me miratimin e të gjitha vendeve anëtare, rast pas rasti, në Këshillin e Atlantikut të Veriut (NAC).

Historiku i angazhimeve të FA-ve shqiptare në NRF

Vendi ynë, qysh pas anëtarësimit në NATO, në prill të vitit 2009, ka shprehur vullnetin politik dhe ushtarak për t'u angazhuar në këtë strukturë. Duhet thënë se pjesëmarrja me trupa në NRF, pavarësisht se bëhet mbi baza vullnetare, është detyrim i vendeve anëtare. Kjo pasi NRF mbetet e vetmja forcë e gatshme në dispozicion të Aleancës për t'u përdorur në momentet e para qoftë në kuadër të Artikullit 5 të Mbrojtjes Kolektive, qoftë në operacione sipas Jo-Artikullit 5, që janë operacionet në përgjigje të krizave.

Zyrtarisht, vendi ynë ka deklaruar pjesëmarrjen në NRF qysh në qershor të vitit 2010. Me një shkresë të veçantë, SHSHP i FA-ve ka formalizuar pjesëmarrjen e FA-ve shqiptare me një togë të Policisë Ushtarake në NRF-n e vitit 2012, në Grupimin e Forcave të Reagimit (RFP), në kategorinë "earmarked". Ky deklarim, pavarësisht se jo në kategorinë IRF, në pikëpamje zyrtare përbën datën e parë të deklarimit të FA-ve shqiptare në këtë strukturë. Me këtë deklarim, kjo togë hyri në një proces stërvitjeje dhe trajnimi kombëtar, sipas standardeve të trajnimit të Forcave të NATO-s, por pa mundur dot të zhvillojë një stërvitje certifikimi në kuadër të NATO-s, gjë që do të krijonte edhe përvojën e parë qoftë në pikëpamje të planëzimit stërvitor dhe përftimit të trajnimit në kuadër të mbulimit të kostos së saj nga Fondi i Përbashkët i Aleancës, qoftë edhe në pikëpamje zbatimi, pasi do të ishte një "ushtrim stërvitor dislokimi" për togën e PU-së dhe një "stërvitje shtabi" për strukturat planëzuese të SHP-së e PU-së që do të "dislokonin" nënrepartin në rajonet e stërvitjes.

Kjo nuk ndodhi, megjithatë, në tetor 2012, në Konferencën Globale të Gjenerimit të Forcave, FA-të shqiptare deklaruan kontribute në NRF-n e vitit 2014, duke kaluar togën e Policisë Ushtarake, nga grupimi RFP në IRF. Ky deklarim është historik, pasi shënon kontributin e parë të FA-ve shqiptare në IRF, në NRF IRF-n e vitit 2014. Ky deklarim kombëtar u shoqërua me një sërë masash përgatitore që përfshinin trajnimin kombëtar dhe atë në kuadër të NATO-s, detyrimet që përfshihen në Direktivën e NRF-ve 080-96, të tilla si: Mesazhi i Përgatitjes së Forcës (FORCEPREPP); Urdhri operacional i Luftimit (ORBATOA); pjesëmarrja në konferencat e Planëzimit të Stërvitjes së Certifikimit dhe Planëzimit të Pjesëmarrjes në Stërvitjen e Certifikimit (stërvitjes"Steadfast Jazz 2013" të zhvilluar në Poloni dhe vendet Baltike, në periudhën 02-11 nëntor 2013). Shqetësimi

kryesor, në pikëpamje të mbështetjes së masave të planëzuara për materializimin e këtij kontributi, mbeti mosmbulimi me fonde buxhetore të parashikuara në buxhet qysh në fillim të vitit dhe miratimi i aktiviteteve të saj, rast pas rasti. Një praktikë e tillë u mori shumë kohë dhe energji strukturave përgjegjëse.

Për informim të lexuesit, në fund të dhjetorit 2013, mbështetur në vlerësimin e realizuar në stërvitjen "Steadfast Jazz 2013", e gjithë paketa e forcave të NRF-ve 2014 u shpall një forcë e bashkuar, e certifikuar, e dislokueshme dhe e gatshme për të realizuar detyrat që mund t'i ngarkohen nga SACEUR për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014. Ashtu siç theksuam më sipër, ky deklarim është në fuqi edhe për togën e PU-së të FA-ve shqiptare.

Kjo togë, tashmë si pjesë e NRF-ve 2014, do të qëndrojë në gatishmëri deri më 31 dhjetor 2014 dhe normalisht, gjatë kësaj periudhe, nuk mund të deklarohet apo planëzohet për të marrë pjesë në ndonjë detyrë tjetër, jashtë këtij angazhimi kombëtar.

Në tetor të vitit 2013, në Konferencën e Gjenerimit të Forcave për NRF-n e viteve 2015, 2016, të zhvilluar në SHAPE, Mons, Belgjikë, FA-të shqiptare deklaruan kontribute në NRF IRF-n e vitit 2016, tashmë me një kompani këmbësorie të batalionit të dytë të brigadës së FT-së. Kjo është një ngjarje tjetër madhore për Forcat e Armatosura, por në të njëjtën kohë, edhe një sfidë. Ndryshe nga angazhimi me togën e PU-së në NRF 2014 , ky deklarim u mbështet edhe nga një urdhër ministri që përcakton me detaje detyrimet për çdo strukturë. Në këtë urdhër përcaktohet edhe pjesëmarrja e kompanisë së deklaruar në NRF në stërvitjen e certifikimit "Trident Juncture LIVEX 2015", e cila është një nga stërvitjet më të mëdha me trupa të NATO-s pas vitit 2006. Kjo stërvitje ambicioze, e parashikuar që të marrin pjesë trupa nga të gjitha llojet e forcave dhe shërbimeve aleate deri në shkallë divizioni, do të jetë në fakt edhe një sfidë për vetë NATO-n, pas një kohe të gjatë angazhimi operacional.

Theksoj se, për herë të parë, këtë vit, pjesëmarrja e vendit tonë në NRF është bërë pjesë edhe e dokumenteve më të rëndësishme planëzuese të MM-së dhe SHP-së dhe ka marrë rëndësinë dhe vlerësimin e duhur. Kështu, pjesëmarrja në NRF-n e vitit 2016 përmendet për herë të parë si përparësi në direktivën e MM-së për vitin 2014, në kuadrin e modernizimit të FA-ve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes[6]. Po kështu, përgatitja dhe certifikimi i kompanisë së parë të këmbësorisë, si pjesë e NRF-ve 2016 dhe në të njëjtën kohë, si pjesë e batalionit të Këmbësorisë së Motorizuar, që është kapaciteti kryesor i FA-ve dhe detyrimi ynë kryesor në kuadër të kapaciteteve të kërkuara nga NATO, ka gjetur vend edhe në udhëzimet e stërvitjes së SHPFA-së për vitin 2014[7]. Në këtë dokument përcaktohen detyrimet stërvitore të Forcave Tokësore për materializimin e këtij kontributi. Mbetet të shohim edhe shpërndarjen e fondeve të përcaktuara buxhetore për këtë kontribut, me qëllim që, në pikëpamje planëzimi, ky cikël të quhet i përmbushur.

"E vetmja gjë më e vështirë se thithja e një ideje të re në mendjet ushtarake është nxjerrja e idesë së vjetër."

B.H Liddell Hart

[6] Direktiva e MM për vitin 2014, faqe 5.

[7] Udhëzimet vjetore të SHSHP për stërvitjen për vitin 2014.

Perspektiva e pjesëmarrjes së FA-ve shqiptare në NRF

Dua të nënvizoj faktin, se pjesëmarrja në NRF është një sfidë për të gjitha vendet e NATO-s dhe aq më tepër, për vendet anëtare me ushtri të vogël dhe me pak kapacitete ushtarake në dispozicion, si vendi ynë.

E thënë kështu, planëzimi i kontributeve kombëtare në NRF duhet të jetë një proces brenda procesit të planifikimit të mbrojtjes dhe pjesë e Nivelit Kombëtar të Ambicies së vendit tonë në NATO.

Aleanca ka shpikur një mekanizëm për këtë qëllim, ku pothuajse të gjitha vendet anëtare e kanë aplikuar me sukses. Bëhet fjalë për Voluntary National Targets (VNT), që në shqip do ta përshtatnim si Objektivat Kombëtare apo Niveli Kombëtar i Ambicies në NRF. Kjo do të thotë: përcaktimi në përqindje i kontributeve që vendi ynë parashikon të kontribuojë mbi baza vullnetare në NRF IRF (në grupimin e Forcave të Reagimit të Menjëhershëm), për një periudhë 6-vjeçare. Kjo përqindje përkthehet në kapacitete në Konferencat e Gjenerimit të Forcave për NRF-n që zhvillohen çdo vit në SHAPE. Si dokument bazë në përcaktimin e Nivelit Kombëtar Afatgjatë të Ambicies në NRF është Plani Afatgjatë i Rotacionit të NRF-ve (NATO Long Term Rotation Plan), dokument i cili gjenerohet në SHAPE nga zëvendëskomandanti i Komandës Aleate për Operacionet, DSACEUR. Ky dokument përcakton për një periudhë 6 deri 7-vjeçare se cilat janë strukturat e Komandës së NATO-s (shtabet) që do të ushtrojnë përgjegjësitë e komandim-drejtimit të NRF-së.

Procedura kombëtare e ndjekur deri tani ka qenë kjo: kur NATO kërkonte kontribute në NRF, në prag të zhvillimit të konferencave të gjenerimit të Forcave për NRF-n e radhës, ne atëherë kemi filluar procesin e vlerësimit dhe vendimmarrjes për të ofruar kontribute në NRF. Për shkak të kohë së kufizuar për vendimmarrje (maksimumi 30 ditë) dhe mosplanifikimit të burimeve (pasi konferencat zhvillohen në muajt tetor-nëntor), autoritetet ushtarake dhe politike janë vendosur në vështirësi.

Një planifikim i hershëm, të cilin na e ofron mekanizmi i trajtuar më sipër i deklarimit të Nivelit Kombëtar afatgjatë të Ambicies të NRF-së, do të na lejonte një vendimmarrje të studiuar dhe planifikim më të mirë e në kohë të burimeve për mbështetjen e këtij angazhimi kombëtar.

Një procedurë e rëndësishme, pjesë e planifikimit kombëtar afatgjatë të pjesëmarrjes në NRF, është atashimi (affiliation) i kontributeve të deklaruara. Mbështetur mbi përvojën e vendeve të tjera, atashimi i forcës mund të zhvillohet në 2 mënyra:

1. Nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim me vendet aleate që synojnë të deklarojnë apo kanë deklaruar kontribute të ngjashme me të njëjtën kategori forcash në NRF. Kjo mund të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit në kuadër rajonal me vendet aleate të NATO-s në rajonin tonë, p.sh., me Kroacinë dhe Sllovenine, të cilat, zakonisht, ofrojnë të njëjtin nivel kontributesh në NRF dhe në të njëjtën kategori. Por, bashkëpunimi dypalësh mund të ndërtohet edhe me vende të veçanta, si p.sh., me Italinë, me të cilën, komanda e Forcave Tokësore dhe batalioni i dytë i këmbësorisë ka një marrëveshje bashkëpunimi, ose me Gjermaninë, Turqinë etj.

2. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit me shtabet e Strukturës së Forcës së NATO-s (GRF) (Graduated Readiness Forces) që kanë deklaruar pjesëmarrjen e tyre në të njëjtën NRF. Atashimi i forcës do të përfshinte trajnimin, certifikimin, komandim-drejtimin

dhe zgjidhjen e problemeve të transportit strategjik gjatë kohës së trajnimit, apo çfarë është më e rëndësishme më pas, edhe në periudhën e qëndrimit të gatshëm (Stand by) dhe dislokimit në Zonën e Operacionit. Struktura të tilla janë Korpuset e Reagimit të Shpejtë të NATO-s (NATO Rapid Deployabe Corps). Theksoj me këtë rast se pjesëmarrja e vendit tonë me oficerë shtabi në tre nga shtatë Korpuset e Reagimit të Shpejtë të NATO-s[8] është dobiprurës jo vetëm për kontributin e drejtpërdrejtë që jep në Strukturën e Forcës së NATO-s, por edhe sepse kemi mundësinë të kërkojmë bashkëpunimin e tyre të bazuar në marrëveshjet e nënshkruara për anëtarësim në këto struktura. Ne kemi personelin e emëruar aty, i cili do të na shërbejë si pikë kontakti për lehtësimin e këtij bashkëpunimi. Atashimi në NRF si proces është i inkurajuar edhe nga NATO dhe i zbatuar edhe në një sërë vendesh anëtare.

Një tjetër mekanizëm dobiprurës i planifikimit të kontributeve në NRF është deklarimi i të njëjtit kontribut për disa rotacione rresht. Kjo do të thotë që një kontribut i caktuar, p.sh., Toga e Policisë Ushtarake e deklaruar në NRF 2014, mund të deklarohej edhe në NRF-n e vitit 2015, edhe në NRF-n e vitit 2016 e kështu me radhë. Ose kompania e këmbësorisë që është deklaruar në NRF-n e vitit 2016, mund të deklarohet edhe në NRF-n e vitit 2017, 2018 e më tej, në rast se NRF nuk do të angazhohej në misione. Ky mekanizëm na lejon kursimin e shpenzimeve për trajnim, kursimin e kohës dhe të energjive dhe përqendrimin te përparësitë e tjera.

Kështu, në mënyrë të përmbledhur, kemi: Në perspektivë, përcaktimi i kontributeve në NRF të bëhet në një dokument të vetëm, të quajtur Niveli Afatgjatë i Ambicies së FA-ve shqiptare në NRF për vitet, p.sh: 2016-2022. Ky dokument të deklarohet në NATO, dhe të përfshijë rreth 1-2 % të kapaciteteve kryesore të FA-ve shqiptare, ato të deklaruara edhe në "objektivat kombëtarë" në kuadër të NATO-s. Me deklarimin e kontributeve të vijojë paralelisht edhe procesi i atashimit (afilimit) të kontributeve me vende që kanë interes të ngjashëm në NRF, që është në fakt një proces negocimi e diskutimi me aleatët për trajnimin, certifikimin dhe dislokimin në rajonin e operacionit. Pas çdo konference për NRF-n, mbështetur në kërkesat e NATO-s, të deklarohen kontributet e përcaktuara në Nivelin e Ambicies Kombëtare në NRF, duke ruajtur të drejtën kombëtare për modifikime e ndryshime të pjesshme. Ky në thelb është procesi kombëtar që vlerësoj se duhet të ndjekim në perspektivë për planëzimin dhe materializimin e kontributeve në NRF.

Konkretisht, mbështetur në arsyetimin e mësipërm, vlerësoj që në NRF të konsiderohen si kontribute kandidate për NRF-n, kompanitë e batalionit të dytë të këmbësorisë së motorizuar dhe nënrepartet e tjera mbështetëse të tij, në kuadër të "battle group"; po ashtu, mund të konsiderohen edhe Forcat Speciale (2-3 grupe speciale), sidomos pas përvojës së shkëlqyer të grumbulluar nga pjesëmarrja në operacionin e ISAF-it, kapacitete "niche", të tilla si: toga EOD, grupe, nëngrupe HUMINT, grupi i kontrollit të lëvizjes, toga kimike apo laboratori i kimisë etj. Ky grupim forcash, të deklaruara edhe si pjesë e objektivave kombëtare në NATO, duhet të përbëjë edhe grupimin e Forcave kandidate për NRF-n.

Përfundime

Në 10 vitet e fundit, vëmendja e NATO-s ka qenë e përqendruar te pjesëmarrja në operacione. Për shkak të angazhimit të saj operacional, në më shumë se 6 operacione

[8] Vendi ynë aktualisht është anëtarësuar në 2 Korpuse të Reagimit të Shpejtë, (Turqi dhe Greqi) dhe është në procedura dërgimi i një oficer shtabi në Itali.

njëherësh, me një numër trupash që shkonte në më shumë se 150 mijë vetë, ka bërë, që, për këtë periudhë kohore, NRF të mos jetë në qendër të vëmendjes së NATO-s dhe vendeve anëtare.

Tashmë, kur angazhimi në operacione po reduktohet në mënyrë të ndjeshme (vetëm në ISAF reduktimi ka shkuar nga 130 mijë vetë në 2012, në rreth 12-15 mijë vetë në janar 2015), NRF po rikthehen në qendër të vëmendjes së Aleancës, ashtu siç është përcaktuar si një "mekanizëm që transformon forcën". Kjo ambicie është tashmë zyrtare edhe në dokumentet kryesorë planëzues të Aleancës. Direktiva e stërvitjes të SACEUR për vitin 2014 e përcakton këtë kërkesë kur thekson se: Aleanca do të kalojë gradualisht nga angazhimi operacional, në përgatitjen operacionale. Planëzimi i stërvitjes "Trident Juncture 2015", si një nga stërvitjet me shikueshmëri të lartë të NATO-s dhe nga më të mëdhatë e NATO-s në 10-vjetshin e fundit, e përforcon këtë kërkesë të Aleancës.

Vendi ynë, FA-të shqiptare si anëtare të saj, do të duhet të ndjekin këtë trend. Në fakt, ashtu siç theksuam qysh në fillim të këtij shkrimi, ky mesazh i NATO-s është ndjekur dhe pasqyruar nga strukturat e Planifikimit të MM-së e SHP-së, dhe është materializuar në dokumentet zyrtare kryesore planëzuese të saj, te "Direktiva e Mbrojtjes" dhe "Udhëzimet e SHP-së për stërvitjen e vitit 2014".

Megjithatë, në perspektivë, mbështetur në direktivat e NATO-s, tendencat e vendeve anëtare dhe mësimet e nxjerra nga përvoja e deritanishme e angazhimit të FA-ve shqiptare në këtë strukturë, kontributi i FA-ve shqiptare në NRF, si përvojë e re, vlerësoj se ka nevojë të jetë më i studiuar, më i planëzuar, për një periudhë më afatgjatë dhe i materializuar si ambicie në një dokument më vete.

Bibliografia:

- NATO: Ready, Robust, Rebalance, Speech by NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen at the Carnegie Europe Event.
- Multinational forces conduct complex and highly integrated operations on land, sea, and in the airspace over Europe during Exercise Steadfast Jazz 2013.
- North Atlantic Treaty Organization, "The NATO Response Force: At the centre of NATO transformation."
- Projekt kërkimor- Zhvillim Koncepti: Zhvillimi i pozicionit tonë kombëtar dhe i kapaciteteve për pjesëmarrje në Forcën e Reagimit të Shpejtë (NRF) të NATO-s. Ilir Pujo, KDS, maj 2010.
- Direktiva e Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2014.
- Udhëzimet Vjetore të Stërvitjes së SHPFA për vitin 2014.
- Faqja zyrtare e NATO-s, The NATO Response Force At the centre of NATO transformation http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49755.htm

Krimea: Parajsa e rifituar e Rusisë?!

Enkelejda Malaj

Trajtesë e shkurtuar. *Ngjarjet e muajve të fundit në Krime mund të duken si të ardhura nga shekujt e kaluar. Madje pak muaj më parë, shumëkujt mund t'i ishin dukur të paimagjinueshme që mund të ndodhnin në 2014. Por e vërteta e realpolitik-ës nuk është hera e parë që habit.*

Rusia, jo vetëm që ka aneksuar Krimenë, jo vetëm që e ka bërë këtë përmes një instrumenti demokratik, si referendumi popullor, madje me një rezultat të shkëlqyer, të dirigjuar në Krime dhe Sevastopol, në përpjekje për të legjitimuar qëndrimin e saj, por ka ngjallur dyshime dhe nxitur frikëra të reja për të ardhmen e Ukrainës dhe jo vetëm.

Në këtë artikull do të përpiqem të jap një këndvështrim mbi arsyet që kanë nxitur Rusinë të ndjekë pa ngurim orekset e saj perandorake, në shpërfillje të së drejtës ndërkombëtare, të rendit botëror dhe sigurisht legjitimitetit dhe sovranitetit territorial të një vendi tjetër, siç është Ukraina. E në vijim, do të analizoj reagimin ndërkombëtar, në përgjigje të këtyre zhvillimeve si dhe ndikimet që pritet të kenë ato në të ardhmen e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Histori: çfarë përfaqëson Krimea?

Krimea është fort e njohur për Konferencën e famshme të Jaltës, e cila shënjoi historinë e ndarë të Evropës së shekullit të XX, Luftën e Ftohtë dhe pasojat e saj edhe në shekullin XXI.

Por a po vazhdon Krimea të japë simbolikisht mesazhe të tjera për ndarje të reja? A nuk është ajo edhe njëherë toka e përplasjeve të interesave, ambicieve, zonave të ndikimit? Sa, në fakt, janë zhvilluar shtetet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare?

Janë të shumta pyetjet që mund të renditim, në nisje të këtij diskutimi dhe, si gjithmonë, përgjigjet nuk janë fort të lehta, aq më pak për një punim modest.

Pa dashur të bëjmë një analizë të mirëfilltë historike të rastit vërtet unikal të gadishullit të Krimesë, do të themi gjithsesi se Krimea, për shkak të pozitës së saj strategjike gjeografike, ka qenë historikisht një territor i lakmuar që në antikitet nga të gjitha perandoritë e fuqitë e kohërave: romake, otomane, ruse, britanike, franceze, Gjermania naziste, Bashkimi Sovjetik e deri te Rusia e sotme.

Gadishulli pro rus i Krimesë, dihet që u bë pjesë e Perandorisë Ruse në shekullin e 18-të, nën drejtimin e Katerinës së Madhe. Në po atë kohë, Sevastopoli kthehet në bazë detare e Rusisë në Detin e Zi. Më shumë se një milion viktima u regjistruan në Luftën e Krimesë

nga 1853-56, mes Rusisë dhe Perandorisë Otomane, të mbështetura përkatësisht nga Britania dhe Franca.

Në vitin 1921, pas luftimesh mes Ushtrisë së Bardhë dhe asaj të Kuqe dhe fitores së kësaj të fundit, gadishulli iu bashkua Bashkimit Sovjetik. Pas kësaj, fati i pakicave etnike: armene, greke dhe sidomos i myslimanëve tartarë, të cilët kanë përbërë shumicën e popullsisë në gadishull, të paktën që prej shekullit XV, mori një kthesë fatkeqe. Në fund të Luftës së dytë Botërore, Jozef Stalini urdhëroi deportimin masiv të tyre nga Krimea, me pretekstin se kishin bashkëpunuar me nazistët. Pavarësisht se tartarët kishin krijuar Legjionin Tartar, në mbështetje të ushtrisë naziste, krahas tyre kishte patur një numër të madh tartarësh që kishin shërbyer në Ushtrinë e Kuqe, por kjo e fundit rezultonte më pak e rëndësishme se e para, sa kohë që politikat e spastrimit etnik dhe përmbysjes së raporteve të popullsisë merrnin përparësi gjeostrategjike.

Krimea vijoi të ishte pjesë e territoreve ruse, të Bashkimit Sovjetik, deri në vitin 1954 kur, siç edhe dihet, Nikita Hrushovi e kaloi brenda kufijve të Ukrainës Sovjetike. Asokohe një gjë e tillë nuk do të thoshte ndonjë gjë të madhe, sa kohë territori mbetej brenda Bashkimit Sovjetik, por në vitin 1991 Ukraina bëhet shtet i pavarur dhe Krimea mbetet brenda territorit të saj.

Pozicioni i saj në Detin e Zi, me portet tregtare, rreth 12 të tilla, lehtësisht të arritshme nga Lindja e Mesme, Ballkani, Mesdheu Lindor, Kaspiku dhe Kaukazi, e bën shumë të qartë dhe të kuptueshme ambicien aneksuese të Rusisë, në rastin tonë. Qyteti i Sevastopolit, baza e Flotës Ruse në Detin e Zi, me një personel prej disa mijë ushtarakësh, shtrihet në bregdetin jugor të gadishullit. Madje, para rënies së Bashkimit Sovjetik, Sevastopoli mbante gjysmën e Flotës Ruse. Ish presidenti Viktor Jushçenko kishte paralajmëruar që flota duhej të largohej në vitin 2017, sipas marrëveshjeve ndërshtetërore, ndërsa krejt tjetër ishte sinjali i lëshuar nga ish presidenti pro rus Viktor Janukoviç, i cili kishte lënë të kuptohej se Flota Ruse mund të qëndronte deri më 2042, në shkëmbim të çmimeve më të ulëta të gazit rus. Largimi i Janukoviçit dhe ardhja në Kiev e një qeverie pro perëndimore risillte frikën e largimit të flotës nga baza e Sevastopolit.

Por Krimea nuk është vetëm baza e Flotës Ruse në Detin e Zi. Krimea përbën 3 % të PPB-së së Ukrainës. Vetëm gruri i prodhuar në fushat e Krimesë përbën 6.6 % të eksporteve të Ukrainës. Për më tepër, Krimea është edhe një destinacion i njohur turistik. Në prill të 2014, Vladimir Putin ka paraqitur një draft ligj, ku bën të njohur planin e tij për ta kthyer Krimenë në një zonë të njohur për biznesin e kumarit dhe kazinove, duke orientuar zhvillimin ekonomik të gadishullit drejt këtij biznesi fitimprurës[1].

Në respekt të së vërtetës, duhet të themi se Krimea e 2014 është një gadishull i shkëputur nga pjesa tjetër e Ukrainës, jo vetëm gjeografikisht, por edhe historikisht e politikisht. Politikat këmbëngulëse të Moskës, pavarësisht regjimeve, për rusizimin e kësaj krahine janë arsyeja e realitetit të sotëm etnik, kulturor e social të Krimesë dhe Sevastopolit. Ajo ka qenë, deri pak kohë më parë, i vetmi rajon autonom brenda Ukrainës, ashtu sikundër edhe Sevastopoli ka patur një status të veçantë brenda shtetit ukrainas. Rreth 60 % e popullsisë vetëdeklarohen rusë, vetëm 24 % ukrainas dhe 12 % tartarë, të cilët janë rikthyer në Krime vetëm pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik e që, përgjithësisht, janë mbështetës të palës pro perëndimore, që çoi në largimin e Janukoviçit nga pushteti.

[1] http://www.bbc.com/news/world-europe-27101228

Por me arritjen e qëllimit të vjetër, pra aneksimin e Krimesë, Moska nuk është më ajo e para, e politikave të rrepta raciste dhe spastrimeve etnike. Vladimir Putini ka ofruar një marrëveshje për etnitë jo ruse në Krime, me dekretimin e një akti për rehabilitimin e tartarëve të Krimesë, si edhe të popullsisë armene, gjermane, greke, me një fjalë të të gjitha popullsive në Krime, që vuajtën nga politikat spastruese të Stalinit, në përpjekje për të premtuar një të ardhme të paqtë në Krimenë e re ruse[2].

Përse vjen kjo ndërhyrje e Rusisë?

Kriza në Ukrainë i ka rrënjët në procesin e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik para më shumë se dy dhjetëvjeçarësh. Ukraina është një vend që pasqyron ndarje të thella etnike dhe kulturore, përqendrim të popullsisë etnike ruse në lindje dhe asaj ukrainase në perëndim, duke përfshirë edhe kryeqendrën e vendit.

Muaj të tërë protestash të dhunshme kundër një qeverie pro ruse, që shfaqte dukshëm mungesën e dëshirës dhe vullnetit politik për të zgjeruar dhe forcuar marrëdhëniet me Bashkimin Evropian, çuan në marrëveshjen e 21 shkurtit, ndryshime kushtetuese dhe zgjedhje të parakohshme. Nga ana tjetër, Rusia nuk mund të pranonte rrëzimin, në këtë mënyrë, të një presidenti të zgjedhur pro-rus dhe ardhjen, në krye të Kievit, të një qeverie pro perëndimore, e cila kuptueshëm do të pengonte realizimin e planeve ruse për Ukrainën, Krimenë, të ardhmen e tyre dhe sigurisht të ardhmen e pranisë dhe ndikimit rus në to. Kështu, Rusia dërgon trupat e saj në Krime dhe Putini flet për shtypjen e të drejtave të rusëve në Krime, të cilët natyrshëm kërkonin mbrojtje nga Rusia.

Me habi kemi parë sesi, megjithë kundërshtimet nga ana e Ukrainës, Kombeve të Bashkuara, Shteteve të Bashkuara, vendeve të Bashkimit Evropian, Rusia dirigjoi me zell e kompetencë referendumin e pavarësisë së Krimesë dhe e paraqiti si një shembull të ligjshëm të triumfit të së drejtës së vetëvendosjes. Dhe jo vetëm kaq. Ndërsa Shtëpia e Bardhë dhe Bashkimi Evropian diskutonin mbi vendosjen e sanksioneve, Moska dhe Krimea u treguan më të shpejta në dakordësimin e tyre dhe vijuan me paketën legjislative dhe realizimin *de jure* të aneksimit të plotë të gadishullit. Për më tepër, ky zhvillim i hapi rrugën forcave pro ruse në një sërë krahinash në Ukrainën lindore që të kërkojnë, me ngulm e protesta, të njëjtën gjë si Krimea. Me po të njëjtën logjikë, Putini deklaronte se do të mbështeste kërkesat e rusëve etnikë kudo që ishin dhe do t'i mbronte nga politikat diskriminuese të Kievit, duke shtuar frikën për sulm ushtarak.

E ndërsa Ukraina dhe perëndimi shihnin me shqetësim zgjerimin e protestave kundër Kievit në krahinat lindore e jugore të Ukrainës, në Donetsk e Lugansk, frika e shkëputjeve të reja dhe cenimi i mëtejshëm i sovranitetit territorial të Ukrainës, në një farë mënyre, e eklipsuan rastin e Krimesë dhe aneksimin e saj. Por ndërsa krahinat lindore e jugore të Ukrainës vijojnë të sfidojnë pushtetin e Kievit, duke bërë thirrje për decentralizim dhe një rregullim të natyrës federale, Moska përcjell mesazhe mbështetëse për kërkesat e drejta të popullsisë ruse, me shpresën se çdo lloj forme decentralizimi do të mundësojë që këto krahina të mbajnë marrëdhënie më të ngushta me Moskën e ku i dihet më tej. Në fakt, asgjë nga Moska nuk flet hapur për realitete të reja aneksimi apo shkëputjeje, por rasti i Krimesë dhe politikat e spastrimit në fillim të shekullit të kaluar nuk kanë se si të mos na bëjnë përshtypje dhe të shtrojnë argumente se asnjë veprim rus nuk mund të merret si i rastësishëm ose i izoluar në kohë dhe hapësirë. Moska flet për negociata, për bisedime

[2] Ibid.

mes palëve dhe gjetjen e një marrëveshjeje, ndërkohë që teza të tilla nuk u dukën aq tërheqëse në rastin e aneksimit të Krimesë. Dhe jo vetëm kaq. Putini ka guximin edhe të shprehet se Rusia kërkon marrëdhënie të mira me vëllezërit ukrainas, duke drejtuar gishtin tek fuqitë perëndimore që po përpiqen të fusin shkopinj në marrëdhëniet ruso-ukrainase.

Por si mund të shpjegohet kjo politikë ruse, në një kohë që imazhi i Rusisë si një aktor i madh e i përgjegjshëm në arenën ndërkombëtare do të cenohej e aq më shumë interesat e saj ekonomike? Pa diskutim që me aneksimin e Krimesë, Kremlini ka parashikuar se, pavarësisht dëmit të jashtëm, në kontekstin kombëtar dhe në Krime kjo do të shihej si një lëvizje e suksesshme, demonstrim i fuqisë në rritje të Rusisë dhe triumf mbi politikat e perëndimit të cilat synojnë minim të fuqisë dhe ndikimit rus.

Kujtojmë se, ashtu si në rastin e Serbisë me Kosovën, edhe Krimea për rusët është e lidhur fort me ndërgjegjen kombëtare dhe luftërat e përgjakshme të Sevastopolit për të mbrojtur madhështinë e kombit rus. Ngjajnë shumë të njohura shprehje të tilla si: Krimea është e "larë në gjakun rus", të cilat lehtësisht mund t'i krahasojmë me "djepin e atij apo këtij vendi".

Kjo, në fakt, shpjegon edhe të drejtën që parlamenti rus i dha Putinit për të ndërhyrë ushtarakisht në Ukrainë, nëse do të ishte e nevojshme. Natyrshëm lind pyetja: për çfarë të drejte në nivel marrëdhëniesh ndërkombëtare flasim? Si mundet një parlament i një vendi të vendosë për "të drejtën" për të ndërhyrë ushtarakisht në një vend tjetër sovran? Aq më tepër kur nuk bëhet fjalë për abuzim me parimin e përgjegjësisë për të qeverisur, pra kur nuk kemi të bëjmë as me dhunë, as genocid e as spastrim etnik? Përkundrazi për një krahinë që gëzon një status të veçantë qeverisjeje, brenda një shteti sovran. Paranoja ruse që shtetet e perëndimit, prej dhjetëvjeçarësh, kanë vetëm një synim: atë të dobësimit të Rusisë, edhe një herë shfaqet nën argumentin se aneksimi i Krimesë u bë për arsye të mbrojtjes kombëtare e përndryshe NATO do të arrinte të dëbonte Rusinë nga pozicioni i saj i merituar në Detin e Zi. Por, nga ana tjetër, Rusia nuk është e pandjeshme ndaj dëmit që kjo i ka shkaktuar dhe mund t'i shkaktojë në të ardhmen, si në aspektin e pozitës ndërkombëtare dhe atë ekonomike. Megjithë dyshimet dhe frikërat ruse për dashamirësinë perëndimore ndaj tyre, apo dëshirën e rilindur ruse për imperializmin e të shkuarës, izolimi ndërkombëtar nuk është diçka që Rusia e dëshiron. E megjithatë, rehabilitimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit pas krizës ukrainase nuk do të jetë një gjë e lehtë për palët.

Kriza në Krime dhe reagimi ndërkombëtar

Kriza në Ukrainë, për fat të keq, tregoi se, pavarësisht se sa të befasishme e të rënda janë situatat që shpërthejnë nëpër botë, reagimi i përbashkët ndërkombëtar në kundërpërgjigje të tyre vijon të mbetet problematik dhe i vështirë për t'u arritur në kohë. Veçanërisht, vendet evropiane vijojnë të shfaqin të njëjtën inkoherencë në qëndrime e ritëm reagimi, atë që kemi parë edhe në shumë raste të tjera, në dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit.

Sekretari anglez për Politikën e Jashtme, *William Hague*, u shpreh se përgjigja për veprimet e Rusisë duhet të jenë sanksione të reja. Ndërsa ministri i Jashtëm holandez, *Frans Timmermans*, u shpreh se ishte shumë herët për të vendosur sanksione. Ministri i Jashtëm suedez, *Karl Bildt* mendonte se nëse rusët do ta përshkallëzonin situatën, të njëjtën gjë duhet të bënte edhe Perëndimi. Presidenti *Holland* është cituar se i kishte thënë *Obamës* se Franca dëshironte veprime të vendosura, por graduale, të kujdesshme. Nga ana e tij,

zv.kancelari gjerman, *Sigmar Gabriel*, i bëri thirrje Evropës për më shumë diplomaci se sanksione dhe se llomotitjet kërcënuese të NATO-s nuk ishin zgjidhja e duhur për rastin në fjalë[3]. Edhe vende të tjera evropiane si Italia dhe Spanja u treguan të kujdesshme në pozicionimin e tyre.

E nëse Evropa nuk ishte e sigurt dhe e qartë në reagimin e saj, Rusia e pa shumë qartë hezitimin e tyre për t'u përballur me Moskën. Edhe pse Evropa arriti ta mblidhte mendjen për të vendosur sanksione ekonomike ndaj Rusisë, sërish hezitimi evropian ishte një gol në favor të Rusisë. Aq më tepër, në një situatë ekstreme: atë të ndërhyrjes në favor të ndryshimit të kufijve të një shteti nga një shtet tjetër.

Ka pasur analiza në Shqipëri dhe jashtë që e kanë krahasuar situatën në fjalë me rastin e Kosovës dhe ndërhyrjen e NATO-s atje. Në mendimin tim, ka të paktën dy elementë që e bëjnë situatën krejt të pakrahasueshme. I pari ka të bëjë me atë që përmenda më lart në këtë artikull. Në rastin e Krimesë flasim për një krahinë me status special, për kufij të rënë dakord mes Ukrainës dhe Rusisë në kohën e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Të dyja këto aspekte nuk qëndrojnë në rastin e Kosovës. Tjetër ndryshim lidhet me atë që përmenda gjithashtu më lart, të respektimit të parimit të përgjegjësisë për të qeverisur. Në rastin e Kosovës, shteti serb kishte nisur prej vitesh një propagandë antishqiptare, mohimin dhe anulimin edhe të atyre të drejtave të fituara dhjetëvjeçarë më parë e, për më tepër, promovim të politikave diskriminuese, spastrimit etnik dhe dhunës etnike. Krimea ishte një realitet krejt i ndryshëm prej kësaj. Për më tepër, në rastin e Kosovës ndërhyrja ushtarake nuk ishte një ndërmarrje e një shteti tjetër njësoj sovran si ai serb, por gjithsesi nga një organizëm ndërkombëtar, një vendimmarrje e gjerë kolektive, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe paqes në rajon e botë. Unë jam e mendimit, se sado e debatueshme, një vendimmarrje e gjerë dhe në kontekstin e lartpërshkruar ka shumë më tepër legjitimitet se orkestrimi rus i aneksimit të Krimesë, në emër të lirisë për vetëvendosje, një parim që Moska herë e ka kundërshtuar, si në rastin e Kosovës dhe herë e ka mbështetur, si në rastin e krahinave separatiste Abkazi e Osetia e Jugut në Gjeorgji.

E përsëri, dyshimi që lind në këtë linjë të menduari është: mos vallë njohja e Kosovës nga Rusia do të kalojë përmes njohjes së aneksimit të Krimesë nga perëndimi??

Në diplomaci është e njohur aksioma që suksesi arrihet kur njëra palë arrin të bindë palën kundërshtare se rezultati i arritur është ai i dëshiruari për të. Kjo ka ndodhur me Rusinë fitimtare. Tensionet e nxitura në Ukrainën lindore, në Donetsk e gjetkë, pushtimi i institucioneve të ligjshme nga rebelë të armatosur që sfidojnë Kievin, menjëherë pas aneksimit spektakular të Krimesë, bënë që përpjekjet diplomatike të fokusohen menjëherë në Ukrainën lindore dhe eklipsimin e aneksimit të Krimesë. Ndaj unë them se Rusia është fitimtarja e të paktën kësaj dore kumari.

Ndikimi i aneksimit dhe e ardhmja

Por shumëçka ka ndryshuar në këtë zgjim të Rusisë, aneksim të Krimesë dhe fushatës me kërcënime ushtarake për Ukrainën. Moska ka cenuar thelbin e diplomacisë, që ka karakterizuar marrëdhëniet ndërshtetërore në Evropë, që prej fundit të Luftës së Ftohtë. Dhe përveç asaj që ka ndodhur deri tani me Krimenë dhe më tej me mbështetjen e

[3] Ibid.

destabilizimit të mëtejshëm të Ukrainës, askush nuk është në gjendje të thotë se çfarë synon Rusia dhe ku do të ndalet. Është përmendur termi "revanshizëm", pasi ka nga ata që mendojnë se Rusia mendon se me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, Perëndimi e trajtoi atë si palë të humbur. Ndërsa fuqizimi ekonomik i dhjetëvjeçarit të fundit dhe, për më tepër, Krimea e Ukraina janë tregues të rikthimit të Rusisë në skenë si fitimtare dhe sfiduese e trajtimit pa respekt të Perëndimit. Sjellja imponuese e Rusisë, në oborrin e vet, pra në Krime, Rusi, Gjeorgji, Moldavi, etj., është, në një mënyrë, mesazhi që Rusia dëshiron t'ia bëjë të ditur Perëndimit: "Kjo është 'perandoria' ime dhe këtu vendos unë".

Në fakt, është e qartë për të gjithë se ajo të ndodhi me Krimenë dhe zhvillimet e pazakonta në Ukrainën Lindore kanë sjellë pikëpyetje të reja të mëdha për sigurinë në botë. Ato kanë sjellë në skenë me vërtetësi thekëse disa rreziqe tradicionale, që me naivitet mund t'i kishim konsideruar të dala nga moda. Ato e kanë bërë të qartë se koha në të cilën jetojmë mund të jetë, në një pjesë të madhe, e sunduar nga rreziqet asimetrike jo konvencionale, por ato konvencionale janë sërish të pranishme. Këto zhvillime, jam e bindur se kanë shtuar, brenda ditës, vlerën e anëtarësimit në NATO të vendeve si ato baltike dhe jo vetëm.

NATO, megjithë tendencën për të orientuar transformimin e saj drejt rreziqeve asimetrike, duhet sërish të rikonsiderojë rreziqet e mundshme për sigurinë e vendeve anëtare. Të mos harrojmë se Ukraina është një vend partner i NATO-s e megjithatë Rusia nuk u duk dhe nuk duket fort e frikur nga kjo. E natyrshëm pyetja lind: e nëse Rusia guxon të bëjë lojëra nesër apo pasnesër me një vend tjetër? Në këtë kontekst, pyetja tjetër që ngrihet është si do të jetë e ardhmja e marrëdhënieve NATO-Rusi? Dhe a mos vallë e gjithë përpjekja për të ndërtuar e konsoliduar një partneritet të qenësishëm me Rusinë është e kotë?

Në fakt, brenda natës, duket se mbrojtja e kufijve dhe garantimi i sigurisë së vendeve anëtare është rikthyer në krye të axhendës së NATO-s. Marrëdhëniet NATO-Rusi duket se do të kalojnë nëpër shtigje të vështira. NATO, me siguri, nuk do të tolerojë shumë gjëra. Ka patur kritikë dhe analistë që janë shprehur se zgjerimi i NATO-s drejt Lindjes ka qenë një shtysë e fortë për të tilla veprime nga ana e Rusisë, e cila është provokuar dhe ndjerë e rrethuar nga NATO, vende anëtare dhe partnere. Por unë jam e mendimit se, në fund të fundit, Perëndimi nuk ka pse të marrë si të mirëqenë të përjetshme se Rusia duhet të ketë ekskluzivitetin në vende që, dukshëm, janë lodhur nga dominimi rus, si në rastin e Polonisë, vendeve balltike e të tjera vende të Lindjes. Nga ana tjetër, me një Rusi që me bindje e ftohtësi provokon konflikt dhe thyen rregullat ndërkombëtare, të cilat ajo pretendon të mbrojë, nuk është fort e palogjikshme që NATO të përpiqet të minimizojë ndikimin e saj. Në fund të fundit, megjithë tolerimin evropian dhe perëndimor ndaj Putinit, për të gjithë është e qartë si drita e diellit që demokracia dhe Rusia do të vazhdojnë të kenë një marrëdhënie të vështirë edhe për shumë kohë e për rrjedhojë, Rusia do të vijojë të jetë, për një sërë arsyesh që e bëjnë një aktor të madh, burim pasigurie, provokimi e të papriturash të rrezikshme për sigurinë në botë.

Dhe nëse rregullat e lojës kanë ndryshuar dhe me gjasë mund të ndryshojnë edhe më, a mos është koha që Evropa të ndryshojë edhe mendësinë e saj për buxhetet ushtarake? Të rrisë ato apo të lërë mënjanë diferencat dhe të paktën të bashkojë më mirë shpenzimet dhe kapacitetet ushtarake? Megjithë shtysën amerikane, Evropa nuk ka arritur të ndryshojë në këtë pikë, por mbase kjo që ndodhi në Krime e Rusi do të shërbejë si një këmbanë për

të gjithë: që siguria nuk është asnjëherë e sigurt; që zhvillimi ekonomik nuk ka të ardhme pa garantimin e sigurisë.

E Rusia ka treguar me këto që ndodhën se ndihet e fortë. Ajo sheh një Amerikë të hutuar e të dobët në Afganistan, në Siri, në Iran e gjetkë. Rusia sheh një Evropë, elitat e së cilës janë të përqendruara tek milionat dhe e gatshme të mbyllë sytë para lojërave dhe shkeljeve ruse. Miliardat ruse, të depozituara në Evropë apo ato që do vijnë, megjithë sanksionet e vendosura, do ta gjejnë vetë rrugën e paqësimit dhe Rusia do të vijojë të shijojë frytet e një Evrope të pavendosur, ashtu si Ben Judah, një njohës i mirë i politikave putiniane, vlerëson kur thotë se Rusia nuk e ka më frikë Perëndimin, pasi ka zbuluar "sekretin e pisët" që me para mund të blejë heshtjen evropiane.

Bibliografia:

- http://www.bbc.com/news/world-europe-27101228
- http://www.bbc.com/news/world-europe-27031261
- Ben Judah; " Why Russia no longer fears the West"; *http://www.politico.com/magazine/story/2014/03/russia-vladimir-putin-the-west-104134.html#.U38a3NKSzrR*

Lidershipi në luftim

Kolonel Dritan Demiraj
Shef i Qendrës së Simulimit, KDS

Trajtesë e shkurtuar. *Në këtë shkrim trajtohet një çështje shumë e rëndësishme që ka të bëjë me lidershipin e mirë dhe me përvojë, ku drejtuesit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin me sukses të operacioneve. Gjithashtu trajtohen dhe shembujt më të mirë të drejtuesve tanë, të cilët kanë drejtuar operacione luftarake në zonat më të rrezikshme të globit si në Afganistan, etj. Cilat janë karakteristikat e liderit në fushëbetejë, shkaqet kryesore që ndikojnë në sigurinë operacionale dhe se çfarë duhet të bëjnë ata në rastet kur ka humbje jetësh në luftim, si duhet të komunikojnë me familjen, shtabin e përgjithshëm dhe si duhet të veprojnë për sigurimin e vazhdimësisë së kryerjes së operacioneve, duke mos lejuar uljen e moralit dhe vigjilencës në detyrë?*

Duke marrë në konsideratë që pjesëmarrja e FA-ve në operacionet paqeruajtëse dhe luftarake, prej më shumë se 15 vitesh, ka bërë të mundur që tashmë dhe në ushtrinë tonë të ketë drejtues me përvojë të cilët, me shumë guxim, dinjitet dhe profesionalizëm, kanë fituar besimin jo vetëm të drejtuesve më të lartë të shtetit shqiptar dhe të FA-ve, por dhe të drejtuesve të NATO-s dhe SHBA-ve. Përvoja e fituar sidomos në misionet luftarake "Eagle 1-7" ka bërë që të rritet ndjeshëm niveli i drejtimit të komandantëve të kontingjenteve dhe i komandantëve të grupeve speciale, përvojë e cila po transmetohet në të gjithë ushtrinë në trajtën e mësimeve të nxjerra dhe të programeve stërvitore paradislokuese

Sfidat e drejtuesit gjatë misionit

Komunikimi me familjen në atdhe dhe siguria operacionale (OPSEC)

Kërkesa për informacion është e lartë. Të plotësosh kushtet e kësaj nevoje, të fokusuar në mënyrë operacionale dhe në bazë të sigurisë operacionale (OPSEC), është sfidë e veçantë dhe aspak e lehtë për kushtet tona. Operatorët e FS duhet të jenë të disiplinuar për të ndjekur rregulloret në fuqi, kur komunikojnë me familjet e tyre dhe kur përdorin adresa të rrjeteve sociale, pasi vetë qënia e tyre në njësi elitë të cilat kryejnë detyra me rëndësi operacionale dhe strategjike, kërkon një ruajtje me rigorozitet të natyrës së misioneve, kohës, vendit, objektivave, etj., të cilat jo vetëm që mund të rrezikojnë jetën e operatorëve, por mund të kenë gjithashtu dhe implikime shumë të mëdha politike deri për politikën e jashtme të RSH. Në shumicën e rasteve, ushtarakët në mision, për shkak të neglizhencës, mund të përcjellin nëpërmjet rrjeteve sociale të komunikimit informacione në lidhje me vendndodhjen e tyre, detyrat që kanë kryer dhe

që do të kryejnë. Liderët e drejtpërdrejtë duhet të jenë gjithmonë të siguruar që efektivi është i njohur me rregullat e komunikimit dhe përdorimit të rrjeteve sociale, me qëllim mbrojtjen e informacionit dhe rritjen e sigurisë operacionale (OPSEC).

Prania e liderit në fushëbetejë

Një lider duhet të drejtojë në fushëbetejë për të parë, komunikuar dhe drejtuar vartësit e tij, duke fituar një kuptim më të mirë të kushteve në të cilat ata operojnë. Prania e liderit (komandantit) në operacionet luftarake speciale, motivon moralisht ushtarakët në mision. Kjo rrit besimin që vartësit kanë tek liderët e tyre dhe gjejnë motivimin e duhur për të realizuar, me sa më shumë sukses, detyrat e ngarkuara. Gjetja e kohës për të kryer qarkullimin në fushëbetejë, drejtuar dhe komanduar sa më shumë që të jetë e mundur, operacione të tilla, do të jetë sfidë. Liderët jo gjithmonë do të kenë kohë për të qenë të pranishëm në çdo operacion. Në varësi të axhendës së tyre, liderët ushtarakë duhet të vendosin përparësitë, përsa i përket pjesëmarrjes në operacione me njësitë vartëse.

Koha të cilën drejtuesit kalojnë duke drejtuar misionet drejtpërdrejt në terren, ka bërë të mundur rritjen e motivimit tek efektivi, por jo vetëm kaq dhe rritjen dukshëm të suksesit për realizimin e misioneve.

Prania fizike e komandantit në mision, gjykoj se është e vetmja mënyrë për të parë se cilat janë kushtet të cilat hasin njerëzit tanë në mision, për të kuptuar plotësisht ambientin operacional, anët pozitive të stërvitjes paradislokuese, pajisjet, armatimin, mjetet e komunikimit, pajisjet e zbulimit, mjetet e shikimit të natës, mjetet e blinduara, nivelin e përgatitjes teknike, taktike dhe fizike të trupave tona, masat që duheshin marrë me qëllim rritjen në vijimësi të nivelit operacional dhe uljen, sa më shumë që të ishte e mundur, të rrezikut të trupave në luftim.

Vetëkënaqësia

Misionet apo detyrat e tejzgjatura që krijojnë mundësi për argëtim, në shumicën e rasteve, krijojnë një ndjenjë sigurie false tek njësitë apo operatorët gjatë misionit. Kjo lloj ndjenje shkaktohet nga disa shkaqe, por në thelb, vetëkënaqësia mund të përkufizohet si ndjenjë vetëbesimi apo sigurie e pajustifikueshme, pasi anashkalohen apo neglizhohen mangësi dhe rreziqe të cilat, në pamje të parë, nuk konsiderohen si të tilla. Kjo paraqet një rrezik të madh, pasi operatorët në mision, humbin fokusin dhe përqëndrimin dhe ekspozohen ndaj rrezikut të papritur, i cili mund të ketë pajoja të rënda për individin ose për njësinë, pjesë e së cilës ai është. Për të parandaluar këto raste, drejtuesit duhet të ndërmarrin hapa të rëndësishëm, disa nga të cilat renditen si më poshtë vijon:

- Sigurimi për zbatimin e rregullave me precedencë.
- Rrotacioni i detyrave për njësi të ndryshme të realizohet duke dorëzuar të gjitha detajet që kanë lidhje me sigurinë në operacion.
- Kryerja e vazhdueshme e stërvitjes edhe gjatë kohës së qëndrimit në mision.
- Shpjegimi qartë dhe vazhdueshëm i qëllimit të misionit dhe arsyeja përse njësia ndodhet në mision si dhe njohja në vijimësi me detyrimet ligjore.
- Mosneglizhimi i përgatitjes fizike, si një element i cili mban lart përgatitjen dhe moralin e efektivit.
- Përcaktimi i qartë i objektivave afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.
- Marrja e masave për sigurimin e pushimit të nevojshëm nga vartësit dhe angazhimi i tyre në veprimtari jo ushtarake, kur janë pa angazhime detyrash.

- Përfshirja e të gjithë operatorëve në procesin e planëzimit dhe analizave të detyrave.
- Kryerja e stërvitjes për të papriturën dhe të mësuarit nga gabimet dhe mësimet e nxjerra.
- Eliminimi i të gjitha mangësive të cilat janë identifikuar në misionin paraardhës.
- Zbatimi me rigorozitet i procedurave standarde të veprimit (SOP).
- Kryerja e provave praktike para kryerjes së çdo operacioni special në detyrë dhe kontrolli i detajuar i njohurive mbi detyrën dhe i çdo pajisjeje që do të përdoret në mision.
- Njohja nga ana e drejtuesit të misionit i gjendjes morale, psikologjike, etj., për çdo operator efektiv të misionit.

Çfarë e bën efektiv drejtuesin gjatë misionit?

Aftësitë komunikuese

Një lider duhet të komunikojë efektivisht me vartësit e tij, të jetojë me ta dhe t'i dëgjojë me kujdes për t'u siguruar që qëllimi dhe misioni janë kuptuar drejt. Sipas gjykimit dhe përvojës sime, aftësitë si: figura morale[1], personaliteti, dinjiteti, komunikimi i duhur dhe mënyra e të shprehurit, aftësitë e drejtimit të misioneve, përgatitja taktike, teknike, profesionale, e lidhur ngushtë me detyrat e operacioneve speciale (si hedhjet me parashutë me efektivin, zhytjet në thellësitë e detit, qëndrimi në çdo stërvitje me efektivin në borë e në shi, vrapimi së bashku me të, etj.) qëndrimi pranë vartësve për t'i zgjidhur sa më shumë problemet e tyre, të luftuarit për t'i pajisur, stërvitur, trajnuar dhe shkolluar sa më mirë, të dëgjuarit dhe të respektuarit në rastet kur ata propozojnë çështje të ndryshme në lidhje me stërvitjen dhe realizimin e detyrave, të qëndruarit, sa më shumë të jetë e mundur, në krye të operacioneve, etj.[2], mendoj që janë disa nga cilësitë të cilat e bëjnë drejtuesin të respektuar para operatorëve.

Një lider duhet gjithashtu të komunikojë me shtabin lart dhe të mbështesë njësitë që ka nën komandë, për ta siguruar njësinë e tij se është duke marrë atë që nevojitet. Liderët marrin vendime dhe i marrin këto vendime sipas informacioneve që kanë siguruar për ta, vartësit e tyre. Informacioni duhet të jetë i kohës, i vlefshëm dhe i detajuar, në mënyrë që të lejojë marrjen e vendimeve të duhura dhe të mundësojë realizimin e misionit në mënyrë sa më të sigurtë që të jetë e mundur.

Të drejtosh me shembullin personal

Një lider duhet të jetë kompetent me operatorët e tij. Ai duhet të tregojë e të performojë në maksimum në mënyrën e sjelljes se çfarë ai pret nga vartësit e tij. Ai duhet të përcaktojë se cili është pozicioni më i mirë i komandimit dhe personave në detyrë dhe vendosjen e tij atje ku duhet. Prania e tij në detyra, sipas meje, e rrit ndjeshëm moralin e vartësve të tij, por në të njëjtën mënyrë, bën që të rritet së tepërmi siguria në operacion, pasi përvoja e një lideri të suksesshëm ndikon ndjeshëm në mosbërjen e gabimeve.

Zhvillimi i aftësive dhe besimi i vartësve

Një lider i mirë i kontrollon dhe i zhvillon aftësitë e vartësit të tij në atë nivel që mund ta zëvendësojë në pozicionin e tij, nëse i kërkohet. Ai duhet t'i trajnojë ata dhe t'i sigurojë

[1] Prof. Dr. Ruzhdi Ramadani, Prof. Dr. Kristaq Xharo, Prof Asc. Dr,Kolonel Edmond Braneshi, Udhëheqja Strategjike, f 78

[2] Dr. Qetsor Orhani, Prof. Asc. Dr. Edmond Braneshi, Majlinda Cukalla, Udhëheqja Ushtarake, f. 29.

atyre mundësinë për të realizuar çdo lloj stërvitjeje duke njohur mirë çdo lloj pajisje në kohë paqeje, të cilën më vonë do të duhet ta përdorin në terrenet operacionale, në mënyrë që në luftë ata të jenë me besim të plotë në kryerjen e detyrave të tyre[3]. Kontrolli vazhdueshëm i njohurive, testimet e herëpashershme, të qëndruarit pranë në stërvitje, etj., ndikojnë drejtpërdrejtë në njohjen e kapaciteteve operacionale dhe të gjendjes fizike dhe teknike të pajisjeve të misionit të efektivit.

Streset e luftës, shkaqet dhe masat që duhen marrë parasysh

FS janë forca elitare të cilat gjithmonë thirren për të kryer detyra dhe misione tepër të vështira, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Me shumë rëndësi janë misionet luftarake që FS shqiptare kryejnë aktualisht në Afganistan. Në shumicën e rasteve, detyrat taktike dhe operacionale që kryhen nga operatorët, nëngrupet apo grupet speciale janë të një shkalle rrezikshmërie tepër të lartë. Edhe pse të përgatitur, të mirëpajisur, të stërvitur dhe me përvojë për të përballuar sfidat e detyrave dhe të misioneve speciale, operatorët specialë janë gjithmonë të rrezikuar ndaj streseve të luftës. Faktorët që ndikojnë në shkaktimin e këtyre streseve mund të kategorizohen si faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Disa nga këto faktorë janë si më poshtë:[4]

- Kohëzgjatja 6-mujore deri në 1 vit e misioneve luftarake.
- Ridërgimi në misione apo detyra, duke mos lënë kohë të mjaftueshme për pushim.
- Fjetja gjatë misioneve më pak se 6 orë në ditë.
- Zgjatja e detyrave deri në 3 ditë.
- Përjetimi i vdekjes së një kolegu në operacion ose detyrë luftarake.
- Humbja e jetës së një familjari apo të afërmi gjatë kohës kur je në mision.
- Dëmtime serioze fizike.
- Pamundësia për të komunikuar me familjen në atdhe.
- Probleme financiare dhe personale në familje.
- Mungesa e besimit tek kolegët e nëngrupit apo grupit.
- Mangësia e kohezionit në grup.[5]

Prania e këtyre faktorëve nuk do të thotë që individi është detyrimisht i prekur nga stresi, por ekziston mundësia apo rreziku që ky individ të preket. Në këto rrethana, një lider i FS duhet të jetë në gjendje të dallojë shenjat dhe të parandalojë dëmtimet serioze nga streset e luftës. Disa nga streset e luftës janë si më poshtë vijon:

Lodhja fizike dhe mendore

Shenjat që lidhen me këtë stres mund të jenë: ngathtësi në veprime, vështirësi në përcaktimin e përparësive, vështirësi për të kryer detyra rutinë, shqetësime të panevojshme apo të tepërta për probleme të vogla, vështirësi për t'u fokusuar në detyra të ndryshme, humbja e iniciativës për shkak të lodhjes, mosha e madhe dhe koha e gjatë e të qëndruarit të personit në të njëjtën njësi, etj.

Tensionet muskulare

Të punuarit për një kohë të konsiderueshme në FS e ekspozon operatorin special që të punojë nën lodhje dhe stres të vazhdueshëm, të cilat pas një periudhe kohe fillojnë dhe

[3] Nënkolonel Dritan Demiraj, Taktikat e Forcave Speciale, f. 78, Tiranë 2009.
[4] US Department of the Army, Filed manual FM 6-22.5, Combat Stress, 23 june 2000, p. 12.
[5] Ibid, p. 14.

japin shenjat e para. Hedhjet me parashutë të rrumbullakët (statike), zhytjet në thellësi të mëdha dhe në ujëra të ftohta pa mbikqyrjen e mjekut zhytës, stërvitjet alpine në terrene arktiku për kohë të gjatë dhe çdo vit nga një muaj, vrapimet e gjata me ngarkesë të përditshme, mbajtja për një kohë të gjatë e peshave gjatë misioneve, etj., krijojnë dëmtime serioze në organizmin e operatorëve specialë. Disa nga shenjat dalluese që lidhen me këtë stres janë: dhimbje koke, gjymtyrësh apo shpine të vazhdueshme, paaftësia për të pushuar, dridhje trupore të pakontrolluara gjatë dyluftimeve, shqetësime të vazhdueshme pagjumësie natën, etj.

Sistemi i tretjes

Shenjat dalluese që kanë të bëjnë me këtë stres janë: përzierje stomaku, të vjella të vazhdueshme dhe humbje e oreksit. Humbja e oreksit është një problem serioz në qoftë se shikohet një humbje e shpejtë e peshës apo nëse individi nuk konsumon një dietë të balancuar për të mbajtur një trup dhe mendje të shëndoshë për operacione të tejzgjatura. Për këtë qëllim, liderit të misionit, i del detyrë që çdo ditë të informohet nga mjeku i misionit në lidhje me gjendjen fizike të efektivit dhe problemet që shfaqin ata si pasojë e misioneve të zgjatura dhe marrjen e masave për shmangien e tyre.

Sistemi i frymëmarrjes dhe i qarkullimit të gjakut[6]

Disa nga shenjat dalluese janë: rrahje të shpejta e të pakontrolluara të zemrës, hiperventilimi, i cila ka të bëjë me djersitje të tepërta, frymëmarrje të shkurtra e të shpeshta, marrje mendsh si dhe dridhje të pakontrolluara të duarve.

Shqetësimet me fjetjen

Disa nga shenjat dalluese që kanë të bëjnë me këtë stres janë vështirësitë për të rënë në gjumë. Kjo ndodh kur individi është angazhuar në detyra me kohë të gjatë dhe nuk mund të flejë edhe kur ka mundësi për të bërë një gjë të tillë. Por edhe nëse fle, ai çohet vazhdimisht nga gjumi dhe ka vështirësi për të rënë përsëri në gjumë. Një tjetër shenjë dalluese janë ëndrrat dhe makthet e vazhdueshme të individit pas detyrave apo operacioneve gjatë të cilave ka patur të vrarë apo të plagosur.

Ankthi

Frika ndaj vdekjes, dëmtimit apo dhimbjes shkaktojnë momente ankthi, të cilat mund të jenë të rrezikshme si për individin, ashtu dhe për grupin special ku ky individ bën pjesë. Në rastin më ekstrem, kjo ndjenjë shfaqet kur individi përjeton vdekjen e një kolegu në luftë. Individi mund të humbë besimin në vetvete, ndihet i rrezikuar apo i paaftë për të kryer detyrën e caktuar.[7] Liderët e FS duhet të jenë gjithmonë vigjilentë për të dalluar simptomat e streseve dhe duhet të jenë të mirëpërgatitur për të parandaluar streset e luftës dhe për të ulur mundësitë që këto strese të shndërrohen në probleme serioze apo të përhershme.

Rritja e kohezionit të njësisë apo të grupit special

Çdo lider ushtarak e di shumë mirë që një njësi me kohezion, e disiplinuar, e pajisur mirë, e paguar mirë, që punon në kushte të mira jetese, e stërvitur mirë, është tepër e efektshme

[6] Ibid, p. 12-20
[7] Ibid, p. 12.

në kryerjen e operacioneve luftarake. Njësitë apo grupet me një nivel të lartë të besimit reciprok, besnikërisë dhe krenarisë janë më pak të rrezikuar ndaj streseve të luftës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pjesëtarëve të rinj të grupit të cilët nuk kanë përvojën e duhur. Ata janë më të rrezikuar ndaj streseve të luftës, prandaj çdo lider duhet të bëjë përpjekje maksimale që të krijojë kushte të favorshme që ata të familjarizohen sa më shpejt me pjesëtarët e tjerë të grupit, duke i vënë në patronazh operatorët më me përvojë luftarake, të cilët t'i ndihmojnë në drejtim të kapjes së ritmit të luftimit.[8]

Marrja e masave për sigurimin dhe çlodhjen e nevojshme për efektivin

Shumica e individëve nuk punojnë në mënyrë të efektshme nëse kanë më pak se 6-8 orë gjumë në ditë. Mungesa e gjumit apo pushimi jo i mjaftueshëm për funksionimin normal të mendjes dhe trupit, mund të ndikojë negativisht në performancën e individit gjatë operacioneve. Në këto situata, operatorët mund të marrin vendime jo të drejta, kanë reflekse të ngadalta dhe janë më tepër të ekspozuar ndaj streseve të luftës. Lideri i FS duhet të sigurohet që çdo pjesëtar i njësisë, nëngrupit apo grupit special të pushojë minimalisht 6 orë në ditë. Nëse kjo kohë është e pamundur që të arrihet, atëherë liderët duhet të përcaktojnë orare fjetjeje për çdo pjesëtar të njësisë, si dhe duhet të planifikojnë orare pushimi shtesë. [9] Ka raste kur, si pasojë e planëzimeve të paparashikuara, njësi të FS dalin në detyra të cilat janë me kohë të gjata në terren. Lideri i FS duhet të jetë shumë i kujdesshëm në procesin e planifikimit, pasi është shumë e rëndësishme që gjatë kohës në dislokim, të bëhet një raport shumë i drejtë i ndarjes së ngarkesave dhe orareve në shërbim brenda njësive, në mënyrë që t'i mundësohet koha e mjaftueshme për t'u rigjeneruar asaj njësie që kthehet nga misione të tilla.

Dhënia e informacionit të nevojshëm vartësve

Një shprehje amerikane thotë: "*Information is motivation.*" (Informacioni është motivim). Kur efektivi është në dijeni të asaj që pritet të ndodhë, atëherë ata do të jenë të parapërgatitur për atë që do të ndodhë dhe do të jenë më pak të rrezikuar ndaj ndonjë të papriture apo streseve të luftës. Një lider i mirë duhet të shpërndajë, në kohën e duhur, informacionin e nevojshëm vartësve të tij. Për ta shpjeguar më me detaje këtë shprehje, do të thosha që një nga aspektet më të rëndësishme që ne si drejtues trupash në luftim kemi patur gjatë kohës së dislokimit, ishte ngritja e një sistemi informacioni dhe inteligjence sa më mirë që të ishte e mundur, duke e përditësuar në vijimësi, në mënyrë që para çdo daljeje në detyrë, efektivi të ishte sa më mirë i informuar në lidhje me terrenin ku do të vepronte, karakteristikat e tij, avantazhet, disavantazhet, kufizimet, rrjetin e talebanëve që vepronte në atë zonë, mënyrat e operimit të tyre, duke studiuar me detaje të gjitha TTP-të e tyre, pajisjet që ata përdornin dhe se si i përdornin, fshatrat dhe familjet e fiset që i mbështesnin, linjat e komunikimit dhe të furnizimit, etj. Kjo rriti ndjeshëm besimin tek efektivat dhe cilësinë e sigurinë e operacioneve.

Kryerja e analizave pas kryerjes së detyrës (AAR)

Analiza pas çdo detyre apo operacioni është metoda më e mirë për të dhënë dhe shpërndarë informacionin pas çdo aksioni apo angazhimi të rëndësishëm. Kjo bëhet me qëllim që të nxirren mësimet e duhura e të përmirësohen veprimet në operacionet pasardhëse. Diskutimi

[8] Ibid, p 13.
[9] Ibid.

i hapur gjatë këtyre analizave do të jetë tepër i frytshëm, do të heqë barrën e fajësisë, si dhe do të shërbejë për të forcuar më tej besimin në vetvete dhe tek pjesëtarët e tjerë të grupit.

Duke e argumentuar këtë me përvojën tonë në Afganistan, do të shtoja se pas kthimit nga çdo detyrë, çdo grup bënte deri në detaje analizën pas kthimit nga misioni, duke analizuar të gjitha anët e mira dhe negative të cilat u pasqyruan gjatë misionit, shkaqet e mosrealizimit dhe detyrat për secilin për eliminimin e tyre. Caktohej gjithashtu një afat i shpejtë dhe nëse duhej, përgatitej direkt një SOP-i e re, me qëllim që t'i përshtatej situatës në terren.

Mbajtja e efektivit në formë fizike të mirë

Një përgatitje fizike e mirë e efektivit të FS është një faktor që ndikon pozitivisht në kryerjen me sukses të detyrave speciale. Në të njëjtën kohë, kjo do të reduktojë mundësitë dhe shanset që operatori i FS të ndikohet nga streset e luftës. Duke qenë në një formë fizike tepër të mirë, kapaciteti i individit për të përballuar streset në çfarëdolloj situatash do të jetë më i lartë.[10]

Disa teknika për menaxhimin e streseve në luftim janë:

- Të sigurojë që janë bërë të gjitha përpjekjet për mirëqenien e ushtarakëve që ka në vartësi.
- Të rrisë besimin në vetvete dhe besimin mbi pjesëtarët e njësisë, liderët dhe pajisjet luftarake.
- Lideri duhet të jetë i vendosur dhe i sigurt; ai duhet të demonstrojë kompetencë dhe udhëheqje të drejtë me shembullin e tij personal në luftim.
- Të sigurojë pushim të mjaftueshëm për vartësit, veçanërisht gjatë operacioneve të vazhdueshme.
- Të sigurojë gjumë dhe pushim për personelin që është përgjegjës për zbatimin e detyrave.
- Të vendosë objektiva realiste për zhvillimin dhe përmirësimin progresiv të pjesëtarëve të njësisë apo vartësve.
- Të monitorojë rregullisht arritjet e këtyre objektivave.
- Të kuptojë që intensiteti dhe kohëzgjatja e detyrave ndikon drejtpërdrejt në streset e luftës.
- Të njohë e të kuptojë që individët apo njësitë reagojnë në mënyra të ndryshme përballë streseve të njëjta.[11]
- Të njohë dhe të dallojë shenjat e streseve të luftës.
- Të kuptojë që frika është një pjesë normale e streseve të luftës.
- Të jetë i vetëdijshëm për burimet e streseve të luftës siç janë: problemet në familje, problemet financiare të çdo ushtaraku që në rastin tonë janë të shumta.
- Të sigurojë shpërndarje të pandërprerë të informacionit në të gjitha hallkat e komandimit.
- Të praktikojë kontroll të streseve nëpërmjet stërvitjes, caktimit të detyrave në mënyrë të drejtë, pa i dhënë dikujt më tepër apo më pak.
- Të tregohet vigjilent ndaj shenjave të streseve si dhe ndaj rënies së kapacitetit për të përballuar streset për çdo individ apo vartës.[12]

[10] US Department of the Army, Filed manual FM 6-22.5, Combat Stress, 2000, p. 40-45.
[11] Dr Qetsor Orhani, Prof Asc.Dr Edmond Braneshi, Majlinda Cukalla,Udhëheqja Ushtarake, f. 35.
[12] US Department of the Army, Filed manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control, 1994, f. 17-25.

Si minimizohet frika gjatë misionit?[13]

Liderët ushtarakë të FS duhet të kuptojnë se rreziku dhe frika do të jenë gjithmonë pjesë e punës së tyre, sidomos në angazhimet dhe misionet luftarake jashtë vendit. Metoda më e mirë për të minimizuar frikën nuk është mohimi i efekteve të saj, por njohja deh pranimi i tyre, si dhe pranimi i përballjes drejtpërdrejt me to. Frika minimizohet ose kapërcehet duke kuptuar situatën dhe duke vepruar me largpamësi për t'u përballur me të. Liderët e FS duhet të kuptojnë që frika shfaqet në momentet e zmbrapsjes apo humbjeve të betejës në dyluftim, në rastet kur njësia nuk e përmbush detyrën me sukses apo në rastet ekstreme kur ka të plagosur apo humbje jetësh të pjesëtarëve të njësisë gjatë operacioneve. Ushtarakët që përjetojnë plagosjen apo vdekjen e një shoku gjatë një dyluftimi, fillojnë të bëhen më të vetëdijshëm ndaj faktit që një ditë edhe ata vetë mund të plagosen apo të vriten.

Lidershipi në luftë është një formë tjetër lidershipi, ku lideri duhet të njohë rrënjësisht veten e tij, përgjegjësitë që ka, ushtarakët në vartësi të tij dhe fuqinë luftarake që ka në dorë. Liderët e drejtpërdrejtë që janë pjesë e misioneve direkt në terren, duhet të jenë takticienë të fortë, të jenë në gjendje të marrin vendime të shpejta e të drejta, si dhe të jenë në gjendje të drejtojnë e të motivojnë vartësit e tyre në situata të vështira. Vetë liderët duhet të jenë në gjendje për të kryer çdo detyrë luftarake dhe të marrin çdo vendim të drejtë në mes të zhurmave, shpërthimeve dhe konfuzioneve të luftës. Ata duhet të dinë si të motivojnë vartësit e tyre përballë çdo vështirësie. Kur vartësit i shikojnë këto cilësi te lideri, atëherë ata do të ndihen më të sigurt në vetvete dhe tek liderët e tyre.

Cilësitë që e bëjnë një ushtarak të aftë për të përballur efektet e frikës dhe për të përmbushur detyrat luftarake me sukses janë: parapërgatitja e mirë, planëzimi i mirë dhe stërvitja rigoroze. Stërvitja realiste e zhvilluar në ambiente të ngjashme me ambientin ku njësia do të dislokohet është burimi i parë për të rritur nivelin e vetëbesimit dhe nivelin e gatishmërisë së ushtarakut. Në të njëjtën kohë, cilësitë si aftësia drejtuese, vetëbesimi, shkathtësia dhe guximi, janë cilësitë që një lider i drejtpërdrejtë duhet t'i zotërojë në mënyrë që njësia, grupi dhe nëngrupi të jenë në gjendje të përballojnë situatat më të vështira në dyluftim[14].

Cilat janë situatat më të vështira dhe çfarë duhet të bëjnë drejtuesit në këto lloj situatash?

Situata më e vështirë për një lider në mision është humbja e jetës së një vartësi ose disave prej tyre gjatë një detyre operacionale. Kjo vështirësi është një vështirësi e dyfishtë. Fillimisht, vështirësia e parë gjendet në faktin nëse lideri i drejtpërdrejtë është në gjendje të menaxhojë situatën, nëse ka humbje jete për të zvogëluar mundësitë që pjesëtarët e tjerë të dëmtohen apo vriten për shkak të kaosit, rrëmujës apo emergjencës së krijuar.

Vështirësia tjetër vjen në çastet kur pasi ka ndodhur fatkeqësia, njësia është kthyer në bazë për t'u rikuperuar dhe për të marrë detyrë tjetër. Përjetimi i plagosjes apo vdekjes së një kolegu në operacion shkakton pasoja psikologjike te të gjithë pjesëtarët e njësisë. Kur përjetojnë diçka të tillë, çdokush është i vetëdijshëm tashmë për mundësitë e plagosjes apo humbjes së jetës në çdo operacion jashtë bazës. Kjo ndjenjë do të ulë gatishmërinë e efektivit dhe në të njëjtën kohë do të rrisë ndjenjën e frikës tek çdo individ. Është përgjegjësia morale e liderit që të motivojë vartësit e tij në mënyrë që detyrat në vazhdim të kryhen me sukses, me qëllim përmbushjen e misionit të caktuar.

[13] ADM McRaven, Special Ops Study, 1997, f.172.

[14] US Department of the Army, Filed manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control, 1994, p. 25.

Një situatë të tillë kaluan në datën 20 shkurt 2012 dhe efektivët e misionit "Eagle-4" ditën të cilën Kapiten Feti Vogli u qëllua pabesisht nga një oficer afgan, ku pasi i bënë të gjitha nderimet e përcjelljes nga ana e personelit atje, efektivat e BFS në mision të drejtuar nga komandanti i misionit u mobilizuan deri në ditën e fundit të qëndrimit në Spin Buldok, duke realizuar me shumë sukses të gjitha detyrat.

Bibliografia:

- Prof Dr Ruzhdi Ramadani, Prof Dr Kristaq Xharo, Prof Asc. Dr. Kolonel Edmond Braneshi, Udhëheqja Strategjike.
- Dr. Qetsor Orhani, Prof Asc. Dr. Edmond Braneshi, Majlinda Cukalla, Udhëheqja Ushtarake.
- US Department of the Army, Filed manual FM 6-22.5, Combat Stress, 23 june 2000.
- N.kolonel Dritan Demiraj, Taktikat e Forcave Speciale, Tiranë 2009.
- FS në një perpsektivë të re të luftimit bashkëkohor, Kolonel Dritan Demiraj, 2014.
- US Department of the Army, Filed manual FM 6-22.5, Combat Stress, 2000.
- US Department of the Army, Filed manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control, 1994.
- ADM McRaven, Special Ops Study, 1997.
- US Department of the Army, Filed manual FM 22-51, Leaders Manual For Combat Stress Control, 1994.

Shqipëria dhe sfidat e sigurisë

Nënkolonel Ali Mali
Shef i Degës së Mësimeve të Nxjerra, QD

Trajtesë e shkurtuar. *Strukturat rajonale dhe globale të sigurisë janë vazhdimisht në përshtatje me ndryshimet e shpeshta të mjedisit të sigurisë. Edhe shtetet e vogla, si vendi ynë, analistët dhe politikë-bërësit përpiqen vazhdimisht të përcaktojnë tendencat e zhvillimeve të ardhshme, me qëllim rekomandimin e politikave të përshtatjes dhe ristrukturimit të këtyre strukturave ndaj modeleve të sjelljes globale dhe rajonale. Ky studim ka patur si synim të fillojë me trajtimin e strategjisë e sigurisë, rreziqet dhe kërcënimet, për të trajtuar tendencat e ardhshme të sigurisë dhe detyrat për institucionet tona të sigurisë, ku një vëmendje më e madhe i kushtohet institucioneve përgjegjëse për sigurinë kombëtare. Kur bëhet fjalë për siguri, patjetër që ka nevojë për një këndvështrim teorik për të. Ç'kuptojmë me termin siguri, çfarë përfaqëson siguria sot cilat janë qasjet e sotme në këtë fushë.*

Në këtë pikë, jam munduar të bëj një përmbledhje të mendimit mbi sigurinë shtetërore dhe sigurinë njerëzore, një këndvështrim për sigurinë kombëtare, elementët e sigurisë si dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e SSK. Jam fokusuar te kërcënimet e sotme asimetrike të sigurisë, të cilat kanë zënë peshën kryesore të kërcënimeve, duke kaluar balancën e kërcënimit nga ato tradicionale pra kërcënimet e jashtme territoriale tek ato të brendshme, si konfliktet etnike, korrupsioni, krimi i organizuar, moszhvillimi ekonomik, varfëria, sëmundjet infektive, droga, siguria mjedisore etj. Në ditët e sotme, kërcënimi matet në terma jo ushtarake dhe kërcënimet ndaj sigurisë janë me natyrë jo ushtarake. Kërcënimet e ardhshme komplekse do t'i kalojnë kufijtë gjeografikë dhe kufijtë midis institucioneve. Kërcënimet e ardhshme si kërcënime komplekse do të vijnë më shumë nga aktorët jo shtetërorë sesa nga aktorët shtetërorë. Mjedisi i sigurisë do të konsistojë në shkurtimin e kohës së paralajmërimit të rrezikut dhe presionit të burokracisë së zakonshme ndaj emergjencës që kërkon vendimmarrja e shpejtë[1].

Rreziqet dhe kërcënimet

Paraqitja e rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare shqiptare është detyra kryesore e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Në përvojën botërore rreziqet klasifikohen në katër shkallë[2] përkatësisht në rreziqe politike (shtetet e dështuara, krizat, paqëndrueshmëria, etj.), rreziqe ekonomike (varfëria, disbalanca sociale, pirateria

[1] "What Roles and Missions for Military and Security Forces in the 21st Century?"-Marshall Center Web Site at www.marshallcenter.org-Designed and produced by VIB, August 2005.
[2] Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë, Manual për parlamentarët, nr 5, 2003.

informaliteti i ekonomisë etj.), rreziqe të mjedisit (katastrofat, mungesa e burimeve jetësore, etj.), si dhe rreziqe shoqërore (konfliktet etnike, mbipopullimi, krimi, emigrimi, etj.). Dallimet në përcaktimin e rreziqeve dhe kërcënimeve më kryesore janë të mëdha nga shteti në shtet. Nëse në SHBA terrorizmi ndërkombëtar është rreziku kryesor, në disa vende afrikane është mungesa e ujit, ndërsa në vendin me popullsi më të madhe në botë, Kinë, Indi burime rreziqesh shihen mbipopullimi dhe dezinformimi. Në konceptin kinez[3] përcaktohet se "lufta informative do të jetë luftimi më kompleks në shekullin e 21-të dhe do të vendosë se kush do të humbë ose kush do të fitojë luftën".

Pra natyra dhe renditja e rreziqeve përcaktohen nga veçoritë e vendeve. Në thelb të njëjtat kritere vlejnë edhe për rreziqet që kanosin sigurinë shqiptare. Detyra e SSK është të analizojë cili nga këta faktorë është më i rëndësishëm, cili ka bazë dhe shanse më të mëdha, si dhe të gjejë mundësitë për eliminimin e tyre. Në dy kategoritë kryesore të rreziqeve, (ushtarake dhe jo ushtarake), siguria shqiptare më shumë cenohet nga rreziqet jo ushtarake, (krimi i organizuar, terrorizmi, dezinformacioni, globalizimi, kufizimet nga burimet, shkatërrimi i ambientit, emigracioni, etj.). Rreziqet dhe kërcënimet, siç shpjegohet edhe në këtë shkrim, nuk vijnë vetëm nga lufta dhe konfliktet e armatosura. Ato janë të shumëllojshme dhe në thelb të paparashikueshme, madje disa prej tyre edhe të paevitueshme. Megjithatë, në raste konfliktesh, rreziqesh dhe kërcënimesh gjithnjë pasojat janë më të vogla dhe suksesi është më i madh, nëse njihet më parë burimi, përbërja, shkalla e rrezikut dhe ecuria e rreziqeve dhe kërcënimeve. Përvoja ka treguar se jo të gjitha konfliktet sociale, kulturore, shoqërore, etj., çojnë në cenim të sigurisë. Një pjesë e tyre janë rrjedhojë e debatit demokratik dhe jo e kundërvënies së ashpër midis palëve. Demokracia, si sistem, me elementët e saj të luftës politike, debateve dhe hera-herës edhe konkurrencës midis alternativave e institucioneve politike, nëse funksion siç duhet, sjell dobi për qytetarët. Ky është edhe synimi i sigurisë, i cili nuk mund të jetë asnjëherë synim në vetvete, por duhet t'i shërbejë mirëqenies së njerëzve. Vetëm në këtë mënyrë, siguria kombëtare shndërrohet si siguri njerëzore, e cila vendos në radhë të parë individin dhe komunitetin.

Vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive aktuale dhe të ardhshme

Hapi më i rëndësishëm në përgatitjen e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është padyshim përcaktimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive që paraqet mjedisi i sigurisë aktuale dhe ai i perspektivës. Pra, këto janë dy elemente të rëndësishme, të cilat gjykoj se nuk duhen trajtuar veçmas. Rreziqet kanë një spektër të caktuar, mbi të cilat vendosen prioritetet për t'u përballuar, duke patur parasysh burimet në dispozicion. Dokumenti i SSK të RSH duhet të japë një pasqyrë të qartë dhe reale të sfidave kryesore të sigurisë me të cilat përballet Shqipëria[4]. Në të duhet të pasqyrohen si rreziqet e jashtme, ashtu edhe rreziqet e brendshme. Ndër rreziqet e brendshme duhet të trajtohen: krimi i organizuar, stabiliteti politik, zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik dhe mosplotësimin e nevojave elementare jetike, emigracionin e paligjshëm të qytetarëve shqiptar drejt vendeve të tjera, fatkeqësitë natyrore, problemet demografike, dezinformimin e opinionit publik, si dhe zhvillimin e pamjaftueshëm të arsimit, shkencës dhe kulturës[5], deri tek siguria rrugore. Më tej të

[3] "Lufta Kibernetike", Samiti Strasburg-Kelh, Prill 2009.

[4] Vërejtje dhe sugjerime të Qendrës Marshall, dhënë Ministrisë së Mbrojtjes në vitin 2008, pas kërkesës së bërë nga kjo ministri për dhënien e ekspertizës në rishikimin e dokumenteve kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes.

[5] Ligji Nr. 9322 datë 25.11.2005 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë", faqe 11.

vijohet me përcaktimin e rreziqeve transnacionale, ku përfshihen si rreziqet rajonale, ashtu edhe ato të jashtme, të tilla si: përdorimi i forcës ushtarake, apo i formave të tjera që vënë në rrezik sovranitetin dhe integritetin e vendit, destabilizimi i rajonit nëpërmjet ndjenjave nacionaliste dhe zhvillimit të konflikteve etnike, terrorizimi si mjet ekstrem i dhunës, krimi i organizuar; trafiqet e paligjshme.

Deri tani janë identifikuar të paktën tre arsye që konsiderohen të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe, veçanërisht, për domosdoshmërinë e realizimit të një procesi sa më gjithëpërfshirës të vlerësimit të sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve. **Së pari,** nëpërmjet udhëheqjes së planifikimit të Sigurisë Kombëtare, institucionet përgjegjëse mund të hartojnë koncepte të qëndrueshme për sigurinë kombëtare nëse do të arrijnë të realizojnë vlerësimin e duhur strategjik të rreziqeve. **Së dyti,** duke nxitur procesin për shpërndarjen e drejtë dhe efektive të burimeve. Studiues të ndryshëm kanë vërejtur rëndësinë e vlerësimit të sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve si një prej hapave paraprakë me rëndësi për të realizuar shpërndarjen e duhur të burimeve njerëzore dhe financiare, tek institucionet e sigurisë. **Së treti,** duke vlerësuar variantet e mundshme të arritjes së objektivave të sigurisë, përmes përqendrimit të burimeve njerëzore dhe financiare. Përgjigja ndaj pyetjes se ku do t'i investojnë paratë institucionet dhe agjencitë e sigurisë për të parandaluar rreziqet, përbën një sfidë me të cilën ato duhet të përballen gjithmonë gjatë procesit të hartimit të buxhetit. Në këtë rast, elementët e vlerësimit të sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve mund të ndihmojnë që sfida në fjalë të përballet me një përqendrim të drejtë e të dobishëm të investimeve në përputhje me mundësitë dhe kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare.

Për sigurinë tradicionale parësore ka qenë mbrojtja e shtetit-komb, kurse në kuadër të sigurisë njerëzore në qendër është individi, standardet e pranueshme të jetës, shëndetit dhe mirëqenës së tij[6]. Rishikimi periodik i dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është jo vetëm një domosdoshmëri, por në rastin tonë edhe një detyrim ligjor. Ky rishikim është i nevojshëm "për të pasqyruar drejt ndryshimet objektive dhe subjektive, të brendshme (politike-institucionale e social-ekonomike) dhe të jashtme (globale, rajonale) që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë siguri[7]".

Kanë ndodhur ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme përsa i përket mjedisit të sigurisë dhe pasojave për vetë sigurinë kombëtare të Shqipërisë; ato janë: shpallja e pavarësisë së Kosovës, anëtarësimi i Shqipërisë në Aleancën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), kriza globale ekonomike dhe koncepti i ri i NATO-s për mbrojtjen e zgjuar, paqëndrueshmëria e mjedisit të jashtëm të sigurisë, si pranvera arabe, vazhdimi i konfliktit në Siri, konflikti në Ukrainë, përkeqësimi i situatës në Irak dhe Pakistan dhe, së fundmi, marrja e statusit vend kandidat për në Bashkimin Evropian i Shqipërisë.

Pra, është mjaft e qartë që këto ngjarje madhore ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kombëtare të vendit tonë dhe janë disa argumente dhe arsye bindëse që do të bënin të mundur rishikimin e dokumentit të SSK.

Interesat kombëtare të RSH

Përcaktimi i interesave kombëtare është vendimtar për zhvillimin e sigurisë së vendit. Interesat kombëtare dhe shtrirja kohore e realizimit të tyre janë të lidhura organikisht me

[6] Meidani, Prof.Dr. Rexhep, "Disa Mendime mbi rishikimin e dokumentit të strategjisë", faqe 26.
[7] Po aty.

sigurinë. Thelbin e realizimit të interesave kombëtare e përbëjnë përgjegjshmëria, legjitimiteti dhe ndershmëria e pushtetit politik për t'i shërbyer kombit e shtetit të vet.

Interesat kombëtare të RSH janë në themel të zhvillimit të sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Strategjia e Sigurisë Kombëtare mbështet fuqimisht parimin e mbrojtjes kolektive si një vend anëtar i NATO-s të bazuar në një lidhje transatlantike të fuqishme, si dhe zhvillimin e një Evrope të fortë e të qëndrueshme politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Interesat kombëtare të RSH mund të ndahen sipas prioritetit në interesa jetësorë dhe në interesa të rëndësishëm.

Interesa jetësore ose të mbijetesës të RSH

- Integriteti territorial, sovraniteti dhe pavarësia politike e RSH.
- Demokracia dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Stabilitet social-ekonomik i vendit dhe mirëqenie për qytetarët.
- Vlerat historike e kulturore, pasuritë kombëtare dhe të drejtat e shqiptarëve.
- Siguri, stabilitet dhe zbatim i shtetit ligjor në gjithë territorin e vendit.

Interesa të rëndësishëm të RSH

- Paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm rajonal dhe euroatlantik.
- Një shoqëri tolerante me stabilitet politik, respektimin e minoriteteve, komuniteteve fetare, etj.
- Forcim i institucioneve e sidomos ato gjyqësore e të pavarura.
- Kosovë e njohur ndërkombëtarisht në OKB dhe zgjidhja paqësore e çështjes shqiptare.
- Shoqëri civile të emancipuar, media dhe shtyp të lirë.
- Arsimim cilësor dhe mbështetje shëndetësore për të gjithë qytetarët.
- Mjedis sa më pak të ndotur në gjithë territorin e vendit.
- Rezerva të mjaftueshme ujore, energjetike, minerare, ushqimore, shërbime, etj.

Përgjegjësia e aktorëve zbatues të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

Për zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare përgjegjësia bie mbi aktorë të veçantë të sigurisë, nisur nga roli i tyre kushtetues dhe ligjeve të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Në thelb, Strategjia e Sigurisë Kombëtare synon të integrojë dhe të bashkërendojë kontributet e aktorëve të sigurisë kombëtare në raport me interesat dhe rreziqet që konsiderohen më të rëndësishme[8]. Disa ekspertë venë re se një nga mangësitë kryesore aktuale të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është fakti që ajo ende nuk është një "strategji veprimi". Shumë nga seksionet e saj dështojnë në kalimin përtej deklarimeve të përgjithshme të synimeve, për të renditur më tepër shembuj specifikë të masave të politikës aktuale[9]. Roli i aktorëve zbatues të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është trajtuar paksa në mënyrë të tërthortë. Kështu për shembull, trajtohen rolet e diplomacisë, mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike, politika ekonomike-financiare, mbrojtja civile, mjedisi dhe shëndeti, marrëdhëniet me opinionin publik, si dhe politika e mbrojtjes.

[8] Law, Dr. David, Ekspert i Lartë i DCAF, "Praktikat më të mira në fushën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim "Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", Botimet Toena, Tiranë 2007, faqe 12.

[9] Vërejtje dhe sugjerime të Qendrës Marshall, dhënë Ministrisë së Mbrojtjes në vitin 2008.

Për zbatimin e politikave të sigurisë kombëtare nevojitet të përshtaten instrumentet ekzistuese të politikës, si dhe të krijohen instrumente të reja në përputhje me specifikat e çdo vendi si dhe me kohën në të cilën hartohet e zbatohet SSK. Gjithashtu për monitorimin e tyre mund të ketë grupe të përhershme ose të përkohshme të cilat mblidhen kur është e nevojshme dhe në periudha të caktuara. Në vendin tonë këtë rol e luajnë Këshilli i Sigurisë Kombëtare, që është një forum këshillues pranë Presidentit të Republikës dhe Komiteti i Politikave të Sigurisë pranë Kryeministrit të vendit. Struktura aktuale institucionale e organizmave vendimmarrëse të sigurisë ende paraqet mangësi për sa i përket fazës së planifikimit strategjik e cila përfshihet në procesin e hartimit të dokumentit të Sigurisë Kombëtare. Kësisoj, boshllëqet që vërehen në vlerësimin e SRRK-ve në nivel kombëtar, janë fryt i kësaj paqartësie institucionale dhe i një procesi ku bashkëjetojnë dy institucione: Këshilli i Sigurisë Kombëtare (KSK) pranë Presidentit të Republikës dhe Komiteti i Politikave të Sigurisë Kombëtare (KPSK) i drejtuar nga Kryeministri[10]. Për të kuptuar këtë nevojitet një vështrim për rolin e tyre të deritanishëm. Nëse në SSK-në e vitit 2000 përcaktohej, si detyrë kryesore e KSK-së, "*formulimi dhe hartimi* i *Strategjisë së Sigurisë të RSH-së, e cila paraqitet për miratim në Kuvend*", rishikimi i SSK-së në vitin 2004 solli ndryshimin e roleve të autoriteteve vendimmarrëse, duke i kaluar këtë kompetencë Kryeministrit. Pra, kryeministri ka kompetencën për të rishikuar SSK-në brenda 3 vjetësh, çka nënkupton edhe procesin dhe vlerësimin e SRRK-ve. Ky ndryshim u parapri nga miratimi në Parlament i ligjit për "*Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave*" në janar 2003, përmes të cilit u krijuan edhe Komitetet Ndërministrore si "*organe konsultative të KM ku diskutohen paraprakisht politikat*", duke përfshirë edhe krijimin e Komitetit të Politikave të Sigurisë Kombëtare.[11]

Dualizmin midis institucioneve të KSK-së dhe KPSK e pasqyron edhe Strategjia e rishikuar e SK (2004). Kjo vërehet konkretisht në pjesën e katërt të këtij dokumenti ku trajtohet Udhëheqja e Strategjisë së Sigurisë së RSH-së në të cilën përcaktohen bazat kushtetuese të udhëheqjes. Sipas saj, pika 78, Presidenti në cilësitë kushtetuese të Kryetarit të Shtetit dhe Komandantit të Përgjithshëm të FA-së dhe Kryetrari i Këshillit të Sigurisë Kombëtare përcaktohet si: *"Funksionari më i lartë dhe përgjegjës për realizimin e misionit, parimeve dhe objektivave të sigurisë së vendit dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave Kombëtare"*. Kështu që, ky përkufizim duket sikur i jep Presidentit, kompetenca ekzekutive kur ndërkohë Këshilli i Sigurisë Kombëtare (Pika79) në këtë rast identifikohet si: *"Organ këshillues' pranë Presidentit të Republikës për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit si dhe drejtimit, organizimit dhe mobilizimit të burimeve njerëzore"* [12]. Nga ana tjetër Këshilli i Ministrave përcaktohet si "*...zbatuesi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH-së, si dhe përgjegjësi për gjendjen dhe zhvillimin e instrumenteve të sigurisë Kombëtare*" (Pika 82). Por përveç këtyre detyrave me karakter ekzekutiv, në pikën 83 theksohen edhe aspektet e formulimit të politikave në fushën e sigurisë nga ana e Këshillit të Ministrave. Sipas saj Këshilli i Ministrave *"përcakton drejtimet kryesore të politikës së sigurisë, i Parashtron ato në Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe drejton veprimtarinë*

[10] Arjan Dyrmishi "Vlerësimi i strukturave vendimmarrëse në fushën e sigurisë", botuar në "Çështje të Reformës së Sigurisë në Shqipëri". Vol. I 2009, fq 43.

[11] Ligji nr. 9000 dt. 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e KM në RSH". Neni 2 (Fletore Zyrtare nr. 10, 2003, fq. 281).

[12] Ligji Nr. 9322 datë 25.11.2005 "Për miratimin e SSK të RSH" pjesa e katërt Udhëheqja e SSK të RSH-së.

e organeve në përputhje me ligjin dhe kushtetutën, si dhe krijon dhe drejton Komitetin e Politikave të Sigurisë Kombëtare (KPSK)"[13]. Ndërkohë, sipas pikës 84, Kryeministrit i njihet e drejta të rishikojë SSK-në. Nga sa u përmend më sipër, duket se ekziston një paqartësi rolesh dhe marrëdhëniesh ndërmjet Presidentit dhe Kryeministrit (veçanërisht pika 78 dhe 83) ku duket se, të dyve u duket e drejta e planifikimit strategjik në fushën e sigurisë kombëtare. Gjithsesi, legjislacioni aktual nuk parashikon ndonjë mënyrë se si Presidenti përmes Këshillit të Sigurisë Kombëtare, mund të ndikojë në përmirësimin apo në aspektin vendimmarrës që lidhet së paku me procesin e hartimit të strategjisë së sigurisë kombëtare dhe vlerësimit të SRRK-ve. Pra me strukturën aktuale, nuk mund të flasim për ndonjë rol të Presidentit dhe Këshillit të Sigurimit Kombëtar, në procesin e hartimit të SSK-së dhe vlerësimit të SRRK-ve. Sipas këtij përcaktimi, roli i Presidentit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare në këtë proces është thjesht ai i zbatuesit të politikave, ndërsa roli i hartuesit i mbetet vetëm Kryeministrit.

Rritja e spektrit të sigurisë kombëtare me përfshirjen e sigurisë njerëzore, gjykoj se kërkohet edhe rritja e spektrit të aktorëve për zbatimin e kërkesave të veçanta që kërkon kjo siguri. Në të përfshihen agjenci vendore, rajonale e ndërkombëtare apo struktura joqeveritare, segmente të tjera të shoqërisë civile, si dhe universitetet, komunitetet fetare etj.[14]

Përcaktimi dhe realizimi i objektivave të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

Për periudhën afatgjatë, SSK duhet të përcaktojë këto objektiva: paqe dhe siguri në vend, bashkëpunimi rajonal, konsolidimi i shoqërisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, konsolidimi i institucioneve dhe i instrumenteve të sigurimit, përmirësimi i ekonomisë, konsolidimi i shtetit, fuqizimi i ekonomisë, mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve kudo në botë etj. Për objektivin *paqe dhe siguri në vend* duhet të ketë tregues realë si dhe të bëhet krahasimi në vite, duke u mbështetur në statistikat dhe në raportet e monitorimit për të gjykuar nëse paqja e siguria janë rritur, kanë mbetur në vend apo janë zhvilluar me uljengritje. Për objektivin *bashkëpunimi rajonal* mund të thuhet se ka patur një rritje të qëndrueshme, duke marrë pjesë në iniciativat rajonale në mënyrë aktive. Ekspertët e Qendrës Marshall vërejnë se: "*Diskutimi i marrëdhënieve rajonale do të zgjerohej ndjeshëm duke patur nën vëmendje organizatat e ndryshme të Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore, si dhe në mënyrë të veçantë ndaj çështjeve kyçe në marrëdhëniet bilaterale individuale me fqinjët më të afërt e direkt*[15]*"*.

Në planin afatmesëm dhe afatgjatë SSK duhet të përcaktojë objektivat që vijojnë: integrimi në strukturat evropiane, përafrimi i legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian, çështja kombëtare shqiptare, mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore, konsolidimi i forcave të armatosura, lufta kundër terrorizmit, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përsa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe burimeve natyrore mendojmë se duhet të vijojë puna edhe në të ardhmen për implementimin dhe zbatimin në praktikë të politikave mjedisore, pasi kjo gjë i afrohet më mirë mirëqenies së popullit, pasi si mjedisi ashtu edhe burimet natyrore kanë impakte të drejtpërdrejtë në jetën e tij. Lidhur me objektivin e *konsolidimit të forcave të armatosura* gjykoj se është realizuar si nëpërmjet rishikimit periodik të strukturës së këtyre forcave, ashtu edhe në profesionalizimin dhe

[13] Po aty.

[14] Meidani, Prof.Dr. Rexhep, "Disa Mendime mbi rishikimin e dokumentit të strategjisë", IDM "Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", botimet Toena, faqe 36.

[15] Vërejtje dhe sugjerime të Qendrës Marshall, dhënë Ministrisë së Mbrojtjes në vitin 2008.

modernizimin e tyre. Të gjitha këto hapa bënë të mundur anëtarësimin me të drejta të plota në NATO. Por mendoj se pas këtij hapi shumë të rëndësishëm duhet t'u jepet fund kalimit të herë pas hershme në struktura të reja, të miratohet dokumenti i ri i Strategjisë Ushtarake, të përmirësohet kuadri ligjor në tërësi për Forcat e Armatosura dhe të kalohet në një strukturë të re që t'i rezistojë kohës dhe t'i paraprijë zhvillimit të ardhshëm e sidomos modernizimit të Forcave të Armatosura. Pasi mendoj se karakteristikë e shteteve të vogla është se bëjnë reforma të shpeshta dhe flasin për strategji të mëdha. *Lufta kundër terrorizmit* përshkruhet si një objektiv që kërkon integrimin e përpjekjeve të strukturave të specializuara të shtetit për t'i bërë ballë këtij fenomeni ndërkombëtar me impakte të drejtpërdrejta në sigurinë kombëtare. Pavarësisht nga këto, ekspertë të ndryshëm të strategjisë së sigurisë mendojnë se duhej të përpunoheshin më tej rrugët dhe mënyrat e përshkrimit të tyre si një kërcënim për sigurinë e brendshme apo të jashtme të Shqipërisë[16]. *Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit* renditet e fundit në listën e objektivave që kërkohen të realizohen. Mendoj që ky objektiv të kishte vëmendje më të madhe, për vetë faktin se përbën një fenomen shqetësues për shoqërinë tonë e cila ka qenë dhe mbetet në një tranzicion të gjatë.

Objekti dhe elementët kryesorë të sigurisë shtetërore

Siguria shtetërore ose siguria kombëtare është kërkesa për të ruajtur mbijetesën e shtetit përmes përdorimit të instrumenteve të fuqisë kombëtare, të tilla si instrumenti ekonomik, diplomatik, informativ dhe ushtarak. ***Siguria ushtarake*** është elementi kryesor dhe tradicional i sigurisë kombëtare të një vendi. Ajo lidhet para së gjithash me aftësinë që ka një shtet për t'iu kundërvënë sulmit të armatosur të një shteti tjetër. Shqipëria e realizon më së miri këtë edhe si anëtare e NATO-s që parim kryesor ka mbrojtjen kolektive, por mendoj se Forcat e Armatosura janë një element i rëndësishëm i krenarisë kombëtare, jo vetëm për mbrojtjen e territorit, por edhe për menaxhimin e kufijve tokësorë, detarë dhe ajrorë dhe mbështetjen ndaj popullsisë për emergjencat civile. Si e tillë mendoj që kërkon më shumë vëmendja nga politika në përgjithësi dhe qeveritë në veçanti.

Siguria politike lidhet me stabilitetin e rendit shoqëror. Kjo siguri kërkon marrjen e të gjitha masave nga ana e shtetit për ruajtjen e rendit kushtetues, institucioneve kushtetuese të vendit. Mendoj se shumë e rëndësishme për vendin tonë është stabiliteti politik në vend, zbutja e klimës, fryma e mirëkuptimit dhe qëndrime të njëjta për problemet madhore, siç janë problemet e integrimit dhe të luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar i të gjitha llojeve, reformave të brendshme etj.

Siguria ekonomike lidhet me pavarësinë e vendit, mirëqenien e popullit të vet, lirinë për të ndjekur zgjidhjen e politikave më të mira për zhvillimin e ekonomisë kombëtare në mënyrën e dëshiruar. Në kushtet e sotme, kur ekonomia botërore është bërë më e ndërvarur se kurrë, siguria ekonomike përbën një element të rëndësishëm të sigurisë kombëtare. Për vendin tonë rëndësi të madhe ka transformimi i ekonomisë nga një ekonomi informale në atë formale.

Siguria mjedisore lidhet me sigurinë kombëtare të një vendi, sidomos kur ajo influencohet nga kërcënimet globale dhe rajonale. Këtu futen ndryshimet klimaterike për shkak të ngrohjes globale, shkrirja e akullnajave, humbja e shumëllojshmërisë biologjike etj.

[16] Po aty.

Mendoj se për Shqipërinë krahas këtyre fenomeneve që janë në shkallë globale duhet t'u kushtojë më shumë vëmendje problemeve kombëtare që janë specifike për vendin tonë si menaxhimi i territorit, informalitetit, i mjedisit etj.

Siguria energjike dhe e burimeve natyrore lidhet me vetë zhvillimin e industrisë dhe fuqisë ekonomike të vendit, të cilat ndikojnë në rritjen e sigurisë së shtetit. Harmonizimi i të gjitha këtyre elementeve gjykojmë se rrit sigurinë shtetërore të një vendi dhe krijon kushtet për zhvillimin e sigurisë njerëzore, si dy pjesë të pandashme të sigurisë kombëtare në kushtet e sotme. Mendoj se Shqipëria duhet t'u kushtojë më shumë vëmendje prodhimit të energjisë jo vetëm me një alternativë nëpërmjet ujit, por të shfrytëzojë edhe alternativat e tjera me qymyr duke shtrirë bashkëpunimin me Kosovën dhe shfrytëzimin e linjës së gazsjellësit TAB që do të kalojë nëpërmjet Shqipërisë.

Objekti dhe elementët kryesorë të sigurisë njerëzore

Koncepti i sigurisë njerëzore u zhvillua pas viteve 90-të, ku siguria filloi të kuptohej si një fushë e gjerë ku përfshiheshin një sërë disiplinash, ndryshe nga koncepti i sigurisë tradicionale. Siguria njerëzore përfshin sigurinë e individit në rrethin, komunitetin dhe në mjedisin ku ai jeton. Siguria njerëzore i qëndron pikëpamjes se në qendër të sigurisë është njeriu, i cili është i domosdoshëm për stabilitetin kombëtar, rajonal dhe global[17]. Raporti i Zhvillimit Njerëzor, i vitit 1994, i Programit të Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) konsiderohet botimi kryesor në fushën e sigurisë njerëzore, duke pasqyruar një sërë argumentesh që lidhen me "lirinë nga dëshira" dhe "lirinë nga frika" për të gjithë njerëzit. Siguria njerëzore ka katër karakteristika kryesore: është universale, komponentët e saj janë të ndërvarura, sigurohet më mirë përmes parandalimit dhe në qendër janë njerëzit[18]. Sfera e sigurisë globale duhet të zgjerohet, ku të përfshihen kërcënimet nga ***shtatë elementë*** kryesore, përkatësisht siguria ekonomike, siguria e ushqimit, siguria e shëndetësore, siguria mjedisore, siguria personale, siguria e komunitetit dhe siguria politike. Më poshtë trajtohen karakteristikat kryesore të këtyre elementeve kryesore:

Siguria ekonomike ka të bëjë me sigurimin e të ardhurave bazë për individët. Nga statistikat e marra shihet se rreth një e katërta e popullsisë së botës janë aktualisht ekonomikisht të sigurtë. Siguria ekonomike gjykojmë se varet pikësëpari nga mirëqenia ekonomike. Kjo mirëqenie arrihet në radhë të parë me anë të rritjes ekonomike[19]. Për të matur këtë rritje nevojitet të paktën një kufi minimal jetese. Banka Botërore propozoi që pragu global i varfërisë ekonomike absolute të jetë jo më pak se 365 dollarë për frymë në vit, e cila është pranuar gjerësisht nga bashkësia ndërkombëtare[20]. Siç shihet kjo rezulton në 1 dollar në ditë për frymë të popullsisë.

Siguria e ushqimit kërkon që të gjithë njerëzit të kenë mundësi fizike dhe ekonomike për sigurimin e ushqimit bazë. Sipas OKB-së, mundësia për sigurimin e përgjithshëm të ushqimit nuk është një problem, por shpërndarja e tyre dhe mungesa e fuqisë blerëse janë aspekte shqetësuese.

---

[17] http://en.wikipedia.org/wiki/Human_security, marrë më 21 maj 2012.

[18] King, Geri dhe Murray, Christopher J.L, "Rikonsiderimi i Sigurisë Njerëzore", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim "Çështje të Sigurisë" Nr. 3, 2007, fq. 39.

[19] Po aty faqe 35.

[20] Po aty, faqe 73.

Siguria shëndetësore synon të garantojë një mbrojtje minimale të njeriut nga sëmundjet dhe stilet e ndryshme të jetesës. Në vendet në zhvillim, shkaqet kryesore të vdekjeve tradicionalisht janë sëmundjet ngjitëse dhe parazitare, ndërsa në vendet e industrializuara, vrasësit më të mëdhenj janë sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut. Sot, si rezultat i sëmundjeve kronike, rreth 80 për qind e vdekjeve ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Siguria mjedisore synon të mbrojë njerëzit nga shfarosja për shkak të degradimit të mjedisit, i cili vjen si rezultat i shkaqeve objektive dhe subjektive. Mungesa e burimeve ujore, ndotja e ajrit nga emetimi i gazeve të dëmshëm në hapësirë përbëjnë disa nga kërcënimet për të ardhmen e njerëzimit.

Siguria personale ka për qëllim të mbrojë njerëzit nga dhuna fizike, si nga aktorët shtetërorë, ashtu edhe nga individë të veçantë. Për shumicën e njerëzve, burimi më i madh i ankthit është krimi, veçanërisht krimi i dhunshëm.

Siguria e komunitetit ka për qëllim të mbrojë njerëzit nga humbja e marrëdhënieve dhe vlerat tradicionale, si dhe nga dhuna sektare dhe ajo etnike. Komunitetet tradicionale, veçanërisht grupet e pakicave etnike, janë shpesh të kërcënuara. Sipas statistikave të dhëna llogariten që rreth gjysma e shteteve të botës kanë përjetuar disa lloje grindjesh ndëretnike.

Siguria politike ka të bëjë me respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Sipas një studimi të kryer nga *Amnesty International*, dhuna politike, tortura sistematike, keqtrajtimi ose zhdukja kanë prekur rreth 110 vende. Dhunimet e të Drejtave të Njeriut ndodhin më shpesh gjatë periudhave të trazirave politike. Së bashku me shtypjen e individëve dhe grupeve, qeveritë mund të përpiqen të ushtrojnë kontroll mbi idete dhe informacionit. Pra, në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet se siguria njerëzore përfshin të gjitha rreziqet që kërcënojnë mbijetesën e njerëzve, jetën e tyre të përditshme dhe dinjitetin e tyre. Degradimi mjedisor, dhunimi i të drejtave të njeriut, krimi i organizuar, drogat e paligjshme, refugjatët, varfëria e tejskajshme, minat kundër personit, sëmundjet vdekjeprurëse si AIDS etj., janë disa nga këto kërcënime.

Zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare

Lidhur me zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, SSK duhet të japë një dimension të drejtë, në përputhje me tendencat e kohës por edhe për zgjidhjen e çështjeve të mbetura pezull, duke e parë këtë zgjidhje përmes integrimit Euroatlantik, por edhe duke rritur bashkëpunimin diplomatik veçanërisht me Greqinë, Maqedoninë dhe Serbinë.

Me Greqinë mendoj se Republika e Shqipërisë gjate këtyre dekadave si para viteve 90-të, por edhe mbas tyre, ka pasur marrëdhënie të mira. Problemet me Greqinë janë po aq të vjetra dhe të reja, duke filluar me ligjin e luftës dhe çështjen çame që janë dy çështje madhore e duke ardhur në ditët e sotme që janë probleme aktuale. Mosrespektimi i të drejtave të njeriut për emigrantët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë atje duke dhënë pse jo një kontribut modest në ekonominë dhe artin e kulturën greke, ndërhyrjet e herë pas hershme sidomos në jug të Shqipërisë në proceset e zgjedhjeve lokale, pretendimet për vendndodhjen e varrezave të ushtarëve grekë të rënë në Shqipëri, vendndodhjen e kishave, përpjekjet për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kufirit detarë midis dy vendeve tona, e deri në mosnjohjen e shtetit të ri të Kosovës që në fund të fundit është një detyrim për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ndërkohë, në krahun tjetër, sjelljet dhe

qëndrimet e Shqipërisë ndaj Greqisë kanë qenë më të ekuilibruara në kohezion me aktualitetin dhe në përputhshmëri me konventat e marrëdhëniet ndërkombëtare, për të ardhur tek qëndrimi më i ri duke e zgjedhur atë si partnere strategjike për bashkëpunimin rajonal e më gjerë.

Midis Shqipërisë dhe Greqisë ka ende një debat juridik për ekzistencën ose jo të ligjit të luftës. Në të gjitha rastet pranohet se fqinji jugor ka interesa kombëtare strategjike në Shqipëri. Edhe në strategjinë greke të sigurisë kombëtare kujdesi për pakicën greke në Shqipëri ka një vend domethënës. Aty thuhet se "ecuria e marrëdhënieve shqiptaro-greke në strategjinë greke vlerësohet nga respekti i kufijve ekzistues dhe të drejtat e njeriut të minoritetit grek në Shqipëri". Midis dy vendeve ka ende një dosje të pahapur, "çështja çame", e cila në çdo kohë mund të rihapet duke paralajmëruar të jetë krye temë e bisedimeve shqiptaro-greke gjatë dekadës së ardhshme. Natyrisht që askush nuk pret që problemi të marrë një zgjidhje të shpejtë, por një gjë duket se është e sigurt: debati rreth saj është i paevitueshëm. Në dokumentet e deritanishme të sigurisë kombëtare, çështja çame nuk është trajtuar, një mangësi e SSK ekzistuese e cila do ta shndërronte SSK-në në një strategji të vërtetë të sigurisë kombëtare të shtetit shqiptar.

Me Maqedoninë, Shqipëria ka ndërtuar dhe ka mbajtur marrëdhënie të shkëlqyera, e ka njohur atë si shtet që në fillesat e saj, duke ndërtuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit të gjithanshëm, duke garantuar mbështetjen e plotë të Shqipërisë për anëtarësimin e saj në organizatat euroatlantike. Ndërsa nga krahu tjetër me gjithë përpjekjet e Maqedonisë për të pasur marrëdhënie të mira me Shqipërinë që edhe kanë qenë të tilla, por dua të theksoj dhe do të dëshiroja që marrëdhëniet me Maqedoninë duhet të ishin përherë të shkëlqyera dhe mendoj se jo gjithmonë kanë qenë të tilla. Dhe e gjitha kjo ka të bëjë me respektimin e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë atje, që nuk janë të shpërngulur dhe ardhur në Maqedoni, por që janë autoktonë atje në trojet e tyre, në mos krijimin e klimës së bashkëjetesës ndërmjet etnive, në promovimin e traditës dhe kulturës së shqiptare, siç është rasti i investimeve për projektin "Shkupi 2014", botimi i enciklopedisë së Maqedonisë, e cila provokoi shqiptarët, vështirësitë e herë pas hershme për regjistrimin e popullsisë shqiptare, nxitja e konflikteve etnike ndaj shqiptarëve në shkolla, stadiume etj. Hezitimet apo zbatimi i njëanshëm i marrëveshjes së Ohrit që është guri i themelit për funksionimin e shtetit Maqedonas. Ndonëse këto në plan të parë duken sikur janë respektuar nga pala maqedonase, ose së paku kështu pretendojnë ato, mendoj se ka vend për të përmirësuar dhe Shqipëria duhet të ridimensionojë qëndrimet e saj.

Me Serbinë mendoj se duhet të hapet një kapitull i ri në lidhje me marrëdhëniet ndërshtetërore. Shqipëria ka ofruar bashkëpunim dhe është treguar e gatshme për rritjen e fushave të bashkëpunimi, të frymës së mirëkuptimit dhe, nga ana tjetër, të kërkojë nga pala e Serbisë të njëjtën gjë. Sidomos në njohjen e zgjidhjen e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës Metvegjës e Bujanocit, pse jo edhe për njohjen e shtetit të Kosovës. Mendoj se në strategjinë e re të sigurisë kombëtare duhet të përpunohet një platformë e re për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, si dhe për zgjidhjen e çështjes çame me Greqinë.

Përfundime dhe rekomandime

Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është një dokument i rëndësishëm në të cilin përshkruhen sfidat, rreziqet, kërcënimet dhe shanset e një vendi, mënyrat dhe

mjetet që përdoren për menaxhimin e tyre sa më mirë. Ky dokument përbën hallkën më të lartë të zinxhirit të dokumenteve të tjerë të sigurisë dhe politikave kombëtare, prandaj është e nevojshme të rishikohet në periudhën e caktuar kohore, duke bërë përpjekjet maksimale të aktorëve të sigurisë kombëtare. Rishikimi i dokumentit të strategjisë së sigurisë kombëtare gjykoj se nuk është çështje dëshirash apo vullnetesh të një grupi të caktuar njerëzish, grupimesh politike, apo institucionesh të veçanta. Ai është një detyrim ligjor, për t'iu përshtatur ndryshimeve të realiteteve në mjedisin e sigurisë dhe për të marrë të gjitha masat për mbrojtjen e shtetit dhe qytetarëve të vet.

Përcaktimi i saktë i kërcënimeve dhe rreziqeve është baza për zhvillimin e një strategjie të sigurisë kombëtare sa më efektive. Kjo kërkon struktura të specializuara e me eksperiencë, koordinim midis institucioneve të sigurisë në vend, rajon e më gjerë. Roli i aktorëve zbatues të SSK është mjaft i rëndësishëm për ta shndërruar strategjinë në një mjet veprimi dhe jo thjesht një dokument që të mbetet në letër. Megjithatë mendoj që duhet të bëhet një përshtatje më e mirë e rolit kryesor të secilit institucion për realizimin e aspekteve të veçanta të strategjisë së sigurisë, si dhe përshkrimi i rolit mbështetës të aktorëve të tjerë, në varësi të kërcënimeve, rreziqeve apo shanseve që mund të krijohen, të parashikuara në këtë strategji. Siguria njerëzore duhet të zërë një vend të veçantë në SSK. Kjo për vetë arsyen se vendi ynë, si vend anëtar i NATO-s, e ka zgjidhur sigurinë tradicionale të mbrojtjes nga rreziqet e jashtme. Ndërsa siguria njerëzore fillon me mbrojtjen e tij fizike dhe vijon me mbrojtjen e dinjitetit, lirive dhe të drejtat më themelore të tij. Kjo kërkon struktura, ligje dhe angazhim të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë për arritjen e standardeve të vendeve më të përparuara në këtë drejtim. Për më tepër, SSK duhet hartuar në mënyrë të tillë që të mundësojë një koncept të ndërlidhur me sigurinë njerëzore duke u nisur nga rëndësia që kjo e fundit ka për disa fusha (si p.sh. siguria ushqimore, mjedisore, sociale, politike, rrugore etj).

Koncepti i sigurisë kombëtare është zhvilluar ndjeshëm nga nocioni i tij fillestar, i cili lindi menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Thelbi i këtij zhvillimi lidhet si me objektin, ashtu edhe me elementët përbërës të tij. Fillimisht, koncepti tradicional i sigurisë lidhej me mbrojtjen e vendit, kufijve shtetërorë, sovranitetit dhe integritetit territorial të tij nga ndonjë sulm i jashtëm, nga një shtet apo nga grupe shtetesh. Për këtë kërkoheshin marrja e masave të nevojshme ushtarake për t'i bërë ballë një sulmi të tillë. Më tej, sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, u vu re se koncepti i sigurisë kombëtare mori një shtrirje më të gjerë. Në të u përfshi siguria njerëzore, si baza për rritjen e mirëqenies dhe mbrojtjes së tij. Siguria njerëzore lidhet para së gjithash me të drejtat universale të njeriut, i cili lind i lirë dhe duhet të gëzojë të gjitha këto të drejta, pa u cenuar dhe privuar nga dhuna apo rreziqe të natyrave të ndryshme. Gama e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është e gjerë, e cila kap shumë aspekte. Plotësimi i tyre në minimum apo në maksimum, gjykoj se tregon edhe për shkallën e plotësimit të sigurisë njerëzore në shtete të ndryshme.

Sigurimi i minimumit jetik të individit në një shoqëri të caktuar, mendoj se është elementi bazë i kësaj shoqërie. Ndërsa plotësimi i një game më të gjerë mbetet për t'u realizuar hap pas hapi, duke punuar si brenda vendit, po ashtu dhe në nivel rajonal e ndërkombëtar. Siguria shtetërore dhe siguria njerëzore janë dy anë të së njëjtës medalje. E para krijon kushte për zhvillimin e institucioneve shtetërore, mjeteve për realizimin e integritetit territorial, rendit kushtetues, funksionimit të sistemit të zgjedhur, të cilat sigurojnë kushtet për zhvillimin e sigurisë njerëzore. Ndërsa e dyta, siguria njerëzore ruan dhe çimenton vlerat e shoqërisë dhe sistemit demokratik, si dhe çon përpara interesat kombëtare, duke

qenë se njerëzit janë jo vetëm objekte por edhe subjekte të konceptit të sigurisë. Zgjidhja e çështjes shqiptare mendoj se sapo ka filluar me njohjen tashmë ndërkombëtarisht të shtetit të Kosovës dhe mbetet një sfidë e shekullit të 21-të për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje mjaft delikate.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se vendi ynë i ka të gjitha mundësitë për përgatitjen e një dokumenti të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare sa më cilësor, i cili do të përbëjë bazën për avancimin e interesave kombëtare, konsolidimin e vlerave kombëtare, si dhe rritjen e rolit të aktorëve të sigurisë në luftën kundër rreziqeve e kërcënimeve, si shfrytëzimin e shanseve dhe mundësive që sjell zhvillimi teknologjik, globalizimi dhe integrimi në strukturat euroatlantike.

Karakteristikë e vendeve të vogla është se bëjnë reforma të shpeshta dhe flasin për strategji të mëdha.

Bibliografia:

- Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë, Manual për parlamentarët, nr 5, 2003.
- Vërejtje dhe sugjerime të Qendrës Marshall dhënë Ministrisë së Mbrojtjes në vitin 2008.
- Ligji nr. 9322 datë 25.11.2005 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".
- Meidani, Prof. Dr. Rexhep, "Disa Mendime mbi rishikimin e dokumentit të strategjisë", IDM "Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", botimet Toena.
- Law, Dr. David, Ekspert i Lartë i DCAF, "Praktikat më të mira në fushën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim "Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", Botimet Toena, Tiranë 2007.
- Dyrmishi Arjan, "Vlerësimi i strukturave vendimmarrëse në fushën e sigurisë", botuar në "Çështje të Reformës së Sigurisë në Shqipëri", Vol. I, 2009.
- Hide MA Enri, ; Kamberi, MA Geron; Baka, MA Besnik, "Rreth zhvillimit të konceptit të sigurisë kombëtare", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim "Çështje të Reformave në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri", Vol. I 2009.
- King, Geri dhe Murray, Christopher J.L, "Rikonsiderimi i Sigurisë Njerëzore", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim "Çështje të Sigurisë" nr. 3, 2007.
- Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare, Volumi II, Tiranë 2009.

Forcat e Armatosura dhe familja si "greedy institutions"*

Nënkolonel MSc. Latif Shurdhi
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Forcat e Armatosura, në kuptimin social të konceptit, parë nga pikëpamja numerike e anëtarëve të saj, janë një organizatë dhe nga pikëpamja e normave dhe vlerave që ato përfaqësojnë, janë një institucion. Ashtu sikundër dhe familja, e parë nga pikëpamja numerike mund të klasifikohet, nga njëra anë, si grup, por nga ana tjetër, nisur nga pikëpamja e normave, të cilat rregullojnë ekzistencën dhe bashkëjetesën e familjes, si një institucion.*

Institucioni familje dhe institucioni Forca të Armatosura janë pjesë e një shoqërie të caktuar dhe një pikë tjetër, tepër e fortë lidhëse mes këtyre dy institucioneve, të cilat do të trajtohen për nga natyra e tyre në këtë punim, është individi, i cili është njëkohësisht anëtar i familjes dhe i Forcës së Armatosur. Individi, pjesëtar i njëkohshëm i këtyre dy institucioneve, jo vetëm që në jetën e tij të përditshme luan këto dy role, që për një mbarëvajtje të kushteve jetësore duhet t'i përmbushë në mënyrë të balancuar, pa krijuar tensione në raportet e tij me këta institucione, por ka dhe role të tjera që perceptohen dhe përmbushen në bazë të mundësive, aftësive dhe preferencave të tij. Në lidhje me rolet e fundit, që në fakt nuk janë parësorë për individin, nuk do të flitet më poshtë, pasi për temën në fjalë është e rëndësishme të nxirren në pah raportet e individit me familjen, Forcat e Armatosura, natyra e këtyre institucioneve dhe kërkesat që i parashtrojnë ato pjesëtarit të tyre, si dhe instrumente të tjera shtesë që i vijnë në ndihmë balancimit të përmbushjes së roleve, në funksion të harmonizimit të marrëdhënieve të institucioneve me individin.

Institucion është një vendosje e normave të ndërlidhura dhe roleve që rregullojnë një fushë të jetës shoqërore. Studimi i familjeve ushtarake përfshin analizën se si ndërpriten këta dy institucione shoqërore-Forcat e Armatosura dhe familja. Të dy plotësojnë kërkesat e mëdha të individëve në drejtim të angazhimeve, besnikërisë, kohës dhe energjisë, prandaj ata kanë disa nga karakteristika të asaj që *Coser* i quan institucione lakmitare (*greedy institutions*), duke pretenduar se ndërmjet profesionit dhe familjes, për shkak të tendencave të ndryshme sociale në shoqëri dhe në modelet e familjes ushtarake në veçanti, ka konflikte më të mëdha në kohët e sotme se sa në të kaluarën.

Forcat e Armatosura dhe familja

Natyra e *"Greedy institutions"*

Mbijetesa e familjes dhe e Forcave të Armatosura, si të gjitha institucionet e tjera sociale varet nga angazhimi i anëtarëve me pjesëmarrjen dhe besueshmërinë e tyre, me anë të të

* Të quajtura "institucione lakmitare", sipas *Coser, Lewis A.*

cilave ata konkurrojnë njëri-tjetrin dhe grupet e tjera sociale.

Studiuesi i sociologjisë ushtarake amerikane *Lewis Coser* e përshkruan këtë garë: "Grupet e organizuar janë përballur gjithmonë me problemin e shfrytëzimit më të mirë të energjisë njerëzore për qëllimet e tyre. Ata duhet të merren me mekanizma, të cilat sigurojnë se njerëzit do të jenë të motivuar në masë të mjaftueshme për të qenë besnikë edhe përballë ankesave konkurruese nga burime të tjera, brenda strukturave më të gjera shoqërore"[1].

Natyrisht, realizimi i objektivave të një organizate gjendet përballë dy elementeve që janë në konkurrencë me njëri tjetrin dhe pikërisht ndaj elementit kohë dhe energji, të cilët në vetvete të dy janë të fundëm. E parë kjo në këndvështrimin e kohës dhe energjive të vëna në dispozicion, do të thotë që koha është e kufizuar dhe burimet energjetike qofshin këto njerëzore apo materiale, jepen në mënyrë të kufizuar.

Individët mund të përmbushin kërkesat konkurruese, pasi "institucionet moderne sociale kanë tendencë të bëjnë vetëm kërkesa të fundme mbi individin dhe për shkak se kjo shumëllojshmëri e kërkesave kanalizohet përmes rregullave normative dhe preferencave"[2].

Kërkesat e punës e të familjes mund të pajtohen në sasinë e kohës që një individ i detyrohet punëdhënësit të tij, çka është normative dhe madje ligjërisht e përcaktuar, duke bërë të mundur që ky i fundit të ketë kohë për familjen e tij apo shoqatat e tjera joprofesionale (edhe legjislacioni ynë e ka të parashikuar detyrimin kohor që ka individi ndaj institucionit ku ai është punësuar).

Këto kufizime normative dhe ligjore për kërkesat e punëdhënësve janë relativisht të kohëve të fundit. Historikisht, punëdhënësit kishin kontroll më të madh të mbi të punësuarit. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë në sistemet feudale, por ajo karakterizohet edhe në sistemet e mësimit të profesionit. Edhe pas industrializimit, para lëvizjes sindikaliste dhe kufizimeve legjislative, punëdhënësit industrialistë kontrollonin kushtet dhe orët e punës të punonjësve të tyre. Lëvizja sindikaliste solli garanci dhe kushte më të mira të punës dhe u kryen negociata mbi kufizimet ligjore për oraret e punës që punëdhënësit ua mundësojnë të punësuarve.

Megjithatë, në botën moderne, ashtu si në botën tradicionale, ende vazhdojnë të lindin organizata dhe grupe, të cilët, në dallim nga parimet dhe normat mbizotëruese, ngrenë pretendime të përgjithshme për anëtarët e tyre dhe bëjnë përpjekje për ta shfrytëzuar sa më shumë individin. Në lidhje me këtë *Lewis Coser* shprehet: "Këto mund të quhen institucione lakmitare, për aq kohë sa ato kërkojnë besnikëri ekskluzive dhe të pandarë dhe përpiqen për të ulur pretendimet e roleve konkurruese dhe pozicionet e statusit, për ata që dëshirojnë të përfshihen brenda kufijve, duke kërkuar nga individi që të japë gjithçka për to"[3].

Ai bën dallimin mes konceptit të tij të "*greedy institutions*" dhe konceptit të *Goffman* të "institucioneve totale". *Goffman* përcakton një "*institucion total*" si vend i banimit dhe i punës, ku një numër i madh i individëve të vendosur e të shkëputur nga shoqëria e gjerë për një periudhë të gjatë të kohës, të çojnë në një raund të mbyllur zyrtarisht të jetës. Ndërsa ky përshkrim është i lidhur shpesh me burgje dhe në spitale psikiatrike, *Goffman*

[1] Coser, Lewis A., Greedy Institution, Patterns of Undivided Commitment, New York. 1974, f. 43.
[2] Hermes, Eberhard, Individuum, Gruppe Gesellschaft. Stutgart 1987, f. 94.
[3] Ibid, f. 47.

dallon disa lloje të institucioneve të përgjithshme në bazë të qëllimeve të tyre. Ai i përdor kazermat e ushtrisë dhe anijet si shembull i "*institucioneve totale*", gjoja të themeluara për të ndjekur më mirë disa detyra të pëlqyeshme dhe për të justifikuar veten e tyre vetëm mbi këto baza instrumentale. Në fakt, shembulli i tij vjen nga situata ushtarake, trajnime kryesisht nga koha e stërvitjeve bazë të ushtarakëve të saporekrutuar, nga kazermat e thjeshta dhe anijet, - kontekste ku familjet janë të përjashtuara.

Duke njohur mbivendosjet ndërmjet institucioneve totale dhe lakmitare, *Coser* bën dallimin mes tyre. Ai vë në dukje se *Goffman* fokusohet në marrëdhëniet fizike që ndajnë të burgosurit nga bota e jashtme. Në të kundërt, ky tregon se institucionet lakmitare munden që, në disa raste, të shfrytëzojnë pajisjet dhe izolimet fizike ose priren të mbështeten kryesisht në mekanizmat jo fizikë për të ndarë te "brendshmit" nga të "jashtmit" dhe për të ngritur kufijtë simbolikë mes tyre.

Ndërsa Forcat e Armatosura dhe familja nuk mund të posedojnë në një formë ekstreme të gjitha karakteristikat e institucioneve totale, ne mund të konstatojmë se këto zotërojnë mjaftueshmërisht karakteristika për t'u listuar në institucione lakmitare dhe për këtë arsye është e dobishme analiza e tyre.

"Gjatë procesit të diferencimit social, tensionet dhe konfliktet zhvillohen pikërisht aty ku ende nuk është krijuar një model të ri normativ për ndarjen e diferencuar të kohës dhe të energjisë"[4].

Në një analizë të mëtejshme të citatit të mësipërm, mund të kuptojmë se konkurrenca aktuale ndërmjet organizatës ushtarake dhe familjes po ndodh në një periudhë të ndryshimeve të tilla sociale, pa një model të themeluar normativ dhe se kjo do të çojë në modele të reja normative për zgjidhjen e konflikteve. Rezultatet e mundshme të këtij procesi të përshtatjes institucionale mund të analizohen në aspektin e modelit institucional e profesional, e organizimit ushtarak duke eksploruar nëse ata e çojnë organizatën ushtarake në një drejtim më institucional apo më profesional. Është e rëndësishme të dihet se ndryshimi mund të jetë nga një formë institucionale në një tjetër.

Për institucionet, grupet dhe organizatat brenda tyre, për të mbijetuar përballë kërkesave konkurruese për individët, ato duhet të zhvillojnë mekanizma për motivimin, pjesëmarrjen dhe angazhimet individuale. Në ushtrinë institucionale, siç përshkruhet nga Moskos, "angazhimi individual dhe sakrifica vetëlegjitimohet përmes veprimit të vlerave normative, që e detyrojnë individin të pranojë kërkesat e mëdha për kohën dhe energjinë e tij"[5].

Më tej, organizata vendos kërkesat që individi nuk ka mundësi t'i zgjedhë, por që duhet t'i përmbushë ato. Roli detyrues është aq ndikues, saqë ushtaraku edhe jashtë vendit të punës reflekton natyrën e vendit të punës. Në këmbim të shërbimit të tij, pjesëtari i Forcave të Armatosura kompensimin e tij në pjesën më të madhe të shoqërisë e merr në formë të veçantë, ku shumica e këtij kompensimi është në formë jo monetare. Nga disa lloje të kompensimit jo monetar, ato që kanë rëndësi më të madhe për familjet janë siguria e punës, mundësia e strehimit, kujdesi mjekësor, aktivitete të ndryshme social-kulturore etj.

Për të përmbushur misionin e tyre, Forcat e Armatosura bëjnë kërkesa të ndryshme për anëtarë e vet. Ndërsa ajo ushtron disa presione të veçanta normative direkt mbi anëtarët e

[4] Hermes, Eberhard Ibid, f. 21.

[5] Moskos, Charles C. , From Institution to Occupation, "Military and Society" Washinton DC. 1974, f. 29.

familjes, shumica e presioneve që ndikojnë në familje ushtrohen në mënyrë indirekte, përmes pretendimeve të bëra nga ushtaraku, i cili njëkohësisht është anëtar i familjes ose në shumicën e rasteve kryefamiljar. Për të dy llojet e presioneve, familja pritet të përshtatet me lakminë e pangopur të institucioneve ushtarake dhe të mbështesë anëtarin e këtij institucioni në përmbushjen e detyrimeve ndaj organizatës.

Për të sqaruar konfliktin, mënyrat në të cilat familja vepron si institucion lakmues, do të shqyrtohet Forca e Armatosur si një *greedy institutions*, dhe kërkesat specifike që e bëjnë të tillë, si dhe disa efekte që ato kërkesa sjellin për anëtarët e shërbimit dhe familjet e tyre dhe, së fundmi, tendencat që çojnë në rritjen e konfliktit dhe përshtatja aktuale dhe potenciale e Forcave të Armatosur ndaj tendencave të familjes.

Familja si një "Greedy Institutions"

Anëtarët e familjes bërthamë janë të prirur të jenë të përkushtuar emocionalisht ndaj familjes, për të shfaqur dashuri ndaj anëtarëve të tjerë, për t'u identifikuar me familjen si një të vetëm dhe për të përmbushur detyrimet e roleve, që janë relative në hapjen e tyre ndaj grupeve të tjera shoqërore. Megjithatë, familja nuk është institucion që lakmon të njëjtin përkushtim ndaj saj nga të gjithë anëtarët. Nëse do të përdoret koncepti i lakmisë si dimension i vazhdueshëm, familja është më lakmitare për disa anëtarë se sa për të tjerët.

Lewis Coser dhe *Rose Coser* vunë re se familja është lakmitare ndaj grave. Ndryshimet e fundit në legjitimitetin normativ të këtij përcaktimi kanë gjetur se nuk është burri, por gruaja që pritet t'i kushtojnë më shumë nga koha e saj, si dhe energjitë emocionale për familjen e tyre. Ata diskutojnë se, si amvisa, duhet të mbajnë shtojcë ekskluzive për familjen dhe për të bërë sakrifica për të. Për shembull, edhe si shkak dhe pasojë e lakmisë së pangopur të familjes, gratë janë përjashtuar nga profesione të statusit, sepse profesionet e tilla kërkojnë angazhime që do të ndërhyjnë me përmbushjen e detyrimeve familjare.

Lewis dhe *Rose Coser* ofrojnë njohuri në dinamikën e konfliktit mes kërkesave të familjes dhe kërkesave profesionale për grua me një profesion të caktuar. Ky konflikt është besnikëri, dhe nuk rrjedh nga vetë fakti i përfshirjes në më shumë se një sistem shoqëror. Konflikte të tillë, zakonisht nuk dalin në rastin e burrave. Meshkujt mund të angazhohen plotësisht në profesionet e tyre pa frikë, për të qenë të akuzuar për mungesën e përkushtimit ndaj familjeve të tyre. Ky fenomen ndodh vetëm kur ka një detyrim normativ që familja do të ndajë burimet e kohës, energjisë dhe të ndikojë në pamundësinë e ndarjes me institucione të tjera sociale ku mund të lindë konflikti. Kjo, zakonisht ndodh vetëm në rastin e gruas që ka mandatin kulturor për të dhënë besnikërinë primare për familjet e tyre (mendimi sundues tradicional për rolin e gruas në familje).

Ndërsa ky konflikt është në përgjithësi më i madh për gruan, ajo ndodh edhe për burrat, në atë masë që puna e tyre ndërhyn me aftësinë e tyre për të siguruar burimet e pritshme normative të kohës, energjinë dhe që ndikojnë në familje. Kjo ndodh kur familja është relativisht lakmitare ose vetë puna është aq lakmuese saqë ndërhyn në përmbushjen e kërkesave relativisht minimale familjare.

Në faza të caktuara, sigurisht familja është relativisht lakmitare për të dy së bashku, burrat dhe gratë. Ky është rasti për shembull në martesat e reja, të cilat kërkojnë kohë më të madhe për rregullim emocional se sa në marrëdhëniet e krijuara edhe me fëmijët, të cilët janë në një moshë të tillë apo për arsye të tjera kërkojnë një mbikëqyrje konstante. Fëmijët më të mëdhenj kanë nevojë për më pak mbikëqyrje të vazhdueshme, megjithatë

prindërit e adoleshentëve shpesh e gjejnë këtë fazë duke kërkuar energji emocionale.

Për më tepër, ndërkohë që kujdesi për fëmijët dhe ndaj detyrave shtëpiake janë konsideruar tradicionalisht etërit e punës, gratë nuk janë shfajësuar nga të gjitha përgjegjësitë familjare, edhe pse ndryshimet sociale po e rrisin pjesën e tyre normative. Legjislacioni ka hequr shumë barriera arsimore dhe profesionale për gruan, duke rritur aksesin e tyre në pozita të një statusi më të lartë se më parë. Këtë zhvillim në raport me gruan e kemi evident edhe në shoqërinë tonë, duke bërë që roli dhe prania e saj në veprimtaritë sociale, kulturore, politike të jetë në rritje të vazhdueshme, e shprehur kjo edhe në rritjen e numrit të femrave që shërbejnë në Forcat e Armatosura.

Duke parë drejt së ardhmes, *Lewis* dhe *Rose Coser* parashikojnë një kohë kur, si rezultat i të dy orareve të punës, më fleksibile dhe në detyrat më të pakta kundrejt shtëpisë, modelet e punës së grave dhe roleve familjare do t'u ngjajnë atyre të burrave.

Në këtë moment, mund të fillojnë të parashikojnë një plejadë të re familjare, në të cilat të dy, ai dhe ajo janë ofruesit e familjes, menaxherët e përbashkët të familjes dhe partnerë të vërtetë në kujdesin për fëmijët, në mënyrë që burimet e tyre përkatëse të pushtetit janë gati të barabarta[6] .

Me zhvillimet e botës moderne, familja e së ardhmes do të pushojë së qëni ekstremisht lakmitare për gruan dhe se kërkesat e përgjithshme të familjes do të ulen. Sa më shumë gratë do t'i rezistojnë grykësisë së familjes dhe marrin pjesë në botën e punës, aq më të mëdha do të jenë kërkesat familjare të anëtarëve të familjes. Kjo rrit potencialin për konflikt, jo vetëm ndërmjet burrave dhe grave, sidomos gjatë tranzicionit për barazi më të madhe mes tyre në shtëpi dhe në punë, por edhe në mes të punës dhe kërkesave të familjes për burrat, sidomos për ata që janë në profesione të tilla si në Forcat e Armatosura. Për shembull, ne mund të presim presione që ndodhin për gratë dhe burrat, për të përshtatur vendimet e tyre të karierës për nevojat familjare, duke përfshirë konsideratat e karrierës dhe ato bashkëshortore[7].

Forcat e Armatosura si *"Greedy Institutions"*

Ashtu siç shprehet edhe në zhargonin e ditës në lidhje me veçantinë e shërbimit në ushtri, Forcat e Armatosura janë specifike në modelet e kërkesave që bën për anëtarët e shërbimit dhe familjet e tyre. Edhe në institucionet e tjera ka kërkesa specifike, bazuar në natyrën e objektivave që ata kanë, por megjithatë, Forcat e Armatosura janë pothuajse unike në konstelacionin e kërkesës ndaj anëtarëve të vet, gjë që i bën ato të dallueshme nga institucionet e tjera. Ndërsa disa kërkesa ndryshojnë në frekuencë dhe intensitet mes tyre dhe brenda shërbimeve, gjatë karrierës ushtarake, një familje mund të presë që të përjetojë të gjithë varietetin e kërkesave të veçanta.

Karakteristikat e stilit të jetesës përfshijnë rrezikun e lëndimit ose vdekjes së anëtarit të Forcave të Armatosura, largimin e ushtarakut për një kohë relativisht të gjatë për studime, trajnime apo shërbim ushtarak, duke e ndarë përkohësisht nga pjesa tjetër e familjes ose qëndrim të gjithë familjes në vendet e huaja. Ka edhe presione normative direkt mbi anëtarët e familjes (p.sh. transferimi i ushtarakut, që në të shkuarën e afërt të FA të Shqipërisë ka qenë shumë i shpeshtë dhe tani ekziston, por në një masë më të zbutur).

[6] Coser, Lewis A., Ibid, 1974 f. 88-89.
[7] Ibid. f. 93-95.

a. Rreziku i lëndimit ose i vdekjes

Rreziku që personeli ushtarak mund të plagoset ose të humbasë jetën për arsye të shërbimit, gjatë kryerjes së detyrës së tij, është një aspekt i dukshëm i kërkesave të institucionit. Legjitimiteti i institucionit për të vendosur anëtarët e saj në rrezik të tillë fizik është ndoshta aspekti me i veçantë i FA-së, aspekt që e shoqëron këtë institucion që nga historia e krijimit. Ndërsa ky rrezik për kohën moderne është më i madh se në kohë lufte, edhe në kohë paqeje manovrat ushtarake të trajnimit sjellin disa rreziqe për plagosje apo edhe më të rënda se sa plagosje ose personeli ushtarak madje mund të dërgohet në zonat e konfliktit të armatosur. Efektet mbi familjet ushtarake të potencialit të lëndimit dhe vdekjes, në të dyja rastet, si në kohë paqeje dhe lufte, janë studiuar relativisht rrallë. Prandaj, në lidhje me këto dihet më pak se sa për efektet e kërkesave të tjera ushtarake në familje.

b. Lëvizshmëria gjeografike

Siç thamë edhe më lart në lidhje me të shkuarën e afërt të Forcave tona të Armatosura, personeli ushtarak ka patur një lëvizshmëri gjeografike për arsye të transferimeve të shpeshta; edhe tani ky fenomen ekziston, pavarësisht zvogëlimit të tij në nivele më të vogla. Sipërfaqja e territorit të shtetit tonë është relativisht e vogël, por mungesa e infrastrukturës së përshtatshme ka pas bërë që distancat gjeografike relativisht të vogla të kishin një distancë kohore relativisht të gjatë për t'u arritur. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ka ndikur në përmirësimin e kushteve të lëvizjes dhe arritjen më të shpejtë në kohë të distancave gjeografike, që më përpara kërkon mbase edhe një ditë udhëtim të lodhshëm. Kështu që efektet e këtij fenomeni i kanë pas prekur shumë familje ushtarakësh. Aktualisht, edhe pse në numër shumë të vogël, ka oficerë të rinj që shërbejnë larg familjeve dhe vendbanimeve të tyre, që me ndryshimet e pavarësisht përmirësimeve të përmendura më sipër, ai nuk është zeruar. Për këtë arsye edhe kjo pikë duhet të jetë në vëmendje.

c. Ndarja

Kërkesat ushtarake shpesh kërkojnë që anëtarët e shërbimit të jenë larg familjeve të tyre. Shtrirja dhe natyra e këtyre kërkesave ndryshojnë brenda dhe ndërmjet shërbimeve. Në kohë paqeje, llojet më të zakonshme të detyrave që rezultojnë në ndarje familjare, përfshijnë shkollimin ushtarak dhe lëvizjet e ndryshme të organizuara për qëllime mësimore apo stërvitore, gjatë të cilave familjet qëndrojnë të ndara. Ka edhe detyra për të cilat familja lejohet të shoqërojë anëtarin e shërbimit, por për arsye të ndryshme nuk zgjedh për këtë, pasi bashkëshorti apo bashkëshortja e anëtarit të Forcave të Armatosura, për arsye të ndryshme (të zënies me punë etj), preferon të mos e ndjekë këtë të fundit.

Efektet e ndarjeve të familjeve ndryshojnë në varësi të llojit të ndarjes, ndërsa të tjerat janë të përbashkëta për shumicën. Kjo duhet të jetë në vëmendje për të krijuar rregullime në lidhje me ndarjet e ushtarakëve nga bashkëshortet dhe fëmijët e tyre.

d. Qëndrimi në vendet e huaja

Ne jemi dëshmitarë të zhvillimeve në Forcat tona të Armatosura pas rënies së murit të Berlinit. Që në mesin e viteve 90, kontingjente të caktuara të Forcave tona të Armatosura kanë qenë pjese e misioneve ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë këta efektivë kanë kryer shërbim në vende të huaja dhe madje në vende ku situatat kanë qenë të ngjashme me ato të luftës. Anëtarësimi në NATO e ka rritur faktikisht numrin e misioneve dhe të efektivëve që shërbejnë jashtë vendit, prandaj fenomenet sociale që shoqërojnë ushtarakun dhe familjet e tyre kërkojnë një studim më të hollësishëm se sa kjo përpjekje e shkurtër.

Megjithatë, duke iu referuar studimeve analoge të kryera nga sociologet amerikanë, ne mund të themi se qëndrimi në detyrë në vende të huaja mund të sjellë në familje ushtarake përfitime dhe vështirësi.

Të gjitha përvojat e zhvendosjes ndryshojnë sipas mënyrës se sa e ndryshme është kultura e vendit pritës nga ajo e shoqërisë sonë. "Reagimi fillestar është shpesh një "tronditje kulturore". Normat e sjelljes ndryshojnë për çështje të ndryshme, barrierat gjuhësore mund të çojnë në ndjenjat e izolimit, madje edhe në frikë"[8] .

Modelet ushtarake familjare

Familjet e ushtarakëve janë komplekse, pavarësisht se edhe ajo është një familje bërthamë si gjithë familjet e tjera, pasi ajo rregullohet nga ndërthurja e normave ushtarake me ato tradicionale civile të shoqërisë, në të cilën ajo është pjesë e saj. Duke iu referuar sociologëve amerikanë *Lewis Cose* dhe *Charles Moscos*, organizatat ushtarake kërkojnë nga familjet ushtarake të adaptohen lloje të caktuara modelesh[9]. Ne këtë kuptim, bashkëshortët dhe fëmijët duhet të jenë të gatshëm për situata të ndryshme, si p.sh. kur anëtari i familjes, pjesëtar i Forcave të Armatosura është transferuar, është dërguar me studime brenda dhe jashtë vendit ose është pjesë e kontingjenteve, të cilat kryejnë shërbim në zona konflikti në kuadër të misioneve të ndryshme për vendosjen apo ruajtjen e paqes. Familjet duhet të jenë të gatshme të përballojnë ndarjen, bashkëshortët duhet të jenë të gatshëm, në dispozicion dhe të aftë të kryejnë rolet e familjarëve të lënë bosh nga anëtari që mungon.

Konflikti në mes të kërkesave ushtarake dhe nevojave familjare, shmanget kur familja i përshtatet kërkesave të ushtrisë. Në këtë kontekst, duke parë edhe përbërjen, gjendjen sociale në të cilën ndodhet familja apo përshtatjen e kësaj të fundit me normat ushtarake të anëtarit të saj. Për këtë arsye do të shohim disa aspekte të formës dhe përbërjes familjare ushtarake.

a. Burrat ushtarakë

Në familjet ushtarake shqiptare më shumë nënkuptohet që kryetari i familjes është ushtarak. Siç theksuam më lart në këtë studim, gratë civile janë më të predispozuara për të qenë të varura nga normat ushtarake të bashkëshortëve të tyre, pavarësisht se vetë ato mund të kenë disfavore të tjera në jetën e tyre intelektuale apo edhe sociale.

b. Gratë ushtarake

Duke e studiuar gruan si pjesë të Forcave të Armatosura mund të thuhet që, edhe pse numri i tyre në krahasim me burrat ushtarakë është më i vogël, ndihmesa apo përkushtimi i tyre në Forcat e Armatosura ka qenë për t'u vlerësuar.

Mund të thuhet që gratë ushtarake kanë një ndërmarrje akoma më të vështirë, pasi, përveç respektimit të normave ushtarake, ato janë nëna, bashkëshorte dhe në këtë rast familja dhe Forcat e Armatosura janë dy institucione që e lakmojnë metë njëjtën fuqi tërheqëse.

c. Çiftet e dyfishta ushtarake

Pavarësisht se në numër e vogël, por që nuk mund të lihet pa përmendur, familja e dyfishtë ushtarake është edhe një kategori tjetër. Kjo kategori e familjes edhe pse është

[8] Ibid., f. 101.

[9] Moskos, Charles C., From Institution to Occupation, "Military and Society". Washington DC. 1974.f. 31.

më e familjarizuar me sistemin ushtarak, ka problemet e saj në lidhje me menaxhimin e personelit, për shkak se shumica e çifteve të tilla dëshirojnë vendbanim të përbashkët, çka i kërkon ushtrisë koordinimin e detyrave të dy njerëzve. Këto, gjithashtu, paraqesin shqetësim rreth vendosjes së çifteve me fëmijë, sepse ata si prindër të vetëm, nuk kanë një bashkëshort civil që pritet të sigurojë përgjegjësitë prindërore.

Në të gjitha rastet, këta çifte mund të përfitojnë nga Forcat e Armatosura në dy mënyra kryesore.

Së pari, ndërsa në familjet e tjera anëtarët civilë të familjes duhet të përshtaten, familja me të dy anëtarët ushtarakë mund të përshtatet më lehtë me mundësitë e punësimit.

Së dyti, por edhe mjaft të përshtatshëm për analizën e efekteve të familjes mbi trendet institucionale dhe profesionale, çiftet ushtarake të përbëra nga dy anëtarë me uniformë, ka të ngjarë të jenë më të përkushtuar në rrugën ushtarake të jetës dhe për të kuptuar njëri -tjetrin në kërkesat e punës.

d. Modelet e vetme

Modelet e vetme (ose prindër të vetëm), janë familje me një prind, të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë njërin prej prindërve në përbërjen e saj. Familja lakmon prindin e vetëm për shkak se nuk ka një tjetër prind të ndarë në përgjegjësitë e kujdesit të fëmijëve. Konflikti mes detyrimeve të shërbimit ushtarak dhe kërkesave te familjes mund të ndodhë.

Në vend të përmbledhjes

Në përgjithësi, sa më shumë shërbimet ushtarake të përshtaten me nevojat familjare, aq më shumë të përkushtuar do të jenë të dy pjesëtarët dhe familjet e tyre në këtë institucion. Cilësia e jetës së familjes dhe plotësimi i kërkesave të saj në lidhje me Forcat e Armatosura mund të përmirësohet me politika të tilla si:

- të merren parasysh dëshirat e familjes në kohën e zhvendosjes, kur të jetë e mundur,
- të jepet njoftim paraprak për lëvizjet brenda apo jashtë vendit,
- të sigurohen forma të ndryshme ndihme psiko-sociale kur largimet e anëtarit të familjes janë të nevojshme.

Sa më shumë të bëjnë Forcat e Armatosura për efektivat e tyre dhe familjet e tyre, atëherë, me të vërtetë, ata dëgjojnë dhe besojnë mesazhin se "Forcat e Armatosura kujdesen për vete".

Si rrjedhojë e kësaj, konflikti midis dy institucioneve lakmitare, të Forcave të Armatosura dhe të familjes, do të jetë më i zbutur dhe më i harmonizuar për të shmangur rënien në krizë të familjes dhe, si rezultat, edhe të individit në cilësinë kryefamiljarit apo të amvisës.

Për aq kohë sa Forcat e Armatosura e shikojnë familjen si një ndikim nga jashtë, me të cilën ajo konkurron, Forcat e Armatosura ka të ngjarë të lëvizin vetëm në një drejtim. Në momentin që ato punojnë për ta përfshirë familjen në vetvete dhe të përshtaten me të, rezultati do të jetë jo ndryshimi institucional, por ruajtja e natyrës institucionale të

organizatës ushtarake dhe ky do të jetë drejtimi i duhur në të cilin Forcat e Armatosura duhet të ecin në lidhje me politikat e rekrutimit dhe të trajtimit të personelit të vet.

Bibliografia:

- Coser, Lewis A., Greedy Institution, Patterns of Undivided Commitment. New York, 1974.
- Moskos, Charles C., From Institution to Occupation, "Military and Society". Washington DC. 1974.
- Hermes, Eberhard, Individuum, Gruppe Gesellschaft. Sttutgard 1987.
- Coser, Lewis A., Houswieves and her greedy Family. Greedy Institutions. New York 1975.
- Bennet, William M., Army Families, (Carlisle Barracks, US Army War College, 1974.
- Doering, Zahava D. dhe P.Huttzler William, Description of Officers and enlisted Personnel ine the US armed forces. Research for Military Manpower Analysis. 1982.
- Dernauer, Paul, "Adolescence Experience in Career Army Families, Family in Military System. Washington DC. 1985.
- Segal, Mady Wechsler, Interuniversity for Military and Society. Washington.1986.

Të panjohurat e "Botës" së Paqeruajtjes dhe Paqebërjes

Kolonel Dr. Zaho Golemi
MSc. Granit Zela

Trajtesë e shkurtuar. *"Bota" e paqeruajtjes dhe paqebërjes lindi si një "profesion" i ri i ushtarakëve. Paqeruajtja është bërë objekt studimi dhe analize edhe nga studimet sociologjike. "Socius"-i latin dhe "Logos"-i grek[1] shtrihen dhe në studimet ushtarake, ndërkohë që shkenca sociologjike nuk është vetëm "privilegj" i hapësirës humane civile, por faktikisht përfshin një spektër më të gjerë.*

Shoqëria shqiptare është ndeshur që prej dy dekadash me praktika të dukurive, problemeve e fenomeneve të blerta. Angazhimi më serioz ka filluar kur Shqipëria u bë pjesë e trupave paqeruajtëse e paqebërëse në Irak, Afganistan, Çad, Bosnjë-Hercegovinë dhe Gjeorgji. Eksportimi i sigurisë është shoqëruar edhe me aspekte psikologjike e sociologjike që rrallë janë bërë objekt i studimeve sociologjike shqiptare.

Duke pasur si pikënisje faktin që mbi 6000 shqiptarë kanë shërbyer nën uniformë në dhjetëra misione paqeruajtëse e paqebërëse, studimet sociologjike mund të bëjnë objekt analize karakteristikat psikologjike e sociologjike të këtyre misioneve, dhe të hulumtojnë në të njëjtën kohë edhe ndikimet në jetën e përditshme të ushtarakëve që kanë shërbyer e shërbejnë në misione paqeruajtëse.

Çështje kërkimore, të njohura e të panjohura, të "botës" ushtarake sjellin natyrshëm debate e diskutime për një mozaik të panjohur e të larmishëm të fushës së paqeruajtjes dhe paqebërjes botërore, si një çështje specifike me vlerë në fushën e kërkimit shkencor në shkencat humane.

Përqendrimi tek "arti i shkatërrimit"

Studimet sociologjike kanë qenë shpeshherë fragmentare në analizën e çështjes së konflikteve ushtarake në botë gjatë shekullit të kaluar. Amerikani *Mathew White*, në librin e tij me titull "Libri i madh i tmerreve: kronika e 100 barbarive më të mëdha të historisë", libër i cili mund të quhet edhe si "Libri i zi i njerëzimit"[2], ka skeduar 100 konfliktet më të ashpra ushtarake në histori, që i kanë kushtuar botës rreth gjysmë miliardi jetë njerëzore.

Njerëzimi është ndeshur përgjatë historisë me luftëra e konflikte që kanë përfshirë pothuajse të gjitha kontinentet. Tashmë është e provuar se, kafsha më e etur për gjak në

[1] Socius në latinisht do të thotë "shoqëri" ndërsa "logos" vjen nga greqishtja e do të thotë "shkencë".
[2] Matthew White, "The Great Big Book of Horrible Things: The Definitive Chronicle of History's 100 Worst Atrocities", New York, 2011.

planet është lloji "Homo sapiens", i cili gjatë evolucionit të historisë, mbizotëroi mbi njeriun e Neandertalit,[3] jo nga inteligjenca, por dhe më i keq se kaq. "Homo sapiens-i" është treguar gjithmonë grabitçar. Instinkti vrasës dhe etja për gjak kanë qenë më zotëruese krahasuar me solidaritetin njerëzor.[4] Ndryshe nuk ka si të shpjegohen luftërat e panumërta, të cilat janë quajtur si "art i shkatërrimit". Një pjesë e madhe e shpikjeve të njerëzimit lidhen me luftërat dhe konfliktet. Gjashtë mijëvjeçarë të qytetërimit tregojnë se ajo që "homo sapiensi" di të bëjë më mirë është luftërat dhe vrasjet. Përfundimi është domethënës: "njeriu ka qenë aktori dhe autori i ngjarjeve më të përgjakshme të historisë së njerëzimit, nga luftërat persiane të shekullit V para Krishtit, deri tek 66 milionë viktimat e Luftës së Dytë Botërore". Njerëzimi numëron 455 milionë të vdekur, një kasaphanë e vërtetë, për të cilën në greqishten e lashtë përdorej termi "emoclisma"[5].

Bota është e mbushur me shembuj të shumtë të milionave të humbur gjatë shekujve; në luftën legjendare të Trojës, mbetën të vrarë rreth një milionë e gjysmë vetë; pushtimi mysliman i Indisë, ndërmjet viteve 1000 dhe 1700 sipas historianëve është një ndër çështjet më të përgjakshme e njerëzimit prej 50 milionë të besimit hindu të vrarë; në vitet 800 revolta në Taiping në Kinë pati 20 milionë viktima; ndërsa kryqëzatat, si konflikt fetare, shkaktuan 3 milionë të vdekur etj. Dhe të gjitha këto konflikte të përgjakshme të historisë studiohen nga "atrocitologjia" [6], e cila analizon këto mizori që përbëjnë "Librin e zi të njerëzimit".

Por "Libri i zi i njerëzimit" nuk është mbyllur as në kohën tonë: Lindja e Mesme, Kaukazi, Ukraina, Siria, zona të tjera të nxehta të globit "prodhojnë" konflikte e viktima të përditshme. Politikat dhe diplomacitë globale nuk kanë mundur të ofrojnë siguri njerëzore, një ndër përparësitë e organizatave më të mëdha ndërkombëtare të globit. Nga ana tjetër, luftërat tradicionalisht janë studiuar si një problem që rrjedh nga marrëdhëniet midis shteteve; ndërsa doktrinat strategjike, marrëveshjet për kontrollin e armëve dhe krijimi i organizatave ndërkombëtare synojnë të pengojnë luftërat midis shteteve bashkë me viktimizimin e shteteve të dobëta dhe të dështuara. Të parandalosh luftërat është më pak e kushtueshme se të lejosh të ndodhin luftërat e pas tyre të vendoset e të ruhet paqja.

Hulumtimet në këtë fushë dhe politikat institucionale përfshi aspektet juridike duhet të ecin në një hap me politikat strategjike të kërkimit shkencor global. Analiza shkencore e faktorëve me ndikim sociologjik në forcat ushtarake shqiptare pjesë e misioneve paqeruajtëse mund të përbëj objektin e studimit të shkencave humane. Kjo analizë u shërben edhe ushtarakëve drejtues në këto misione të cilët mund t'i përdorin gjetjet e studime të tilla me qëllim që "mesazhi për këta ushtarakë të përcillet në mënyrë më të efektshme" [7], tek të gjithë elementët njerëzor që realizojnë paqeruajtjen si dhe me synimin që "misioni të realizohet me sukses"[8].

---

[3] "Njerëzit modernë" cilësohen ose klasifikohen si lloji *homo sapiens*, nënlloji i vetëm ekzistues i të cilit është "Homo sapiens sapiens". "homo neanderthalensis", që u zhduk rreth 30000 vjet më parë, herë pas here është klasifikuar si nënlloji "*homo sapiens neanderthalensis*", por studimet e fundit gjenetike na sugjerojnë një shmangie të neandertalit nga homo sapiensi rreth 500000 vjet më parë.

[4] Revista "Mbrojtja", organ qendror i Ministrisë së Mbrojtjes, fq. 48, qershor 2008.

[5] Fjala "emoclisma" vjen nga greqishtja e lashtë dhe shkencërisht do të thotë "përmbytje gjaku".

[6] "Atrocitologjia" është një disiplinë e veçantë që merret me studimin e përllogaritjeve si dhe të përshkrimit të mizorive njerëzore. Një ndër ekspertët më të mëdhenj në këtë fushë, është është *Matthew White*, nga Ricmond, Virginia, një bibliotekar metodik dhe i vlerësuar amerikan.

[7] Rudolf Giuliani, Udhëheqja, ShB. Dudaj, Tiranë, viti 2006, faqe 211.

[8] Mehmet Ali Birand, Urdhëroni Komandant!/Emret dersiniz Komutanim!, SHBU, Tiranë, 1994, faqe 143.

Paqeruajtësit që "lindën" nga "shkolla e luftës"

Paqeruajtësit dhe paqebërësit kanë "lindur" nga "shkolla e luftës". Ata kanë përvojë ushtarake të betejave në luftërat botërore dhe më pas me përpjekjet për ruajtjen e paqes. Ushtria franceze, më 1917, u tërhoq nga Moska e detyruar pas një rënieje të frymës luftarake, pesimizmit dhe vështirësive ekonomike si mungesa e furnizimit me ushqime, armatime e municione. Kjo krizë morale e trupave ushtarake franceze lidhej edhe me dimrin e ashpër rus, për të cilin udhëheqja ushtarake francez nuk ishte përgatitur. Një shembull tjetër është ai i vitit 1944, kohë kur ushtria fashiste gjermane pësoi të njëjtin fat përballë ushtrisë ruse, kur u paralizua 60% e industrisë, e transportit dhe burimeve minerale, të cilat detyrimisht çuan në konsumimin moral në radhë të parë dhe më tej atë material, që çoi në dështimin e luftës së tyre.

Gjysmë shekulli pas LIIB, në Luftën e Gjirit Persik, në operacionin e forcave shumëkombëshe "Stuhia e shkretëtirës", u duk qartë uniteti mes faktorëve të strategjisë ushtarake, mbështetjes materiale dhe forcës morale të ushtrisë. "Objektivi ushtarak ishte mposhtja e frontit iraken, nëpërmjet pengimit të ushqimeve dhe bombardimeve njëzetekatërorëshe pa ndërprerje, për të shkatërruar moralin e trupave irakene"[9] Pas luftës, forcat ushtarake shndërrohen në forca të ruajtjes së paqes, mision i cili kërkon qartësi morale, nisma e veprim të kthjellët operacional, bindje në misionin e marrë, kujdes material e shëndetësor, përshtatje të veshjes për kushtet e reja të operacionit, ruajtjen e gjendjes së mirë shëndetësore, fizike, ushtarake dhe morale.

Një nga rekomandimet për logjistikën të N. E. Morris-it në librin "Rruga drejt triumfit" është gatimi i ushqimeve për paqeruajtësit njësoj si në vendet e tyre, sidomos për ditë pushimi dhe festash; me qëllim që "paqeruajtësit ta ndiejnë veten si në shtëpinë e tyre, të harrojnë lodhjet dhe tensionin e luftës e kërcënimit si dhe të ripërtërijnë forcat dhe shpirtin luftarak, pasi këto ndikojnë mbi gjendjen morale.[10] Është fakt se kërcënimi i urisë, lodhjes, pagjumësisë, është po aq i rëndësishëm sa kërcënimi moral e material. Paqeruajtësi duhet të jetë i siguruar me ushqim, kushte pushimi, mbështetje e siguri në përmbushje të detyrës. Në planin moralo-psikologjik, qetësia shpirtërore, besimi, fryma luftarake është domosdoshmëri.

Nga njëri kontinent në tjetrin ka me dhjetëra e qindra përvoja betejash e luftërash nga më interesantet, aq sa aktualisht bota ka sot një "bibliotekë" gjigande me përvoja doktrinare e luftarake, mësymëse e mbrojtëse, fitore dhe disfatash. Studiuesi amerikan Pery M. Smith[11] në librin e tij "Doktrina ushtarake e SHBA", ka mbledhur fakte historike nga historiografia botërore. Ai arrin në përfundimin se, ushtria ruse në shekullin XVI, për mungesë furnizimi me material, hodhi armët, nuk njihte asnjë lloj pushteti civil, kundërshtoi urdhrat, deri sa përfundoi në luftë të ashpër civile, pasi shpresat për atdheun e vet u humbën. Ndikimi i faktorit material në gjendjen luftarake e moralo-psikologjike nuk duhet parë në përgjithësi, por i specifikuar sipas natyrës së detyrave, kushteve klimaterike, përbërjes së efektivave etj. Historia ushtarake botërore është e mbushur me shembuj të shumtë nga lindja e perëndimi, nga lashtësia tek historia bashkëkohore dhe që mund të studiohet nga këndvështrime të ndryshme sociologjike.

Mbarimi i Luftës së Ftohtë solli ndryshime edhe për paqeruajtjen. "Tranzicioni" nënkupton ristrukturimin tërësor të makinerive moderne ushtarake, misioni i së cilave ka qenë

[9] N. E. Morris, "Rruga drejt triumfit", Tiranë, faqe 208.
[10] Ibid, faqe 230.

parandalimi i konflikteve dhe dhunës; ndërsa koncepti i ri strategjik kërkon organizata postmoderne ushtarake, me mision të posaçëm paqeruajtjen. Ky tranzicion vazhdon dhe është një proces historik ndryshimi që ka filluar mbas Luftës së Dytë Botërore e që vijon me forcat moderne të organizuara për parandalimin e konflikteve. Këto ndryshime në formatin organizativ normalisht kanë pasoja dhe një ndër to është kuptimi individual subjektiv i ushtarakut, se çfarë është duke bërë dhe përse vepron në këtë mënyrë.

Ushtritë nga më modernet sot në botë, janë ridimensionuar e ristrukturuar në funksion të përmbushjes së detyrave të reja, është zëvendësuar shërbimi ushtarak i detyrueshëm me atë ushtrisë profesioniste, ide kjo e përkrahur nga shumë shtete evropiane e më gjerë. Paqeruajtësit sot që mbajnë peshën në të gjitha vatrat e krizave janë padyshim nga vendet "që bëjnë ligjin" në rendin botëror, që kanë fuqi e potenciale ekonomike, ushtarake, diplomatike. Flamujtë e tyre gjenden të parët aty ku kanë qenë vatrat e konfliktit, por bota dhe paqeruajtja në të nuk mund të shikohet jashtë interesave dhe zonave të influencës. Shembull i kësaj janë të gjitha operacionet paqeruajtëse në ndihmë të shuarjes së konflikteve.

Paqeruajtësit-aktorë dhe faktorë stabiliteti rajonal dhe global

Një ndër elementët thelbësorë të paqebërësit dhe paqeruajtësit është arti i negocimit. John F. Kennedy thoshte, "Kurrë të mos negociojmë pa patur frikë; por kurrë të mos kemi frikë për të negociuar". Negociatat janë formë bisedore e komunikimit e dialogut dy ose shumëpalësh për zgjidhjen e problemeve të çfarëdolloji. Arti negociues është i vjetër sa vetë historia e njerëzimit. Negociatat gjejnë zgjidhje me më shumë fitues dhe më pak humbës. Detyra e paqeruajtësve fillon së pari tek aftësia negociuese me njerëzit apo grupe të caktuara kundërshtarësh. Janë të pafund këshillat, manualët, doracakët, librat që flasin për artin e sjelljes dhe të komunikimit të paqeruajtësve. Fakt është se planeti ynë i madh dhe i vogël njëkohësisht ka kaq larmi kulturash e diversitetesh që ndryshojnë nga një kontinent në tjetrin, nga një rajon në tjetrin, nga një civilizim në civilizime shpesh edhe të panjohur. Paqeruajtësit ushtarakë janë krijesa lufte që janë kthyer në krijesa me mision të fisnikëruar siç emërtohen "ambasadorë të paqes".

Le të ndalemi në një element të dukshëm siç është "dhënia e dorës", që është edhe element i parë i takimit midis njerëzve. Tradita e popujve, racave dhe civilizimeve ndryshojnë nga njeri kontinent tek tjetri. Elementi i parë i takimit mes njerëzve është natyrisht "shtrëngimi i duarve". Por jo për të gjithë popujt, racat e kombësitë përcjell të njëjtat mesazhe. Për njerën palë mund të jetë mesazh i largimit ndërsa për palën tjetër mund të lexohet si mesazh pozitiv drejt arritjes së marrëveshjes. Është e nevojshme të njohim dallimet kulturore në treguesit kryesorë përpara se të kryhen negociatat.

Një element po kaq i rëndësishëm sa edhe "shtrëngimi i duarve", për paqeruajtësit janë edhe leximi i sinjaleve, që mund të grupohen: "të folurit me zë të ulët dhe të ngadaltë". Kjo shpreh lirshmëri dhe besim në vetvete në artin e negocimit; "të qeshurit e panevojshëm dhe të folurit e shpejtë" tregon përgjithësisht nervozizëm; "vështrimi poshtë, anash apo më së shumti drejt daljes së sallës së bisedimeve" tregon se negociuesi dëshiron të largohet; këtu bën pjesë edhe komunikimi për gjëra dytësore e jashtë termi si për motin, temperaturat etj.,[12] që janë sinjal i mbylljes së bisedimeve.

[11] Perry M. Smith, "Taking Charge, a practical guide for leaders", National Defense University Press, Washington, D.C. 1986.

[12] Mehmet Ali Birand, Ibid, f. 27.

Leximi i gjuhës trupore është domosdoshmëri për ekipin kundërshtar sepse gjuha trupore mund të përforcojë, por edhe mund të kontradiktojë atë që shprehet me fjalë. Në këto situata mbajtja e kontaktit sy me sy, që është natyrisht edhe më e lodhshmja dhe kërkon përqendrim, por është instrumenti më të mirë për të depërtuar përtej dialogut. Kontakti sy me sy përbën edhe "armën" psikologjike negociuese në luftën psikologjike, që "armë që kërkon të zotërohet në perfeksion edhe nga paqebërësit dhe paqeruajtësit.

Tashmë njihen dallimet kulturore nga njeri kontinent në tjetrin. Evropianët dhe amerikanët shpesh e marrin mungesën e dëshirës japoneze për t'u angazhuar në konfrontime të hapura në mënyre konfuze. Por japonezët i konsiderojnë pikëpamjet e amerikanëve dhe evropianëve, me nënkuptime, si të vështira për kompromise. Nëse amerikanët janë të drejtpërdrejtë në kulturën e tyre negociuese, nga kinezët kjo etiketohet "diplomaci kaubojsish". Amerikanët e kuptojnë shpesh stilin aziatiko-kinez të negociatave si përpjekje për të fituar faktorin "kohë" duke iu shmangur angazhimit direkt në zgjidhjen e problemeve. Propozimi, kundërpropozimi, prioritetet dhe përgjegjësitë, çështjet klasike e praktike, shpesh vijnë edhe përmes përvojave që paqeruajtësit e paqebërësit përdorin artin e komunikimit ndërglobal.

Operacionet paqeruajtëse me gjuhën e shifrave

Themelimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara pas Luftës së Dytë Botërore, synonte që shtetet anëtare që nënshkruanin dokumentet themelore të angazhoheshin për zgjidhjen e "mosmarrëveshjeve me mjete paqësore". Synimi themelor ishte që shtetet anëtare të OKB-së, t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet me bisedime, ndërmjetësim, pajtim dhe arbitrazh, duke ruajtur kështu paqen dhe sigurinë. Kjo është paracaktuar në nenin 1[13] dhe nenin 2[14] të Kartës së OKB-së.

Në fakt, planeti ynë kurrë nuk ka qenë më i vëzhguar dhe i ruajtur se sa nga organizata e gjithëpranuar ndërkombëtare e OKB-së[15]. Janë një "armatë" njerëzish në botë që përkujdesen për paqeruajtjen: më 31 Mars 2014 personeli i paqeruajtjes së OKB-së përbëhet nga 85.424 trupa vëzhgues ushtarakë, personeli policor nga 12.094 trupa; personeli civil ndërkombëtar përbëhej nga 5256 trupa; personeli i stafit civil lokal ishte 11.723 vetë; vullnetarët e OKB-së janë 2020.[16] Në total janë 69 operacione të paqeruajtësve ndërkombëtare me kontribut nga 122 shtete anëtare të OKB-së. Operacioni më i fundit është ai i prillit 2014, "Misioni i stabilizimit shumëdimensional të Kombeve të Bashkuara në Republikën e Afrikës Qendrore.[17]

[13] Në nenin 1 të Kartës së OKB-së thuhet: "Kombet e Bashkuara marrin përsipër të ruajnë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare dhe, për këtë qëllim, marrin masa kolektive të efektshme për të parandaluar dhe mënjanuar kërcënimet e paqes, për të mposhtur veprimet mësymëse dhe shkeljet e tjera të paqes, si dhe për të zgjidhur, me mjete paqësore, sipas parimeve të drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare konflikte ndërkombëtare apo situata, që do të mund të çonin në shkelje të paqes".

[14] Në nenin 1 të Kartës së OKB-së thuhet: "Të gjithë anëtarët i zgjidhin konfliktet e tyre me mjete paqësore, në mënyrë të tillë që paqja botërore, siguria ndërkombëtare dhe drejtësia të mos rrezikohen".

[15] OKB u formua në vitin 1945 me iniciativën e shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore (SHBA, Kina, Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Franca) dhe zëvendësoi Lidhjen e Kombeve të formuar në vitin 1919. Është organizata më e madhe në botë e cila për qëllim ka sigurinë ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. OKB ka aktualisht 192 shtete anëtare.

[16] http://www.un.org/en/peacekeeping/about/

[17] Lista e operacioneve të Paqeruajtjes botërore nga viti 1948 deri në vitin 2014. http://www.un.org/en/ peacekeeping/ documents/operationslist.pdf

Sekretariati i OKB-së ka një staf ndërkombëtar prej 44000 anëtarësh që punon në të gjithë botën, administron programet dhe politikat e përcaktuara. Në krye të OKB-së, është Sekretari i Përgjithshëm i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme me rekomandim të Këshillit të Sigurimit për një pesëvjeçar me të drejtë rinovimi. Kombet e Bashkuara ndërkohë që në seli në New York ka një prani të rëndësishme në Addis-Ababa; Bangkok; Bejrut; Gjenevë; Nairobi; Santiago dhe Vjenë, dhe ka zyra në të gjithë botën. Shërbimi paqeruajtës për çështjen e paqes në një botë të dhunshme është një profesion i rrezikshëm.

Që prej themelimit të Kombeve të Bashkuara, qindra burra e gra kanë dhënë jetën e tyre në shërbim të saj. "Paqeruajtja" ka qenë një nga mjetet më të efektshme në dispozicion të OKB-së, për të ndihmuar vendet nga konflikti në paqe. Paqeruajtja e OKB-së udhëhiqet nga tre parime themelore: pëlqimin e palëve, paanshmërinë dhe mospërdorimin e forcës përveç në vetëmbrojtje dhe mbrojtje të mandatit. Paqeruajtësit ose helmetakaltrit aktualisht janë në 16 operacione të OKB-së, për të vendosur paqen në katër kontinente. Operacionet shumë dimensionale të paqeruajtësve bëhen sot për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, për të lehtësuar proçesin politik, për të mbrojtur civilët, për të ndihmuar për çarmatimin e çmobilizimin, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për të ndihmuar në rivendosjen e sundimit të ligjit. Nga norvegjezi Trygve Lie që hapi siparin e drejtuesve të OKB-së e deri tek Ban Ki Moon kanë kaluar 68 vjet.[18] OKB po ecën drejt objektivave të mijëvjeçarit të ri, në mënyrë jo të zhurmshme me vijimësi, kur në fakt butësia nuk përputhet gjithmonë me vlerat universale. OKB-ja ka fituar çmimin "Nobel" 10 herë, por përsëri paqeruajtja globale nuk është vendosur.

Edhe pse suksesi nuk është i garantuar, paqeruajtësit e OKB-së, janë një shpresë e madhe e popujve të kërcënuar, një shpresë që vijon që prej vitit 1948 kur Këshilli i Sigurimit autorizoi vendosjen e vëzhguesve ushtarak të OKB në Lindjen e Mesme. Që prej vitit 1948 nën flamurin e OKB-së janë zhvilluar 66 operacione paqeruajtëse; nga të cilat pas vitit 1988 janë zhvilluar 53 operacione paqeruajtëse. Gjatë viteve qindra e mijëra personel ushtarak, dhjetëra mijëra policë të OKB dhe civilëve nga më shumë se 120 vende kanë marrë pjesë në operacionet paqeruajtëse të OKB-së. Më shumë se 2.900 paqeruajtës të OKB-së, nga rreth 120 vende të botës janë vrarë, ndërsa shërbenin nën flamurin e OKB-së.

Pas Luftës së Ftohtë, Këshilli i Sigurimit autorizoi 20 operacione të reja paqeruajtëse nga 1989 deri 1994, duke rritur numrin e paqeruajtësve nga 11000 në 75000 vetë. Shekulli XX ka qenë shekull krizash me rreth 217 kriza, ku 65% e tyre nuk kanë përfunduar me luftë; 12% e tyre kanë përfunduar me luftë si dhe 23 % e rasteve krizat kanë ndodhur gjatë luftërave. Misionet paqeruajtëse kanë qenë në Angola, Kamboxhia, El Salvador, Mozambik, Namibi, ish-Jugosllavi, Ruanda, në Lindjen e Mesme, në Qipro, në Maqedoni, në Guatemala, në Haiti, në Timorin Lindor, në Kosovë (UNMIK), në Burundi, në Republikën e Afrikës Qendrore e Çad (Minurcat); në Kongo, në Siera Leone, në Etiopi, në Sudan, në Afganistan etj.

Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO) bën udhëheqjen e tyre dhe ka një personel ushtarakë e civil të përbërë nga 120.000 vetë; ndërkohë që personeli nga data

[18] Trygve Lie (norvegjez) është i pari që drejtoi OKB-në 1946-1952; më tej vijuan: suedezi Dag Hammerheldin (1953-1961), që është cilësuar vetë paqeruajtja; U Thant nga Myanmar 1961-1971, Kurt Ualdheim nga Austria 1972-1981; Havjer Perez dë Kuelar nga Peruja 1982-1991; egjyptiani Butros Butros Gali 1992 -1996; Kofi Anan (1997-2006) nga Gana dhe Ban Ki Mun që prej vitit 2006.

30.06.2011, përbëhet prej 85.376 trupa që shërbejnë në terren, si dhe vëzhguesit ushtarakë; 14.233 veta përbëjnë personelin e policisë. Kontributi në këto organizma vjen aktualisht nga 115 vende të botës me personel ushtarak dhe policor; nga të cilët 5707 vetë përbëjnë personelin ndërkombëtar civil; 13856 vetë janë stafi vendas civil dhe 2311 janë vullnetarët e OKB-së. Fakt është se aktualisht aktiviteti paqeruajtës përfshin sot 193 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara me forca, mjete apo kontribute financiare.

Kontributi i ushtarakëve shqiptarë në paqeruajtjen botërore

Sot, bota vazhdon të trashëgojë grindje, përplasje, luftëra nga më të përgjakshmet. Paqebërja dhe shuarja e konflikteve është një plagë ende e pambyllur edhe pas shumë ndërhyrjeve të OKB-së dhe organizatave më të njohura ndërkombëtare. Nxjerrja në pah e shkaqeve, skenave dhe prapaskenave që "ushqejnë'' konfliktet, ka bërë që roli i forcave të armatosura kudo në botë të ridimensionohet dhe të fokusohet edhe në "paqeruajtje". Paqebërja dhe paqeruajtja janë "profesioni" më i ri i ushtarakut shqiptar. Shqiptarët e "prekën" me vonesë paqeruajtjen dhe po me vonesë e mësuan atë dhe rolin e saj. Shqiptarët dhe ekipi që i drejtonte për gjysëm shekulli gjatë shekullit XX jo rrallë u "ikte treni" i pjesëmarrjes në ngjarje madhore të kohës, dhe po kështu edhe mundësia e ofrimit të kontributeve ndërkombëtare si "paqeruajtja" e "paqebërja". Teknikat e "Paqeruajtjes" u mësuan dhe u trajtuan me vonesë në raport me shtetet e tjera, ku "Paqeruajtja" shërbente si një mjet për trajtimin e konflikteve ndërshtetërore dhe luftërave civile.

Në fakt Forcat e Armatosura shqiptare sikurse ato të ushtrive më të përparuara mbeten shtylla themelore e operacioneve paqeruajtëse kudo në planet. Fytyra e paqeruajtësve përfshin në radhë të parë ushtarakët, administratorët, ekonomistët, oficerët e policisë, ekspertët ligjorë, vëzhguesit e zgjedhjeve, specialistët e çështjeve civile dhe të qeverisjes, punëtorët humanitarë të komunikimit dhe ekspertët e informimit publik.

Shqiptarët janë të njohur edhe me problematikën reformuese të paqeruajtjes siç është "Doktrina Capstone" (2008), që në fakt është strategji e reformës së Departamentit të Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO), që lidhet me sigurinë kolektive për shekullin e ri, e cila krijon strategji gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe fushën e sjelljes dhe disiplinës. "Misionarë të paqes", pjesëtarë të FASH, zhvillojnë më tej traditën e ushtarakëve shqiptarë si paqeruajtës".

Ka pothuaj dy dekada që misionarët e paqes nga FASH mbrojnë me kurajë e profesionalizëm jetët e pafajshme të kërcënuara nga terrorizmi, këtij armiku nga më të egrit e njerëzimit. Paqeruajtësit janë luftëtarë antiterroristë në mbrojtje të lirisë së kombeve dhe aspiratave të të gjithë kombeve, në një front me trupat paqeruajtëse botërore. Deri në marsin e vitit 1992 Shqipëria ishte vend i izoluar; ndërsa pas këtij viti, kur triumfoi demokracia, Shqipëria u ftua të bëhej anëtare e Programit të NATO-s, Partneriteti për Paqe.

Për herë të parë në shtator 1996, Shqipëria dërgoi 33 trupa për të shtuar Forcën e Zbatimit të Paqes "Peace Implementation Force" (IFOR)[19], ku trainimin e parë si paqeruajtës e morën në Gjermani. Fillimisht u vendosën në Kroaci dhe më vonë në kampin franko-gjerman në Rajlovac. Pas vitit 1996 kontingjentet paqeruajtëse erdhën duke u shtuar dhe që shërbyen jo vetëm në Bosnjë, por edhe në Irak, Afganistan, Chad, Gjeorgji etj. Misioni paqeruajtës shqiptar u larguan pas përfundimit të mandatit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara nga Iraku në dhjetor 2008.

[19] Gazeta"Ushtria", Paqeruajtja një profesion i ri i ushtarakut shqiptar, Tiranë, 2011.

Angazhimi i Forcave të Armatosura shqiptare në misionin SFOR të drejtuar nga NATO, ka filluar në 09.09.1996 me dërgimin e kontingjentit të parë Paqeruajtës, të bazuar në Ligjin Nr. 8139, datë 05.09.1996. Angazhimi në misionin "Althea" të drejtuar nga Bashkimi Evropian, ka filluar në 02.12.2004. Forcat e Armatosura shqiptare u angazhuan në misionin ISAF nën drejtimin e NATO-s në gusht 2002, me dërgimin e Kontingjentit të Parë Paqeruajtës.

Aktualisht, forcat ushtarake shqiptare, që përfaqësojnë imazhin e Shqipërisë dhe përcjellin mesazhe të paqes kryejnë operacione të përbashkëta në Kandahar, Herat, Kabul, Komandën Rajonale të Veriut, krah për krah me Kontingjentet e SHBA-së, Italisë, Gjermanisë, Turqisë e Hungarisë etj. Në korrik të vitit 2008, Forcat e Armatosura Shqiptare kanë angazhuar edhe një kontingjent në operacionin e Eufor Tchad-Rca, drejtuar nga Bashkimi Evropian në Çad të Afrikës. Deri tani në këtë mision kanë marrë pjesë 189 ushtarakë shqiptarë.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen me Bashkimin Evropian, për dërgimin e trupave në Çad, si pjesë në misionet ushtarake të BE-së. Është fakt se një marrëveshje e veçantë është nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës, për mbështetjen e trupave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake të BE-së.

Në Kandahar, forcat speciale shqiptare janë angazhuar për herë të parë në operacione luftimi krah për krah forcave speciale amerikane të brigadës 525. Forcat speciale shqiptare janë vlerësuar nga Komanda Rajonale e Jugut, për kurajon, guximin dhe profesionalizmin që tregojnë në kryerjen e detyrave në këtë zonë luftimi me rreziqe të shumta. Serioziteti dhe forca e paqeruajtësve shqiptarë erdhi në rritje, deri në arritjen e një forcë paqeruajtëse reale e të ndërveprueshme.

Në gati dy dekada në të gjithë misionet në Bosnjë, Irak, Afganistan, në Çad, Gjeorgji etj., kanë qenë të konsiderueshme për kapacitetet shqiptare. Kështu nga muaji Shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin shkurt 2013, janë përfshirë në misione paqeruajtëse gjithsej 6033 ushtarakë.[20] Sigurisht që kontributi shqiptar është modest, por krahasuar me popullsinë, burimet, Forcat e Armatosura, buxhetet etj, shqiptarët janë bërë pjesë e kontributit botëror të paqeruajtjes. Faktikisht vitet e fundit, ritmi i veprimtarive ndërkombëtare në angazhimin e shteteve ka ardhur duke u rritur vazhdimisht. Aktualisht, Kombet e Bashkuara kanë të dislokuar 70 mijë trupa në 17 misione të ndryshme paqeruajtëse në botë.[21]

Bashkëpunimi dhe dialogu mes vendeve të Evropës Jug-Lindore zhvillohet sot me kontributin për siguri dhe stabilitet rajonal, si dhe me nxitjen e marrëdhënieve të fqinjësisë. Kështu më 26 Shtator 1998, Ministrat e Mbrojtjes së shtatë vendeve pjesëmarrëse, firmosën në Shkup, "Marrëveshjen për një Forcë Shumëkombëshe për Paqe të Evropës Jug-Lindore". Sllovenia dhe Shtetet e Bashkuara, si vende vëzhguese, shprehën mbështetjen e tyre dhe angazhimin për të kontribuar në këtë iniciativë. Kjo iniciativë konsiston në përputhshmëri të plotë me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, një forcë transparente dhe e hapur për NATO-n e vendet e Partneritetit për Paqe në rajon, që synon bashkëpunimin rajonal në kuadër të OKB-së, NATO-s, OSBE-së, dhe BE-së.

Paqeruajtja si, "parandalim, kufizim, moderim dhe ndërprerje e armiqësive brenda shteteve" gjatë shtatë dekadave ka bërë hapa përpara por nuk e ka përmbushur misionin.

[20] Sipas http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/misione-ndërkombëtare

[21] http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-03-01-voa6-85626337/424989.html.

Një ridimensionim i politikave, diplomacive dhe praktikave të paqeruajtjes dhe paqebërjes si dhe ristrukturimi dhe riformatimi i institucioneve që prodhojnë siguri globale të OKB-së është plotësisht i justifikuar. Kriza globale dhe kufizimi i ndërhyrjeve energjike që kërkojnë mjete të fuqishme financiare kanë detyruar Këshillin e Sigurimit të OKB-së që të jenë të matur e ndonjëherë edhe të kufizuar.

Kontingjentet që mbushin radhët e paqeruajtësve e paqebërësve janë para së gjithash ushtarakë që përfaqësojnë 122 shtete të globit. Por, para se të jenë paqeruajtës, ata janë qenie njerëzore, me interesa e botë njerëzore të gjerë, me përvoja individuale, që në situata të caktuara krijojnë tension, çrregullim. Interesi i grupit në mision është uniteti me fuqi e aftësi fizike, gatishmëria për të reaguar më intensitet të lartë ndaj situatave.[22]

Debati shkencor në këtë fushë në mënyrë të argumentuar do të jetë i dobishëm për shoqërinë shqiptare sepse ashtu sikurse shprehet Anthony Gidens: "Sociologjia është shkencë që nënkupton metodat sistematike te studimit dhe vlerësimit të teorive nën dritën e fakteve dhe argumenteve logjike".[23] Këto argument logjike duhet të "mblidhen" nga faktet e përvojave botërore por edhe nga përvoja e paqeruajtësve e paqebërësve shqiptarë që tashmë kanë një përvoj afërsisht 20 vjeçare.

Në një kohë kur Shqipëria është prej pesë vitesh anëtare e NATO-s, Forcat e Armatosura synojnë përgatitje të një korpusi elitar ushtarak me numër të reduktuar, por më profesionist. Praktikisht zhvillimet strukturore ushtarake shqiptare përputhen me atë që thotë Samuel P. Hantington se, "Korpusi modern i oficerëve është një grupim profesional dhe oficeri është një individ profesionist". Ushtarakët shqiptarë janë gjithmonë të gatshëm sepse, "Në një botë që ndryshon, NATO qëndron gjithmonë e gatshme". Citimi

Bibliografia:

- Anthony Giddens, Sociologjia, e ribotuar Shtëpia botuese "Çabej", Tiranë, 2008.
- Andrew Krepinevich, "The Army and Vietnam, Baltimore", Johns Hopkins University Press, 1986.
- Cooper, K. C, Effective competency modeling and reporting. New York, 2000.
- Colin S. Gray, "National Style in Strategy: The American Example", International Security 6, no. 2, Fall 1981.
- Howard Means, Colin Powell: Soldier/Statesman-Statesman/Soldier, New York, 1992.
- Matthew White, "The Great Big Book of Horrible Things: The Definitive Chronicle of History's 100 Worst Atrocities", New York, 2011.
- Kosta Bajraba, "Sociologjia pas një mungese të gjatë", SHBU, Tiranë, 1994.
- Martin Edmonds, "Shërbimet e Armatosura dhe Shoqëria", SHBU, Tiranë, 1999.
- Friedman, George, "100 Vitet e Ardhshme-Parashikim për shekullin XXI", Sh.B."Plejad".
- Kalevi J. Holsti, "Shteti, lufta dhe gjendja e luftës", Tiranë, 2008.
- Mehmet Ali Birand, "Urdhëroni Komandant!/Emret dersiniz Komutanim!", Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1994.
- N. E. Morris, "Rruga drejt triumfit", Tiranë, 2008.
- Terry Pettijohns, "Psikologjia, shkaqet e stresit", Tiranë, 1996.
- Perry M. Smith, "Taking Charge, a practical guide for leaders", Washington, D.C. 1986.

[22] Terry Pettijohns, "Psikologjia, shkaqet e stresit", Tiranë, më 1996, faqe 433.

[23] Anthony Giddens, Sociologjia, e ribotuar Shtëpia botuese "Çabej", Tiranë, 2008, faqe 34.

- Rudolf Giuliani, "Udhëheqja", ShB. Dudaj, Tiranë, 2006.
- Samuel P. Huntington, "The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations", Cambridge, 1957.
- "Udhëheqja ushtarake", Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.
- http://www.un.org/en/ peacekeeping/ documents/operationslist.pdf
- http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/misione-nderkombetare
- http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-03-01-voa6-85626337/424989.html.
- Periodiku i gazetave "Ushtria", Revista "Mbrojtja, "Revista Ushtarake", "Albanian Armed Forces", "Vizion Strategjik".
- AQFA, Fondet e Ushtrisë, Drejtoria Operacionale dhe e stërvitjes.
- AQSH, Fondet dokumentare "Ushtria"; "Forcat e Armatosura"; "Xhandarmëria", "Operacionet".

RUBRIKA E KATËRT

Punime historike

Në këtë rubrikë, autorë të ndryshëm sjellin në vëmendje të lexuesit shkrime historike me vlerë aktuale. Në shkrimin e autorëve MSc. A. Malaj dhe Nënkolonel A. Pando, me temë "Strategjia e 'Përgjigjes Fleksibël', strategjia e reagimit proporcional ndaj kërcënimeve", lexuesi njihet me strategjitë e përdorura nga SHBA gjatë Luftës së Ftohtë. Strategjia e re e "Përgjigjes Fleksibël", e përdorur nga SHBA në periudhën e Luftës së Ftohtë për parandalimin e përhapjes së komunizmit në botë, sipas autorëve, e ka zanafillën në librin e gjeneralit *Maxwell D. Talyer* "Trumbeta e pasigurt", në të cilën thuhet: "...SHBA duhet të përgatitin veten e tyre për të reaguar kudo, në çdo kohë, me armë dhe me forcat e duhura, në përputhje me situatën". Strategjia e "Përgjigjes Fleksibël" vendos një theks të veçantë te mbrojtja si një mjet për parandalimin e kundërshtarit, por edhe si qëllim kur parandalimi dështon. Në shkrim vlerësohet epërsia e "Përgjigjes Fleksibël" në krahasim me teorinë e "Shpagimit Masiv" e, sipas autorëve, kjo strategji është përdorur në shumë vende të botës dhe është aktuale dhe sot e kësaj dite.

Autori J. Zenuni, në shkrimin e tij "Fillesat e komunikimit diplomatik në komunitetet ilire" na sjell në kujtesë, nëpërmjet fakteve e dokumenteve të autorëve të ndryshëm, fillesat e komunikimit, jetesën dhe veprimtarinë diplomatike të shteteve ilire, që në fillesat e tyre e në vazhdim. Trajtimi nën dritën e dokumenteve dhe fakteve shkencore e historike, hulumtimi në këto dokumente dhe trajtimi sa më objektiv i tyre, jashtë ndikimeve nacionaliste-thekson autori,- është detyrë e studiuesve tanë e të huaj për të bërë një pasqyrim sa më të saktë dhe real të jetesës, komunikimit, veprimtarisë dhe marrëdhënieve diplomatike të komuniteteve ilire, për të pasqyruar një qasje sa më reale të prejardhjes sonë të lashtë.

Në materialin "Karakteristikat e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Luftarake Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore (LANÇ)", të autorëve Dr. Asllan Zemani dhe MSc. Afërdita Hajro, përshkruhet nevoja dhe rruga e ndjekur për krijimin e organeve drejtuese ushtarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe veçanërisht, të SHP të UNÇl-së, të shtabeve e organeve të tjera drejtuese të Ballit Kombëtar, Legalitetit. Pas një vlerësimi të situatës së krijuar në vend, menjëherë me pushtimin fashist të vendit, autorët theksojnë nevojën e menjëhershme për krijimin e elementeve drejtues të luftës së filluar nga grupe të armatosura, zgjerimi i të cilëve kërkonte edhe një drejtim të njehsuar të gjithë veprimtarive të tyre luftarake.

Strategjia e "Përgjigjes Fleksibël", strategjia e reagimit proporcional ndaj kërcënimeve

MSc. Agron Malaj
Nënkolonel Aleksandër Pando
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Lufta e Ftohtë ishte produkt i ndarjes së botës në dy grupime kundërshtare, liderët e të cilëve, me kohë, morën rolin e dy superfuqive dhe këto dy grupime ushtruan ndaj njeri-tjetrit të gjitha llojet e presioneve psikologjike, politike, ushtarake, ekonomike, etj. Kjo periudhë u karakterizua nga një angazhim serioz i administratës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për parandalimin e përhapjes së komunizmit në botë, e cila u shoqërua me hartimin e një sërë strategjish, mes të cilave veçohet Strategjia "Përgjigjja Fleksibël" (Fleksible Response*).

Zanafilla e kësaj strategjie është te libri i gjeneralit Maxwell D. Taylor "Trumbeta e pasigurt" (The Uncertain Trumpet). Në këtë libër, ai paraqiti një program të quajtur "Përgjigjja Fleksibël", ku shpjegonte se qëllimi i tij ishte të sugjeronte nevojën e një kapaciteti për të reaguar në të gjithë spektrin e sfidave të mundshme, për përballimin e të gjitha situatave, duke filluar nga konfliktet e kufizuara lokale deri në luftën e përgjithshme atomike. Kërkesa për një kapacitet të tillë të gjerë justifikohej mbi bazën e asaj që është po aq e domosdoshme për të parandaluar ose për të fituar shpejt luftërat e kufizuara, sa edhe për të penguar luftërat e përgjithshme.... Sipas Gjeneralit Taylor, Shtetet e Bashkuara duhet të përgatitin veten e tyre për të reaguar kudo, në çdo kohë, me armë dhe me forcat e duhura, në përputhje me situatën. Kjo përbënte themelin e strategjisë "Përgjigjja Fleksibël".

Hyrje

Periudha e Luftës së Ftohtë u karakterizua nga një angazhim serioz i administratës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për parandalimin e përhapjes së komunizmit në botë, e cila u shoqërua me hartimin e një sërë strategjive. Formulimi i strategjisë së SHBA-ve në epokën bërthamore[1] mbështetet në katër elemente kritike të rëndësishme, të

[1] Për strategjitë ushtarake të epokës bërthamore, shih Charles W Kegley, JR. Politikat Botërore, Tendenca dhe Transformimi, Botimi 12, SH.B. "UFO Press", Tiranë 2009, f. 415-433, si dhe: John Lewis Gaddis, "Strategies of Containment", A Critical Appraisal of Postwar American National Security (Oxford University Press), viti 1982.

cilët janë: politika e jashtme, shkurajimi *(deterrence)*, mbrojtja dhe fondet financiare. Pjesa më e madhe e kritikës së politikave të mbrojtjes amerikane është e çorientuar, për arsye se kritikët kanë formuluar përkufizime të ndryshme për të paktën tre elementet e para, të cilat bëjnë pjesë në formulimin e strategjive të SHBA-ve.

Për më shumë se njëzetë vjet, shtysa kryesore e politikës së jashtme amerikane, në mënyrë të qartë, ka qenë kontrolli i zgjerimit komunist, sidomos kur ai mori formën e agresionit të plotë. Deri në mesin e viteve 1975, në Shtetet e Bashkuara ka pasur konsensus për vlerën dhe drejtësinë e kësaj politike, përkundër mungesës së vazhdueshme të konsensusit mbi atë se si mund apo duhet të arrihet kontrolli.

Por çfarë kuptojmë me shkurajimin dhe mbrojtjen? Përkufizimet më të mira të shkurajimit dhe të mbrojtjes janë formulimet e *Glenn H. Snyder*:

"Në thelb, shkurajimi do të thotë çtrimërimi i armikut për ndërmarrjen e veprimeve ushtarake, duke i vënë përballë një kosto dhe një rrezik të madh të pritshëm që duhet të përballojë, në krahasim me fitimin që ai pret për të ardhmen. Mbrojtja do të thotë ulja e kostove dhe rreziqeve tona të pritshme në rast se dështon shkurajimi. Mbrojtja zvogëlon aftësinë e armikut për të na dëmtuar apo për të na privuar ne nga liria e veprimit. Vlera mbrojtëse e Forcave të Armatosura është ndikimi i tyre në zbutjen e pasojave të dëmshme për ne, si rezultat i lëvizjeve të mundshme të armikut, nëse pasoja të tilla konsiderohen si humbje të territorit apo dëme të luftës".[2]

Kuptohet që fondet financiare kanë një rëndësi të veçantë në përcaktimin e formës që do të kenë Forcat e Armatosura të një vendi. Megjithatë, shpesh, në diskutimet për hartimin e politikës së sigurisë kombëtare, supozohet se fondet financiare nuk janë një pengesë e madhe për variantet e zgjedhura të politikave, apo anasjelltas, gjykimet se fondet financiare janë përcaktuesit kryesorë në formulimin e politikës së sigurisë kombëtare të një vendi. Asnjë nga supozimet e mësipërme nuk është i saktë, pasi njëri është i bazuar mbi një fakt themelor të jetës dhe tjetri mbi një parim të qeverisë, të pranuar në përgjithësi. Pa marrë parasysh se sa i pasur është një komb, ai do të përballet me faktin që burimet e tij nuk janë të pakufizuara. Nga ana tjetër, ashtu si ka vënë në dukje presidenti *Nixon*, detyra themelore e qeverisë është që të ofrojë siguri për qytetarët e saj.[3] Këtë e vërteton edhe situata aktuale financiare që po kalojnë vendet e botës, ku si rezultat i vështirësive, u janë kthyer shpesh shkurtimeve të buxhetit të mbrojtjes.

Strategjia "Hakmarrja Masive", pararendëse e strategjisë "*Përgjigjja Fleksibël*"

Duke folur para Këshillit për Marrëdhëniet me Jashtë, në janar 1954, *John Foster Dulles*, Sekretar Shteti gjatë administratës *së Eisenhower*, tha se vetëm duke forcuar një mbrojtje lokale, me shkurajimin që ofron fuqia e Hakmarrjes Masive (Massive Retaliation), mundet që bota e lirë të shpresojë për të kontrolluar përhapjen e komunizmit. Për këtë arsye, qeveria amerikane ka arritur një vendim themelor, i cili është: mbështetja mbi një kapacitet të madh për t'u hakmarrë. Për më tepër, ky vendim themelor do të shmangë pasoja të rënda buxhetore, ekonomike dhe sociale[4].

---

[2] Glenn H. Snyder, *Deterrence and Defense; Toward a Theory of National Security,* Princeton University Press 1961, f. 3-4.

[3] Richard M. Nixon, *US Foreign Policy for the 1970's; A New Strategy for Peace,* 18 shkurt 1970, fq. 124.

[4] John Foster Dulles, *"Strategjia e Shpagimit Masiv," në Politikën e Mbrojtjes së SHB-ve. Perspektiva nga koha e Kolonializmit deri në ditët tona,* 1965, ed. nga Raymond C. O'Connor, fq. 327.

Edhe pse politikat dhe programet e sigurisë të SHBA-ve nuk kanë qenë krejtësisht të pandryshueshme në periudhën pas fjalës së *Dulles,* dy supozime dhe vendime bazë, të shpallura në këtë fjalim, vazhduan të modelojnë politikën amerikane të sigurisë për pjesën tjetër të Presidencës së *Eisenhower*. Supozimet ishin:

- Fuqia tokësore e botës komuniste gëzonte një epërsi të tillë, e cila nuk mund të përballohej nga forca mbrojtëse e një vendi të vetëm.
- Nëse Shtetet e Bashkuara do të përpiqen për të mbajtur forca tokësore të përshtatshme për të siguruar një mbështetje të mjaftueshme për mbrojtjen e vendeve të botës së lirë, ajo do ta shpenzojë veten deri në falimentim.

Vendimi bazë ishte që Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj mund të zmbrapsnin agresionin komunist kundër mbrojtjeve lokale të vendeve të botës së lirë, duke u mbështetur kryesisht te kapacitetet e saj për sulm bërthamor[5].

Në strategjinë e "Hakmarrjes Masive", sulmet përqendrohen në efektivitetin e fuqisë bërthamore të SHBA-ve si një instrument për mbështetjen e mbrojtjes lokale të vendeve të botës së lirë. Kështu u argumentua se kërcënimi sipas strategjisë "Hakmarrja Masive" ishte më i vogël në krahasim me mbrojtjet lokale, sepse ajo parashtron, për vendimmarrësit amerikanë, zgjedhjen në mes të përdorimit të armëve bërthamore apo pranimit në heshtje të agresionit komunist. Pas periudhës në të cilën sovjetikët zotëronin armën bërthamore, konsultimi para përdorimit të armëve bërthamore si një zgjedhje racionale, duhej të bëhej në nivele me të vërtetë shumë të larta.

Formulimet e *Dulles*, përfshirë shpjegimet e tij të mëvonshme në fjalimin e famshëm, nuk arritën të bëjnë një dallim të qartë në mes shkurajimit (dekurajimin e armikut për ndërmarrjen e veprimeve ushtarake) dhe mbrojtjes (shkurtimit të kostove dhe rreziqeve në rastet kur parandalimi nuk është i suksesshëm).

Si rezultat i këtyre kritikave, politikat e sigurisë të administratës *Eisenhower,* gjithnjë e më shumë, u zhvendosën në drejtim të një kapaciteti për të zhvilluar luftërat e kufizuara. Megjithatë, çdo përfshirje e SHBA-ve në konflikte të tilla do të varet kryesisht në përdorimin e armëve taktike bërthamore[6]. Për fat të keq, që kur sovjetikët futën armët bërthamore taktike në strukturën e forcës së tyre gjatë viteve 1950, ky ndryshim në politikën amerikane, nuk i mohoi kritikat më themelore për strategjinë "Hakmarrja e Masive". Rreziku i përshkallëzimit në një luftë të përgjithshme bërthamore, menjëherë pas përdorimit të armëve taktike bërthamore, e bëjnë luftën taktike të kufizuar një instrument aq të dobësuar, sa dhe Hakmarrja Masive e "pastër". Me fjalë të tjera, për shkak të mundësisë së përshkallëzimit, mbrojtja lokale, e bazuar në përdorimin e armëve taktike bërthamore, përfshiu shumicën e të metave të strategjisë "Hakmarrja Masive" në aspektin e saj parandalues, mbrojtës dhe të vlerave diplomatike.

Strategjia "Hakmarrja Masive", e zbatuar nga Administrata e *Eisenhower,* dukej se ishte pak efektive në lidhje me ngjarjet në zonat nën hegjemoninë komuniste dhe në zonat ku nuk kishte përballje të qartë dhe të drejtpërdrejtë të fuqisë së SHBA-ve dhe Bashkimit

[5] Strategjia e 'Shpagimit Masiv' ishte një strategji "ose të gjithën, ose asgjë". Për më gjerë shih John Foster Dulles, "The Evolution of Foreign Policy", Departamenti i Shtetit, nr. 81 (12 janar 1954, si dhe Gjeneralmajor Viktor Berdaj dhe nënkolonel Dritan Stroni Strategjia e "Shpagimit Masiv" si ndryshim i parë madhor në strategjinë bërthamore amerikane, Revista Ushtarake, Prill 2014, f. 103-121.

[6] David W Tarr, *American Strategy in the Nuclear Age,* 1966, fq. 88-89.

Sovjetik. Nga ana tjetër, në Evropën Perëndimore, strategjia "Hakmarrja Masive" ishte një strategji e arsyeshme dhe e efektshme. Besueshmëria për gatishmërinë e SHBA-ve për të pranuar pasojat e një lufte bërthamore me Bashkimin Sovjetik ka qenë relativisht e madhe. Megjithatë, për arsye se aftësia strategjike bërthamore sovjetike ishte përmirësuar dhe zgjeruar, u bë gjithnjë e më e dhimbshme të menduarit e pasojave të mundshme të një lufte të tillë.

Drejt një strategjie të re, Strategjia "Përgjigjja Fleksibël" (Flexible Response)

Që prej fillimit të Sputnik, më 4 tetor 1957, ishte e qartë se BS kishte arritur përparësinë, nga gjenerata e parë e raketave (raketat me rreze të shkurtër dhe të mesme, deri në 4000 km) te gjenerate e dytë raketore (Raketat me rreze të largët dhe raketat ndërkontinentale nga 6.000 deri 12.000 km). Deri në këtë kohë, BS nuk ishte në gjendje që, për shkak të mangësisë së raketave më rreze të largët, të rrezikonte, me armët e tij, objektivat strategjikë të SHBA-ve në territorin e saj. Ndryshe nga BS, SHBA zotëronte sasi bombash me rreze të largët, që prej periudhës së Luftës së Dytë Botërore, e cila mbas kësaj lufte, ishte modernizuar dhe mund të furnizohej edhe në ajër. Këtu do të shtohen dhe një sistem bazash amerikane, të cilat ndodhen përreth zonës së ndikimit sovjetik, si dhe bazat artificiale amerikane, si p.sh., aeroplanmbajtëset amerikane.[7]

Por, në vitin 1960, raporti i trupave ndërmjet SHBA-ve dhe Rusisë ishte ndryshe. Krahasimet tregojnë se BS, përkrah epërsisë në disa fusha konvencionale (si Forca tokësore, Divizione, Tanke luftarakë), ka arritur të ketë të njëjtat ose më saktë, ka më shumë armatime në fusha strategjike më të rëndësishme. Kjo, ndoshta, sepse rritja e trupave bazohet në faktin që sovjetikët, në vitin 1961, kishin në mendje krizën e Berlinit dhe ndërtimin e Murit të Berlinit, si dhe më 1962, krizën e Kubës[8].

Në këto kushte, një numër i madh i literaturave shkencore e trajtojnë termin e *"frikësimit"* si frikësim bërthamor. Kështu *Dieter Stockfisch* shkruan që "… armët nukleare, ekzistenca e të cilave e bëjnë të mundur frikësimin"[9] Gjithashtu *dhe Henry Kissinger* është për termin e "Frikësimit Nuklerar", kur ai vë re që " Problemi i frikësimit nga ana historike është i ri në historinë e luftës".[10]

Edhe pse strategjia e "Shpagimit Masiv" ishte e efektshme përballë BS-së, shumë herët u vu re, nga politikanë dhe shkencëtarë të rëndësishëm, një lloj sikleti mbi këtë strategji.

[7] Walpunski, Günter: Verteidigung + Entspannung = Sicherheit Bonn- Bad Godesberg 1975, Seite 16-18.

[8] Edhe pse politikat dhe programet e sigurisë të SHBA nuk kanë qenë krejtësisht statike gjatë viteve pas fjalës së Dulles, dy supozime dhe vendime bazë të shpallura në këtë fjalimi vazhduan të modelojnë politikën amerikane të sigurisë për pjesën tjetër të Presidencës së *Aizehauer*. Supozimet ishin që fuqia tokësore e Botës Komuniste gëzonin një epërsi të tillë që nuk do të kishte një mbrojtje thjesht lokale që të mund të ishte e suksesshëm dhe nëse Shtetet e Bashkuara do të përpiqen për të mbajtur forca tokësore të përshtatshme për të siguruar një mbështetje domethënëse për mbrojtjen lokale të vendeve të botës së lirë, ajo do të shpenzojë veten deri në falimentim. Megjithëse bazuar në dokumentet Ruse mbi sasinë e forcave të dy blloqeve rezulton se ky supozim është i gabuar. Sasia e forcave është si më poshtë: Bashkimi Sovjetik 1250 000 trupa, Bullgaria, Hungaria dhe Rumania (së bashku) 560 000 Republika Demokratike Gjermane, Çekosllovakia dhe Polonia 1 270 000 trupa dhe Shqipëria 35 000 trupa, Britania e Madhe 630 000 trupa, Republika Federale Gjermane, Danimarka dhe vendet e BENELUX 777 000 trupa, Italia 360 000 trupa, Franca 720 000 trupa dhe Portugalia dhe Spanja 68 000 Trupa. Në total raporti i trupave ishte Traktati i Varshavës: 3 118 000 trupa dhe NATO: 3 075 000 trupa.

[9] Stockfisch, Dieter:, Zur Philosophie der Abschreckung", in: Soldat und Technik 9/1987, S. 532.

[10] Kissinger, Henry: Die Entscheidung drängt, 1. Auflage, Düsseldorf 1961, S. 24.

Me ngritjen e BS-së, në fushën e armatimit, në nivelin amerikan, në Aleancë u bë e qartë se një luftë e përgjithshme do të përfundonte me pasoja të paparashikueshme për të dy konkurrentët. Me përsosjen e BS-së në fushën e armatimit dhe ngritjen e tij në nivelin amerikan, në Aleancë u bë e qartë, që një luftë e përgjithshme do të përfundonte me pasoja të parashikueshme, për të dy konkurrentët.

Në protokollin e një takimi të NSC-së, më 1 maj 1958, u mbajtën shënim deklaratat e ministrit të Jashtëm *John F. Dulles*. Ai thoshte që: "Shpagimi masiv nuklear deri tani ka qenë pjesa kryesore e arsenalit ushtarak amerikan, por duhet të koncentrohet me prioritet te këto elemente që, në dy ose tre vitet e ardhshme, do të mund ta zëvendësojnë shpagimin nuklear masiv. SHBA duhet të jetë në gjendje të drejtojë luftën defensive, e cila nuk do të kishte si pasojë asgjësimin total të kundërshtarit".[11]

Në NSC-Dokument 5906/1, i datës 5 gusht 1959 mbi "Politikën e sigurisë kombëtare", nga politika e SHBA-ve, ndër të tjera, kërkohej: *"përballimi i agresionit ushtarak të kufizuar komunist, ose n.q.s .është e nevojshme, në një mënyrë dhe me një angazhim, eliminimin e këtyre agresioneve që armiqësitë të mos shndërrohen në një luftë të përgjithshme"*.[12]

Në vitin 1960 doli në publik libri i gjeneralit *Taylor* me titull "The Uncertain Trumpet". Në këtë libër ai paraqiste projektin e konceptit të ri strategjik, të cilin shefi i Shtabit Amerikan e kishte orientuar që në vitin 1956.[13] *Taylor* paraqiste në libër doktrinën e ashtuquajtur"flexible reaction". Në kohën e frikësimeve të ndërsjella, "shpagimi masiv" nuk është më strategji praktike, sepse ajo "…sjell vetëm shkatërrim të pakufishëm dhe më tej, asgjë tjetër."[14] Në anën tjetër, strategjia "flexible reaction" nuk duhet të marrë në konsideratë vetëm frikësimin e armikut, por ajo duhet të jetë e efektshme të frikësojë si në një luftë të përgjithshme, ashtu edhe në një luftë lokale të kufizuar, dhe në fund, të arrijë një fitore të shpejtë. Një luftë e kufizuar duhet të ndodhë vetëm me armë dhe me trupa konvencionale. Përdorimi i armëve atomike duhet të ndodhte vetëm në rastin e dëmtimit të interesave jetike të SHBA-ve, p.sh., në rastin e ekzistencës kombëtare, si në këto tre raste:

- Në rastin e një sulmi atomik në territorin amerikan.
- Në rastin e një zbulimi të fakteve të pakundërshtueshme që një sulm i tillë do të ndodhë.
- Në rastin e një sulmi të madh ndaj Evropës Perëndimore, humbja e së cilës do të kërcënonte njëkohësisht ekzistencën e SHBA-ve.[15]

Kjo "flexible reaction", e zhvilluar nga *Taylor*, përmbante elementet e rëndësishme të strategjisë së mëvonshme të "Flexible response". Me marrjen e detyrës së Presidentit nga *Kennedy*, në janar 1961, kjo strategji u zhvillua më tej nga ministri i Mbrojtjes *Robert S. McNamara*. Në mesazhin e Presidentin drejtuar Kongresit, më 28 mars 1961, u qartësuan më tej bazat e kësaj strategjie. *Kennedy* paraqiti qartë: Qëllimi kryesor i armatosjes amerikane është paqja dhe jo lufta. Duhet t'i frikësojmë të gjitha luftërat qofshin ato të

[11] Czempiel, Schweitzer:Weltpolitik USA, S. 190.
[12] Ibid, S. 238.
[13] Taylor: Trompete, Seite 55 und 57, zitiert nach Kissel: "flexible response", S. 195/196.
[14] Ibid, S. 53.
[15] Kissel: Doktrin und Strategie der "flexible response", S. 197.

përgjithshme, apo të kufizuara, të drejtuara me armë bërthamore apo konvencionale, luftëra të mëdha apo të vogla. Trupat amerikane që do të angazhoheshin jashtë territorit amerikan do të ishin të afta të frikësojnë ose të kufizojnë konflikte të tilla:

"Pozicioni ynë mbrojtës duhet të jetë si fleksibël, ashtu dhe i vendosur. Çdo agresor potencial, i cili do të ndërmarrë një sulm në ndonjë pjesë të botës së lirë qoftë ky me armë nukleare, apo me armë konvencionale, duhet të dijë që, reagimi ynë do t'i përshtatet sfidës, do të koncentrohet në objektiva të përcaktuara dhe do të ndodhë shumë shpejt dhe në mënyrë të efektshme."[16]

Kontributi i rëndësishëm i librit "Trumbeta e pasigurt" ishte paraqitja nga ana tij e një programi që synonte korrigjimin e mangësive të strategjisë "Hakmarrja Masive". Gjeneral *Taylor* shpjegoi se etiketa "Përgjigje Fleksibel" sugjeronte nevojën për një kapacitet për të reaguar në të gjithë spektrin e sfidave të mundshme, për përballimin e të gjitha situatave, duke filluar nga konfliktet e kufizuara lokale deri në luftën e përgjithshme atomike. Ai e justifikoi kërkesën për një kapacitet të tillë mbi bazën e asaj që është po aq e domosdoshme për të parandaluar ose për të fituar shpejt luftërat e kufizuara, sa edhe për të penguar luftërat e përgjithshme. Kjo për arsye që luftërat e kufizuara të mos përfundojnë në konsumimin tonë pjesë-pjesë ose në përfshirjen në një konflikt i cili mund të zgjerohet në një luftë të përgjithshme, të cilën ne të gjithë duam ta shmangim.[17]

Duke shpjeguar në vija të përgjithshme programin e tij, gjenerali *Taylor* krijoi pa mëdyshje muzikën që ai donte të dëgjonte, në vend të tingullit të mëparshëm të "pasigurt" të "trumbetës" së politikës së sigurisë të SHBA-ve[18]. Programi i gjeneralit *Taylor,* i "Përgjigjes Fleksibile", përbëhej kryesisht nga pesë elemente kryesore.

Së pari, modernizimi dhe mbrojtja e forcave strategjike bërthamore për të siguruar se ato do të mund t'i mbijetojnë një sulmi sovjetik. duke rezultuar në një forcë të mjaftueshme për të shkaktuar nivele të papranueshme dëmi mbi Bashkimin Sovjetik.[19]

Së dyti, në mënyrë të menjëhershme, të fillojë një përpjekje e rëndësishme për të rigjallëruar kapacitetet e të tre forcave, për të kryer luftë në nivele më të ultë se ajo e përgjithshme ose të asaj gjithëpërfshirëse. Dhe megjithëse forcat duhet të ruajnë kapacitetet e tyre bërthamore taktike, theksi kryesor duhet të vihet në aftësinë e tyre për të luftuar me armët konvencionale.

Së treti, të krijojë një forcë të fuqishme dhe të gatishmërisë së lartë të njësive aktive në Shtetet e Bashkuara, për t'u përdorur si një forcë rezervë për mbështetjen e forcave amerikane të dislokuara dhe të aleatëve të saj.

Së katërti, modernizimi dhe rritja e madhësisë së forcave të transportit strategjik ajror dhe detar, për të siguruar një kapacitet të rëndësishëm për zhvendosjen e shpejtë të forcave

[16] Czempiel, Schweitzer: Weltpolitik USA, 266.
[17] Maxwell D. Taylor, *The Uncertain Trumpet,* 1959, fq. 5-6.
[18] Ibid, fq. 146. Programi Ushtarak Kombëtar i strategjisë "Përgjigjja Fleksibël" duhet të përmbante që në fillim një heqje dore, të shprehur qartë, të mbështetjes në strategjinë e "Hakmarrjes Masive". Duhej të bëhej e qartë se Shtetet e Bashkuara do të përgatitin veten e tyre për të reaguar kudo, në çdo kohë, me armë dhe forcat e duhura në përputhje me situatën.
[19] Sipas *General Maxwell D. Taylor, Për t'iu përgjigjur situatave, kudo dhe kurdoherë, me armët dhe forcat e përshtatshme.*

aktive në Shtetet e Bashkuara dhe për rifurnizimin e të gjitha forcave të angazhuara në misione jashtë vendit.

Së pesti, zhvillimi i forcave kundër nëndetëseve, të mjaftueshme për mbikëqyrjen e nëndetëseve sovjetike dhe për mbrojtjen kundër nëndetëseve të armikut.[20]

Si strategjia e "Hakmarrjes Masive", dhe strategjia e "Reagimit Fleksibël" janë të projektuara për të zbatuar politikën e jashtme të kontrollit dhe të dyja i kanë dhënë rëndësi të madhe konceptit të parandalimit. Megjithatë, ato ndryshojnë shumë në lidhje me rëndësinë që i kanë bashkëngjitur konceptit të mbrojtjes, aftësisë për të luftuar në atë mënyrë, që të minimizojë dëmin dhe humbjen. Për shkak të kësaj, ato ndryshojnë në lidhje me burimet të cilat duhet të vihen në dispozicion për forcat e sigurisë së vendit. Këto dallime janë mjaft të mëdha, pasi ato nuk janë thjesht çështje të shkallës, por në vend të kësaj, paraqesin qasje dukshëm të ndryshme filozofike për problemin e sigurisë kombëtare. Filozofia bazë e "Reagimit Fleksibël", me theksin e saj te kapacitetet për bërjen e luftës dhe vullnetit për t'i përdorur këto kapacitete në luftërat e kufizuara, është thellësisht e ndryshme nga filozofia bazë e "Hakmarrjes Masive". Prandaj, sapo u përshtat strategjia e "Reagimit Fleksibël" çoi në ndryshime thelbësore në politikën e sigurisë, buxhetit të mbrojtjes dhe mënyrës së sjelljes së forcave ushtarake.

Zbatimi i Strategjisë "Përgjigjja Fleksibël"

"Vetëm kur armët tona, jashtë çdo dyshimi, janë në sasi të mjaftueshme, ne mund të jemi të sigurt pa asnjë dyshim se ato kurrë nuk do të përdoren".[21] Me këto fjalë, presidenti i ri i hodhi Shtetet e Bashkuara në një kurs të ri drejtimi të politikës së saj të sigurisë dhe vendosi një theks të ndryshuar në strukturimin e forcave të saj ushtarake. Ndonëse shpresa e nënkuptuar e shmangies së konfliktit ishte e dënuar të dështonte, qëllimi i presidentit për të ndryshuar mënyrën e sjelljes për sigurinë e vendit, ishte i qartë. Sekretari i ri i Mbrojtjes, *Robert S. McNamara*, menjëherë nisi një program për të korrigjuar mangësitë e strategjisë "Hakmarrja Masive". Me përjashtim të forcave strategjike bërthamore, ndryshimet e *McNamara*-s te forcat dhe strategjia ishin të ngjashme me ato të propozuara nga gjenerali *Taylor* në Programin Ushtarak Kombëtar të strategjisë "Përgjigjja Fleksibël".

Praktikisht, çështja e parë, së cilës iu adresua *McNamara,* ishte madhësia dhe kombinimi i forcave bërthamore strategjike. Dy pozicione krejtësisht të ndryshme në lidhje me madhësinë e duhur dhe kombinimin e forcave bërthamore strategjike ishin zhvilluar në themelin e mbrojtjes që trashëgoi *McNamara*. Të dy pozicionet pranojnë që forcat strategjike duhet të jenë në gjendje t'i mbijetojnë një sulmi të befasishëm, duke ruajtur një forcë të mjaftueshme për t'u hakmarrë me një goditje shkatërruese dhe të dy theksojnë kërkesën për komandim dhe kontroll efektiv, për të parandaluar një sulm aksidental ose të paautorizuar të SHBA-ve. Megjithatë, ata dallonin në lidhje me teorinë e tyre të përcaktimit të objektivave dhe të madhësisë dhe përbërjes së forcave të kërkuara.

Një qëndrim i përshtatur nga gjenerali *Taylor* në librin "Trumbeta e pasigurt" dhe zakonisht i identifikuar si përfundimi ose parandalimi minimal, vlerëson se një pakicë armësh, të mbrojtura relativisht mirë (ndoshta 300 apo 400 raketa "Polaris"), të cilat kanë në shënjestër

[20] Maxwell D. Taylor, *The Uncertain Trumpet, Harper & Brothers* 1959, fq. 146-160

[21] John F. Kenedi, " *Fjalimi i Inaugurimit " in To Turn the Tide* (1962), ed., John W. Gardner, p. 8.Shih dhe Charles W. Kegley, JR. Politikat Botërore, Tendenca dhe Transformimi, Botimi 12, SH.B. "UFO Press", Tiranë 2009, f.4121-426.

qytetet sovjetike, do të sigurojnë një parandalim strategjik bërthamor të përshtatshëm. Mbështetësit e tij argumentuan se një forcë e tillë do të ngadalësojë garën e armatimit, do të zvogëlojë mundësitë që sovjetikët të bëjnë të pamundurën për një sulm parandalues nga frika e forcave amerikane dhe do të çlirojë fondet financiare për t'u përdorur për qëllime të tjera. Qëndrimi tjetër bën thirrje për forca ndjeshëm më të mëdha , të përbëra nga një kombinim i sistemeve të shpërndarjes dhe të afta për një shumëllojshmëri variantesh të përcaktimit të objektivave, madje edhe pas një sulmi të parë sovjetik. Zakonisht, e etiketuar si "strategjia e të bërit të luftës bërthamore", ky pozicion u mbështet në dy parime kryesore: së pari, se edhe pas një sulmi sovjetik, Shtetet e Bashkuara do të ruajnë një interes të natyrës së situatës së pasluftës, dhe së dyti, ndoshta një kombinim i shmangies së qyteteve të armikut në sulmin fillestar shpagues të SHBA-ve dhe mbajtjes së forcave bërthamore në rezervë, do të nxitë sovjetikët për të kufizuar sulmet e tyre, vetëm mbi objektivat ushtarake. Edhe pse asnjëherë *McNamar*a nuk e identifikoi plotësisht veten me këtë qëndrim, ka pak dyshim se, të paktën në fillim të viteve 1960, ai i ka pranuar argumentet e këtij qëndrimi dhe ka zbatuar pikëpamjet e tij për masën e përgjithshme, formën dhe përcaktimin e objektivave të forcës bërthamore.[22]

Sekretari *McNamara* sigurisht që është përkëdhelur me idenë e nxitjes së sovjetikëve për të përshtatur një strategji "jo-qytete". Në një fjalim, ndoshta të parapërcaktuar për Kremlinin po aq sa edhe për miqtë e Fondacionit të Avokatëve Amerikanë, të cilëve u ishte drejtuar zyrtarisht, ai tha:

Forcat tona mund të përdoren në mënyra të ndryshme. Neve mund të na duhet të hakmerremi me një sulm të vetëm masiv. Ose ne mund të jemi në gjendje të përdorim forcat tona hakmarrëse për të kufizuar dëmin e bërë te ne dhe aleatët tanë, duke trokitur mbi bazat e armikut, para se ai të ketë kohën për të nisur breshërinë e tij të dytë. Ne mund të kërkojmë që të ndërpresim një luftë me kushte të favorshme, duke përdorur forcat tona si një armë për negociatat, duke kërcënuar për sulm të mëtejshëm. Në çdo rast, rezerva jonë e madhe e fuqisë së mbrojtur të zjarrit do t'i japë armikut një nxitje për të shmangur qytetet tona dhe për të ndaluar luftën. Politika jonë e re na jep fleksibilitetin për të zgjedhur midis disa planeve operacionale, por nuk kërkon që ne të marrim ndonjë angazhim paraprak në respekt të strategjisë ose përcaktimit të objektivave. Ne do të zotohemi vetëm për një sistem që na jep ne mundësinë për të përdorur forcat tona në mënyrë të kontrolluar dhe të matur.[23]

Në qoftë se këto fjalë ishin të përcaktuara për sovjetikët, duket sikur ato po bien në vesh të shurdhër. *McNamara* ka pritur më kot për ndonjë tregues që Kremlini ishte i përgatitur për të miratuar një strategji *counterforce*[24] ose të shmangies së qyteteve. Ndoshta, si rezultat i kësaj, *McNamara* gjithnjë e më tepër, i përqendroi diskutimet e tij publike të mëvonshme të çështjeve bërthamore strategjike, mbi konceptet e shkatërrimit të sigurt dhe kufizimin e dëmeve. Megjithatë, ai kurrë nuk e braktisi këmbënguljen e tij se forcat strategjike të SHBA-ve duhet të përfshijnë një sistem të komandimit dhe kontrollit, të aftë për të mbijetuar dhe shumë efektiv, në mënyrë që armët strategjike të mbeten një instrument fleksibël i politikës, të afta për t'u përdorur në një mënyrë të përshtatshme, në përputhje me situatën.

Shkatërrimi i sigurt do të thotë zhvillimi dhe drejtimi i forcave strategjike bërthamore dhe sistemeve të komandimit dhe kontrollit në mënyrë që të mund t'i mbijetojnë një sulmi

[22] William W. Kaufmann, *The McNamara Strategy,* 1964, fq. 50-53.

[23] Robert S. McNamara, *Speech before the Fellows of the American Bar Foundation,* 17 february 1962, fq. 6-7.

armik, pa marrë parasysh sa i fuqishëm është ai, duke siguruar një forcë të mjaftueshme për t'u hakmarrë dhe duke i shkaktuar dëme armikut në një nivel të paimagjinueshëm. Një kapacitet i tillë ka përfaqësuar elementin strategjik parandalues të politikës së sigurisë amerikane, nga viti 1961 deri më sot. Por, parandalimi, madje edhe përfundimi bërthamor i spektrit të dhunës, nuk duhet të jetë elementi i vetëm i politikës së sigurisë. Maturia dikton se atje duhet të jetë një element i mbrojtjes në rast se parandalimi do të dështojë. Etiketa që *McNamara* përcaktoi tek elementi i mbrojtjes i politikës amerikane të sigurisë bërthamore, ishte kufizimi i dëmeve, si " *aftësia për të reduktuar peshën e sulmit armik prej të dy masave, sulmuese dhe mbrojtëse dhe për të siguruar një shkallë të mbrojtjes për popullsinë kundër efekteve të shpërthimeve bërthamore*." [25] Gjatë viteve 1960, epërsia relative e arsenalit bërthamor të SHBA-ve siguroi një kapacitet të rëndësishëm të kufizimit të dëmeve, pasi numri i mbushjeve të raketave në dispozicion do të kishte lejuar përcaktimin e objektivave si kundër forcave, ashtu edhe kundër vlerave.

Një pjesë e rëndësishme e rritjes së buxheteve të mbrojtjes, në fillimet e Administratës së Kenedit, u përkiste shpenzimeve për sistemet bërthamore të shpërndarjes dhe të mbushjeve të raketave, në mënyrë që të sigurohej që Shtetet e Bashkuara të mund të arrinin dhe të mbanin një kapacitet të shkatërrimit të sigurt.[26] Megjithatë, në vitet e mëvonshme, *McNamara* tha se numri i mbushjeve efektive të raketave që Shtetet e Bashkuara zotëronin, ishte më shumë sesa ishte kërkuar për të kontribuuar në vazhdimin e garës së armatimeve:

Në rrjedhën e mbrojtjes kundër asaj që atëherë ishte vetëm një ndërtim sovjetik teorikisht i mundur, ne morëm vendime të cilat dhanë rezultate në epërsinë tonë aktuale. Por fakti mbetet i hapur se, nëse ne do të kishim pasur më shumë informacion të saktë mbi forcat strategjike sovjetike të planifikuara, ne thjesht nuk do të kishim nevojë për të ndërtuar një arsenal bërthamor aq të madh siç e kemi sot.[27]

Në analizat finale, nëse njëri përdor propozimet e gjeneralit *Taylor* të vitit 1958 apo atë çfarë *McNamara* tha nga mesi i viteve 1960, filozofia themelore e "Reagimit Fleksibël" ndaj armëve strategjike bërthamore është se zotërimi i tyre në numër të mjaftueshëm është jetik, por ato kanë pak dobi në aspektin e politikës, diplomacisë apo konflikteve të kufizuara bërthamore të botës moderne. Pasi të dyja palët kanë arritur një kapacitet të

[24] Debatet e strategjisë kundër-forcës dhe kundër-vlerave kanë ndodhur si një diferencim konceptual i kundërveprimit fleksibël. Objektivat e strategjisë së kundërforcës dhe kundërvlerave u ndanë në dy kategori. Strategjia e kundërvlerave është një koncept strategjik, që kërkon përdorimin e forcave strategjike ajrore dhe të raketave, për shkatërrimin ose paaftësimin e qendrave të populluara, të industrisë, burimeve ose të institucioneve të zgjedhura të armikut, të cilat përbëjnë strukturën sociale të një shoqërie. Strategjia e kundërforcës është një koncept strategjik, që kërkon përdorimin e forcave strategjike ajrore dhe të raketave me qëllim për të shkatërruar ose nxjerrë jashtë përdorimit të aftësive dhe kapaciteteve të zgjedhura ushtarake të forcave të armikut.Ideja ishte se objektivat e kundërforcës mund t'i japin kundërshtarit nxitje për të mos goditur qytetet amerikane. Kundërvlera ishte një mendim, një parandalim i vërtetë e cila duhej të realizohej me një aftësi të dytë goditjeje (shkatërrim i sigurt). Shih dhe Robert S. McNamara, "Defense Arrangements of the North Atlantic Community", Buletini i Departamentit të Shtetit, 47, 9 korrik 1962, faqe 64-70, si dhe Ribaj, Pajtim, Hasani, Proletar, etj: Teori të luftës dhe strategjisë, Tiranë 2011,f.365-369.

[25] Robert S. McNamara, "*General Nuclear War: Assured Destruction and Damage Limitation: in American Defense Policy* (1968), ed. by Mark E. Smith III and Claude J. Johns, Jr., fq. 98.

[26] Melvin R. Laird, *Deklarimi i Sekretarit të Mbrojtjes përpara Komitetit të Forcave të Armatosura të Senatit në vitin Buxhetor, 1972-1976 për Programet e Mbrojtjes dhe në vitin 1972 për Buxhetin e Mbrojtjes,* 15 mars 1971, fq. 155 dhe fq. 157.

[27] Robert S. McNamara, *The Essence of Security;Reflections in Office,* 1968, pp. 58-59.

sigurt shkatërrimi, mjetet e marrëdhënieve ndërkombëtare kundërshtuese duhet të jenë ato tradicionale të diplomacisë, të pushtetit politik ose, në rastin më të keq, te konfliktet e kufizuara të armatosura, çdo drejtim tek armët strategjike bërthamore do të ishte i paarsyeshëm.

Elementet kryesore të strategjisë së "Përgjigjes Fleksibël" kanë të bëjnë me strategjinë e përdorimit të forcës në të gjitha nivelet, duke filluar nga konfliktet e kufizuara e deri te lufta termobërthamore dhe struktura e nevojshme e forcave për të luftuar në konflikte të tilla. Në librin "Trumbeta e Pasigurt", gjenerali *Taylor* e përshkruan "Përgjigjen Fleksibël" si aftësia për të reaguar kudo, në çdo kohë, me forcat e duhura në përputhje me situatën.[28] *McNamara*, në dëshminë e Kongresit, tha:

"Forcat tona të kufizuara të luftës duhet të jenë të pajisura siç duhet për t'u marrë me të gjithë spektrin e agresionit të kufizuar, dhe ato duhet të kenë mjetet për të lëvizur shpejt, kudo që ato mund të jenë të nevojshme, në një kohë shumë të shkurtër nga njoftimi. Aftësia për t'iu përgjigjur menjëherë agresioneve të kufizuara, ndoshta në më shumë se një vend në të njëjtën kohë, mund të shërbejë edhe për t'i penguar ato dhe për të parandaluar përhapjen e tyre jashtë, në konflikte më të mëdha".[29]

Krizat në Laos dhe Berlin, në fillim të Presidencës Kenedi, shërbyen për të përforcuar theksin e ri në qëllimin e përgjithshëm ose në forcat konvencionale: njëra në një mënyrë negative, tjetra në një mënyrë pozitive. Administrata e re kishte trashëguar një krizë qeveritare në rritje. Disa muaj më vonë, rezultatet e mobilizimit të pjesshëm të rezervave dhe dislokimi i forcave të rregullta shtesë në Evropë, në përgjigje të kërcënimeve sovjetike kundër Berlinit, sugjeruan fuqishëm vlerën shumë reale të parandalimit të vlerës së mbrojtjes të siguruar nga forca të gatshme dhe të dislokueshme për qëllime të përgjithshme.[30] Të dyja krizat si e Laosit, dhe e Berlinit, e vitit 1961, shërbyen për të bindur Kenedin dhe *McNamara*-n, se vendimi i tyre për të përmirësuar në mënyrë thelbësore kapacitetet e SHBA-ve për luftë të shkurtër të nivelit strategjik bërthamor, ishte i saktë.

Nga fundi i vitit 1961 ishte e qartë se Shtetet e Bashkuara po ndërmerrnin hapa për t'i siguruar vendit një strukturë të forcave për qëllime të përgjithshme, të cilat mund të përdoren në përputhje me parimet e strategjisë së "Përgjigjes Fleksibël", veçanërisht në lidhje me konceptin e mbrojtjes. Pikërisht, ishte kjo kohë kur administratës së re iu desh të përballej me kufizimet e pashmangshme të fondeve. Nga kjo del se një kapacitet, për t'u marrë me një agresion në të gjithë spektrin e dhunës, duhet të zhvillohet dhe ky zhvillim i tij duhet të bazohet në një përcaktim objektiv të kërkesave, pa e lidhur atë me "tavanet arbitrare buxhetore". Kenedi, gjithashtu, tregoi një interes të veçantë për Forcat Speciale, të njohura si "Beretat e Gjelbërta"[31].

[28] Maxwell D. Taylor, *The Uncertain Trumpet*, 1959, pp.146

[29] Kongresi i SHBA, *House, Committee on Appropriations, Department of Defense Appropriations for 1962*, 87th Cong., 1st Sess., 1961 Hearings, pp. 18-19 quoted in Robert S. Ginsburgh, *U.S. Military Strategy in the Sixties* (1965), fq. 77-78.

[30] Ibid, fq. 80, 88 dhe 261.

[31] Një forcë ushtarake elitë, e frymëzuar nga trupat britanike të cilët ishin trajnuar për të marrë pjesë në luftëra jokonvencionale, duke përfshirë luftën guerile. Kenedi zgjeroi forcat speciale dhe u dha atyre një publicitet të rëndësishëm ndërsa Robert Kenedi ishte një kampion i kundërkryengritjes dhe mbante një beretë të gjelbër në tryezën e tij në Departamentin e Drejtësisë.

Aftësia për t'iu përgjigjur me shpejtësi agresioneve të kufizuara mund të shërbejë për të frenuar dhe për të parandaluar përhapjen e tyre në konfliktet më të mëdha,- deklaronte Robert S. McNamara. Por, në një sistem demokratik, është krejt tjetër për ta bërë në fakt atë. Pa diskutimet e gjata, politikat dhe teknikat e menaxhimit të epokës "McNamara", pavarësisht nga përdorimi i strategjisë, duhet të merrnin vendime të vështira, për sa i përket kompromiseve dhe rrezikut të marrë përsipër. Kështu, qëllimi për një strukturë të forcave të gatshme për qëllime të përgjithshme, të afta për të luftuar në dy teatro të operacioneve të mëdha dhe në një operacion të vogël të planifikuar diku tjetër, asnjëherë nuk është arritur. Megjithatë, vlera e mbrojtjes e forcave amerikane u përmirësua dukshëm, shoqëruar me një rritje në pushtetin diplomatik dhe politik të Shteteve të Bashkuara në arenën botërore.

Përgjigjja Fleksibël, angazhimet dhe interesat e SHBA-ve në vendet në zhvillim

Justifikimi për vënien e theksit te forcat për qëllime të përgjithshme, dukej qartë dhe ishte e lehtë për t'u mbrojtur në lidhje me vendet e pazhvilluara ose me vendet në zhvillim të botës jokomuniste. Në janar të vitit 1961, Bashkimi Sovjetik njoftoi zyrtarisht se jo vetëm luftërat botërore, por edhe luftërat lokale, për shkak të rrezikut të përshkallëzimit të tyre në luftë botërore, duhet të shmangen. Megjithatë, luftërat për çlirimin kombëtar ishin të pranueshme dhe të pashmangshme dhe për më tepër, duhet të mbështeten nga Forcat Komuniste.[32] Duke përdorur këtë deklaratë sovjetike si një sfond për një fjalim të rëndësishëm politik, Sekretari *McNamara* u përpoq të shpjegonte natyrën e kërcënimit që vjen nga luftërat për çlirimin kombëtar dhe se si Shtetet e Bashkuara mendojnë për ta kundërshtuar atë. Me përdorimin e luftërave të çlirimit kombëtar, sovjetikët shpresonin për të praktikuar atë që *McNamara* e ka karakterizuar si teknika e "fetave të sallamit", e cila gradualisht, në mënyrë pak nga pak, do të dëmtojë kredibilitetin dhe vendosmërisë amerikane për të mbrojtur interesat e saj dhe angazhimet në botën e pazhvilluar, duke reduktuar edhe territorin e botës jokomuniste dhe vullnetin e tyre për t'i rezistuar zgjerimit të mëtejshëm komunist.

Që nga koha kur u miratua strategjia e "Përgjigjes Fleksibël", SHBA zgjodhën për t'i rezistuar të ashtuquajturës teknika e "fetave të sallamit", e cila ishte testuar në Indi, në Afrikë, në Lindjen e Mesme, në Hemisferën Perëndimore dhe më e rëndësishmja, në Azinë Juglindore. Vetëm dy rastet e ndërhyrjes në luftërat që zhvilloheshin në Republikën Domenikane dhe në Indokinë, përfshinë angazhimin e forcave ushtarake amerikane. Në rastet e tjera, si: ndërhyrja kineze në Indi, ndërhyrjet komuniste në vende të ndryshme të Afrikës dhe depërtimi sovjetik në Egjipt dhe në një masë më të vogël, te shtetet e tjera arabe, reagimi i SHBA-ve përfshiu një shportë të përzier të pranisë ushtarake, të veprimeve ekonomike, të diplomacisë dhe demonstrimit të forcës, e cila dha një shportë të njëjtë të përzier rezultatesh.

Vështirësitë kryesore në vlerësimin e ndërhyrjes së SHBA-ve në Republikën Domenikane qëndrojnë në fushën e politikës së jashtme dhe jo në fushën strategjike. Në qoftë se rreziku i marrjes së kontrollit të pashmangshëm, shkatërrues komunist të Republikës Domenikane u llogarit si duhet dhe nëse parandalimi i zgjerimit komunist, veçanërisht në Hemisferën Perëndimore, ishte një aksiomë themelore e politikës së kontrollit, atëherë ndërhyrja e SHBA-ve duhet të gjykohet si një demonstrim i suksesshëm i efikasitetit të

[32] Fjala e Nikita Hrushovit në 6 janar 1961.

strategjisë së "Përgjigjes Fleksibël". Dislokimi i shpejtë dhe në nivelin e duhur të forcave amerikane kishte shuar me të vërtetë një vatër zjarri, para se ajo të bëhet ose një fitore e komunistëve, ose një kërcënim tjetër serioz për sigurinë e Hemisferës Perëndimore.

Për sa i përket luftës në Azinë Juglindore, mund të thuhet se strategjia nuk është zbatuar siç duhet, pasi zbatimi taktik i strategjisë u rrethua nga shumë pengesa në përdorimin e fuqisë ushtarake në dispozicion. Ose, për arsye krejt të ndryshme, mund të thuhet se situata në Indokinë nuk përfshiu as një angazhim të mjaftueshëm e të qartë të SHBA-ve, as interesin për të kërkuar ndërhyrjen e armatosur. Të dy argumentet prekin një veçori kyçe të strategjisë së "Reagimit Fleksibël", vlerën e mbrojtjes. Vlera e mbrojtjes e forcave amerikane dhe atyre aleate dështoi të sigurojë vlera të mjaftueshme parandaluese, për të parandaluar përshkallëzimin e vazhdueshëm të përpjekjeve të luftës së armikut në Indokinë. Dhe, pasi dështon parandalimi, mbrojtja është ajo çfarë bëhet për të zvogëluar dëmet apo humbjet që armiku është përpjekur që të shkaktojë, të cilat janë llogaritur në aspektin e territorit, popullsisë, fondeve, jetëve të humbura dhe fuqisë së ndikimit politik. Në ato kushte, pa marrë parasysh se cili është rezultati i konfliktit tragjik, një pjesë e konsiderueshme e opinionit amerikan si publik, edhe ai zyrtar, do ta konsiderojë nivelin e dëmit dhe të humbjeve të shkaktuara nga ndërhyrja e SHBA-ve në Vietnam, shumë më të madh sesa shpenzimet që do t'i ishin shkaktuar Shteteve të Bashkuara nëse ato do të kishin zgjedhur për të mos mbrojtur Vietnamin e Jugut. Me pak fjalë, ironia e Luftës së Vietnamit mund të jetë, që konceptet themelore të strategjisë së "Përgjigjes Fleksibël" mund të refuzohen.

Strategjia "Përgjigjja Fleksibël", angazhimet dhe interesat e SHBA-ve në arenën ndërkombëtare

Evropa Perëndimore

Në Athinë, në fillim të majit 1962, sekretari *McNamara* mbajti një fjalim në takimin gjashtëmujor të ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes të NATO-s. Ai u përpoq të shpjegojë prirjen e re të menduarit strategjik të SHBA-ve dhe se si ajo do të zbatohet te hapësira e NATO-s.[33] Fjalimi shkaktoi një debat strategjik mbi rolin e SHBA-ve në sigurinë e Evropës Perëndimore, i cili nuk ka marrë fund akoma, edhe në ditët tona.

Në thelb, *McNamara* u tha ministrave të vendeve të NATO-s se Shtetet e Bashkuara kërkojnë të zgjerojnë strategjinë e "Përgjigjes Fleksibël" në Evropë. Fjalimi sqaroi që forcat tokësore të NATO-s mund të funksionojnë vetëm si një forcë e vogël ushtarake në vijë të parë të mbrojtjes, ku në rast sulmi, ato do të shkaktojnë një sulm masiv hakmarrës mbi Bashkimin Sovjetik. Tema kryesore ishte rëndësia e zhvillimit të varianteve ushtarake, në mungesë të një shkëmbimi bërthamor dhe kur strategjia parandaluese e NATO-s ka dështuar:

Aleanca ka, mbi të gjitha, forcën bërthamore të mjaftueshme për t'u përballur me çdo sfidë. Kjo forcë jo vetëm zvogëlon mundësitë e luftës së madhe bërthamore, por kjo e bën të mundshme një strategji të hartuar për të ruajtur strukturën e shoqërive tona, nëse lufta duhet të ndodhë. Për llojet e konflikteve, politike apo ushtarake, të cilat kanë më shumë mundësi që të lindin në zonën e NATO-s, aftësitë tona për përgjigje nuk duhet të kufizohen vetëm në armët bërthamore. Në mënyrë që të mbrojë popullsinë e vendeve të NATO-s dhe për të përmbushur detyrimet tona në traktat, ne kemi vënë në dorë një

[33] William Kaufmann, *The McNamara Strategy,* 1965, fq. 114.

seri masash për të forcuar fuqinë tonë jobërthamore. Ne presim që aleatët tanë të ndërmarrin veprime për të forcuar më tej forcat e tyre jobërthamore, dhe për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtyre forcave. Këto arritje do të plotësojnë forcën tonë parandaluese. Me përmirësimet në fuqinë dhe qëndrueshmërinë e forcave tokësore të Aleancës, të kapaciteteve ajrore jobërthamore të përmirësuara dhe të forcave rezervë të pajisura dhe të trajnuara më mirë, ne mund të jemi të sigurt se nuk ekzistojnë mangësi në mbrojtjen e NATO-s, të këtij rajoni vital dhe asnjë agresion, i vogël apo i madh, nuk mund të ketë sukses.[34]

Argumentet evropiane kundër strategjisë së "Përgjigjes Fleksibël" ndahen në tri kategori themelore:

1. Të gjitha deklaratat apo veprimet zyrtare që tregojnë zbatimin e strategjisë, si p.sh., forcimi i dukshëm i forcave tokësore të NATO-s, minimizojnë vlerën parandaluese të forcave bërthamore hakmarrëse, duke sugjeruar te sovjetikët se një luftë në Evropë nuk ka nevojë të përfshijë pagesën e çmimit të fundit të një shkëmbimi bërthamor të përgjithshëm.

2. Parimi themelor i argumentit të parë është zgjeruar nga argumenti i dytë, zakonisht i identifikuar me francezët, të cilët mendonin se miratimi formal i strategjisë "Përgjigje Fleksibël" thekson dyshimet e ankesave në lidhje me besueshmërinë e angazhimit të SHBA-ve për të ndërmarrë hapat e fundit, të cilat do të çojnë në një sulm sovjetik në territorin e SHBA-ve. Në thelb, ky argument ndan pikëpamjet e teoricienit ushtarak francez, gjeneral *Gallois*, i cili pohon se aleancat kanë pak vlerë në epokën bërthamore. Asnjë komb, argumenton ai, nuk do të rrezikonte asgjësimin për hir të një vendi tjetër. Pasoja jashtëzakonisht të rënda do të rrjedhin nga një pranim i përgjithshëm i kësaj linje të argumentit, jo pak prej të cilave do të ishin një përhapje e sistemeve kombëtare bërthamore të shpërndarjes dhe si rezultat, një paqëndrueshmëri serioze e balancës bërthamore.[35]

3. Argumenti i tretë është më bindës. Ai fillon me pranimin se mbrojtja fillestare e Evropës Perëndimore nën strategjinë "Përgjigje Fleksibël" mund të marrë vetëm dy forma; ose një mbrojtje të plotë konvencionale, ose një mbrojtje të bazuar në përdorimin e armëve taktike bërthamore. Një mbrojtje e pastër konvencionale, pothuajse me siguri, nuk do të ishte e mundur te "Perdja e Hekurt". Është e mundur që një mbrojtje e përshtatshme mund të krijohet në lumin Rin, por është më e mundshme që ajo mund të ngrihet në vijën *Somme, Vosges, Jura*, dhe Alpet. Në fjalët e një ish-shefi të Shtabit Francez, thuhej: "*Kjo do të kulmojë në lejimin e agresorit për të kapur një pjesë të Evropës, e cila nuk mund të rimerret për një kohë të gjatë, ose që nuk mund të rimerret kurrë nëse metodat konvencionale janë përdorur. Kjo për ne, si evropianë që jemi, nuk duket një metodë e mirë për të mbrojtur Evropën"*.[36]

Një mbrojtje taktike bërthamore, e cilat me siguri do të rezultojë në përdorimin e armëve bërthamore taktike sovjetike, është po aq e papranueshme për evropianët. Madje edhe një shkëmbim zjarri taktik bërthamor do të shtypë krejtësisht Evropën për 1800 milje, nga Atlantiku deri në kufirin e BS". [37] Si përfundim, mundësia e luftës taktike bërthamore,

[34] Robert S. McNamara, *Fjalimi në Universitetin e Michigan-it, 16 Qershor 1962*, fq. 5 dhe 8.
[35] Henry A. Kissinger, *Diplomacia e Koalicionit në Epokën Bërthamore, Politika e Mbrojtjes së SHBA*, 1964, fq. 183-184.
[36] Charles Aillert, "Përgjigja Fleksibël," Rishikimi i Mbrojtjes, Shkurt 1965,fq. 81.
[37] Ibid, fq.82.

e cila për një kohë të gjatë ka mbetur e kufizuar, është shumë e ulët, prandaj, kostoja e zhvillimit të një kapaciteti për një mbrojtje të përshtatshme do të jetë e paefektshme. Me pak fjalë, parandalimi, jo mbrojtja, është perceptuar si e vetmja qasje e pranueshme për problemin e agresionit serioz sovjetik në Evropën Perëndimore.

Nga këndvështrimi evropian, siguria e territorit të NATO-s fillon dhe mbaron me parandalimin. Mbrojtja vetëm me armët konvencionale është refuzuar me arsyetimin se është gati e pamundur të besohet se sovjetikët do të rrezikonin të ndërmerrnin një sulm, pa përdorur të paktën armët taktike bërthamore. Për më tepër, edhe në qoftë se ata dështojnë të përdorin armët taktike bërthamore, një pjesë e madhe e papranueshme e pasurive të patundshme evropiane, ndoshta në mënyrë të pakthyeshme, do të bien në duart e Bashkimit Sovjetik. Një mbrojtje me armë taktike bërthamore është madje më pak tërheqëse. Për qytetarin e mesëm evropian, një mbrojtje e tillë do të prodhojë rezultate pak më të ndryshme nga ato të një lufte të përgjithshme bërthamore.

Shtetet e Bashkuara pohojnë se një kapacitet i arsyeshëm dhe i besueshëm për mbrojtjen ofron dy përparësi: *Së pari*, variantet e mungesës së luftës termobërthamore ofrojnë të paktën mundësinë që agresioni sovjetik të mund të kontrollohet. *Së dyti*, dhe më i rëndësishmi, sa më e madhe të jetë vlera e mbrojtjes e forcave për qëllime të përgjithshme të NATO-s, aq më e madhe është besueshmëria e përgjithshme e veprimit parandalues të NATO-s.

Henry Kissinger ofron një përmbledhje të shkëlqyer të natyrës së debatit: *Problemi i vërtetë nuk është se evropianët dështuan të kuptojnë kërkesën tonë për variante të shumta. Ata thjesht refuzojnë atë kur bëhet fjalë për veten e tyre. Kur bëhet fjalë për çështje në Azi ose në Amerikën Latine, evropianët favorizojnë një përgjigje edhe më fleksibël se sa ne amerikanët, në lidhje me mbrojtjen e Evropës. Qëndrimi i tyre është më i ngurtë. Ata kanë pohuar se parandalimi varej nga përgatitja për përballimin e rreziqeve më ekstreme. Ata kanë qenë përgatitur të sakrifikojnë një masë të besueshmërisë në favor të rritjes së përmasës së kërcënimit. Ky debat nuk ka qenë përfundimtar, sepse ai, në fund të fundit, varet nga një gjykim psikologjik dhe jo një gjykim teknik.*[38]

Strategjia "Përgjigja Fleksibël" dhe NATO

Në vitet 1950, strategjia fillestare e diskutuar nga NATO për të mbrojtur veten kundër një sulmi të Bashkimit Sovjetik dhe të Traktatit të Varshavës ishte një mbrojtje konvencionale. Në takimin e Lisbonës, në shkurt 1952, ishin vendosur objektiva të forcave shumë ambicioze, të cilat, deri në vitin 1954, do të krijonin 96 divizione të NATO-s që do të mobilizoheshin brenda 90 ditëve dhe gjysma e tyre do të ishin të gatshme, me fillimin e sulmit të kundërshtarit[39]. Por, përmbushja e këtyre qëllimeve u vërtetua se ishte e pamundur për anëtarët e Aleancës si financiarisht, dhe politikisht.

Gjithsesi, edhe kur dokumenti i NATO-s MC 14/2 ishte duke u miratuar, besueshmëria te strategjia "Hakmarrja Masive" ishte vënë në pikëpyetje. Kjo për shkak të përmirësimit të vendeve të Traktatit të Varshavës në lidhje me forcat dhe me sistemet e armëve si: ndërtimi i avionëve bombardues bërthamor me rreze të gjatë dhe të mesme e me raketa balistike, mundësia për të pasur një aftësi të raketave balistike ndërkontinentale që do të mund të godisnin SHBA, në fund të viteve 1950. Kjo i hapi rrugën strategjisë "Përgjigjja Fleksibël".

[38] Henry Kissinger, *Diplomacia e Koalicionit në Epokën Bërthamore*, 1964, fq. 186, 187 dhe 188.
[39] Dr. Gregory W. Pedlow, *NATO Strategy documents 1949-1969*, fq. 16-17.

Kundërshtimi i fortë i partnerëve evropianë të NATO-s ndaj strategjisë së zhvilluar në vitet 1961-1962 nga administrata "Kennedy" dhe në veçanti, nga ministri *McNamara*, mbi uljen e nivelit të reagimit ndaj agresionit të Paktit të Varshavës, u shfaq në frikën që siguria amerikane nuk është e lidhur me sigurinë e tyre dhe garancitë amerikane mund të anuloheshin. Kjo çoi në atë që, koncepti strategjik ushtarak " Flexible response", vetëm më 16 janar të vitit 1968 do të paraqitej zyrtarisht në Dokumentin MC /13 si Strategji e NATO-s.[40] Paraprakisht, më 11 maj të vitit 1967, zyrtarëve ushtarakë të NATO-s iu dha një udhëzim me të dhëna për MC 14/3 nga *Defence Planning Committee (DPC).*

Duke iu referuar analizës së kërcënimeve të politikës sovjetike, si dhe kohës së alarmimit, nga 4 deri në 15 ditë, për një sulm me 80 divizione, DPC ishte e bindur që duhej një spektër i gjerë i aftësive ushtarake, me qëllim frikësimin nga një agresioni të mundshëm ose, n.q.s do të ishte e nevojshme, t'i bëhej ballë atij. Në këtë spektër bënin pjesë: trupat nukleare strategjike të NATO-s, trupat nukleare taktike dhe trupat konvencionale.[41]

Ndryshe nga kjo, më 13 dhe 14 dhjetor të vitit 1967 u zhvillua në Bruksel takimi i 15 kryetarëve të shteteve dhe qeverive të NATO-s, ku u miratua raporti i Këshillit të NATO-s mbi "Detyrat e ardhshme të Aleancës", i njohur si "Harmel Report". Ky raport, me dy funksionet kryesore të Aleancës, Siguri ushtarake dhe Politikë e zbutur, pasqyronte një koncept politik, i cili do të kthehej në një formulë: *Siguri = Mbrojtje + Politikë e zbutur* .[42] Kjo do të shërbente si bazë për politikën e ardhshme të vendeve Lindore. Dokumenti MC 14/3 shpjegonte analizën e kërcënimeve. Duke iu referuar politikës sovjetike, e cila bazohej në mjetet ekonomike dhe politike, propagandë dhe fuqi ushtarake, aftësitë e Paktit të Varshavës u paraqitën në formën e një spektri të gjerë kundër NATO-s[43]. Më 8 dhjetor të vitit 1969 doli dokumenti MC 48/3 "Masat për implementimin e konceptit strategjik për mbrojtjen e rajonit të Aleancës". Ky dokument zëvendësoi dokumentin MC 48/2 të vitit 1957. Dokumenti jep udhëzime për deklaratat më të rëndësishme të konceptit strategjik MC 14/3, si më poshtë:

- Domosdoshmëria e një kontakti të ngushtë dhe të përhershëm ndërmjet zyrtarëve politikë dhe ushtarakë të NATO-s
- Nevoja për trupa konvencionale, përmirësim aftësish gjatë operacioneve jobërthamore dhe ruajtja e mirëmbajtja e mundësive bërthamore
- Mundësisht, shfrytëzim i mirë i kohës së paralajmërimit për të sjellë në gatishmëri trupat e frontit
- Konceptim i mbrojtjes sa më përpara në koordinim me trupat e thellësisë dhe lëvizshmërinë e tyre taktike.
- Konceptim i kundërgoditjes fleksibël me një numër të madh të mundësive reaguese.
- Aftësimi i skalionimit të paramenduar

---

[40] Zell, Ralf, Lippert, Ekkehard, Rössler Tjarck (Hrsg.): Bundeswehr und Gesellschaft, Opladen 1977, S. 165 – 166.
[41] MC 14/3 in: NATO, Strat Doc 1997, S. 340 – 341.
[42] Walpunski, Günter: Verteidigung + Entspannung, S. 24.
[43] Sipas dokumentit MC 14/3,f352-354 këtu përfshihen: Sulm nuklear i gjerë kundër NATO-s ,Sulm nuklear i gjerë me armë atomike taktike kundër Evropës Perëndimore;Sulm i gjerë kundër një ose dy rajoneve të NATO-s me ose pa armë taktike nukleare dhe armë kimike.;Sulm i kufizuar kundër një shteti anëtar i NATO; Operacione të kufizuara nukleare dhe jo nukleare kundër rajoneve detare të NATO-s ;Manovër e re, bllokadë ose një sulm kundër Berlinit Perëndimor; Luftë e mbuluar; Presion politik dhe ushtarak dhe kërcënime kundër një ose shumë anëtarëve të Aleancës

- Jo trupa rezervë për veprime luftarake mbas një sulmi të përgjithshëm bërthamor.[44]

Në formë përmbledhëse, mund të thuhet që: MC 14/3 dhe 48/3 ishte baza kryesore për strategjinë e "flexible response", një strategji e cila do të kishte vlefshmëri deri në vitin 1991. Gjatë kësaj vlefshmërie të gjatë në fushën bërthamore do të ndodhnin një numër i madh ndryshimesh dhe modifikimesh, ndërsa fusha konvencionale, në veçanti në zbatimin veprues, nëpërmjet masave të përgjithshme, karakterizohej nga zgjerime dhe zëvendësime.

Raporti i trupave dhe koncepti i luftës tokësore të Paktit të Varshavës

Pavarësisht fazave të qeta, sovjetikët, në veçanti, në fillim të viteve 70, filluan me ndryshime në strukturë, modernizim të gjerë dhe me përforcim të trupave. Por, numri i njësive të mëdha të trupave tokësore, të forcave detare në luftim afër bregut, mbeti pothuajse i pandryshuar

Një rritje domethënëse të fuqisë luftarake patën elementet e zjarrit të fuqishëm, të tankeve dhe lëvizshmërisë. Trupat luftuese tokësore u rritën dhe u zhvilluan më tej për operacione të shumta.[45]

Dy raporte krahasuese të trupave konvencionale në vitet 1970-1983 do ta qartësonin më shumë këtë.

Raporti i trupave ndërrajonalë:

	NATO		**Pakti i Varshavës**	
	1970	**1983**	**1970**	**1983**
Ushtarë (në Milionë)	5.6	4.4	4.3	5.7
Divizione	108	117	218	253
Tanke		25330		62900

Raporti prej 12 000 avionësh luftarakë të Paktit të Varshavës, me 11270 të NATO-s do të ishte i njëjtë n.q.s do t'i shtonim dhe 520 avionët luftarakë të Francës. Pakti i Varshavës zotëronte një numër pak më të madh anijesh luftarake.[46]

Zhvillimi i trupave konvencionalë rajonalë në Evropë:

	NATO		**Pakti i Varshavës**	
	1970	**1983**	**1970**	**1983**
Divizione	79	84	166	173
Tanke Luftarakë	10300	10300	32000	42500
Tanke Mbrojtës	2195	2374	37000	59000
Sisteme Raketore	1250	8100	4700	24300
Artileri/ Mortaja	14000	10750	23300	31500
Avionë Luftarakë	2800	2975	6900	6890[1]

[44] MC 48/3, S. 376 – 377.

[45]Poser, Günter: Militärmacht Sovjetunion 1977, München 1977, S. 37 – 38.

[46] Ministri i Mbrojtjes: Weißbuch 1983, Zur Sicherheit der Bundesrepublik Deutschland, S.60 – 65.

Në këtë tabelë bie në sy rritja e madhe e numrit të tankeve, e sistemeve të mbrojtjes si dhe e armëve të artilerisë. Një krahasim të trupave detare do të çonte shumë larg, për shkak të numrit të madh të tipave të ndryshme të anijeve, n.q.s ato do t'i krahasonim në detaje.

Whitebook-u gjerman i vitit 1983 thekson që: " Në përgjithësi trupat detare të NATO-s nuk do të ishin në numër më të madh se ato të Paktit të Varshavës, duke qenë se trupat detare të NATO-s duhet të mbrojnë njëkohësisht rrugët lidhëse të NATO-s në Atlantik".[48]

Në qendër të konceptit të luftës tokësore të dominuar nga Pakti i Varshavës, ishte ofensiva strategjike, e përbërë nga aksione në sipërfaqe të gjerë, duke thyer mbrojtjen e armikut dhe duke përparuar deri në thellësi të armikut.[49]

Që në vitet 60 -70, NATO, gjatë analizës së situatës së Paktit të Varshavës, kishte theksuar katër rajone të mundshme lufte të Paktit të Varshavës.

Skenari i mundshëm për një sulm të përmasave të tilla nga ana e Paktit të Varshavës u vlerësua si mundësia më reale dhe në literaturën publike, qëndroi në bërthamë deri në fundin e Luftës së Ftohtë, si bazë për analiza të detajuara të situatave.

Strategjia "Përgjigjja Fleksibël" mbështetet në një "treshe" të armatimeve: armët konvencionale, armët taktike bërthamore dhe armët strategjike bërthamore për të penguar një sulm kundër NATO-s. Nëse do të ndodhte një sulm ndaj NATO-s, atëherë ajo mund të përdorte një ose të gjitha elementet e përmendura më sipër, për të detyruar një agresor të ndërpresë sulmin e tij dhe të tërhiqet nga territori i vendeve të NATO-s.

"Përgjigje Fleksibël" përfshinte tre elemente**:** mbrojtjen direkt, përshkallëzimin e kujdesshëm dhe përgjigjen e përgjithshme bërthamore**.** Mbrojtja direkt kërkon të mundë një agresor dhe të parandalojë arritjen e qëllimeve të tij për konflikt. Kjo duhet të jetë në nivel konvencional. Nëse mbrojtja direkt dështon për të penguar ose ndaluar një sulmues, atëherë NATO ruan variantin e përshkallëzimit të kujdesshëm. Me këtë variant, NATO mund të përshkallëzojë konfliktin**,** duke përfshirë përdorimin e armëve bërthamore, për t'i shkaktuar sulmuesit ndërprerjen e konfliktit dhe tërheqjen nga territori i NATO-s. Qëllimi i përshkallëzimit të kujdesshëm është të krijojë pasiguri për sulmuesit dhe të bëjë që kostoja e arritjes së qëllimeve dhe e objektivave të tij të jetë e papranueshme**.** Nëse këto masa dështojnë, ose në rast se është planifikuar një sulm i madh bërthamor nga një sulmues, NATO-ja mund të përdorë mundësinë e përgjigjes së përgjithshme bërthamore, duke përdorur armët bërthamore strategjike dhe taktike kundër sulmuesit.[50]

Vendet e NATO-s duhet të përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me *Objektivat e Forcës.* Ato duhet të mbajnë një forcë konvencionale që përdor municione konvencionale me teknologji të lartë, të ruajnë një forcë reaguese për t'iu kundërvënë sulmeve bërthamore të kundërshtarit, me qëllim që të plotësojnë tre elementet e "Përgjigjes Fleksibël": mbrojtjen direkt, përshkallëzimin e kujdesshëm dhe përgjigjen e përgjithshme bërthamore.

---

[47] Bundesminister der Verteidigung: Weißbuch 1983, S. 85-98

[48] Ibid, S 101.

[49] Poser: Militärmacht SU, S. 37.

[50] Curtis E. Lemay, *NATO's Strategy of Flexible Response and the Twenty-first Century* 1986, p. 6

Përfundime

Strategjia "Përgjigjja Fleksibël" vendos një theks të veçantë te mbrojtja si mjet për parandalimin e kundërshtarit, por edhe si qëllim, kur parandalimi dështon. Kjo do të thotë se hartuesit e politikave të nivelit të lartë janë të detyruar të marrin në konsideratë, paraprakisht, pasojat e një dështimi në parandalimin e luftës, por kjo nuk do të thotë se çdo herë që dështon parandalimi, Shtetet e Bashkuara duhet të zgjedhin për t'u mbrojtur. Vendimet për t'u mbrojtur duhet të bazohen në analizën e kostove si në rastet kur zgjidhet mbrojtja, edhe kur refuzohet ajo.

Natyrisht, strategjia "Përgjigjja Fleksibël", kur krahasohet me strategjinë "Hakmarrjen Masive" është një strategji më e shtrenjtë dhe gjithashtu, sugjeron një gatishmëri më të madhe të forcave në përgjigje të provokimeve të niveleve të ulëta. Në fund të fundit, strategjitë "Hakmarrja Masive" dhe "Përgjigjja Fleksibel" janë të ndryshme. Ndryshimi i tyre qëndron në faktin se strategjia "Përgjigjja Fleksibel" është e bazuar mbi një perceptim më të saktë të asaj që përbën parandalimin. Në vitet 1950, strategjia "Hakmarrje Masive" dështoi të llogariste si duhet vlerën e mbrojtjes, ajo ishte e përqendruar te parandalimi.

Angazhimet dhe interesat e SHBA-ve nuk janë formuluar nga strategjia, por strategjia është e formuluar nga interesat dhe angazhimet. Paaftësitë për të mbrojtur një interes apo angazhim të kërcënuar, për shkak të mungesës së vullnetit për vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme për mbështetjen e forcave të gatshme dhe rezervë, nuk duhet të merret domosdoshmërisht si një dështim në strategji, por mund të jetë, thjesht, një gjykim i pasaktë në rreshtimin e përparësive kombëtare. Kjo tregon se edhe pse strategjia "Përgjigjja Fleksibël" kontribuoi te dështimet, në mënyrën si u zbatua në vitet '60-të, duke u përqendruar te ndërhyrjet në vlerësimin si duhet të vlerës së mbrojtjes të përdorimit të forcave amerikane në situata të caktuara, kjo thjesht përfaqëson një dështim në gjykim dhe nuk ka të bëjë me një dështim në strategji.

Ata që pohojnë se situata ndërkombëtare ka evoluuar në një pikë, ku konceptet themelore të strategjisë "Përgjigjja Fleksibel" nuk janë më të vlefshme, janë të gabuar. Një shembull i këtij gabimi është shkëmbimi i zjarrit të artilerive midis Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut, më 30 nëntor 2011 në ishullin *Yeonpyeong*. Shembulli më i freskët është ndërhyrja ruse në Krime dhe situata në Ukrainë. Në të ardhmen, ashtu si dhe në të kaluarën, mundësia e luftës së përgjithshme është e ulët, ndërsa mundësia e konflikteve të kufizuara është relativisht e lartë. Për këtë arsye, Shtetet e Bashkuara nuk mund të presin për të "ruajtur një mjedis të jashtëm të favorshëm për stabilitet relativ dhe siguri në botë", pa një kapacitet të përshtatshëm dhe të besueshëm për luftë të kufizuar.

Bibliografia:

- Buxheti i Qeverisë së SHBA-ve, pjesa e Departamentit të Mbrojtjes për vitin 1964.
- Charles Aillert, Përgjigjja Fleksibël, Rishikimi i Mbrojtjes, shkurt 1965.
- Curtis E. Lemay, NATO's Strategy of Flexible Response and the Twenty-first Century, 1986.
- Charles W. Kegley, JR. Politikat Botërore, Tendenca dhe Transformimi, Botimi 12, SHB. "UFO Press", Tiranë 2009.
- Teori të luftës dhe strategjisë,AFA, Tiranë 2011.
- Revista Ushtarake, Prill 2014.
- David W. Tarr, American Strategy in the Nuclear Age, 1966.
- Dr. Gregory W. Pedlow, NATO Strategy documents 1949-1969.

- Glenn H. Snyder, Deterrence and Defense; Toward a Theory of National Security, Princeton University Press 1961.
- Henry Kissinger, Diplomacia e Koalicionit në Epokën Bërthamore, 1964.
- John Foster Dulles, Strategjia e "Shpagimit Masiv" në Politikën e Mbrojtjes të SHBA-ve Perspektiva nga koha e Kolonializmit deri në ditët tona, 1965.
- Maxwell D. Taylor, The Uncertain Trumpet, 1959.
- Melvin R. Laird, Deklarimi i Sekretarit të Mbrojtjes përpara Komitetit të Forcave të Armatosura të Senatit në vitin Buxhetor FY 1972-1976 për Programet e Mbrojtjes dhe në vitin 1972 për Buxhetin e Mbrojtjes, 15 March 1971.
- Richard M. Nixon, US Foreign Policy for the 1970's; A New Strategy for Peace, 18 Shkurt 1970.
- Robert S. McNamara, Fjalimi tek Universiteti i Michigan, 16 Qershor 1962.
- Robert S. McNamara, Speech before the Fellows of the American Bar Foundation, 17 February 1962.
- Robert S. McNamara, "General Nuclear War: Assured Destruction and Damage Limitation: in American Defence Policy, 1968.
- Robert S. McNamara, The Essence of Security; Reflections in Office, 1968.

Fillesat e komunikimit diplomatik në komunitetet ilire

Dr. Jaup Zenuni
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Burimet arkivore, dokumentet historike dhe arkeologjike autoktone shqiptare që dëshmojnë fillesat e komunikimit diplomatik mbi trevat ku sot shtrihet Shqipëria, të paktën deri tani, janë të pakta. Shkak për këtë mund të jenë disa faktorë si: Qenia e kësaj treve shesh lufte për shekuj, ku janë përplasur Fuqitë e Mëdha në etapa të ndryshme historike; zhdukja e gjurmëve të shkruara nga mungesa e kujdesit apo nga elementë të ndryshëm antishqiptarë; mungesa e kronikanëve të aftë për të përshkruar mënyrat se si shqiptarët i kanë ndërtuar marrëdhëniet me fqinjët dhe shtetet e tjera. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se fiset ilire që jetonin në mbretëritë e këtyre trevave nuk ndërtonin marrëdhënie me mbretëritë dhe popujt fqinj apo më gjerë.*

Pavarësisht se deri tani ato nuk i kemi të dokumentuara nga të dhëna apo burime autoktone, duhet të themi me bindje se ilirët kishin marrëdhënie me popujt e tjerë, sepse komunikimi është nevojë për tregje, për marrëveshje, për paqe, për marrëdhënie midis kulturash. Fiset ilire, që jetonin në trojet ku jetojnë sot shqiptarët, nuk mund të ishin një ishull i izoluar nga pjesa tjetër e botës. Pra, ata patjetër kanë pasur mënyrat dhe format e tyre të komunikimit me popujt e tjerë. Ajo që ne nuk kemi sot nga burime të mirëfillta ilire është se çfarë dinamike kishte ky komunikim, si kryhej ai, me çfarë rrugësh dhe mjetesh realizohej.

Problematika që lidhet me evidentimin historik të komunikimit diplomatik në trevat ilire

Studiuesit e kohëve moderne ndeshen me probleme të mëdha në lidhje me hapësirën e njohur si *Iliri. Ivan Matijašiæ* [1] thekson se: "Në fakt, është më se e sigurt se një *etnos* ilir homogjen dhe i centralizuar nuk eksiztonte para shekullit të 3-të p.e.s. dhe se një shtet ilir (*Etat illyrien* i *Fanula Papazoglou*-t[2]), nga Bardhyli te Genti, duhet konsideruar si një ndërtim modern (i shtetit për kohën në fjalë)". Ilirët jetonin në një hapësirë gjeografike që fillonte në veri me lumenjtë Danub, Sava dhe Morava deri te deti Adriatik në perëndim, madje dhe zotërime që shtriheshin në brigjet e detit Jon. Kjo veçori, dhe qasja e mjaft autorëve, sidomos atyre grek dhe romak, si: *Polibi, Tucididi, Livi, Appiani, Mela* etj., kanë krijuar vështirësi në përcaktimin e saktë të prejardhjes së

[1] Matijašiæ, I. (2011). "Shrieking like Illyrians" Historical geography and the Greek perspective of the Illyrian world in the 5th century BC", Arheološki vestnik 62, 2011, fq. 291.
[2] Historiane, autore e librit "Les origines et la destinée de l'État Illyrien: Illyrii proprie dicti.", 1965.

popujve që sot jetojnë mbi këto troje. *Appiani* (në *McPherson,*)[3] shprehet se: "*Illyrioi* nuk i referohej një populli të vetëm të njehsuar politikisht, por ai ishte një term i përdorur për shumë fise të pavarura apo grupe klanore". Duke u nisur nga këto veçori, duket se *Matijašiæ*[4] ka pjesërisht të drejtë kur arrin në përfundimin se duhen pasur parasysh disa rrethana që shpjegojnë mungesën e dokumenteve apo burimeve autoktone ilire: a. Nuk ka mbijetuar ndonjë tekst epigrafie ilire, ndoshta sepse tekste të tilla mbase nuk kanë ekzistuar [shkrime epigrafie të zbuluara janë në gjuhën latine ose greqishten e vjetër]; b. nuk ka mbijetuar "histori" e plotë ilire, përveç *Illyrike*-s së *Appianit* (një shtojcë e librit të tij *Historia Maqedonase*), i cili merret me pushtimin e mëvonshëm romak të krahinës, që më pas u quajt *Illyricum*; c. shumë prej veprave të historianëve grekë kanë humbur, ku sipas fjalëve të *Luciano Kanforës,* ne po punojmë në *"un intero infranto"* (një trup thuajse të tërë të shkatërruar); d. pak autorë grekë i kanë përmendur popujt dhe fiset ilire, dhe shumë prej veprave të tyre kanë mbijetuar përmes traditës jo të drejtpërdrejtë, pra në formë të copëzuar. Sikundër vë në dukje *Dzino*[5], "Rrëfimet për popullsinë indigjene të Ilirisë mbeten të fshehura dhe janë thënë vetëm me gjuhën dhe sistemin e vlerave kulturore të pushtuesit të tyre."

Është e sigurt se hapësira gjeografike ku shtrihet Shqipëria e kufijve të sotëm ka qenë banuar nga fiset ilire të Ardianëve, Dardanëve, Taulantëve, Arbërve, Enkeleasve, Kaonëve dhe Molosëve (këto dy të fundit të helenizuar më vonë). Ilirët, përveç marrëdhënieve midis fiseve që jetonin në këtë trevë të quajtur Iliri, kishin marrëdhënie tregtare me fise të tjera, si: me maqedonasit e lashtë, me grekët dhe thrakët. Madje, grekët kishin ngritur në brigjet e Adriatikut koloni tregtare të tilla si Epidamnosi (Durrësi) apo Apolonia. Karakteristikë e marrëdhënieve midis fiseve në atë periudhë historike ishte paqëndrueshmëria. Këto marrëdhënie kalonin shpejt nga paqja në luftë dhe anasjelltas, si rrjedhojë e etjes së fiseve të ndryshme për zgjerim mbi fiset e tjera dhe për fuqizim. Sipas *Wilkes* në *McPherson*[6], "Luftërat midis fiseve në rajon ishin të përhershme dhe buronin nga dy shkaqe kryesore:

a. konkurrenca për burimet, sepse bregdeti dhe tokat në thellësi të Ilirisë kishin pak pasuri bujqësore;

b. ashtu si në të gjitha shoqëritë e lashtësisë, pushteti dhe autoriteti i udhëheqësve të fiseve qëndronte te forca dhe suksesi ushtarak dhe për këtë arsye, këta udhëheqës, në mënyrë të vazhdueshme, kërkonin të zgjeronin territoret e tyre dhe të fusnin brenda këtyre territoreve fise të tjera."

Si rezultat, herë pas here krijoheshin mbretëri të cilat nuk kishin jetë të gjatë. Në këtë pikëpamje historike, edhe përpjekjet për bisedime dhe për realizimin e marrëveshjeve për aleanca apo armëpushime ishin të shumta. Mjafton të sjellim ndërmend marrëdhëniet midis ilirëve në kohën e mbretit Bardhyl me Filipin II të Maqedonisë; të Enkelejasve, që shpesh luftonte për territore me grekët; të Taulantëve, që u morën grekëve Epidamnusin; të Ardianëve, që vunë nën kontroll Dardanët apo të Kaonëve me fiset helene dhe, gjithashtu, rolin e tyre në luftën e Peloponezit.

[3] McPherson, A. C. (2012). "The first Illyrian War: A study in Roman Imperialism", Montreal University", Department of History and Classical Studies. fq. 28-29).

[4]Matijašiæ, I (2011), Ibid, fq. 291

[5] Dzino, D. (2010). "*Illyricum in Roman Politics*" Cambridge: Cambridge UP. fq. 7.

[6] McPherson, A. C. (2012). Ibid, fq. 31.

Kompleksiteti i marrëdhënieve të ilirëve me popujt fqinjë

Marrëdhëniet midis fiseve ilire dhe popujve helenë, në periudhën e lashtësisë, kanë qenë komplekse. Është Herodoti ai që flet i pari për ilirët dhe trevat e tyre (ku sot shtrihet Shqipëria), qysh në gjysmën e parë të shekullit të 5-të p.e.s. Këto fise, sipas burimeve të shumta historike, ishin vendosur në veri të trojeve të banuara nga grekët. Bashkekzistenca gjeografike në atë sfond historik i bënte marrëdhëniet midis tyre të shpeshta dhe me zigzage. Ata herë luftonin kundër njëri-tjetrit dhe herë ktheheshin në aleatë. Gjatë shekujve të 6-të dhe të 5-të p.e.s, grekët lëvizën drejt veriut dhe krijuan kolonitë e tyre në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut. Historianët e lashtësisë, në mjaft raste, përmendin bashkëjetesën midis fiseve greke dhe atyre ilire. Qytetet që fillimisht banoheshin kryesisht nga ilirët pritën kolonë nga Korinti dhe pjesët e tjera të Peloponezit.[7]

Një prej mjeteve të përdorura për ndërtimin e aleancave ushtarake ishin *martesat*. E ëma e Filipit II, babait të Aleksandërit të Madh, ishte *Juridisi*, vajza e *Sirrës*, e një sundimtari *Linkestian*, emri i të cilit del se është ilir. Vetë Filipi u martua me disa gra, përfshi edhe njërën me emrin ilir, *Audata*. Nga ana tjetër, Pirro i Molosëve, i cili u bë mbreti famëmadh i Epirit, u martua me të bijën e *Audelonit*, mbretit të Paeonianëve dhe Vircenën, vajzën e mbretit ilir Bardhylit. Ja përse familjet mbretërore të fiseve fqinje ishin të lidhura me njëra-tjetrën. Për të shmangur akuzat për prejardhjen barbare, sunduesit u përpoqën për të lidhur origjinën e tyre me mite të vjetra, të tilla si Kadmos dhe heronjtë trojanë. Sipas Cekës[8] "Burra me origjinë pjesërisht ilire, ishin ftuar nga grekët për të marrë pjesë në Lojërat Olimpike qysh në shekullin e 6-të p.e.s dhe më vonë, në shekujt e 3-të dhe të 2-të p.e.s., u ftuan të gjithë ilirët."

Përveç fqinjëve jugorë, ilirët e trevave të Shqipërisë moderne kishin marrëdhënie të shpeshta me fqinjin lindor dhe juglindor, Maqedoninë. Dëshmitë e mjaft historianëve, si: *Herodoti, Diodorus Siculus, Justin, Tucididi* etj., i karakterizojnë këto marrëdhënie me ulje-ngritje. *W.S. Greenwalt* , në librin e tij "Maqedonia, Iliria dhe Epiri", përshkruan historinë e gjatë të ndërveprimit dhe të konflikteve midis maqedonasve dhe ilirëve. Sipas *Edward M. Anson*: "Armiqësitë e shpeshta midis grupeve të fiseve, që grekët i quanin ilirë, dhe maqedonasve, nuk ishin rezultat i një armiqësie të gjatë, por buronin nga afërsia midis tyre, nga dobësia maqedonase dhe nga rëndësia që kishin për ekonominë ilire inkursionet për bastisje."

Nëse në periudhën para Filipit II, ilirët e udhëhequr nga mbreti i tyre Bardhyli ishin superior ndaj maqedonasve, me largimin e Perdikasit dhe pasardhësit të tij Amintasit, në fron erdhi Filipi II. *G.T.Griffith*, mes të tjerash, ndalet edhe në kurbën e marrëdhënieve midis mbretit Bardhyl dhe Filipit II të Maqedonisë. Pas disa fushatave ushtarake të suksesshme mbi territoret maqedonase të viteve 393-392 dhe 383-382 p.e.s, në vitin 359 p.e.s Bardhyli kishte kontrollin e tij mbi gjithë Ilirinë dhe Maqedoninë e Sipërme. Kur Filipi ndërmori fushatën kundër Bardhylit në vitin 358.p.e.s., përgjigjja fillestare e këtij të fundit ishte oferta për paqe, e cila do të bënte që të dyja palët të ruanin kontrollin mbi

[7] Bazuar në të dhëna nga shkrimtarët e lashtësisë, Stefani i Bizantit shkruante në vitin 528-545 e.s se tridhjetë qytetet më të rëndësishme banoheshin nga ilirët, por 200 korinthianë u zhvendosën atje. Strabo (8.32.3) bën fjalë për migracionin peleponezian në Epirin e Veriut. Tucididi (1.26) përmend faktin se apollonianët kishin ndihmuar në betejën e Salamisë kundër persëve në vitin 480 p.e.s, duke i quajtur ata si aleatë të rëndësishëm të korkyrianëve (banorëve të Korfuzit).

[8] Ceka, N: "Ilirët", Shtëpia Botuese "Ilar", 2001, fq. 267.

territoret që kishin në zotërim. Pavarësisht se nuk ekziston ndonjë dokument historik që të dëshmojë për ndonjë marrëveshje apo traktat midis tyre, studiues të ndryshëm janë të mendimit se një pakt i tillë mund të ketë ekzistuar për disa arsye. *Benjamin David Turner*[9] mendon se: "…sigurisht, pas disfatës së vitit 359, mendohet që Filipi bëri përpjekje për të hyrë në bisedime. Megjithatë, fakti që ai arriti t'i zgjaste këto bisedime për më shumë se një vit, në kushtet kur kishte të bënte me një forcë ilire të etur për suksese të mëtejshme, është pak i besueshëm, veçanërisht po të kihen parasysh pozitat e ilirëve dhe maqedonasve, ku i pari në thelb mund t'i diktonte kushtet të dytit dhe t'i kërkonte që ose t'i pranonte këto kushte shpejt, ose ndryshe do të përballej me pushtimin. Më tej, autori shpjegon se Bardhyli duhet të jetë ndodhur përballë tre situatave, meqenëse pranoi t'i zgjaste bisedimet kaq gjatë.

Së pari, ka gjasa që Bardhyli kishte mjaft besim në pozitën e vet e cila e lejonte atë të merrej ose me çështje të tjera, ose të paktën t'i jepte kohë vetes për të vendosur se si do të vepronte më tej me Maqedoninë.

Së dyti, mund të jetë arritur një lloj aleance. Martesa e parë e Filipit ndodhi në fillim të mbretërimit të tij, dhe ajo ishte me iliren Audata, vajzën e mbretit Bardhyl. Kjo na bën të mendojmë se kjo ujdi ishte politike dhe kishte lidhje me konfliktin midis Filipit dhe Bardhylit. Një prej hamendësimeve (në mungesë të dokumenteve) është se martesa u bë për të siguruar arritjen e traktatit që pasoi fitoren e Filipit ndaj Bardhylit në vitin 358 p.e.s. Megjithatë, *J.R. Ellis*[10] është i mendimit se martesa pasoi disfatën e Perdikasit dhe ishte pjesë e një marrëveshjeje të ndërmjetësuar më pas nga Filipi.

Së treti, dikush mund të shtrojë pyetjen se si ka mundësi që Bardhyli të kërkonte një marrëveshje të tillë për të hyrë menjëherë pas saj në konflikt, për arsye se ai e kishte të qartë se vonesa në hyrjen në konflikt nuk i sillte fitim. Me sa duket, Bardhyli nuk ka qenë i prirur për ta shfrytëzuar plotësisht fitoren e tij mbi Perdikasin. Ai ende i kishte mundësitë për t'i shtuar asaj që zotëronte më shumë territore të tjera, sepse me gjendjen ekzistuese, e gjithë Maqedonia mund të bëhej e tij. Përplasja e Filipit me Bardhylin në betejë, në vitin 358 p.e.s., në fakt u shkaktua nga pushtimi i territoreve të Bardhylit nga Filipi dhe jo e kundërta. Që Bardhyli të ketë pranuar kushtet (e marrëveshjes), shpjegohet vetëm me një gjë: ai nuk ishte më i interesuar për zgjerim territoresh."

Edhe pse jo të dokumentuara plotësisht, marrëdhëniet midis mbretit të fuqishëm Bardhyl dhe Filipit II të Maqedonisë, tregojnë se përveç fuqisë ushtarake, ata kanë shfrytëzuar edhe diplomacinë për të arritur marrëveshje, armëpushime apo për të kryer martesa politike për interesa të fuqizimit të fronit të tyre apo të mbrojtjes nga kundërshtari. Është e kuptueshme që komunikimi diplomatik nuk ishte i përhershëm. Si në të gjitha hapësirat e tjera të hartës gjeopolitike të botës, diplomacia e asaj kohe ishte diplomaci e brishtë, e bazuar te përvoja e qytetërimit grek dhe realizohej me anën e të dërguarve, me anën e ambasadave të përkohshme, me anën e korrespondencës midis mbretërve dhe sundimtarëve, me anën e martesave midis oborreve mbretërore dhe me anën e dhuratave. Në mungesë të dokumenteve apo burimeve historike origjinale, ku shpjegohen rrugët dhe mjetet e përdorura nga ilirët para periudhës së quajtur *Illyricum*, na mbetet që të

[9] Turner, D. B. (2012). "Philip II of Macedon: Aspects of his reign", University of Birmingham, http://etheses.bham.ac.uk/3303/1/Turner12MPhil.pdf., fq. 31.
[10] Ellis, J.R. (1970), 'The Security of the Macedonian Throne Under Philip II.' *AM* I, fq. 68-75.

hamendësojmë se ilirët, duke qenë fqinjë me qytet-shtetet greke, u ndikuan nga kjo kulturë edhe në ushtrimin e diplomacisë.

Marrëdhëniet diplomatike Iliro-Romake, dinamika, format, mjetet dhe instrumentet e realizimit

Marrëdhëniet ndërkombëtare të fiseve ilire, të dokumentuara, vijnë nga arkivat romake, sidomos për periudhën e *Illyricum-it*. Sipas *Dzino*(2010, fq. 38)[11]: "Manovrave diplomatike të romakëve është e vështirë t'u gjenden gjurmë në Iliri. Përveç komuniteteve greke të Adriatikut, veprimtaritë diplomatike së të cilëve janë vërtetuar në mënyrë të arsyeshme, nuk kemi të dhëna për sjelljen diplomatike me banorët autoktonë. Disa prej tyre është e sigurt që dërgoheshin në ambasada në Romë apo te magjistri[12] i ngarkuar si në rastin e Daorsëve, në vitin 156 p.e.s apo të Liburnëve, në vitin 50 p.e.s. Ardianët ishin më të sofistikuar në çështjet diplomatike, duke u përpjekur të shtynin apo ndalonin ndërhyrjen romake në vitin 135 p.e.s."

Periudha kur trojet e sotme shqiptare u quajtën *Illyricum* përkon me atë periudhë kur Roma filloi të rriste ndikimin e vet në jugun e gadishullit Apenin dhe në hapësirat që në atë kohë quheshin *Magna Graecia* [Greqi e Madhe].[13] *Appiani*[14] (në Verne Norman Martin 1993, fq. 8) e përshkruan kështu territorin e kësaj hapësire të quajtur *Illyricum* në shtojcën e librit të tij *Historia Maqedonase:* "Grekët quajnë ilirë popujt, të cilët jetojnë në rajonin tej Maqedonisë dhe Trakes, nga Kaonia dhe Threspatia deri te lumi Danub, kjo është gjatësia e vendit, ndërsa gjerësia e tij fillon nga Maqedonia dhe malet e Thrakës deri në Panoni, në Adriatik dhe në rrëzë të Alpeve…" Kështu e gjithë kjo hapësirë e gjerë ku jetonin popuj të ndryshëm, mori emrin Illyricum dhe duke u nisur nga përkufizimi etnik, Plini i Madh[15] shkon deri te një përcaktim gjeografik i kësaj zone. Nga ana tjetër, hapësira në brigjet lindore të Adriatikut, sidomos ngushtica e Otrantos, shikoheshin si zona me mjaft interes për zhvillimin e tregtisë.

Danijel Dzino[16], duke iu referuar rritjes së interesit të Romës për këto hapësira, si dhe mënyrës se si po ndryshonte qëndrimi gjeostrategjik romak, thekson se: "Duket si kuriozitet historik që një territor kaq i gjerë, pikërisht matanë detit, kishte mbetur i paprekur nga ekspansionizmi romak deri në fund të shekullit të 1-rë p.e.s. Gjeografia, sigurisht është njëra prej arsyeve për pushtimin e vonë, sepse terreni i thyer shkurajonte planet e një pushtuesi të mundshëm për t'u shtrirë nga brigjet lindore të Adriatikut, më thellë në kontinent. Një politikë afatgjatë pushtimi kërkonte, në radhë të parë, një ndryshim në qëndrimin romak ndaj mendimit strategjik, i cili u zhvillua pasi i ashtuquajturi Revolucion

[11] Dzino, D. (2010). "*Illyricum in Roman Politics*" Cambridge: Cambridge UP fq. 38.

[12] Në Romën e Lashtë magistratusi ishte njëri prej zyrtarëve më të lartë dhe kishte edhe pushtet gjyqësor edhe pushtet ekzekutiv.

[13] Magna Graecia është emri i hapësirave bregdetare në Italinë e Jugut në gjirin e Tarentinos që ishin kolonizuar gjerësisht nga grekët. Këta kolonë që filluan të nguliten në këto hapësira qysh në shekullin e 8-të p.e.s sollën me vete edhe qytetërimin Helen i cili pati ndikim mjaft të fuqishëm në Itali, sidomos mbi kulturën e Romës së Lashtë.

[14] Appiani i Aleksandrisë (95 e.s-165 e.s), ishte historian romak me origjinë greke i lindur në Aleksandri. Nga 24 librat e tij origjinale me shkrime historike, sot ekzistojnë pjesë vetëm nga gjysma e tyre.

[15] Plini i Madh (23 e.s-79 e.s). Ishte një ndër penat e njohura të perandorisë Romake, i famshëm për librat e tij filozofik dhe natyralist por edhe për shkrime të tjera. Njihet më tepër për veprën e tij "Naturalis Historia" (Historia e Natyrës", e cila kishte karakterin e një enciklopedie.

[16] Dzino, D. (2010). Ibid, f.q. 3.

Romak riformësoi thelbin e *respublica*-s, duke ia dhënë të gjithë pushtetin e makinerisë ushtarake romake një dore të vetme. Pas atij ndryshimi, pushtimi i hapësirave brenda kontinentit evropian varej nga fushatat ushtarake të planifikuara me kujdes dhe të zbatuara në disa faza. Ai, gjithashtu, riktheu prioritetet gjeostrategjike të Romës aty ku ajo ndjehej më komode, në mjedisin kontinental, dhe u dha fund dy shekujve të ankthit kronik të luftërave detare."

Politika e jashtme romake në fakt kishte filluar të interesohej për çështjet ilire, për herë të parë, në shekullin e 3-të p.e.s, sidomos për çështjet që kishin lidhje me mbretërinë ilire të Ardianëve, të cilët sipas romakëve, e kishin kthyer piraterinë në veprimtari shtetërore. Kjo dëmtonte tregtinë e aleatëve të Romës dhe u bë shkaku kryesor i Luftës së Parë dhe të Dytë Ilire në vitet 229 dhe 219 p.e.s. Në fakt, pretekst për fillimin e Luftës së Parë Ilire u bë vrasja e të dërguarit të Romës nga ana e Ilirëve. Me kërkesë të *issaianëve*, të cilët i dërguan një kërkesë senatit të Romës për të marrë masa për ndërprerjen e piraterisë së ardianëve në detin Adriatik, ky i fundit ngarkoi me mision diplomatik dy të dërguar që do të shoqëronin të dërguarit e *issaianëve* (përfaqësuesve të qytet-shtetit të *Issas*, ishulli i Vishit në Kroaci) për te mbreti Agron, për të marrë më shumë informacion mbi çështjen. Sipas burimeve historike (shiko Appia, Polibi dhe Derow), ishte vrasja e njërit prej të dërguarve romak dhe të dërguarit të *issaianëve* nga ana e ardianëve, shkak i shpërthimit të Luftës së Parë Iliro-Romake. Sipas *Appias*, romakët dërguan ambasadorë me mision të pastër diplomatik "…për të shoqëruar *issaianët* dhe për të konstatuar se çfarë krimesh ishin kryer… ndaj tyre". Vetëm kur kjo ambasadë u sulmua në det nga anijet ilire dhe u vranë si i dërguari i Romës, dhe ai i *issaianëve*, vetëm atëherë Roma u provokua për të shpallur luftë kundër ardianëve. Kjo sipas burimeve historike u konsiderua nga ana e Romës si sulm ndaj shtetit romak, sepse një sulm ndaj të dërguarit të saj diplomatik, sipas ligjeve të saj, Roma e konsideronte si sulm ndaj Romës. Polibi[17] shkruan se: "Mbretëresha Teutë kishte vrarë një emisar në rrugën e kthimit për në Romë, sepse ai kishte censuruar përgjigjen e saj ndaj kërkesave romake." Studiuesit kanë vënë në dukje faktin se ka disa mospërputhje midis *Appias* dhe *Polibit* në lidhje me këtë incident, por këto mospërputhje nuk e ndryshojnë faktin që Roma e shfrytëzoi këtë incident diplomatik për të filluar zgjerimin e saj në lindje, matanë detit Adriatik.

Prej momentit të shpalljes, nga ana e Senatit, e luftës me Ilirinë, në vitin 229 p.e.s, Roma filloi të ndërtonte politika të caktuara mbi këtë rajon, për të cilin, para shekullit të 3-të p.e.s, nuk kishte treguar ndonjë interes. Nga fundi i periudhës së hegjemonisë republikane dhe deri në kthimin e Ilirisë në pjesë të Perandorisë, Roma shpeshtoi marrëdhëniet me shtetet e kësaj hapësire, duke ndërtuar, sikundër shprehet *Danijel Dzino*[18], "…një politikë të jashtme rajonale etnike". Iliria e kësaj periudhe përbën një shembull të mirë, por nga ana tjetër, edhe një shembull jo tipik të politikës romake, për shkak të pozicionit të saj të veçantë kulturor dhe gjeografik midis botës helene dhe asaj kontinentale evropiane, si dhe të rëndësisë strategjike, si një ndër portat hyrëse për në Italinë e Veriut. Politikëbërësit romakë jo vetëm i njihnin sistemet politike rajonale, por në disa raste, i krijonin ato dhe i

[17]Polibi. 2.8.9-13, 61: "ambasadori më i ri në moshë u indinjua shumë nga fjalët e saj [Teutës], dhe iu përgjigj me sinqeritetin më të madh, por në mënyrën më të papërshtatshme…, duke shkaktuar inat tek ajo si grua dhe si pasojë qëndrim të pakujdesshëm, sepse ajo e mori ters këtë sinqeritet, dhe u nevrikos aq shumë me atë mënyrë të foluri sa, në kundërshtim me ligjin e marrëdhënieve midis vendeve, dërgoi njerëz për ta vrarë emisarin që kishte folur aq me guxim".

[18] Dzino, D. (2010). "*Illyricum in Roman Politics*" Cambridge: Cambridge UP, fq. 3, 13.

trajtonin në dy mënyra të mbivendosura mbi njëra-tjetrën. Sipas disa gjetjeve arkeologjike në *Cisalpina*, *Purcel* (1990) dhe *Gaul*, apo sipas disa autorëve si *Timpe*, *Goudineau*, *Woolf*, perceptimi romak për sistemet rajonale ndikohej shumë nga "gjeografia e tyre konceptuale" dhe nga "perceptimi subjektiv i gjeografisë".

Marrëdhëniet Romako-Ilire përbëjnë një shembull të qartë të konceptit të *Wallerstein*-it mbi "perandorinë botërore" të marrëdhënies së një sistemi rajonal mbi bazën e aspektit gjeopolitik. Roma ndikonte mbi sistemet rajonale, duke u imponuar atyre një kuadër politik dhe, në faza më të përparuara, një paketë ligjesh që t'u përshtatej interesave të saj. Detyrimin e kuadrit politik Roma e arrinte me dy mënyra: Së pari, duke përdorur pushtetin e fortë (agresionin, pushtimet, luftërat e mëdha) dhe; së dyti, duke përdorur mjetet e pushtetit të butë, si: diplomacia, luftërat e vogla apo krijimi i marrëdhënieve miqësore me fqinjët armiqësorë.

Pozita gjeografike e veçantë e Ilirisë me detin, si boshti i saj kryesor strukturor, kishte ndikim në marrëdhëniet e saj me Romën. Vënia e theksit tek interesat gjeostrategjike romake ishte, gjithashtu, pjesë e marrëdhënieve që Roma ndërtoi me Ilirinë. Këto marrëdhënie ishin dyplanëshe: detare dhe kontinentale.

Duke u mbështetur te ndarjet kronologjike mbi marrëdhëniet Romako-Ilire të bëra më parë nga ana e autorëve *Marin Zaninoviè* dhe *J. Wilkes* (1969), *Dzino*[19] bën një kronologji më bindëse mbi ecurinë e marrëdhënieve midis Romës dhe Ilirisë, sipas fazave që vijojnë:

1. Lulëzimi dhe rënia e mbretërisë ilire, (shekujt 229 p.e.s.-60 p.e.s).
2. Periudha e protoprovincës ose periudha e Ilirisë Bregdetare, (shekujt 59 p.e.s.-33 p.e.s).
   a. Ngritja dhe fuqizimi i Ilirisë Bregdetare, (shekujt 59 p.e.s.-44 p.e.s).
   b. Vendosja e paqes me zonat në brendësi të Ilirisë, (shekujt 44 p.e.s.-33 p.e.s).
3. Iliria si provincë senatoriale (Iliri më e vogël, shekujt 33 p.e.s.-11 p.e.s.).
4. Provinca Perandorake (Iliria më e madhe, shekujt 11 p.e.s-10 e.s).
5. Dy Iliritë (shekujt 10 e.s-68 e.s).

Faza e parë dallohet lehtë. Ajo lidhet më tepër me interesin dhe investimin e Romës për eliminimin e piraterisë në Adriatik, por pa ndonjë angazhim të përhershëm ushtarak. Faza e dytë përkon me fundin e mbretërisë Ardiane , në vitin 167 p.e.s, mbretëri mbi të cilën ishte përqendruar vëmendja e Romës në fazat fillestare të marrëdhënieve iliro-romake. Pas fundit të mbretërisë së ardianëve, politika e Romës për Ilirinë karakterizohet nga një qasje dyvatrore, duke e përqendruar vëmendjen në jug dhe në veri të Adriatikut dhe duke i trajtuar ato si zona të veçanta, por përsëri, pa ndonjë angazhim të përhershëm ushtarak. Faza e tretë lidhet me politikën e emërimit të guvernatorëve të provincave që ndoqi perandori Jul Çezar. Ajo konsiderohet si fillimi i fazës së transicionit dhe nis me formimin dhe mbrojtjen e një zone të njehsuar operacionesh ose e quajtur ndryshe *protoprovinca* në brigjet e Adriatikut dhe vendosjen e paqes në zonat më në thellësi të saj. Në këtë periudhë vihet re nxitja e migrimit italian në Iliri dhe formimi i kolonive dhe të ashtuquajturave *municipia* në brigjet lindore të Adriatikut. Nga ana tjetër, një dukuri e tillë tregon edhe ndryshimin që kishte pësuar politika e Romës ndaj Ilirisë, duke ndjerë gjithnjë e më shumë nevojën strategjike për ta përfshirë Ilirinë në botën romake. Fillimet e fazës së katërt përkojnë me suksesin e ekspeditës së perandorit Oktavian August në vitet 35-33

[19] Ibid,fq 17.

p.e.s. Ky sukses bëri të mundur krijimin e një Ilirie senatoriale midis bregut të detit dhe tokave rreth tij. Faza e pestë lidhet me politikën e ndjekur nga Roma për krijimin e Ilirisë së Madhe, deri në brigjet e lumit Danub. E ashtuquajtura *Bellum Pannonicum* shënoi formimin e provincës perandorake me emrin *Ilyricum*. Por, në shekujt 6-9 e.s, si rezultat i kryengritjeve dhe i disa gabimeve strategjike, Iliria e Madhe u nda në provincat e Dalmacisë dhe të Panonisë.

Zhvillimi i marrëdhënieve të Romës me Ilirinë duhet parë në dritën e tërësisë së politikës së jashtme që ndërtonte dhe vinte në jetë Roma. Po t'i qasemi problemit nga ky këndvështrim, natyrshëm lindin disa pyetje: A kishte Roma një bosht të politikës së saj të jashtme mbi bazën e të cilit ndërtoheshin marrëdhëniet me vendet e tjera? Nëse po, cilët ishin politikëbërësit dhe si ndërtohej kjo politikë? A kishte një strategji të caktuar që të frymëzonte doktrinën e Romës në marrëdhëniet ndërkombëtare? *Finley*[20] mendon se përgjigjet për këto pyetje duhen vënë në sfond historik. "Sigurisht, politikëbërja romake nuk mund të shihet me syrin e kështilltarëve të politikës së jashtme moderne apo me syrin e qendrave kërkimore për politikat rajonale apo globale (në kohët moderne). As nuk mund të pretendojmë të njohim mekanizmat e tyre të vendimmarrjes, sepse shumë copëza mungojnë nga pasqyra e përgjithshme (përjashto disa raste të rralla) si protokollet e debateve në Senat apo letrat private, që do të na ndihmonin për të zbuluar pikëpamjet e individëve dhe debatet mes njerëzve të përfshirë në procesin e vendimmarrjes."

Nëse themi që me politikë kuptojmë aftësinë e sundimtarëve dhe drejtuesve politikë për të përdorur të gjitha mjetet dhe burimet politike për interesat e shtetit dhe të qytetarëve të tij, atëherë, nga kjo pikëpamje, nuk ka dyshim se politika e jashtme romake ekzistonte. Ishin interesat ekonomike, politike dhe private të sundimtarëve të Romës dhe të njerëzve që kishin ndikim mbi ta për të nxjerrë përfitime nga shteti, sikundër ishin burimet dhe tregjet e reja apo mbrojtja e *res publica*-s, ato që frymëzonin dhe udhëhiqnin politikën e jashtme romake, dhe sipas rastit e transformonin atë. Me këndvështrimin bashkëkohor, nuk mund të themi që romakët ishin plotësisht të vetëdijshëm për pasojat e planeve politike që hartonin dhe nga ana tjetër, është e vështirë të besohet se Senati Romak merrej me të gjitha çështjet kaotike të përditshme të politikës së jashtme, apo që komandantët ushtarakë në terren kishin liri të plotë veprimi. Gjithashtu, është e vështirë të pranohet se rendja pas lavdisë personale apo interesat komerciale, ishin faktorë mjaft të rëndësishëm për frymëzimin e politikës së përbashkët nga ana e Senatit.

Në gjykimin për politikën e jashtme romake, duhet të mbahen parasysh dy momente të rëndësishme. E para, periudha e Romës si Republikë, ku Senati, pavarësisht luftës së brendshme për pushtet dhe mosmarrëveshjeve që ekzistonin, kishte thuajse kontroll të plotë mbi çështjet e shtetit, përfshi dhe politikën e jashtme. *Sherwin-White* (1984 në Dzino 2005, fq. 32[21]) bën një përmbledhje të tillë mbi thelbin e vendimmarrjes për politikën e jashtme romake në shekullin e 2-të p.e.s., ku thotë: "Politika e jashtme e shtetit romak në shekullin para Luftës Sociale[22] përcaktohej nga Senati Romak brenda kufijve që

[20] Finley, M.I. (1978). "Empire in the Greco-Roman world", Greece & Rome 25(1), Cambridge University Press, fq. 2-3.

[21] Dzino, D. (2005). "*Illyricum in Roman Politics*" Cambridge: Cambridge UP, fq.32.

[22] Lufta Sociale ose e quajtur ndryshe *Lufta e Aleatëve* apo *Lufta Italiane* u zhvillua në vitet 90-88 p.e.s midis Republikës Romake dhe disa prej qyteteve të tjera italiane, të cilët para luftës kishin qenë aleatë të Romës për shekuj me radhë. Fitorja e Romës në luftërat Samnite solli dominancen e saj mbi të gjithë gadishullin Italian.

imponente sistemi republikan…Për këtë arsye, është e ligjshme të flitet për politikë senatoriale jo në kuptimin që ekzistonte një opinion uniform brenda tij, por në kuptimin që dekretet senatoriale mbi politikën e jashtme përfaqësonin pikëpamjen e shumicës dhe dilnin mbi ambiciet politike të individëve apo fraksioneve."

Periudha e dytë është ajo, kur me rënien e sistemit republikan, politikëbërja dhe vendimmarrja kaloi nga forumi, në dyert e mbyllura të pallatit perandorak. Në thelb, duhet të themi se tipari thelbësor i kësaj faze është rritja e rolit të perandorit dhe të njerëzve afër tij në përcaktimin e politikave të shtetit romak. *Princep*-ët (e përkthyer 'qytetarët e parë' ishte një titull zyrtar që jepte perandori romak, titull që përcaktonte kush ishte udhëheqës në Romë) dhe rrethi i tij i ngushtë familjar, miqtë dhe këshilltarët, gradualisht u bënë boshti i politikëbërjes së perandorisë.

Për sa i përket përcaktimit të natyrës së politikës së jashtme të Republikës së Romës, studiuesit ndahen në dy grupe. Grupi i parë përbëhet nga ata autorë që e konsiderojnë atë "agresive" (agressive imperialism shiko *Harris* 1979; *Brunt* 1978; *Rich* 1993; *Shatzman* 1975; *Pašaliæ* 1975; *Richardson* 1986 dhe *Harman* 1989). Grupi i dytë (*Stevenson* 1951; *Badian* 1968; *Sherwin-White* 1980; 1984; *Lutwak* 1976 dhe *Brunt* 1987) e konsiderojnë politikën e jashtme të Romës Republikane si *defensive* (defensive imperialism). Ithtarët e politikës së jashtme "agresive" janë të mendimit se forca e traditës, prestigji individual dhe etja për lavdi ushtarake e shtynte fisnikërinë romake në luftëra agresive. Përveç kësaj, ata argumentojnë se motive të tjera ishin: interesat ekonomike të klasës sunduese; shtimi i mundësive dhe hapësirave për tregti dhe; nevoja për të shfrytëzuar provincat e reja që pushtonin duke u bazuar te perceptimi i krijuar te popujt e tjerë mbi "rrezikun romak". Nga ana tjetër, mbrojtësit e pikëpamjes se politika e jashtme e Republikës Romake ishte "defensive" argumentojnë se paria e Republikës, në përgjithësi, ishte kundër ekspansionit. Sipas tyre, ekspansioni, edhe kur ndodhte, bëhej për arsye sigurie ose në mbrojtje të interesave romake (si në rastin e shpalljes së Luftës së Parë Ilire). Këta autorë, kanë pikëpamjen se Roma në vend të politikës së aneksimit, preferonte kontrollin diplomatik të vendeve të pushtuara.

Instrumentet e realizimit të politikës së jashtme romake mund të klasifikohen në dy grupe: Në instrumente të integrimit dhe në instrumente të fuqisë. Tek grupi i instrumenteve të integrimit futen një numër mjetesh dhe rrugësh të ndryshme që përdoreshin për arritjen e qëllimit. Midis tyre mund të përmendim diplomacinë, traktatet e apo marrëveshjet e paqes, armëpushimet, joshjen me poste dhe ofiqe, ofrimin e nënshtetësisë romake, dhuratat, deri te përdorimi i politikës së *amisticias*. Këto mjete ndihmonin që Roma të mbante nën kontroll zonat e pushtuara, pa përdorur forcat pushtuese. Qëllim tjetër i përdorimit të këtyre instrumenteve ishte të ndihmonte territoret e pushtuara të bëheshin pjesë përbërëse e perandorisë. Më pas, këto vende shërbenin si katalizatorë për integrimin e popujve fqinjë brenda Perandorisë Romake. Është e vërtetë se "politika e karotës" i jepte më vonë rezultatet e saj, por në terma afatgjatë, ajo ishte mjaft e dobishme dhe rriste kohezionin e perandorisë. Kur flasim për instrumente fuqie kemi parasysh, mbi të gjitha, ushtrinë romake, që përdorej për të neutralizuar kundërshtarët e rrezikshëm, për të zgjeruar kufijtë e perandorisë me territore të reja dhe për të garantuar sigurinë në hapësirën perandorake.

Njëri prej instrumenteve të politikës së jashtme romake, nëse mund të quhet i tillë, ishte përdorimi i miqve dhe aleatëve, pra, i komuniteteve të pavarura si qytetet apo popujt e lirë jashtë kufijve të Romës dhe të ashtuquajturit mbretër "klientë" të Romës, që kujdeseshin për sigurinë në hapësirat ku sundonin dhe mbronin interesat romake në këto hapësira,

duke u bërë, me kalimin e kohës, pjesë e shtetit romak. Pjesët e helenizuara të mbretërisë së Ilirisë dhe kolonitë greke në Adriatikun Juglindor ishin përfshirë në këtë rrjet kompleks marrëdhëniesh me Romën, duke nënshkruar lloje të ndryshme traktatesh në periudhën fillestare të zgjerimit romak përtej Adriatikut, në vitet 229-168 p.e.s. Ndonëse nga dokumentet historike natyra e këtyre marrëdhënieve nuk del fortë e qartë, mund të themi se kemi dy grupe studiuesish me qasje të ndryshme ndaj natyrës së këtyre marrëdhënieve. Grupi i parë (*Sherin-White* 1973; *Linott* 1981; *Braund* 1984; *Verboeven* 2002: *Burton* 2003 dhe *Shattuck* 2013) mendon se marrëdhëniet klient-padron që u zhvilluan më herët në praktikën e shtetit romak si marrëdhënie midis individësh, në disa aspekte u mbartën në politikën e jashtme të Republikës së Romës. Sipas këtyre studiuesve, Roma i ndante shtetet me të cilat kishte marrëdhënie në dy kategori: në kategorinë e shteteve që i quante miq (*amici)* dhe; në kategorinë e shteteve që i quante aleatë (*socio)*, që në thelb ishin klientë të shtetit romak. Grupi i dytë i studiuesve (*Matthaei* 1907; *Badian* 1958; *Timpe* 1972 dhe *Lica* 2000) mendon se qasja e grupit të parë nuk është e mbështetur mirë me fakte historike. Sipas tyre, ajo buron nga historia përshkruese dhe nuk thellohet në analizën politike, juridike dhe sociale të marrëdhënieve të Romës me shtetet e tjera. Ata argumentojnë se shteti romak, në rrugë zyrtare apo si kërkesë e ligjeve romake, nuk i konsideronte shtetet e tjera, sidomos mbretërit, si klientë(*clientela)*. Pas vitit 150 p.e.s, sipas këtyre studiuesve, nuk ka shenja të marrëdhënieve të barabarta me shumicën e shteteve të huaja në pellgun e Mesdheut, sepse Roma ishte afirmuar si fuqia e vetme politike në këtë hapësirë gjeografike. Ky ndryshim në balancën e fuqisë kërkoi që ligji romak që kishte të bënte me trajtimin e të huajve dhe me marrëdhëniet e Romës me *externea gentes* (kombet e huaja), si p.sh., banorët e Ilirisë, të ndryshonte, duke u bërë më i thjeshtë. Në thelb, thuajse të gjithë aleatët dhe miqtë e mëparshëm të Romës u kthyen në vartës të vullnetit të Republikës, duke ruajtur kështu vetëm pavarësinë nominale. Kjo është faza kur Roma zbatoi një politikë të jashtme agresive.

Një nga mekanizmat e rëndësishëm për realizimin e politikës së jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera nga ana e Romës ishte "amicitia" (term latin që ka kuptimin miqësi). Në Romën e Lashtë, ky term përshkruante mënyrën se si shteti romak ndërtonte marrëdhëniet me shtetet e tjera. Ai ishte një term fleksibël dhe varionte për sa i përket rëndësisë në varësi të shtetit me të cilin zbatohej apo ndërtonte marrëdhënie Roma. Kishte raste që termi i bazohej në miqësinë në largësi dhe në raste të tjera mund t'i referohej një aleance të përkohshme në luftë. Duke pasur parasysh këtë elasticitet të termit dhe natyrën e hapësirës së quajtur Iliri me shumë komunitete etnike, Roma zbatoi një "amicitia" të veçantë për këtë hapësirë gjeografike. Roma e vuri në jetë politikën e saj të jashtme në marrëdhëniet me Ilirinë nëpërmjet "amiciatias", fillimisht për të garantuar stabilitetin dhe sigurinë në kanalin e Otrantos, që ishte kanal shumë i rëndësishëm për tregtinë me vendet e tjera. Mënyra se si u zbatua përbën veçori, sepse pati mjaft fleksibilitet dhe angazhimin më minimal në marrëdhëniet midis vetë Romës dhe Ilirisë. Garantimi i sigurisë në kanalin e Otrantos i dha mundësi Romës të mbronte interesat e tregtisë përmes detit, të aleatëve të saj grek në *Magna Graecia* (Greqinë e Madhe) dhe të merrte gjithashtu nën mbrojtje qytetin *Brundisium* (Brindizi i kohëve moderne), qytet i cili ishte skaji më jugor i rrugës "Apian", rrugë që të çonte drejt e në Romë dhe ishte me rëndësi mjaft të madhe, edhe për mbrojtjen e vetë qytetit.

Po të krahasojmë mënyrën se si Roma e zbatoi "amiciatia-n" me tre vende, Egjiptin, Aetolian dhe Ilirinë, vëmë re se: me Egjiptin marrëdhëniet nuk ishin shumë angazhuese,

ato ishin në kuadrin e një miqësie formale në kohë paqeje, sepse pozita gjeografike e Egjiptit, larg Romës, e diktonte një marrëdhënie të tillë; në kohë lufte, ajo merrte trajtën e një *foedus*-i, pra të një aleance të përkohshme për një kauzë të përbashkët, sikundër ishte rasti me *Aetolian* në luftën kundër Filipit V të Maqedonisë; në raport me Ilirinë, "amicitia", sikundër shprehet *Vrene Norman Martin* [23]"ishte një shprehje diplomatike që i lejonte romakët të zëvendësonin tarentinët si forcë policore në Adriatik, siç tregohet në dënimin e *Demetriusit* të Farosit. Në Iliri kurrë nuk pati një *foedus*, pra një aleancë në kohë lufte, askush nuk u përfshi në "amiciatia", në qytetet që ishin koloni greke dhe nuk pritej që ilirët të ndihmonin romakët në luftë. Shkurtimisht, për Ilirinë u luftua në dy konflikte të shkurtra, në të cilat Roma përdori një politikë të jashtme të bazuar në përvojat e mëparshme dhe vazhdoi konceptin grek të *amiciatia*-s dhe të lirisë së shtetit. Romakët bënë detyrën e tyre: Tregtia përmes Otrantos ishte çliruar nga pengesat e krijuara nga piratët ilirë, dhe Senati Romak ishte në gjendje të shtrinte interesat e tij në ujërat midis brigjeve perëndimore të Greqisë dhe thembrës së çizmes së gadishullit Apenin. Kjo krijoi një zonë sigurie për fundin e gadishullit të Italisë dhe për qytetin *Brundisium*, ekstremin e arteries juglindore të rrugës "Apian", që të shpinte në Romë". Krahas përfitimeve të përmendura më sipër, si rezultat i zbatimit të politikës së "amiciatia-s" me Ilirinë, Roma i përdori hapësirat ilire si pikënisje për zgjerimin e mëtejshëm në lindje.

Një veçori tjetër e përdorimit të "amiciatia-s" në Iliri ishte, se ky term u përdor në të dyja kuptimet si në kuptimin pasiv, edhe në kuptimin agresiv, që do të thotë se i dha mundësi Romës të ishte e pranishme në Iliri, pa qenë nevoja të vendoste trupa ushtarake. Duke arritur të prishte "unitetin e piratëve ilirë" dhe duke bërë që 'të gjithë miqtë të sundonin veten veç e veç", Roma përdori një mënyrë të veçantë të ndërhyrjes në Iliri dhe të ndërtimit të marrëdhënieve me shtetet e kësaj hapësire. Ndërsa "miqtë" e Romës në Iliri ruanin rendin dhe rregullin, Roma ishte në gjendje të përqendrohej te patrullimi i kanalit të Otrantos, pa u marrë me problemet e Ilirisë. "Amicitia" në Iliri dhe mënyra si u zbatua ajo, ishte një eksperiment gjatë periudhës së hershme të politikës së jashtme të Romës me vendet matanë detit. "Amicitia" në Iliri pasqyronte maninë e romakëve për rregull dhe rend, për mënyrën e tyre të rendit, që kishte filluar qysh me Luftën e Parë Samnite. Senati e kishte fiksim që të sigurohej nëse vendet në kufijtë skajor të Perandorisë të kishin siguri. Kjo kërkonte luftë dhe nënshtrim të vendeve fqinje me vendet në kufijtë skajor të perandorisë. Ky lloj rendi dhe rregulli romak vazhdoi gjatë gjithë kohës së perandorisë Romake.

Përfundime

Si përfundim, shtetet dhe komunitetet që jetonin në hapësirën e quajtur Iliri kanë pasur mënyrën, format dhe instrumentet e tyre të komunikimit diplomatik. Nëse ky komunikim nuk vjen i pasqyruar përmes dokumentacionit autokton ilir për shkaqe të ndryshme historike, kjo nuk do të thotë se ky komunikim nuk ekzistonte. Faktet dhe dëshmitë që kanë sjellë historianë grekë dhe romakë të kohës, në ndonjë rast të deformuara dhe të para me syrin e interesave greke dhe romake, përsëri flasin për marrëdhënie midis popujve të këtyre trevave me popujt fqinjë, të shkëmbimeve kulturore, politike, diplomatike, ekonomike dhe të martesave që ata kishin me këta popuj. Kërkimi shkencor për gjetjen e burimeve autoktone ilire të pazbuluara deri tani dhe thellimi në studimet e kryera deri

[23] *Verne Norman Martin* (1993). "Roman application of amicitia in Illyria, 229 to 196: from the first Illyrian war to the end of the second Macedonian war", fq. 46-47.

tani nga studiues të ndryshëm për natyrën, dinamikën, rrugët dhe instrumentet e komunikimit diplomatik midis ilirëve dhe popujve të tjerë, mbetet një detyrë e përhershme për shkencën shqiptare, sepse gjetja e fakteve dhe dëshmive të reja është kontribut në përforcimin e identitetit tonë kombëtar. Trajtimi objektiv i këtyre fakteve dhe dëshmive, larg ndikimeve nacionaliste dhe prirjeve për t'i trajtuar ilirët si popuj më pak të qytetëruar se popujt e tjerë fqinjë, do të evidentonte se ilirët ishin po aq të civilizuar sa popujt helenë, maqedonas apo të gadishullit Apenin edhe në ndërtimin e marrëdhënieve diplomatike.

Bibliografia:

- Anson, M. E. (2010). "A Companion to Ancient Macedonia", edited by Joseph Roisman and Ian Worthington, Wiley-Blackwell.
- Ceka, N. (2001). "Ilirët", Shtëpia Botuese "Ilar", 2001.
- Dzino, D. (2010). "*Illyricum in Roman Politics*" Cambridge: Cambridge UP.
- Ellis, J.R. (1970), 'The Security of the Macedonian Throne Under Philip II.' *AM* I.
- Finley, M.I. (1978). "Empire in the Greco-Roman world", Greece & Rome 25(1), Cambridge University Press.
- Goudineau. C. (1996). 'Gaul', CAH² 10.
- Matijašiæ, I. (2011). "Shrieking like Illyrians" Historical geography and the Greek perspective of the Illyrian world in the 5th century BC", Arheološki vestnik 62.
- Martin. N. M. (1993). "Roman application of amicitia in Illyria, 229 to 196: from the first Illyrian war to the end of the second Macedonian war".
- McPherson, A. C. (2012). "The first Illyrian War: A study in Roman Imperialism", Montreal University", Department of History and Classical Studies.
- Timpe, D. (1996). Rome und die Barbaren des Nordens. In Schuster, M. (ed.), Die Begegnung mit dem.
- Turner, D. T. (2012). "Philip II of macedon: Aspects of his reign", University of Birmingham, http://etheses.bham.ac.uk/3303/1/Turner12MPhil.pdf
- Wallerstein. I. (1987). "World System Analysis" in A. Giddens /J.H.Turner (eds.,), *Social Theory Today*, Cambridge.
- Wilkes.J.J. (1969). "dalmatia", London.
- Woolf, G. (1998). Becoming Roman, Cambridge University Press, New York.
- Zaninoviæ, M. (1976b). "Das Rõmische heer in der entwicklung des altertums des unseren küsten", in Batoviæ (1976a).

Karakteristikat e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Luftarake Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore (LANÇ)

Dr. Asllan Zemani, historian ushtarak
MSc. Afërdita Hajro, specialiste në AQSH

Trajtesë e shkurtuar. *Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm drejtuan me aftësi UNÇSH në përmbushjen e misionit të saj përfundimtar strategjik, çlirimin e vendit. Madje, një pjesë e formacioneve partizane luftuan edhe për çlirimin e pjesës më të madhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve të shtetit amë. Duke plotësuar me dinjitet angazhimin e tyre në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist botëror, Komanda, Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria shqiptare i ndoqën pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre, që u tërhoqën me ta, deri në Vishegrad (Bosnja Jugore).*

Balli Kombëtar, ndonëse u përpoq që të vihej në veprim për të realizuar drejtimin tërësor e të pjesshëm të forcave, këto nuk patën qartësi organizative në përcaktimin e detyrave që duhej të kryenin. Këto mangësi çuan në rënien cilësore të nivelit të drejtimit dhe ndikuan ndjeshëm e negativisht në veprimet luftarake të forcave të Ballit Kombëtar në fushën e luftimit.

Forcat e Armatosura të Legalitetit, brenda një harku kohor të shkurtër, nga formimi deri në shpërbërjen e tyre, nuk mundën të përvijonin e të kristalizonin dot sa e si duhej organet e drejtimit ushtarak të formacioneve ushtarake të tyre, ndonëse në përbërje kishte shumë ish oficerë të karrierës. Ato mbeten në një fazë të thjeshtë e tepër të zbehtë edhe në drejtim.

Fjalë kyçe: mision, LANÇ, Koalicioni i Madh Antifashist, Balli Kombëtar, veprimet luftarake, Legaliteti, organet e drejtimit.

Formimi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së

Siç dihet, gjatë Luftës së Dytë Botërore bota u nda në dy kampe. Nga njëra anë, trekëndëshi i fuqive agresor,e në të cilin bënin pjesë Gjermania naziste, Italia fashiste dhe Japonia militariste, me pak satelitë, nga ana tjetër, kampi i madh antifashist i kryesuar nga Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilët u rreshtuan të gjithë popujt e pushtuar nga agresorët fashistë ose që rrezikoheshin prej tyre. Për Shqipërinë, parimisht dhe praktikisht, e vetmja rrugë për të rifituar lirinë e shkelur dhe pavarësinë e humbur ishte, në bazë të Kartës së Atlantikut, të nënshkruar nga Ruzvelti dhe Çërçilli, rreshtimi në krah të koalicionit të madh antifashist[1]. Pjesëmarrja në

[1] Frashëri, K. "Mbi historinë e Ballit Kombëtar", Sh. Botuese "Durda", Tiranë, 2012, fq. 14.

këtë koalicion të madh anglo-sovjeto-amerikan nënkuptonte angazhimin e shqiptarëve në luftë të armatosur kundër agresorëve nazifashistë. Në mbarë Evropën e pushtuar, të gjithë tok, komunistë dhe nacionalistë, të majtë dhe të djathtë, laikë dhe klerikë, burra dhe gra, rrëmbyen armët dhe luftuan, diku të bashkuar e diku të veçuar, kundër okupatorëve të huaj.

"Ndërsa pushtimi fashist italian i 7 Prillit 1939, popullin dhe Atdheun tonë i gjeti pa ushtri, pa udhëheqje politike e ushtarake, pasi mbreti Zog dhe komanda ushtarake e lartë, e lanë vendin në mëshirën e pushtuesit fashist duke ia mbathur jashtë kufijve të Shqipërisë[2]. Ndërkaq, në këtë periudhë historike, opinioni publik në Shqipëri u polarizua afërsisht në katër rreshtime kryesore politike: në "Partia Fashiste Shqiptare" dhe në tri parti antifashiste, në Partinë Komuniste Shqiptare, në Organizatën e Ballit Kombëtar dhe në atë të Legalitetit"[3].

Përfaqësuesit e këtyre rrymave të ndryshme nacionaliste dhe ato të partisë komuniste (përkatësisht 8 e 17 veta[4]), u mblodhën më 16 shtator 1942 në Pezë dhe krijuan Frontin Nacionalçlirimtar. Ky i fundit, si organi më i lartë politiko-ushtarak në shkallë vendi, krijoi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Fryma dhe detyrat që shtroi Konferenca e Pezës, por edhe përhapja e tyre në masat e gjera popullore, bënë që deri nga mesi i vitit 1943, qëndresa e armatosur popullore të merrte shtrirje të gjerë. Në radhët e formacioneve partizane, "...si i vetmi grup i rezistencës i vendosur për të luftuar pushtuesit[5]" kishte rreth 10.000 partizanë të përfshirë në 20 batalione e mbi 30 çeta partizane[6], krahas rreth 20.000 të tjerëve në radhët e forcave vullnetare[7] e territoriale. Ky zhvillim i organizimit ushtarak dhe i veprimeve luftarake kishte bërë që anë e kënd Shqipërisë të krijoheshin "Zona të Lira" si në Pezë, Kurvelesh, Mesaplik, Skrapar, Gorë-Opar, Çermenikë, Martanesh, Dibër, Tropojë, Mbishkodër[8] etj., duke mbuluar kështu, gati 50% të territorit të vendit. Në këtë mënyrë u krijuan kushtet optimale të domosdoshme për të kaluar në një shkallë më të lartë të organizimit ushtarak, por edhe të objektivave të luftës çlirimtare. Por, jo vetëm zhvillimet e brendshme, edhe ato të jashtme, në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist, shënuan kthesën e madhe në fatet e Luftës së Dytë Botëror. Kishin përfunduar me asgjësimin e grupimit gjerman betejat e El Alameit dhe të Vollgogradit (Stalingradit), si betejat e para të kthesës së madhe; kishte filluar operacioni i desantimit detar në Siçili dhe, në Frontin e Lindjes, po përgatitej beteja e Kurskut, që do të shënonte kthesën përfundimtare në fatet e gjithë luftës. Tashmë, vështrimi i aleatëve të mëdhenj po drejtohej më pranë Ballkanit dhe Evropës Qendrore.

Pikërisht, në fillim të korrikut 1943, në kushtet e krijuara, Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, i dalë nga Konferenca e Pezës, vendosi të mblidhej në Labinot të Elbasanit. Mbledhja u hap me 4 korrik dhe vijoi deri me 10 të atij muaji. Motivi kryesor i

---

[2] Çeli, Xh. Gazeta "Labëria", Nr. 239, dt. 15 korrik 2000.

[3] Frashëri, K. "Mbi historinë e Ballit Kombëtar", Sh. Botuese "Durda", Tiranë, 2012, fq. 15.

[4] Po aty, fq. 19.

[5] Lucas. Peter, "The OSS in World War II-Albania Covert Operations and Collaboration with Comunist Partisans", (botim shqip) Sh. Botuese "Bota Shqiptare", Tiranë, 2008, fq. 165.

[6] Kasneci. L. "Steeled in the Heat of Battle, A Brief Survey of the National Liberation War of the Albanian People, Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1966, fq. 156.

[7] Leka, Prof. Dr. Shahin, "Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSh-së, 1943-1945", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1998, fq. 8.

[8] Hasani, Prof. Dr. Proletar, "Histori e Pashkruar", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1999, fq. 131.

saj ishte të krijohej, më në fund, organizimi i nevojshëm drejtues, i mirëfilltë ushtarak, jo vetëm ai qendror, por edhe degëzimet poshtë. Së dyti, të krijoheshin formacionet luftarake dhe vetë ushtria, aq të domosdoshme për stadin ku kishte arritur Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe shndërrimin e saj në kryengritje të përgjithshme të armatosur[9].

Në këto rrethana, në kuadrin e brendshëm, lindi natyrshëm nevoja e krijimit të një organi të specializuar ushtarak për drejtimin operativo-strategjik të luftës brenda vendit, por edhe për koordinimin e veprimeve me forcat aleate të "koalicionit botëror antifashist"[10]. Ky organ do të ishte Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH "...një qendër organizative, politike e operative e të gjitha fuqive të armatosura antifashiste"[11]. Ai u krijua me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Si vetë Këshilli, që kishte karakter pluralist, edhe Shtabi i Përgjithshëm, për nga përbërja, kishte të njëjtin karakter. Krahas përfaqësuesve të PKSH, si formacioni kryesor politik i luftës (Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Ramadan Çitaku, Mustafa Gjinishi, Nako Spiru, Dali Ndreu, Bedri Spahiu), në përbërje të tij u futën edhe nacionalistë që pranonin platformën e Frontit Nacionalçlirimtare për luftën (Myslim Peza, Abaz Kupi, Haxhi Lleshi, Baba Faja, Spiro Moisiu). Qendra politike e "…Lëvizjes, nga forcimi e zgjerimi i lëvizjes vullnetare e partizane[12]" do të dilte Shtabi i Përgjithshëm, i fuqive të armatosura të luftës sonë për çlirimin e Shqipërisë. Në mbledhjen e tij të parë, sikurse shprehet në procesverbalin përkatës, "…zgjodhi unanimisht si komandant të shtabit, Spiro Moisiun[13],…ish-major i ushtrisë mbretërore[14], i cili "nuk ishte as anëtar partie"[15] dhe si komisar Enver Hoxhën[16]". Ai përcaktoi edhe strukturën organizative të tij, të përbërë nga: shtabi operativ, komisariati politik, komisariati ekonomik, sektori i brendshëm, seksioni i ndërlidhjes dhe disa specialistë. Detyrat e Shtabit të Përgjithshëm përmblidheshin në tre drejtime kryesore: organizimi i "…një ushtrie të rregullt të çlirimit kombëtar[17], realizimi i udhëheqjes operative e strategjike të luftës dhe përpunimi i taktikës së luftës popullore"[18].

Krijimi dhe lindja e këtij organizmi madhor paraqiste një varg vlerësimesh të një rëndësie të jashtëzakonshme shumëplanëshe, të brendshme e të jashtme. Pavarësisht se ky shtab kishte veçoritë e veta dhe nuk ishte një shëmbëlltyrë tipike e shtabeve klasikë të ushtrive moderne, gjithsesi ai kishte vlerat e veta për çastin kur doli në dritë.

Në planin e brendshëm, ky organizëm drejtues përbënte një mekanizëm ushtarak të mirëfilltë, krejt të domosdoshëm, që e diktonte nevoja e organizimit të formacioneve

[9] "Historia e Ushtrisë Shqiptare" (Organizimi), 1912-1944, Sh. Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 2000, fq. 294.
[10] "Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar" vëll. 2, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1986, fq. 311.
[11] "Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar, 1942-1944", Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1962, fq. 12.
[12] Prof. Dr. Proletar Hasani, "Histori e Pashkruar", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1999, fq. 47.
[13] Më 28 Nëntor 1938, S. Moisiu mori gradën major i Këmbësorisë dhe u emërua pranë Komandës së Grupit të Pestë të Përzier të Ushtrisë.
[14] Smirnova. Nina, "Historia e Shqipërisë, përgjatë shekullit XX", Sh. Botuese "Ideart", Tiranë, 2004, fq. 253.
[15] Quku. Faik, "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", Sh. Botuese "Ilar", Tiranë, 2006, fq. 159.
[16] Fischer. B. J, "Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945", Sh. Botuese "Çabej", Tiranë, 2000, fq. 190.
[17] Fischer. B. J, "Diktatorët e Ballkanit", Sh. Botuese "Aiis", Tiranë, 2008, fq. 271.
[18] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Kombinati poligrafik "Shtypshkronja e re", Tiranë, 1985, fq. 1060.

luftarake ekzistuese, por edhe i atyre që do të krijoheshin më pas në fushën e luftës. Njëherazi ai ishte një organ i specializuar ushtarak, një qendër e mirëfilltë drejtuese, përpunuese dhe bashkërenduese e veprimeve luftarake të formacioneve të të gjitha përmasave dhe niveleve. Ndërkaq, ky shtab përbënte një garanci për drejtimin dhe zhvillimin me sukses të veprimeve luftarake kundër pushtuesve për të kapërcyer detyrat e vështira, por të rëndësishme të kësaj lufte.

Karakterin partiak dhe politik ky shtab e reflektonte tek pjesëmarrja në përbërje dhe në krye të tij e kreut më të lartë të PKSH-së, por edhe të drejtuesve të tjerë të saj. Enver Hoxha, komisar politik i Shtabit, njëherësh edhe Sekretar i Përgjithshëm i PKSH-së ishte treguesi më i qartë i kësaj dukurie. Natyrisht, kjo dukuri, por edhe vendosja e linjës partiake dhe e komisarit politik nuk ishin thjesht produkt shqiptar. Ato ishin metodë e stil drejtimi, të ngjashme me atë të vendeve që luftonin për çlirimin nga fashizmi, por që ndikoheshin nga komunistët. Frymëzimi dhe shembulli për këtë sistem ishin marrë nga jugosllavët dhe rusët, pasi, siç pohon vetë E. Hoxha në një nga librat e tij të fundit, kishte rezultate të mira[19]. Ndërkohë, ky sistem bënte të mundur udhëheqjen politiko-partiake në të gjithë zinxhirin e forcave dhe të shtabeve të UNÇ-së, krahas drejtimit ushtarak të tyre.

Ky sistem, përveç anëve të forta organizative, të gërshetuara me një disiplinë mjaft të rreptë, bënte të mundshëm ruajtjen e kontrollit dhe njëherësh udhëheqjen dhe drejtimin politik, krahas atij ushtarak, në të gjitha nivelet e formacioneve luftarake të UNÇ-së. Pushteti i këtij sistemi, rritej e forcohej edhe me tej, po të mendohet se ky dublohej edhe me linjën partiake përmes organizmave të të gjitha niveleve të PKSH-së në UNÇ. Por, një dukuri e tillë, ku varësia ishte tipike partiake për sferën ushtarake të luftës dhe të forcave që e bënin atë, është mjaft i prekshëm, sidomos për fazën fillestare (ku ende nuk ka shtabe të kësaj madhësie) edhe tek Balli Kombëtar, kur njëlloj si tek PKSH-ja, Komitetet Qarkore të Partisë bënin drejtimin e forcave ushtarake në qarqet[20]. Kjo dukuri u vu re edhe tek Legaliteti, ku kryetari i kësaj force politike, A. Kupi, kryente edhe detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të saj Luftarake.

Nevoja e një organizimi drejtues të mirëfilltë ushtarak ishte ndier në të vërtetë qysh më parë, por çasti i përshtatshëm dhe mundësia për krijimin e tij u gjykuan vetëm në fillim të korrikut 1943. Por është po kaq e vërtetë se, ekzistenca e një presioni për krijimin e një shtabi të madh ishte bërë i pranishëm dhe i dukshëm me ndërhyrjet e të deleguarve ushtarakë jugosllavë, me Tempon në krye, në prag të krijimit të këtij shtabi. Sipas fragmenteve të polemikës mes E. Hoxhës dhe Svetozar Tempos, të riprodhuar në librin "Titistët", del se misionari jugosllav ngulte këmbë e madje imponoi krijimin e shtabeve të mëdhenj. Mirëpo e vërteta është se pas kësaj këmbëngulje dhe arrogance të të dërguarit jugosllav fshihej synimi për një shtab Ballkanik[21] apo ndërballkanik, i cili do të drejtonte me një ide të vetme të gjitha forcat dhe luftën Nacional Çlirimtare të popujve të Ballkanit. Natyrisht, në këtë rast Jugosllavia duhej të merrte rolin e dirigjentit ose të violinës së parë. Por kjo ide mbeti e parealizueshme në këto përmasa!

Në planin ushtarak, që ishte "fronti" kryesor i veprimtarisë së tij, Shtabi i Përgjithshëm, duke qenë organi më i lartë ushtarak për organizimin e kryengritjes së armatosur dhe të

[19] Hoxha. Enver, "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re", Sh. Botuese "8 Nëntori, Tiranë, 1984, fq. 142-143.
[20] "Organizatat tradhëtare, Balli Kombëtar e Legaliteti", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1950, f. 5
[21] Hoxha, Enver, "Titistët", Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982, fq. 46-47.

forcave luftarake të saj, kishte një numër të ngjeshur detyrash. Nëpërmjet Komandës dhe organeve përbërës të specializuar, ky shtab merrej me përpilimin dhe përpunimin e planeve strategjike dhe operative, me organizimin e forcave të armatosura, që nënkupton krijimin e Ushtrisë N.Çl.; me udhëheqjen dhe drejtimin operativo-strategjik të Luftës dhe të forcave e formacioneve luftarake, merrte vendimet më kryesore dhe më të përgjithshme të luftës, në përputhje me vijën politike të PKSH. Drejtimin operativo-strategjik të luftës dhe të forcave të UNÇ-së Shtabi i Përgjithshëm e realizonte përmes shtabit operativ, që ishte pjesë përbërëse e strukturës së tij organizative. Në vijim, nisur nga analiza e veprimtarisë së këtij shtabi, vihet re se ai, gjithmonë në planin e brendshëm ushtarak, ndihmoi fuqishëm që të përpunohej taktika tradicionale e luftës së popullit tonë, e cila, pas kësaj, u zhvillua e u zbatua e ndërthurur me elemente të taktikës së luftës moderne[22]. Shtabi, me elementet e tij përbërës mundësoi drejtimin e mirë të formacioneve partizane të deriatëhershëm dhe, me kalimin shkallë-shkallë në ato më të mëdha, duke e shtrirë këtë aktivitet deri në shkallën e lartë operative dhe strategjike, në planin politiko-ushtarak. Duke qenë organi më i lartë dhe i specializuar i drejtimit ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm, përmes komandës së tij, merrej me përpunimin e planeve operative dhe strategjike, merrte vendime për çështjet kryesore dhe më të përgjithshme të kryengritjes së armatosur. Imazhi i këtij shtabi, si një organ për drejtimin konkret operativo-strategjik të forcave luftarake të UNÇ-së, realizohej nëpërmjet shtabit operativ, që ishte pjesë kryesore përbërëse e tij.

Si përfundim, do të vlenin vetë shënimet e procesverbalit të mbledhjes së 4 korrikut 1943 të Labinotit, ku ndërmjet të tjerave shkruhet se Shtabi i Përgjithshëm ishte, "…një qendër organizative politike dhe operative e të gjitha fuqive të armatosura antifashiste"[23]. Por i tillë nuk u bë dot tërësisht sepse, nën drejtimin e tij nuk u vunë forcat e armatosura të Ballit Kombëtar (BK) dhe as ato të Legalitetit.

Në planin ndërkombëtar, Shtabi i Përgjithshëm pati një rëndësi të posaçme. Krijimi i tij ishte bërë i nevojshëm edhe për shkak të gjendjes ndërkombëtare, pasi Lufta Antifashiste ishte bërë tashmë pjesë përbërëse e vetë Luftës Antifashiste Botërore. Si e tillë, ajo nuk mund të bashkërendohej siç duhej me luftën që bënin shtetet dhe popujt e tjerë, anëtarë të Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, sidomos Anglia, BS dhe SHBA-ja, pa një shtab drejtues të përmasave kombëtare. Njëherësh, po ky shtab do të mundësonte dhe ndihmonte në krijimin dhe forcimin e një fronti ballkanik, luftën e popujve të tij kundër pushtuesve të përbashkët fashistë e nazistë.

Se sa e vërtetë është kjo, mund të ilustrohet me faktin e njohur mirë, se Lufta Antifashiste e popullit shqiptar u njoh dhe u propagandua edhe nga tre Aleatët e Mëdhenj Antifashistë, në dhjetor të vitit 1942*. Kjo përbën veçse një akt verbal. Më pas, ky akt do të mishërohej e do të bëhej i prekshëm dhe më konkret me ardhjen dhe veprimtarinë në Shqipëri të disa misioneve ushtarake anglo-amerikane[24] dhe, krejt në fund të luftës, edhe të një misioni të vogël sovjetik, i përbërë nga dy oficerë[25]. Po në këtë kuadër, përfshihet edhe vendosja e një delegacioni të përhershëm oficerësh shqiptarë të UNÇ, pranë Shtabit Aleat të Mesdheut,

[22] Gjoligaj, Valbona (2014). Developing a Sports Club Management Competency Model for Albania: A Delphi Study (dizertacion i doktoraturës i papublikuar). Capella University, Minnesota.

[23] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Kombinati poligrafik "Shtypshkronja e re", Tiranë, 1985, fq. 1060.

* AQSH- Procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm NÇ i dt. 4 korrik 1943.

[24] Lucas, P. "Misioni amerikan në Shqipëri", Sh. Botuese "Bota Shqiptare", Tiranë, 2008, fq. 12.

[25] Po aty, fq. 184.

me qendër në Bari të Italisë. Delegacioni përbëhej nga oficerë të lartë të UNÇSH-së, të kryesuar nga kolonel Bedri Spahiu.

Vendosja dhe njohja e delegacionit shqiptar ishte njëherësh edhe një afirmim zyrtar i kësaj lufte, një njohje e "dekretuar" e saj nga vetë aleatët.

Në aspektin organizativ ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm përbëhej nga disa hallka, ndër më të nevojshmet. Kështu, në skemën e dhënë nga Proklamata e KPANÇ, të 10 korrikut 1943, del se në majën e piramidës komanduese qëndronte Shtabi Operativ, që përfshinte Komandantin dhe Komisarin politik dhe tok me ta edhe dy specialistë ushtarakë të përzgjedhur prej tyre. Më poshtë Shtabi degëzohej në disa komisariate, si ai politik, ai ekonomik për furnizimin e ushtrisë; pastaj vinin seksioni i brendshëm dhe ai i shëndetësisë[26]. U krijua, si një degëzim me vete, edhe Shërbimi Qendror i Informacionit. Po kështu ,një hallkë të rëndësishme përbënte grupi i specialistëve ushtarakë, ku përfshiheshin specialistë për xhenion dhe ndërlidhjen. Për të ruajtur Shtabin u formua edhe një kompani e posaçme që thirrej kompania e sigurimit e Shtabit të Përgjithshëm.

Siç është shkruar edhe më lart, Shtabi i Përgjithshëm kishte 12 anëtarë, të cilët përbënin "kolegjiumin" apo "stafin" e tij, por sigurisht jo me karakter të përhershëm e jo rezidentë. Ndërkohë, në organizmat e tij bënin pjesë edhe mjaft specialistë ushtarakë për xhenion, ndërlidhjen, artilerinë, planëzimin e deri tek shkruesë, daktilografistë, ekonomatë, furnitorë, roje, etj., të cilët kishin detyrat e tyre përkatëse. Midis anëtarëve, një pjesë ishin njëkohësisht drejtues të formacioneve luftarake, si Myslim Peza, Dali Ndreu, Abaz Kupi, Bedri Spahiu, Mustafa Xhani (Baba Faja Martaneshi).

Lista e plotë e Shtabit të Përgjithshëm përmbante emrat e Spiro Moisiut-Komandant i Shtabit; Enver Hoxha-Komisar Politik; Dali Ndreu-zëvendëskomandant. Pastaj vijonin anëtarët: Abaz Kupi, Bedri Spahiu, Haxhi Lleshi, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ramadan Citaku, Mustafa Gjinishi, Sejfulla Malëshova dhe Ymer Dishnica[27].

Marrja e vendimit për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe përbërjen e tij, u bë përmes diskutimeve dhe paskëtaj u vendos.

Duke parë përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe gjendjen e politike të anëtarëve të tij, të bie në sy se në pikëpamje përkatësie politike, 5 vetë ishin atdhetarë nacionalistë si Myslim Peza, Mustafa Xhani, Abaz Kupi, Haxhi Lleshi dhe Spiro Moisiu, pjesa tjetër ishin anëtarë të PKSH-së, madje drejtues kryesorë të saj. Megjithëkëtë, ata të gjithë luftonin me të njëjtin motiv, nën të njëjtën parullë, kundër pushtuesit fashist e nazist, për çlirimin e Shqipërisë.

Komandanti dhe Komisari politik të Shtabit të Përgjithshëm përbënin së bashku Komandën Eprore të Ushtrisë Nacionalçlirimtare[28].

Me krijimin e këtij shtabi, Ushtria Nacionalçlirimtare dhe lufta e armatosur e popullit shqiptar po futej më me siguri në një etapë të re, më të lartë, në atë të kryengritjes së përgjithshme të armatosur. Në fokusin e këtyre detyrave, Shtabi i Përgjithshëm, nëpërmjet urdhrave, udhëzimeve, rregulloreve, të deleguarve pranë komandave vartëse etj., përcaktoi kriteret dhe masat konkrete të organizimit të formacioneve të veçanta dhe të ushtrisë në

[26] "Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm", vëll. I, cituar më parë, f. 10.
[27] Hoxha. Enver, "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re", Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1984, f. 271.
[28] "Historia e LANÇ-it të Popullit Shqiptar", vëll. II, Tiranë, 1986, f. 313.

tërësi, duke kaluar nga çetat e batalionet në brigada e, më pas, me rritjen cilësore të luftës dhe të organizimit ushtarak, krijimin e divizioneve dhe të korparmatave, si njësi operativo-strategjike; përcaktoi dhe përsosi organizimin, pajisjen dhe funksionimin e disa llojeve të shërbimeve si atë informativ, të ndërlidhjes, të xhenios, të prapavijës, artilerisë etj; pajisjen me armatim, municion, furnizimin me ushqim e veshmbathje të formacioneve partizane; organizimin e popullit të armatosur në formacionet vullnetare territorial, si forcë rezervë e në ndihmë të UNÇ; organizimin dhe drejtimin e pushtetit ushtarak të vendit (komandat e qarqeve, komandat e vendit, rojat partizane e ato vullnetare). Për secilën nga këto drejtime e detyra, Shtabi i Përgjithshëm përpunoi e shpërndau urdhra e udhëzime konkrete, duke siguruar edhe zbatimin e tyre.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së Shtabit ishte edhe përpunimi i teorisë dhe i formave konkrete të veprimeve luftarake të formacioneve vartëse në veçanti dhe të ushtrisë në tërësi. Mbështetur në parimet e luftës çlirimtare dhe përvojën e gjallë luftarake shumëshekullore të popullit tonë, në vartësi të etapave të zhvillimit të luftës dhe të vetë ushtrisë, Shtabi përcaktoi rregullat dhe kriteret e përqendrimit të forcave në kohën e vendin e duhur; rregullat në përcaktimin dhe zgjedhjen e drejtimit të goditjes kryesore, të bashkëveprimit ndërmjet formacioneve partizane dhe të këtyre të fundit me formacionet vullnetare territorial, që shtriheshin në të gjithë vendin; rregullat e përballimit të operacioneve mësymëse të armikut me forca superior në numër e cilësi. Në themel të taktikës partizane dhe të asaj me front të rregullt (kur u përdor) si dhe të përgatitjes luftarake, u vunë tiparet kryesore të taktikës partizane si shpejtësia, vrulli, shfrytëzimi i terrenit, i errësirës e motit, manovra, guximi, ruajtja e fshehtësisë së idesë dhe të forcave. Si metodë kryesore, për vetë kushtet e luftës dhe të ushtrisë më të vogël në numër, u vu metoda e asgjësimit të armikut pjesë-pjesë.

Gati një vit më pas nga koha e krijimit të SHP, në maj 1944, situata politiko-ushtarake në vend kishte ndryshuar së tepërmi. Këtej lindi edhe nevoja për përcaktimin e objektivave të reja e përfundimtare strategjike të luftës për çlirimin e vendit dhe kalimin e ushtrisë në një shkallë më të lartë organizimi, të aftë të përballonte detyrat e reja strategjike. Kjo u materializua me vendimet e Kongresit të Parë ANÇ që u mbajt në Përmet më 24 Maj 1944. U vendos që të kalohej në mësymje të përgjithshme strategjike për çlirimin e vendit, kalimin e ushtrisë nga ushtri vullnetare partizane në ushtri të rregullt (edhe në pamjen organizative, krahas brigadave do të krijoheshin edhe 8 divizione dhe 3 korparmata, si njësi operativo-strategjike[29] me rreth 70.000 partizanë); vendosjen e gradave në ushtri; krijimi i Komandës së Përgjithshme, si organ i unifikuar ushtarak. Komandant i përgjithshëm u zgjodh Gjeneral Kolonel Enver Hoxha dhe kryetar i SHP, gjeneral major Spiro Moisiu.

Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm e drejtuan me aftësi UNÇ në përmbushjen e misionit të saj strategjik për çlirimin e vendit. Madje, një pjesë e formacioneve partizane luftuan edhe për çlirimin e pjesës më të madhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve të shtetit amë. Duke plotësuar me dinjitet angazhimin e vet në kuadrin e Koalicionit të Madh Antifashist botëror, Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria shqiptare i ndoqën pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tij, që u tërhoqën me të, deri në Vishegrad (Bosnjën Jugore). Populli shqiptar, me ushtrinë e tij, të udhëhequr ushtarakisht me aftësi profesionale nga Shtabi i Përgjithshëm, e radhiti me dinjitet veten në anën e fitimtarëve, duke bërë

[29] Hasani. Prof. Dr. Proletar, "Histori e Pashkruar", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1999, fq. 59.

pluhur e hi edhe synimet grabitqare të shovinistëve fqinjë, të cilët shpresonin e punonin që Shqipëria të rradhitej me të mundurit dhe vendi ynë të kthehej në plaçkë tregu për lakmitë shoviniste. Kjo përbën edhe fitoren e meritën më të madhe të popullit tonë në këtë luftë dhe justifikon gjithë sakrificat e tij, duke e radhitur atë në radhët e para të popujve që kontribuuan më tepër në fitoren mbi fashizmin dhe nazizmin. Ndaj edhe brezi që bëri luftën meriton nderimin e brezave më të rinj. Parë në këtë kënd, loja që bëhet me datat historike, sikurse është edhe ajo e 10 korrikut, ditës së krijimit të ushtrisë dhe mënyra se si u bë, nuk ka qëllim të vendosë të vërtetat historike në vend, por thjesht të zbehë e të mohojë vlerat dhe rolin e Shtabit të Përgjithshëm dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pra të vetë luftës së popullit shqiptar. Dihet se UNÇ, pas çlirimit të vendit, në kushtet e reja politiko-shoqërore, u reduktua në sasinë numerike, u modernizua me të gjitha llojet e armëve dhe të forcave si dhe u pajis me armatim modern të kohës. Ajo nuk njohu asnjë ndërprerje, duke realizuar me sukses misionin e vet për mbrojtjen e Atdheut.

Dukuritë e drejtimit ushtarak në forcat e Ballit Kombëtar

Në sistemin organizativ të forcave ushtarake të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, ashtu si dhe në forcat e alternativave të tjera shqiptare gjatë procesit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri, një vend të rëndësishëm zuri drejtimi ushtarak i forcave përkatëse. Natyrisht, secila prej forcave kishte të veçantat, që i dallonin mes tyre, duke iu përshtatur përmasave, organizimit, shtrirjes dhe natyrës së veprimtarisë në zonat apo në trevat ku ato vepruan gjatë kohës së ekzistencës së tyre[30].

Menjëherë pas formimit, Balli Kombëtar krijoi organin drejtues politik qendror të tij, të emërtuar Komiteti Qendror. Është e kuptueshme që ky organ detyrë kryesore kishte, krahas të tjerave, drejtimin politik dhe shtrirjen e tij në të gjithë qarqet ku kishte ndikim dhe vepronte, përmes organizmave drejtuese vendore që ajo krijoi në to, komiteteve qarkore. Por në fillesat e tyre, në mungesë të një organi drejtues të mirëfilltë ushtarak, këto organizma politike duhet të luanin edhe rolin e këtij organi. Për këto arsye, ato u plotësuan me disa drejtues, të cilët u quajtën "të deleguar". Këta ishin përfaqësues të krahinave përbërëse të qarqeve e që u mbështetën në njohuritë e aftësitë organizative ushtarake të vetë anëtarëve të qarkorit përkatës.

Kështu, ndër anëtarët e shumtë të komiteteve qarkore, për shembull tek ai i Korçës, kishte 16 vetë[31], u zgjodhën ata "me përvojë në punë luftarake..."[32], të cilët u përpoqën me aftësitë e tyre profesionale të merrnin përsipër organizimin dhe drejtimin ushtarak të qarqeve e krahinave ku bënin pjesë. Pranë organizmave të tillë morën pjesë Jani Dilo, Gani Zëmblaku në qarkun e Korçës[33], Hysni Lepenica e Skënder Muço në atë të Vlorës[34]; kolonel Nexho Bejleri e Ismail Golemi në qarkun e Gjirokastrës, Faik Quku në qarkun e Shkodrës[35] etj. Me gjithë pjesëmarrjen e tyre në këto organizma, drejtimi ushtarak nuk u ngrit dot në nivelin e duhur profesional ushtarak, pasi ende ai dominohej nga elementë

[30] Gjoligaj, Valbona, Po aty.
[31] "LANÇ në qarkun e Korçës", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1986, fq. 197.
[32] Po aty, f. 358.
[33] "LANÇ në qarkun e Korçës", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1986, fq. 197.
[34] Quku. Faik, "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", Sh. Botuese "Ilar", Tiranë, 2006, fq. 155.
[35] Quku. Faik, Po aty, fq. 152.

dhe dukuri të një drejtimi politik. Ky, zakonisht ushtrohej përmes sekretarit të organizatës së qarkorit, i cili për të gjithë problemet, përfshi dhe atë ushtarak, lidhej "... direkt me Sekretarin e Përgjithshëm..."[36] të Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar. Këtë dukuri të evidentuar deri më tash, e bëjnë më të qartë disa dokumente që pasqyrojnë aktivitetin organizativ-politik të Organizatës së Ballit Kombëtar. Kështu, në "Udhëzimet e Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar, dërguar komiteteve krahinore", të datës 15 gusht 1943, përfaqësuesit politik të niveleve të ndryshme merrnin përsipër edhe drejtimin ushtarak. Pra, linja politike, e cila bënte drejtimin e përgjithshëm të organizatës, ishte e pranishme në të tri nivelet e saj. Në krye ndodhej Sekretari i Përgjithshëm, nga i cili vareshin ai i qarkut dhe sekretari i vatrës*. Kjo e fundit fare pak u formua si nivel më vete. Të dy nivelet e fundit, jo vetëm kishin varësi nga Sekretari i Përgjithshëm, por, krahas të tjerash, përpiqeshin të bënin edhe drejtimin ushtarak në nivelet përkatëse të tyre, sidomos në fazën e parë, por edhe në fillimet e asaj të dytë[37]. Një dukuri e tillë ngjante me atë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Përfaqësuesit e qarqeve, anëtarë të Komitetit Qendror, nuk arritën të organizonin struktura të qarta organizative e funksionale të këtyre komiteteve qarkore, ndonëse skeletet e tyre u ngritën. Ato nuk kishin detyra të përcaktuara saktësisht. Komiteti qarkor funksiononte kur komiteti krahinor që ndodhej në qendër të prefekturës thërriste në mbledhje edhe komitetet e nënprefekturave që ishin në përbërje të saj[38]. Kjo mbledhje bëhej kur kryetari i komitetit krahinor, ku përfshihej qendra e prefekturës, e shikonte të arsyeshme atë. Komiteti krahinor me qendër në qytetin kryesor të prefekturës merrte rol drejtues jo vetëm nga rëndësia administrative e saj, por edhe nga përbërja intelektuale e organizuese që drejtuesit e këtyre organizmave përpiqeshin t'i jepnin vetes.

Brenda çdo komiteti qarkor u krijua "...seksioni ushtarak, i propagandës, i financës e i gjyqit..."[39]. Si rregull, në krye të çdo seksioni qëndronte një anëtar i komitetit qarkor. Përtej këtyre organeve drejtuese, organizimi politiko-ushtarak ishte i paqartë, për rrjedhojë edhe drejtimi ushtarak nuk u zhvillua sipas një plani të detajuar me mendim të qartë, racional e rezultativ (efektiv). Kështu formimi i formacioneve të para balliste u orientua nga politika dhe u realizua falë aftësive organizative të nacionalistëve të veçuar, më në zë të qarqeve. Këto detyra u përcaktuan vetëm në shkurt 1944, kur Komiteti Qendror dërgoi me shkrim "Detyrat e kompetencat e komiteteve krahinore". Kuptohet, që vonesa kohore e qartësimit dhe e ndarjes së këtyre detyrave, pati ndikimin e vet negativ edhe në drejtimin ushtarak, si dhe vijimin e tij evaziv. Organizata e Ballit Kombëtar, drejtimin ushtarak, u përpoq ta organizonte me anë të komiteteve qarkore, nëpërmjet seksioneve ushtarake, këshillave krahinore* si dhe atë operativ deri diku me komandën e Zonës së Jugut.

Krijimi i Komisionit Ushtarak

Në verën dhe në vjeshtën e vitit 1943, në teatrin evropian të luftës ndodhën përmbysje të gjendjes politiko-ushtarake. Një nga anëtarët e Boshtit, Italia fashiste, kapitulloi. Ngjarje

[36] "Organizatat tradhëtare, Balli Kombëtar e Legaliteti", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1950, fq. 14.

* Vatra, quhej elementi fillestar i organizimit politik të Organizatës së Ballit Kombëtar.

[37] Faza I, nëntor 1942-shtator 1943, u formuan komitetet qarkore, këshillat krahinore e çetat balliste. Faza II, tetor 1943-shtator i 1944-ës, u formuan batalione e dy grupe vullnetare deri në shpërbërjen e tyre.

[38] AQSH, F.1056, dosja 3, fl. 12, "Detyrat e kompetencat e komiteteve krahinore", dt. 21 shkurt 1944.

[39] Lama. Faik, "Demaskimi dhe shpartallimi i organizatave tradhtare të B.Kombëtar e Legalitetit", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1985. fq. 141.

të tilla, si sulmi e pushtimi i Siçilisë dhe rënia e Musolinit, nuk kaluan pa ndikimin e tyre në luftën e armatosur kundër okupatorit edhe në Shqipëri. Këto ngjarje dhe krijimi, rritja dhe forcimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, si dhe domosdoshmëria e një drejtimi të përgjithshëm në shkallë vendi e formacioneve ushtarake balliste, bëri të nevojshëm formimin e një organi drejtues strategjik, i cili do të merrte përsipër drejtimin ushtarak profesional të të gjitha formacioneve balliste. Me formimin e këtij niveli, drejtimi kompletohej, sipas gjykimit të drejtuesve të Ballit Kombëtar, e gjithë piramida e drejtimit ushtarak nga lart-poshtë e forcave të Ballit Kombëtar.

Në hullinë e ndryshimeve përcaktuese dolën "Udhëzimet e Komitetit Qendror, dërguar komiteteve krahinore"[40], që përcaktuan, ndër të tjera, detyrat dhe strukturat politiko-ushtarake qendrore, por edhe ato që orientoheshin se ishin shtrirë, kryesisht në ata qarqe, ku kjo organizatë kishte ndikim. Duke pretenduar se ngritja e qarkorëve u bë pothuajse pas formimit të Ballit Kombëtar në harkun prej tetë muajsh të jetës së këtyre organizmave, deri në daljen e këtyre "udhëzimeve", më 15 gusht 1943, mund të konkludohet se drejtimi ushtarak, në tërësi, është bërë evaziv dhe joracional. Në vijim të këtyre "udhëzimeve", për herë të parë bëhej përpjekje për ndarjen e drejtimit ushtarak nga ai politik, që ky i fundit të mos bënte më edhe komandimin ushtarak. Tashmë, sipas këtij dokumenti, në përbërje të Këshillit Veprues (pjesë e Komitetit Qendror), që zgjidhej me anën e përfaqësuesve të deleguar nga qarkorët dhe nga çetat e krahinave, u ngrit edhe "Komisioni Ushtarak".

Çfarë përfaqësonte Komisioni Ushtarak? Ai në vetvete përfshinte një grup ushtarakësh, rreth 4-5 vetë, të cilët bënë përpjekjet e para që, përmes profesionalizmit ushtarak, mundësisht të kryenin e të ndanin drejtimin ushtarak nga ai politik. Me atributet e organizimit kryesor të drejtimit të mirëfilltë ushtarak, detyra parësore e tij ishte ajo e organizimit të atyre që ata i emërtuan "forca ushtarake të Lirisë Kombëtare", duke caktuar ndërkohë edhe "strategjinë ushtarake dhe taktikën e përshtatshme". Formacioni i çetës, që tashmë ishte kristalizuar, u përcaktua si "baza e fuqisë luftarake". Ajo ishte "organ ekzekutiv i gjithë organizatës, qoftë kundër okupatorit, qoftë për mbrojtjen e qetësisë".

Megjithë përpjekjet për realizimin e misionit që ky Komision Ushtarak merrte përsipër, ai mbeti vetëm brenda caqeve të përcaktimeve teorike të termave të mësipërme. Si "vatër" e debatit dhe e përcaktimeve teorike për drejtimin ushtarak të forcave ushtarake balliste, Komisioni Ushtarak nuk arriti të përcaktonte një strategji dhe taktikë ushtarake të efektshme, të përshtatshme për luftë. Këto mangësi dhe zhvillimet e paqarta drejt përsosjes cilësore të drejtimit ushtarak të formacioneve balliste të ndryshme, penguan deri në venitjen e misionit, të cilën kjo forcë shpalli se merrte përsipër.

Përpjekje për formimin e hallkave të larta të drejtimit

Duke kthyer sytë në historinë e periudhës para dhe pas formimit të Shtetit Shqiptar, nëpërmjet kujtimeve të shkruara të Eqerem bej Vlorës, që, me përcaktimet e tij sentimentale, të bëra jo me aq qetësi shpirtërore apo me diplomaci "shkencore", shprehet se: "Shqiptari ka prapa një traditë mijëravjeçare kapadaillëku dhe dhunë; populli nuk u këndon mendjelartëve, shpirtmirëve, zemërdhembshurve, por mburr hakmarrësin, trimin, të pamëshirshmin, të dhunshmin dhe intrigantin[41]", duke vijuar më pas me natyrën e

[*] Ishin organe që u përpoqën të realizonin drejtimin ushtarak të 10-15 fshatra të një krahine.

[40] AQSH, fondi 270, dosja 1, fl. 1, dt. 15 gusht 1943.

[41] "Eqerem bej Vlora", kujtime, Sh. Botuese e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2002, fq. 44.

shqiptarit, e cila nuk e duron as "disiplinën mendore, as atë fizike, po as rregullin"[42] dhe, duke vijuar më poshtë me rëndësinë, që "kush e quan veten dikush, duhet t'u imponohet të tjerëve, duhet të mbahet rëndë, të shquhet për sjellje autoritare, por njëherësh atëroro-patriarkale", të cilat për mua fatkeqësisht janë ende aktuale. Me sa duket, të tilla përcaktime të karakterit shqiptar kanë ndikuar ndjeshëm, kryesisht në organizimin politik, por sidomos atë ushtarak apo luftarak të anëtarëve të kësaj Organizate që, në përbërjen e saj, ekzistonte kundërshtia midis brezit të vjetër të udhëheqësve politikë me të rinjtë aktivë edhe ndoshta pro veprimeve luftarake kundër pushtuesve.

Pas plotësimeve të bëra në nivelet e ndryshme të organeve të drejtimit dhe, krahas tyre, edhe për përmirësimin e organizimit të formacioneve balliste, një nevojë e dorës së parë mbetej krijimi i hallkave të larta drejtuese, të nivelit strategjik e operativ, të cilat do të merrnin përsipër drejtimin ushtarak cilësor e profesional të tyre.

Megjithëse formimi i "Komandës së Përgjithshme Luftarake", organ i domosdoshëm i lartë organizimi e drejtimi, përmendet në librat, "Organizatat tradhtare, Balli Kombëtar e Legaliteti" dhe "Demaskimi e shpartallimi i organizatave tradhtare gjatë LANÇ", që i referohet të parit, nuk është gjetur ende asnjë dokument arkivor autentik, qoftë dhe i vetëm, që të pohojë e të provojë këtë fakt. Parë në këtë aspekt, mbetet e errët dhe e paqartë ekzistenca e këtij organi qendror, të domosdoshëm për drejtimin e përgjithshëm ushtarak të forcave luftarake. Gjithsesi, në përpjekjet e ndryshme për formimin e këtij shtabi, ku kandidatë për drejtimin e tij ishin Hysni Lepenica dhe Abaz Ermenji, qenë të pranishme rreth muajve maj-qershor 1943. Në Frashër të Përmetit, u zhvillua një mbledhje mes kryetarëve të çetave të Kolonjës, Safet Butka, Tomoricës, Abaz Ermenji, të Dangëllisë, Veli Zlehusha dhe Faslli Frashëri, ku u vendos domosdoshmëria për një "Shtab të përbashkët të këtyne tri zonave"[43]. Por nuk u arrit që ky organ i nevojshëm të formohej, sepse nuk u arrit në konsensus për emrin e drejtuesit të këtij organi.

Duke iu referuar botimeve të ndryshme, në të cilët përmendet formimi i "dy komanda-zonash, Jug e Veri …."[44] kam arritur të konkludoj se janë bërë disa përpjekje për të krijuar hallka drejtimi, që mund të quhen të shkallës operative. Po çfarë përfaqësonin në vetvete zonat, në pikëpamje drejtimi?

Ato ishin njësi gjeografike, të Veriut dhe të Jugut të vendit, të cilat përfshinin të gjitha ndarjet administrative brenda kufijve të tyre. Për formimin e "Komandë-zonës së Veriut" u bënë përpjekje, të cilat nuk e kaluan kufirin e një mbledhjeje, të asaj të Lurës, në datat 28-29 gusht 1943, duke "zgjedhur 9 persona për çdo krahinë..."[45]. Por, duke mos patur aktivitete konkrete, formimi i kësaj Komande ngeli vetëm në kuadrin teorik edhe për faktin se tri krahinat (Dibra, Mati, Luma), krerët e të cilave morën pjesë në mbledhje, ishin bajraqe, ku nuk kishte ndikim kjo forcë politike.

E emërtuar me termin "Komanda e Zonës së Jugut", si hallkë komandimi, ajo duhet të kishte më tepër atributet e drejtimit dhe të organizimit të formacioneve ushtarake balliste, që ushtruan aktivitetin e tyre në qarqet jugore të vendit. Qendra e saj u vendos në Berat.

[42] Po aty, fq. 301.
[43] Po aty, fq. 156.
[44] "Organizatat tradhëtare B.Kombëtar e Legaliteti", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1950, fq. 36.
[45] AQSH, fondi 270, dosja 17, fl. 3, "Qarkore e Komitetit Qëndror të B. Kombëtar dërguar komiteteve qarkore", dt. 30 gusht 1943.

Në përbërje të saj bënin pjesë "...komandat e Elbasanit, të Korçës, Gjirokastrës, Beratit dhe Vlorës"[46]. Në organizimin e brendshëm të saj, me përjashtim të "...kryetarit e zëvendëskryetarit...", të dhëna konkrete përmbi numrin dhe detyrat që mbulonte e zgjidhte, nuk gjenden të pasqyruara në ndonjë dokument të shkruar arkivor apo të botuar, duke mos e ndriçuar sa e si duhet këtë hallkë, me rëndësi për drejtimin ushtarak. Për ekzistencën e kësaj komande bën fjalë edhe dalja e shpalljes me rastin e vrasjes së Hysni Lepenicës, e cila e përcaktonte atë si "komandant i përgjithshëm i fuqive të Ballit Kombëtar për pesë prefekturat e Jugut"[47]. Pas emërtimit të fillimit, "Komanda e Zonës së Jugut", ajo mori emrin "Komandë e Grupit të Vullnetarëve të Jugut"[48] e më pas u quajt "Komanda e Përgjithshme e Operacioneve të Jugut"[49] ose dhe "Komanda e Fuqive Vullnetare të Jugut"[50].

Të gjitha këto organizma apo hallka, synonin dhe përbënin në fakt sistemin e drejtimit të forcave luftarake të Ballit Kombëtar. Ndonëse u përpoqën të viheshin në veprim për të realizuar drejtimin tërësor e të pjesshëm të forcave, ato vuanin nga paqartësi organizative dhe e përcaktimit të detyrave që duhej të kryenin. Mangësitë e mësipërme çuan në rënien cilësore të drejtimit dhe ndikuan ndjeshëm e negativisht në veprimet luftarake të forcave të Ballit Kombëtar në fushën e luftimit.

Organizata e Legalitetit

Në aspektin politik, kjo organizatë, me struktura të paqarta politiko- ushtarake, tentoi që të merrte vlerat e dikurshme, si pasardhëse e Mbretit Zog, në teatrin luftarak të vendit. Me gjithë përpjekjet e shumta të komandantit të forcave të Legalitetit, major Abaz Kupi, së bashku me paritë lokale, për të arritur një rezultat të tillë, ato nuk patën sukses. Në të ndikoi ndjeshëm qëllimi strategjik i kësaj organizate që kishte pak mbështetje brenda vendit[51]. Për rrjedhojë, kjo u pasqyrua edhe në aspektin organizativ të forcave ushtarake të Legalitetit, që nuk u bënë dot, sipas Hibertit, një faktor ushtarak[52].

Nën udhëheqjen e A.Kupit, krerët kryesorë të këtij grupimi politik, duke bashkëvepruar me paritë lokale, shtuan përpjekjet për formimin e çetave, të cilat, duke përfshirë forca e armatime të grupuara, do të ishin në gjendje për kryerjen e veprimeve luftarake të mirëfillta. Meqënëse një pjesë e madhe e oficerëve ishin pasonjës të këtij grupimi politik, në shumë çeta u bënë ata drejtues të këtij niveli formacioni. Këtë fakt e pohon edhe vet Komandanti i Përgjithshëm i forcave Nacionaliste, major Abaz Kupi, i cili në gazetën "Atdheu" shkruante se "... ndër ato çeta marrin pjesë qindra oficerë të ushtrisë e gjindarmërisë kombëtare..."[53]. Po të njëjtën gjë vinte në dukje edhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare në një raport, ku krahas të tjerave thuhej: "...Megjithëse ka mjaft oficerë, organizimi ushtarak i tyre është krejt si i Ballit Kombëtar..."[54]. Kështu

[46] Lama. Faik, "Demaskimi dhe shpartallimi i organizatave tradhtare të B.Kombëtar e Legalitetit", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1985, fq.145.
[47] AQU, fondi 270(Organizata tradhëtare e Ballit Kombëtar), dosja 7, fl. 19, dt. tetor 1943.
[48] AQSH, fondi 260, dosja 31, fl. 48, dt. 12 maj 1944.
[49] AQSH, fondi 260, dosja 31, fl. 48, dt 12 maj 1944.
[50] AQSH, fondi 270, dosja 57, fl. 3, dt. 27 maj 1944.
[51] Barker. Elisabet, "Shqipëria, Britania dhe rezistenca", dok nr. 177, Beristol 1976, ndodhet pranë Akademisë së Mbrojtjes.
[52] Hibert. Rixhinald, "Fitorja e hidhur", (Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë), Sh. Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë 1991, fq. 228.
[53] Gazeta "Atdheu", Nr.6, dt. 15 janar 1944.
[54] AQSH, fondi 41, dosja 156, fl. 8

krahas major Abaz Kupit e kapiten Xhemal Herrit[55] në krye të çetave u vunë edhe kapiten Ndue Pali[56], major Hamza Drini, kapiten Rifat Tërshana[57], kapiten Brahim Farka[58]etj.

Në të gjithë harkun kohor të aktivitetit të Legalitetit, të pasqyruar në dokumentacionin e kohës, nuk gjenden ose të paktën nuk janë hasur ende orientime mbi organizimin e çetave legaliste, qoftë edhe ato personale, nga Abaz Kupi e jo më nga ndonjë organ qendror. Për rrjedhojë, këto çeta u mbushën me anëtarë mbi bazën e njohjes, krushqive, dhënies së besës ose të fjalës nga ana e kryetarit të fisit etj. Përpjekjet kryesore për forcimin e çetave të tjera u bënë kryesisht në ato zona ku ndikimi i Legalitetit ishte më i ndjeshëm e, sidomos tek fshatarët e këtyre zonave, ku popullsia ishte më e madhe. Përveç "... çetës së Abaz Kupit..."[59], asaj të ish - kapitenit Xhemal Herri[60], çetës së Jubës me kryetar Hilmi Xhaka[61], të organizuar qysh para formimit të vetë Organizatës së Legalitetit, u shtuan edhe formacione të tjerë të këtij niveli, gjithnjë brendapërbrenda këtyre zonave të Shqipërisë së Mesme, ku ky grupim politiko -ushtarak ushtronte ndikimin më të madh.

Në aspektin ushtarak, ky proces, sikundër edhe tek Balli Kombëtar, u shoqërua me shumë paqartësi jo vetëm në aspektin procedurial, organizativ, por edhe në atë dokumentar. Kështu, për njohjen e aktivitetit të formimit të çetave zogiste, u pa e nevojshme që të shfrytëzoheshin deri në detaje të dhënat dokumentare që, në pamjen e parë, ishin krejt të parëndësishme. Njëkohësisht, duke i ballafaquar ato me botime të ndryshme historiografike, u bënë përpjekje për të ndriçuar diçka nga e vërteta, të cilën e kishin mbuluar hijet e labirintheve të historisë.

Veçoritë e drejtimit në Forcat e Legalitetit

Drejtimi ushtarak në forcat luftarake legaliste, deri në kohën e formimit të grupimit politik të Legalitetit, kishte një farë tradite, e cila rridhte kryesisht nga prejardhja dhe formimi ushtarak i drejtuesve kryesorë e të formacioneve të ndryshme, si dhe vendndodhja ose qarkullimi i tyre brendapërbrenda kufijve hapësinorë relativisht të vegjël ku shtrihej ndikimi i tyre. Nga dokumentacioni arkivor ekzistues, si dhe nga literatura e botuar, rezulton se drejtimi në forcat e armatosura të Legalitetit, kur kjo organizatë ende nuk ishte krijuar, ishte i thjeshtë e tradicional. Në krye drejtonte major Abaz Kupi, i cili, veç pjesëmarrjes në Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, gëzonte dhe atributet e drejtuesit të formacioneve luftarake legaliste të formuara deri atëherë. Drejtimin ushtarak të tyre ai e organizonte përmes lidhjeve, takimeve e kontaktit fizik të drejtpërdrejtë me komandantët e çetave, shumica e të cilëve kishin qenë oficerë karriere, si major Hamza Drini, kapiten Refat Tërshana[62], kapiten Ndue Pali[63], kapiten Xhemal Herri, kapiten Brahim Farka[64], etj. Përveç këtij niveli drejtimi, në këtë kohë nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e ndonjë hallke apo sistemi të veçantë e të qendërzuar, të organizuar për drejtimin e formacioneve ekzistuese legaliste.

[55] AQSH, fondi 25, dosja 5/3, fq. 57.
[56] Smajlli. Devid, "Me detyrë në Shqipëri", Sh. Botuese e Lidhje së Shkrimtarëve, Tiranë 1993, fq. 94.
[57] Po aty, fq. 120.
[58] AQSH, fondi 253, dosja 513, fl. 57, dt. 24 gusht 1943.
[59] Hoxha. Enver, Vepra, vëll. 1, botim i dytë, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1983, fq. 258.
[60] AQSH, fondi 253, dosja 513, fl. 57, dt. 24 gusht 1943.
[61] Historiku i LANÇ-it të ish-qarkut të Durrësit, Maket pranë Akademisë së Mbrojtjes, fq. 568.
[62] Smajlli. Devid, "Me detyrë në Shqipëri", Sh. Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1994, fq. 120.
[63] AQSH, fondi $270/_{1}$, dosja 5, fl. 21, dt. 1 tetor 1944.
[64] AQSH, fondi 253. dosja $5/_{3}$, fl. 57, dt.24 gusht 1943.

Largimi i Abaz Kupit nga Fronti Antifashist Nacionalçlirimtare dhe nga Shtabi Përgjithshëm i UNÇ-së u shoqërua me ndryshime raportesh politike dhe me formimin e një grupimi politik të ri me emrin Legaliteti, në jetën politike shqiptare të viteve dyzet të Shekullit XX. E formuar në praninë edhe të një përfaqësuesi të "... misioneve ushtarake angleze..."[65], më 21 nëntor 1943 në Zall Herr, me kryetar majorin Abaz Kupi, kjo organizatë politike u përkiste përkrahësve të ish-mbretit Zog i Parë. "Kryesia e përkohshme"[66], që u zgjodh, mori përsipër shtrirjen e ndikimit të "Lëvizjes së Legalitetit" nëpërmjet veprimtarisë së zogistëve, "...parisë së të gjitha rangjeve..."[67] dhe njerëzve me ndikim në krahina e fshatra. Të gjitha këto përpjekje gjetën, deri diku, mbështetje në një hapësirë mjaft të kufizuar në krahasim me ato të grupeve të tjera politike.

Në qoftë se bëjmë një krahasim midis niveleve të drejtimit, parë në të gjithë spektrin e tij, midis dy grupimeve, të Ballit Kombëtar e Legalitetit, dallojmë se ky element përbën një nga veçoritë e Legalitetit, që e ndan atë me Ballin Kombëtar. Drejtimi tek Balli Kombëtar u tentua të realizohej nga njerëz më të zotë, të lauruar madje edhe me grada shkencore e me një kulturë intelektuale, pak a shumë të kompletuar dhe të admirueshëm, por gjithsesi, jo aktivë në aspektin luftarak. Kurse drejtimi i Legalitetit, që vepronte si rregull në mal, bëhej nga njerëz jo me këtë nivel intelektual e kulturor, anëtarë parish, bajraktarë e kryetarë fisesh me mentalitete të drejtimit të gjithçkaje nga ata, por, në përgjithësi, pa nivel profesional dhe disi të papërshtatshëm për të marrë vendime sa më kolegjiale për këtë nivel drejtimi, të cilët,, për interesa personale nga më të ndryshmet, mund ta braktisnin Legalitetin menjëherë. Për rrjedhojë, niveli i drejtimit tek Legaliteti, përfshi edhe atë ushtarak, ishte nën nivelin e atij të Ballit Kombëtar.

Sipas dokumenteve arkivore, struktura organizative e Legalitetit kishte një ndërthurje të asaj politike me atë ushtarake, pa raporte të qarta varësie dhe udhëheqjeje midis njëra-tjetrës. Përkundrazi, ato ishin të pleksura njëra me tjetrën dhe të përqendruara në një dorë të vetme. Kështu, mund të thuhet se drejtimi ushtarak ndikohej dhe ishte nën atë politik, edhe në këto forca. Domethënës për këtë ishte zgjedhja e kreut të saj, majorit Abaz Kupi, i cili u ngarkua të kryente dy funksione njëherësh, të Kryetarit të partisë dhe atë të "Kryekomandantit të Përgjithshëm të Fuqive të Armatosura të Lëvizjes Kombëtare të Legalitetit". Kjo dukuri spikat në sferën e lartë të drejtimit, kurse në sferat më të ulta ushtarake nuk jepet ndonjë rast i ndonjë drejtuesi ose përfaqësuesi politik në krye të ndonjë formacioni ushtarak ose dhe mbi këtë nivel.

Përpjekjet për formimin e shtabit ushtarak

Në dimrin e rëndë të vitit 1943-1944, kur forcat ushtarake të Legalitetit ishin shtuar dhe "...ishin në kulmin e forcës..."[68], u bë e nevojshme të formohej një hallkë e re drejtimi më profesionale, e cila do të qëndronte mbi nivelin e deriatëhershëm të drejtimit ushtarak. Kjo strukturë drejtuese e nivelit strategjik do të organizonte drejtimin dhe bashkëpunimin e gjithë forcave legaliste në një nivel më të lartë ushtarak. Për formimin e kësaj hallke drejtuese shkruhet në literaturën e botuar deri më sot, por veçanërisht në një dokument arkivor ku është përmendur në krye të tij "Shtabi i Përgjithshëm i Forcave Nacionale"

[65] Hoxha. Enver, Vepra, vëll. 5, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1970, fq. 301.
[66] Lleshi. Haxhi, "Vite, njerëz, ngjarje", Tiranë, 1996, fq. 161.
[67] AQSH, fondi 1056, dosja 1, fl. 47-48, dt. 8 nëntor 1943 e 4 dhjetor 1943.
[68] Hoxha. Enver, Vepra, vëll. 2, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982. f. 580.

dhe është firmosur nga Abaz Kupi me atributet e "Komandantit të Përgjithshëm të Forcave nacionaliste". Ndërkohë, nuk gjendet asnjë dokument tjetër që të sqarojë e përcaktojë datën e saktë të formimit, pjesëmarrësit në këtë mbledhje, si dhe strategjinë e taktikat që do të ndiqte ky "shtab" gjatë luftës etj. Megjithatë, një dokument i datuar më 12 shtator 1944, ku shkruhet për " krijimin e një Shtabi të Përgjithshëm të Forcave Luftarake Nacionaliste"[69], lë shteg për një kuptim të dyfishtë. Dokumenti nuk përcakton se për çfarë krijohet ky shtab dhe përse në atë kohë. Gjithsesi, ai dëshmon se në krye të këtij "shtabi", që kishte përmasa modeste dhe vetëm në emërtim ngjante i tillë, u emërua me detyrën "shef i shtabit të forcave zogiste"[70] major e më pas kolonel Jahja Çaçi. Ky shtab përbëhej nga tre ish-majorë të xhandarmërisë, Murat Basha, Kurt Haliti e Xhafer Shkëmbi[71], si dhe prej një ish-majori e një kapiteni të këmbësorisë.

Ndërkohë, nuk gjendet asnjë dokument tjetër që të bëjë të njohur ndarjen dhe raportet e vartësisë brendapërbrenda, si dhe ndarjet e detyrat specifike të secilit anëtar të shtabit. Detyra e këtij organi drejtimi ishte organizimi i fuqive luftarake që mund të nxirrte çdo pari brenda juriduksionit të aktivitetit të këtij grupimi politik, rreshtimi i tyre nëpër formacione ushtarake, si dhe drejtimi e bashkërendimi i tyre në veprime luftarake. Shtabi i forcave zogiste ishte rezident në të shumtën e kohës në fshatin Shupal të rrethit të Tiranës. Ai ishte i vendosur në një grumbull shtëpish, që ndodheshin në rrafshnaltën midis Malit të Dajtit e Bastarit, duke siguruar në një farë mënyre një pozitë të fortë në vetvete, por dhe sheshpamje të plotë.

Pranë këtij shtabi mbahej një çetë me rreth 150 vetë, e cila kishte detyra ruajtje, ndërlidhje për këtë hallkë drejtimi të rëndësishme të forcave zogiste. Por, në dokumentet e njohura dhe të botuara deri më sot, jo vetëm nuk mund të provohet asgjë për aktivitetin drejtues ushtarak të këtij shtabi, përmes planeve ushtarake konkrete, por, si të thuash, ky organ drejtues ishte demoralizuar nga një inaktivitet i gjatë.

Në vijim të masave të tjera plotësuese nga Komandanti i Përgjithshëm i Fuqive të Armatosura të Lëvizjes Kombëtare të Legalitetit, major Abaz Kupi, lëshoi një "Urdhër mobilizimi i përgjithshëm"[72]. Në të përcaktoheshin qendrat e mobilizimit, në Prezë dhe në Shijak. Por zhvillimi dhe evoluimi i shpejtë i ngjarjeve dhe i veprimeve luftarake të kryera nga ana e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, pas shtator-tetorit 1944, kur ajo ishte rritur shumë në përmasa e në formacione, si dhe duke qënë se ajo kishte çliruar shumë krahina të vendit, duke ia ngushtuar mjaft zonën e veprimit forcave të Legalitetit, çuan në largimin e Abaz Kupit nga Shqipëria. Kështu, nuk u arritën rezultatet e shpresuara nga ky mobilizim.

Në përfundim mund të thuhet se Forcat e Armatosura të Legalitetit, brenda harkut kohor të shkurtër, nga formimi deri në shpërbërjen e tyre, nuk mundën të përvijonin e të kristalizonin dot sa e si duhej organet e drejtimit ushtarak të formacioneve ushtarake të tyre, ndonëse në përbërje të saj kishte shumë ish-oficerë të karrierës. Ato mbeten në një fazë të thjeshtë e tepër të zbehtë edhe në drejtim.

[69] AQSH, fondi 1056, dosja 1, fl. 62, dt. 12 shtator 1944.
[70] Po aty.
[71] Lleshi. Haxhi, vepër e cituar, f. 275.
[72] AQSH, fondi 1056, dosja 43, dt, 28 shtator 1944.

Përfundime

Shtabi i Përgjithshëm pati një rëndësi të posaçme. Krijimi i tij ishte bërë i nevojshëm edhe për shkak të gjendjes ndërkombëtare, pasi Lufta Antifashiste ishte bërë tashmë pjesë përbërëse e vetë Luftës Antifashiste Botërore. Si e tillë, ajo nuk mund të bashkërendohej siç duhej me luftën që bënin shtetet dhe popujt e tjerë, anëtarë të Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, sidomos Anglia, BS dhe SHBA-ja, pa një shtab drejtues në përmasa kombëtare. Njëherësh, po ky shtab do të mundësonte dhe ndihmonte në krijimin dhe forcimin e një fronti ballkanik, luftën e popujve të tij kundër pushtuesve të përbashkët fashistë e nazistë.

Me krijimin e këtij shtabi, Ushtria Nacionalçlirimtare dhe lufta e armatosur e popullit shqiptar po futej më me siguri në një etapë të re, më të lartë, në atë të kryengritjes së përgjithshme të armatosur.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së Shtabit ishte edhe përpunimi i teorisë dhe i formave konkrete të veprimeve luftarake të formacioneve vartëse në veçanti dhe të ushtrisë në tërësi. Mbështetur në parimet e luftës çlirimtare dhe përvojën e gjallë luftarake shumëshekullore të popullit tonë, në vartësi të etapave të zhvillimit të luftës dhe të vetë ushtrisë, Shtabi përcaktoi: rregullat dhe kriteret e përqendrimit të forcave në kohën e vendin e duhur, zgjedhjen e drejtimit të goditjes kryesore, rregullat e bashkëveprimit ndërmjet formacioneve partizane dhe të këtyre të fundit me formacionet vullnetare territorial, që shtriheshin në të gjithë vendin, por edhe ato të përballimit të operacioneve mësymëse të armikut me forca superiore.

Të gjitha këto organizma apo hallka synonin dhe përbënin në fakt sistemin e drejtimit të forcave luftarake edhe të Ballit Kombëtar. Ndonëse u përpoqën të viheshin në veprim për të realizuar drejtimin tërësor e të pjesshëm të forcave, ato vuanin nga paqartësi organizative dhe të përcaktimit të detyrave që duhet të kryenin. Mangësitë e mësipërme çuan në rënien cilësore të drejtimit dhe ndikuan ndjeshëm e negativisht në veprimet luftarake të forcave të Ballit Kombëtar në fushën e luftimit.

Forcat e Armatosura të Legalitetit, brenda harkut kohor të shkurtër, nga formimi deri në shpërbërjen e tyre, nuk mundën të përvijonin e të kristalizonin dot sa e si duhej organet e drejtimit ushtarak të formacioneve të tyre, ndonëse në përbërje të saj kishte shumë ish-oficerë të karrierës. Ato mbeten në një fazë të thjeshtë e tepër të zbehtë edhe në drejtim.

Bibliografia:

Dokumente të AQSH-së e AQFA-së:

- fondi 25, dosja $5/_3$, fl. 57;
- fondi 41, dosja 156, fl. 8;
- fondi 253, dosja 513, fl. 57, dt. 24 gusht 1943;
- fondi 260, dosja 31, fl. 48, dt. 12 maj 1944;
- fondi 270, dosja 1, fl. 1, dt. 15 gusht 1943;
- fondi 270, dosja 17, fl. 3, "Qarkore e Komitetit Qendror të B. Kombëtar dërguar komiteteve qarkore", dt. 30 gusht 1943;
- fondi 270, dosja 57, fl. 3, dt. 27 maj 1944;
- fondi $270/_1$, dosja 5, fl. 21, dt. 1 tetor 1944;
- fondi 1056, dosja 3, fl. 12, "Detyrat e kompetencat e komiteteve krahinore", dt. 21 shkurt 1944;
- fondi 270 (Organizata e Ballit Kombëtar), dosja 7, fl. 19, dt. tetor 1943.

Botime të ndryshme:

- Frashëri, Kristo, "Mbi historinë e Ballit Kombëtar", Sh. Botuese "Durda", Tiranë, 2012.
- Lucas. Peter "The OSS in World War II-Albania Covert Operations and Collaboration with Comunist Partisans", (botim shqip) Sh. Botuese "Bota Shqiptare", Tiranë, 2008.
- Kasneci. Lefter "Steeled in the Heat of Battle, A Brief Survey of the National Liberation War of the Albanian People, Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1966.
- Gjoligaj, Valbona (2014). Developing a Sports Club Management Competency Model for Albania: a delphi study (disertacion i doktoraturës i papublikuar). Capella University, Minnesota.
- Leka. Prof. Dr. Shahin "Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSh-së, 1943-1945", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1998.
- Hasani. Prof. Dr. Proletar, "Histori e Pashkruar", Sh. Botuese "Fllad", Tiranë, 1999.
- "Historia e Ushtrisë Shqiptare" (Organizimi), 1912-1944, Sh. Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 2000.
- "Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar" vëll. II, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1986.
- "Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar, 1942-1944", Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1962.
- Smirnova. Nina, "Historia e Shqipërisë, përgjatë shekullit XX", Sh. Botuese "Ideart", Tiranë, 2004.
- Quku Faik, "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", Sh. Botuese "Ilar", Tiranë, 2006.
- Fischer. Bert J., "Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945", Sh. Botuese "Çabej", Tiranë, 2000.
- Fischer Bert J., "Diktatorët e Ballkanit", Sh. Botuese "Aiis", Tiranë, 2008.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Kombinati poligrafik "Shtypshkronja e re", Tiranë, 1985.
- "Organizatat tradhtare, Balli Kombëtar e Legaliteti", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1950.
- Hoxha Enver, "Titistët", Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982.
- Hoxha Enver, Vepra, vëll. 1, botim i dytë, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1983.
- Hoxha Enver, Vepra, vëll. 5, Sh. Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1970.
- Hoxha. Enver, "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re", Sh. Botuese "8 Nëntori, Tiranë, 1984.
- Lleshi Haxhi, "Vite, njerëz, ngjarje", Tiranë, 1996.
- "LANÇ në qarkun e Korçës", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë 1986.
- Lama. Faik "Demaskimi dhe shpartallimi i organizatave tradhtare të B.Kombëtar e Legalitetit", Sh. Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1985.
- "Eqerem bej Vlora", kujtime, Sh. Botuese e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2002.
- Barker. Elisabet, "Shqipëria, Britania dhe rezistenca", dok nr. 177, Beristol 1976, ndodhet pranë Akademisë së FA-së.
- "Historiku i LANÇ-it të ish-qarkut të Durrësit", Maket pranë Akademisë së FA-ve.
- Hibert. Rixhinald, "Fitorja e hidhur", (Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë), Sh. Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë 1991.
- Smajlli. Devid "Me detyrë në Shqipëri", Sh. Botuese e Lidhje së Shkrimtarëve, Tiranë 1993.
- Gazeta "Atdheu", Nr.6, dt. 15 janar 1944.
- Çeli. Xhemil, Gazeta "Labëria", Nr. 239, dt. 15 korrik 2000.

Brief Summary in English

Challenges and new assessments on the eve of the Wales Summit

Dr. Karl-Heinz Kamp
Director of Research Department at NATO Defence College

Short commentary. *From 4 to 5 September, the government leaders of the 28 NATO member countries and high personalities from 30 partner countries will assemble in Wales to discuss about major issues that concern everyone, such as: terrorism, piracy, unstable countries, cyber attacks and challenges to build stability in an unpredictable world. We will also make sure that all NATO nations have the necessary equipments, skills and intelligence needed to protect them.*

But, among all the scopes that this year's NATO summit in Wales will undoubtedly bring, perhaps the most important thing that reiterates the message is that the interests of the free world and its peoples are that, by working closely together, we will always continue to be better protected.

In the following article, Dr. Karl-Heinz Kamp, director of the Research Department at the NATO Defence College, addresses issues related to NATO-Russia relations, missile defence, cyber threats, NATO expansion, U.S.A-as the central actor in Asia, evolution of partnerships, as well as NATO's vision for the post 2014 era.

The views expressed in this article are his personal views and do not necessarily reflect the opinions of the NATO Defence College or the North Atlantic Treaty Organization.

Wales Summit and Albania

Colonel Manushaqe Shehu
Director of J9, GS

Short commentary. *Early September this year, UK will host the biggest meeting of world leaders to discuss about hot topics in the field of global security. The U.S. President Obama, British Prime Minister Cameron, German Chancellor Angela Merkel, along with 60 states' leaders and defence ministers from around the world will attend the next summit of the Euro-Atlantic Alliance in Wales. This very important summit takes place at a time when NATO will decide on the military withdrawal from Afghanistan,*

after a long mission of several years, aiming at the transition of the mission from a combat one into an advisory and training mission. Moreover, the summit comes as a necessity for reducing political tensions caused by the Russian intervention in Crimea and the profound instability in Ukraine.

The aim of the Euro-Atlantic Alliance will be to convey the message that NATO will continue to be in the front line, in order to build stability in an unpredictable world. Another important aspect of Wales summit agenda will be the review and strengthening of the collective defence by improving the capacity and role of the NRF and Special Forces, with emphasis on the improvement of the expenditure budget of 2% of GDP, due to the increase of expenditures by Russia and other countries. In the framework of the collective defence by European countries, the assumption of greater responsibilities will be another issue of discussion in the further modernization of collective defence.

Another issue that will require the attention of the heads of states will be the proactive commitment for a safer complex global environment, the partnership and cooperation with the other countries, especially those in Eastern Europe, the "open-doors policy" and the support for poor countries. Further development of cooperation based on the concept of "Defence Capacity Building" by sending specialists or training teams in the partner countries and the preparation of a comprehensive and ambitious program, will be some of the basic directions of the two-day summit discussions in Wales.

Among all the opportunities that NATO Summit this year will bring, perhaps the most important, it reiterates the message that the interests of the free world and of its people are that, by working closely together, they will continue to be always better protected.

An overview on the Wales Summit

Col. (R) Thimi Hudhra
Deputy Director at National Strategic Defence Centre

Short commentary. *Recently there is an intensive discourse about the next NATO Summit in Wales. After the Strategic Concept of Lisbon and Chicago Summit, and after the finalization of the great mission in Afghanistan, it seemed that NATO would have a more peaceful period. But things did not go like this. These expectations were spoiled by the "polar bear" that awaked. Since 2008, it is being more aggressive challenging NATO like in the case of Georgia, and lately in the case of Ukraine.*

What can be expected next? Everything can be possible in Russia's Foreign Policy and by its increasing defence budgets in the last 10 years. With a greater concern, NATO is increasingly taking into consideration the unpredictable developments and the cold and haughty attitude of Russia towards it. Russian Security Strategy considers NATO and especially its enlargement to the east as a hostile policy. Many analysts state that we are going toward s a cold war of another type. "... The core of Medvedev's doctrine is: "A unipolar world is unacceptable ...".

This assessing survey sets the expectations of NATO agenda for the next summit in Wales. Unlike the previous summits, this summit will focus on greater concerns. Where

is Russia going? What are its goals? Where are the Asian countries, like India and China going? What should NATO do? What needs to be changed in political, economic and financial viewpoints by the Alliance member countries to respond to these changes in the security environment? One thing is certain: Wales Summit will bring new NATO stands towards Russia.

As a NATO member, Albania should normally be part of these changes too. Despite our modest contribution to this organization, we are part of unimaginable benefits of collective defence and security. In consultation with allies, Albania needs to articulate its views for the achievement of consensus in decision-making of the Alliance in this summit.

This is the aim of this strategic assessment, which will be followed by other articles in the following months, before and after Wales Summit. This paper also provides 10 assessments and recommendations that can help the working staffs or decision-making authorities that are going to participate in this summit.

New concept to military education and training in the Armed Forces

Colonel Ruzhdi Kuçi
Deputy Commander of TRADOC

Colonel Ahmet Leka
Chief of Doctrines Centre

Short commentary. *The drastic transformations made in the AF of the Republic of Albania and the need to create an effective force professionally capable to respond the Euro-Atlantic integration requirements and force development, impose always the need for transformation and development of the philosophy of education and training, doctrinal concepts and military thought, generally. Today, it is clear to the entire society that full integration of our country into Euro-Atlantic structures, is a prior strategic goal for the Republic of Albania. The new reality following NATO membership requires and sets at the same time the need for profound changes in the field of education and training of the Armed Forces.*

Government program and the Defence Directive for 2014 lay a number of obligations from an educational, doctrinal, conceptual and structural viewpoint, in order to increase professionalism in fulfilling the full range of operational tasks.

The following paper, after highlighting some of the deficiencies throughout the pyramid of education and training in the Armed Forces, addresses and submits a draft concept for the development of education and training system for the future. It tries to provide the answer to some questions that require solution in such moments the AAF are experiencing, such as: How will the individual preparation of the personnel of the AAF staff carry on in the future? How will the candidates for officers be recruited? What are the recruitment criteria for officer and NCO candidates? How will the career courses be conducted? How can we develop the structure of the Troops School? What will be the impact and proportion of the doctrine, standardization and lessons learned system with the curricula and education and training programs?

In a discreet way, the paper tries to answer the above questions and makes some recommendations, which may be the subject of meetings, discussions, different opinions, in order to generate new ideas and determine the ways that profoundly argue the necessity of drafting a concrete strategy for education and training.

Concepts and ideas for education, training and preparation of state intelligence officers

MSc. LtC. Sokrat Paskali
Head of Intelligence Training "Shawn Pine" Centre in AIM

Short commentary. The intelligence officer is a state employee who works in the intelligence, organization (agency), in the intelligence staff. This is explained in NATO doctrine, AJP 2.0, to clearly distinguish intelligence officer as intelligence staff. Regarding authentic professionalism in the intelligence agencies, it means intelligence staff or a more inclusive concept of "Intelligence Officer".

Considering the architecture, the intelligence employee appears as a category, addressing the specifics of his privacy and reliability, as well as it appears as individually when it comes to the National Intelligence Officer. As a category, the approach is more related to target people groups, structures, community necessaries, extensive quantities, application. etc.

The suggested government and institutional policies, as well as the intelligence schools consider two types of intelligent clerks: employees and seniors which must be chosen or become like this, because they know themselves that they are important and have to do with important things for themselves, as well as for their country and the people to which they belong.

Environmental education of the AAF personnel through legislation

MSc. Valbona Zeka
Lecturer of Physical Education at AAF

Short commentary. *Development of industry has witnessed rapid steps nowadays. Along with its positive sides, this development is increasingly associated with environmental concerns. Industrialized countries, along with powerful environmental organizations, are increasing sensitivity and measures to reduce the negative effects of industry on nature and our shared environment. A great number of international meetings with governments, non-governmental and environmental organizations have been held about these issues.*

In the following paper, we focus on issues related to the acquaintance and respect of international environmental laws, and enforcement of the treaties, agreements and conventions of the field. The aim of Albania to be an EU candidate country dictates the necessity to further improve legislation related to environment. In this context, the impact of the Albanian Armed Forces over environment, our daily life and the ecology of the

surrounding world through military products, equipments, armament and various waste produced by them, is not so small. This paper addresses the obligations and responsibilities of the Armed Forces for the environment in terms of the normal conditions near the installations and firing ranges, as well as during various operations. Another aspect, this paper deals with, is the education of the Albanian Armed Forces personnel by means of legislation and NATO's STANAG-s, ratified by our forces as well.

Defence Strategic Concept of Kosovo Republic as an essential part of state strengthening

Agim Çeku
Minister of Defence of the Republic of Kosova

Short commentary. *The Draft Concept for the Defence of the Republic of Kosovo is a planning document of the policies for the period 2014-2024, which describes the basic strategic principles of national defence, the priorities and measures to ensure national defence. The Draft Concept of Kosovo Defence provides guidance for peacetime and in times when the national security is threatened.*

The Draft Concept of the Kosovo Defence is based on the Strategic Review of the Security Sector, which began on March 2012 and was finalized on March 2014. It is designed on the basis of the geopolitical situation in Kosovo, of the security, national interests and objectives, foreign policy, objectives and international presence in the country.

The Draft Concept of Defence provides the basis for planning national defence activities. It details the specific resources necessary for its implementation, the development of Kosovo Armed Forces (KAF), the required level of readiness and operation of the state and local authorities, individual and legal entities in time of peace and in times when national security is threatened.

Given the economic situation, the implementation of national defence activities and the fulfilment of the functions and tasks legally set for KAF, it should be guaranteed that the implementation must be in accordance with the available resources.

This concept paper is not yet authorized and discussed so far in Kosovo institutions and it is a collection of thoughts, experiences, practices and lessons learned. It also presents the summary of the analysis, findings and recommendations of the Strategic Review of the Security Sector and will serve as the basis for drafting the National Strategy of Defence.

"Task Force"-a pragmatic concept, as well as modern[1]

Short commentary. *We all know the saying "unity is strength". Proven through centuries in the world experience, even nowadays, it sounds meaningful, while being properly used in the intellectual circles, including the military ones, being already tested even in*

[2] This paper was prepared for the Military Review by the Center of Doctrines.

many military concepts and applied practices, like the concentration of forces and means, efforts, etc. The new concept for the use of forces and means for military purposes, in the interest of achieving a specific mission, follows this furrow.

Coming up as a necessity to successfully realize the military goals and missions, this concept, among other things, embodies rationality in the use of force, troops and equipments, in authentic military activities, participation of truly professional and qualitative troops, in such cases. Nowadays, while the range of military operations is estimated quite broad and complex, the thrifty and effective use of troops in them is both a need and necessity. In the simplest sense, the concept of "Task Force" is a certain group of military people or troops, deriving from one or more kinds of forces, newly created, with a new command, to perform a particular military mission, in a certain place and time, in full compliance with the relevant legislation, domestic or international. It should be emphasized that such a structure is temporary.

In essence, "Task Force" is considered as a military structure, newly created by different types of troops of two or more forces, based on the quantity and quality needed, in order to fulfil a mission in the shortest time and with the smallest losses possible. When such a temporary military structure is created by troops of a kind of force, in this case, it is a structure of tactical level, while it also generally performs military tasks of this level (TF). Formed by troops of two or more kinds of forces, depending on the mission assigned to fulfil, it can be assessed also at the operational level. Meanwhile, it can perform tasks of this level, but also those of the strategic level (JTF).

In the case of analogous structures, newly created in the framework of NATO, UN, etc., the mission contains in itself performance of such tasks, which, considering the extent of the effect they create after the end of the military operation, bring about qualitative changes in the balance of forces in the creation of the favourable conditions for the large units, and realise their mission quickly and with minimal losses, by making also impossible for the opponent troops the chances of their mission completion (JCTF).

Apparently, this new concept was born as a necessity in the terms of the complexity of the environment of the war battles, of the creating asymmetry in terms of contemporary actions in the military activities, etc. The need for such a concept was influenced by the situation, always changing, and security in Europe and in the world, but also the rise of unpredictable, diverse and dangerous situations, towards the peace and international stability

The creation of such military units, firstly, means the transfer of command authority in another command, already new. All the activity of the elements that constitute a Task Force structure, henceforth are directed and commanded by a new command cell. In the best case, the axis of such a command cell is constituted by leadership elements of the TF. At the operational leadership level, such one cell is established on the basis of the leadership elements of the force type, in whose jurisdiction the next operation will be performed (JTF).

NRF(NATO Response Force), participation and perspective of the Albanian Armed Forces in this structure

Colonel Ilir Pujo
Deputy Military Representative for Operations,
SHAPE, Mons, Belgium

Short commentary. *Perhaps, not everybody knows that the 2014 is a remarkable event for the Armed Forces, regarding commitments towards NATO. For the first time the Albanian Armed Forces participate actively in the NATO Response Forces (NRF) 2014, with a platoon of Military Police. Expressed in doctrinal terms, a subunit of the Albanian Armed Forces, such as the Military Police platoon, as part of the NRF IRF 2014, will remain stand-by for the period from 1st January to 31st December 2014 at NATO disposal, in accomplishing the missions that could be charged with, under Article 5 and non-Article 5 (Crisis Response Operations).*

On this occasion, for military and civilian readers of the Armed Forces, I deemed useful to make a summary for NATO Response Forces: what this force represents; how has it evolved; what was the road made by the Albanian Armed Forces to participate in it; some lessons learned and what is the perspective of the AF being engaged in this structure.

> *"We ... need to strengthen the communication between our Armed Forces through more joint exercises, education and training and strengthen the NATO Reaction Forces, in order to protect any ally, to be deployable everywhere and prevent every kind of threat..."*
>
> *NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen*

Crimea: The Russian regained paradise?!

Enkelejda Malaj

Short commentary. *The recent month's events in Crimea may seem like deriving from the past centuries. Even a few months ago, for most of us, it might have seemed unimaginable that such events would occur on 2014. But the truth of real politics is not surprising us for the first time.*

Russia, not only has annexed Crimea, not only did this through a democratic instrument, as the popular referendum, having even excellent results, being orchestrated in Crimea and Sevastopol, in attempt to legitimize its position, but it has raised doubts and new fears for Ukraine's future and not only.

In this paper, I will try to give a perspective on the reasons that have encouraged Russia to pursue its imperial zest without hesitation, disregarding the international law, world order and certainly the legitimacy and territorial sovereignty of another country, such Ukraine. Next, I will analyze the international reaction, in response to

these developments, as well as the impacts that are expected to have in the future of international relations.

Leadership in combat

Colonel Dritan Demiraj
Chief of Simulation Centre, TRADOC

Short commentary. *This paper deals with a very important issue that has to do with the good and experienced leadership, as leaders have direct impact on the successful accomplishment of operations. Furthermore, this paper deals with the best examples of our leaders, who have led military operations in the most dangerous areas of the globe, such as Afghanistan, etc. What are the characteristics of a leader in the battlefield, the causes that affect operational safety and what they should do in cases where there is loss of life in combat; how to communicate with family of the deceased, with the general staff and how to act to ensure continuity in the conduct of operations, without allowing the decline of morale and vigilance while carrying out the task.*

Taking into consideration the fact that the participation of the Armed Forces in peacekeeping and combat operations, for more than 15 years, has made it possible for our army to have brave and experienced leaders, who, with dignity and professionalism have earned the trust not only of the top leaders of the Albanian state and the Armed Forces, but also of NATO and U.S leaders. Experience gained, especially in combat missions "Eagle 1-8", has significantly increased the level of management of contingent commanders and commanders of special groups, which is being transmitted in our army in the form of lessons learned and pre-deployment training programs.

Albania and security challenges

LtC. Ali Mali
Chief of "Learned Lessons" Branch,
Doctrines Centre

Short commentary. *Regional and global security structures are constantly in compliance with the frequent changes of the security environment. Even in small countries like Albania, analysts and policy-makers try constantly to determine the trends of the future development, intending to recommend adjusting policies and restructuring of these structures, according to the models of global and regional attitudes. This paper aims to begin with the treatment of security strategy, risks and threats, then deal with future security trends and tasks for our security institutions, where a greater attention is paid to the responsible institutions for national security.*

When it comes to security, there is definitely a need for a theoretical perspective. What do we understand with the term security, what does security represent and what are today's approaches in this field?

Regarding this, this is an attempt to summarize the opinions on national security and human security, a national security perspective, security elements and responsibilities

of key stakeholders for the preparation, approval and implementation of the NSS. The focus is on today's asymmetric threats to security, based on the analysis made, which constitute the major threats, by shifting the balance from traditional external territorial threats to domestic ones like ethnic conflicts, corruption, organized crime, economic backwardness, poverty, catching diseases, drugs, environmental security, etc.

Nowadays, the threat is assessed in non-military terms, and security threats are of non-military nature. Complex future threats will cross geographic borders and boundaries among institutions. Future threats, as complex threats, come from non-state actors more than by state actors.

Security environment will consist of shortening the period of risk warning and on the pressure towards common bureaucracy in regard to emergency that requires quick decision[45].

Armed Forces and family as "greedy institutions"

LtC.MSc. Latif Shurdhi
Lecturer at AAF Academy

Short commentary. *The armed forces, regarding the social sense of the concept and the numerical point of view of its members, are considered as an organisation. Regarding the norms and values they represent, they are an institution. We can say the same regarding the family, because regarding the numerical point of view, it is considered as a group, and regarding the norms which govern its existence and coexistence, it is an institution.*

On the other hand, the family and the armed forces as institutions are part of a particular society. The individual is a very strong tie point of these two institutions, because he is, at the same time, member of family and member of the armed forces. The individual, being simultaneously member of these both institutions, not only plays, in his daily life, these two roles, but he has to play other roles, fulfilled according his capabilities, opportunities and preferences. He has to fulfil them in a balance way, without creating tensions with these institutions, because of his welfare.

The other roles, which are not priority for the individual, will not be subject of this paper, because on this subject, it is important to draw out the relations of the individual with the family, the armed forces and the features of these institutions and the requirements they submit to their member, as well as other additional instruments helping the roles fulfillment, in order to harmonize the relations of the individual with the institutions.

"Puzzles" of peacekeeping and peacemaking "world"

Colonel PhD. Zaho Golemi
MSc. Granit Zela
Armed Forces Academy

Short commentary. *The peacekeeping and peacemaking "world" became a new "profession" of the military. Peacekeeping became an object of study and analyses of*

the sociological studies. The Latin "Socius" and the Greek "Logos"[6] are also part of the military studies, while the sociological science is not a "privilege" of civil human space, but actually it involves a further broader spectrum.

The Albanian society has faced, for more than two decades, phenomena and issues related to the military. The most serious engagement began when Albania became part of the peacemaking and peacekeeping troops in Iraq, Afghanistan, Chad, Bosnia-Herzegovina and Georgia. The exportation of security is associated by psychological and sociological aspects which are rarely become subject of the Albanian sociologic studies.

Considering as a starting point of investigation the fact that over 6.000 Albanians have served in uniform in dozens of peacemaking missions, the sociologic studies should take into consideration the psychological and sociological characteristics, but also can study, at the same time, their impact on the daily lives of military who served and continue to serve in peacekeeping missions.

Known and unknown research issues of the military "world" initiate military debates and discussions about an unknown and diverse field of peacekeeping and peacemaking "world" as a valuable specific research issue in human sciences.

"Flexible Response" strategy, proportional response strategy to the threats

MSc. Agron Malaj
LtC. Aleksandër Pando
Armed Forces Academy

Short commentary. *The Cold War was product of the division of the world into two opposing factions, whose leaders played the role of the two superpowers and these two groups practiced against each other all kinds of political, military, economic and psychological pressures. This period was characterized by a serious commitment of the United States administration to prevent the spread of communism in the world, followed by the drafting of a number of strategies, among which it is distinguished the strategy of "Flexible Response".*

The origin of this strategy dates back from the book by General Maxwell D. Taylor "The Uncertain Trumpet". In this book he presented a program called "Flexible Response" explaining that his goal was to suggest the need for a capacity to respond to the whole spectrum of possible challenges, coping with all situations ranging from limited local conflicts to general atomic war. The demand for such a wide capacity was justified on the grounds that it is necessary to prevent or quickly win limited wars, as well as to prevent general wars.... According to General Taylor, United States should prepare themselves to respond anywhere, anytime, with appropriate weapons and forces, in accordance with the situation. This constituted the foundation of the "Flexible Response" strategy.

Beginnings of diplomatic communication in Illyrian communities

PhD. Jaup Zenuni
Armed Forces Academy

Short commentary. *Native Albanian archive sources, historical and archaeological documents, which can testify the beginning of diplomatic communication on the lands that nowadays comprise Albania, at least so far, are scarce. The reason for this may be found in several factors as: this area being, through centuries, a battlefield where the great powers have been clashed with each other, at different historical stages; the disappearance of written traces due to the lack of care or to the different anti-Albanian elements; lack of capable chroniclers to describe the ways the Albanians established their relationships with neighbours and other countries. However, this does not mean that the Illyrian tribes that lived in the kingdoms of these areas, did not have relationships with neighbouring kingdoms and nations, and beyond.*

Despite the fact that this communication is not documented by authentic documents or sources so far, there is no doubt that Illyrians had relations with other people, because communication is a necessity for markets, for agreements, for peace, for relationship among cultures. Illyrian tribes, who lived in territories where Albanians live today, could not reside in an isolated island far from the rest of the world. So, they definitely had their ways and forms of communication with other people. What we do not have today from authentic Illyrian sources is what were the dynamics of this communication, how was it conducted, what were the ways and means to attain it.

Key words: *diplomatic communication, Illyrian communities, relations, kingdoms.*

Characteristics of General Staff of Albanian Military Forces in Second World War

PhD. Asllan Zemani,
Military historian
MSc. Afërdita Hajro,
Specialist at Albanian National Archive

Short commentary. *The Command and the General Staff led skilfully the National Liberation Army (NLA) to fulfil its final strategic mission for the liberation of the country. Furthermore, a part of partisan formations fought for the liberation of most of the Albanian territories, outside the borders of Albania. Fulfilling its commitment in the context of the global Anti-Fascist Grand Coalition with dignity, the Command, the General Staff and the Albanian Army chased the German occupiers and their collaborators, who withdrew with them, up to Visegrad (Southern Bosnia).*

Although Balli Kombëtar (National Front) tried to get organized, in order to achieve the overall or partial direction of forces, it could be said that the forces suffered from organizational uncertainties and lack of task setting for the duties they have to be

performed. These shortcomings led to the decline of quality of management and significantly and negatively impacted the hostilities of the National Front Forces in the battlefield.

The Armed Forces of Legaliteti (Legal Movement), within a short time, from their formation until their dissolution, could not efficiently delineate and crystallize, in a proper way, the leading structures of their military formations, though they had many career officers within their ranks. They remained in a simple and weak stage of leadership.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

"Revista Ushtarake" është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, përparësia numër një e RU janë vlerat zbatuese të krijimtarisë origjinale të autorit.

Ftojmë studentët ushtarakë e civilë të sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes të jenë të pranishëm me shkrimet e tyre në faqet e RU-së. Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit, me tre deri në katër fjalë.

Autori, bashkautori: Shkruhet emri i autorit ose bashkautorëve të artikullit.

Trajtesa e shkurtuar: Është pjesa që paraprin një artikull. Tek trajtesa autori shkurtimisht, duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet ose rekomandimet, etj). Trajtesa nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë të 400 fjalët.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe hapësirat përfshi edhe *"endnotes"* dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: "Times New Roman"; Madhësia e shkrimit 11. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numërzuar; teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerat bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike dhe me CD në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Këshillin Botues.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen, nga çdo autor, të artikujve e trajtesave me referenca dhe *"footnote"* si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. *"Footnote"* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, *website*-in ku ndodhet artikulli. *(p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209,* http:/www. iir.cz/ display.asp?lng=uk&ida=*).*

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të paraqesë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime të cilat duhet të jenë zgjidhje të propozuara për realitetin tonë.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.

Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrime e as qëndrime politike apo partiake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Doktrinës, KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QD, Dega e Botimeve
Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext. 516 /1195, 516/ 1159

Mobile: 0664050100/0664050220

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al qdm@aaf.mil.al
ahmet.leka@aaf.mil.al silvana.markgjonaj@aaf.mil.al

Redaksia e Revistës Ushtarake